



# PSIKOLOGJI

**prof. dr. sci. Mujo Hasković**

SARAJEVË / PRISTINË 2006

FSK/S - 10/06

## PARATHËNIE:

Një nga fushat e para të interesimit të njeriut për njohje është fusha e jetës së tij psikike. Si *homo sapiens* njeriu vazhdimisht është përpjekur të njohë natyrën që e rrethon, por edhe qëndrimin e tij ndaj asaj rrethine. Ky interesim ekziston edhe sot, e për shkak të ndërlikueshmërisë së saj, jeta psikike e njeriut do të mbetet fushë që përvetësohet vështirë, por edhe fushë intriguese për hulumtime të reja. Në saje të psikologjisë bashkëkohore sot realiteti psikik akceptohet si pjesë e realitetit të përgjithshëm, d.m.th. si sintezë e realitetit natyror dhe shoqëror. Njohuritë fundamentale nga psikologjia gjithnjë e më shumë aplikohen në sfera të ndryshme të veprimtarisë së njeriut. Kështu, psikologjia ka gjendur vendin e vet në fushën e patologjisë sociale, të sjelljes asociale dhe kriminale. Rëndësi të veçantë psikologjia ka për një numër të madh masash dhe veprimesh operative – teknike, të metodave dhe të teknikave kriminalistike në zbulimin e provave materiale, si dhe të veprimeve dhe të dëshmisë hulumtuese të fajit në procedurën gjyqësore.

Funksioni i risocializimit të personave të gjykuar në kuadër të trajtimit penologjik mbështetet në njohuritë nga psikologjia. Në fund, punëtorët operativë të organeve të punëve të brendshme, policët, kriminalistët gjatë punës së vet komunikojnë me një numër të madh njerëzish, e atë komunikim e ndërlikon një numër i madh i indikatorëve të natyrës psikologjike. Pasi që aftësia e komunikimit me njerëzit e profileve të ndryshme psikologjike nuk trashëgohet, por ajo arrihet përmes procesit të mësimit dhe të përvetësimit të dijeve, është e nevojshme që studentët e Fakultetit të Shkencave të Kriminalistikës të përvetësojnë informata të caktuara dhe të fitojnë njohuri të caktuara nga psikologjia e përgjithshme, psikologjia e personalitetit, psikologjia sociale, psikologjia e komunikimit, në mënyrë që të aftësohen për punët efikase dhe humane me njerëzit. Të gjithë këto do t'u ofrojnë programi i propozuar nga moduli / lënda mësimore – psikologjia.

Njohja e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Kriminalistikës me nocionet fundamentale nga psikologjia e përgjithshme, psikologjia e personalitetit, psikologjia sociale, psikologjia e komunikimit, me theks të veçantë mbi njohuritë aplikative psikologjike lidhur me punët e kriminalistit. Për studentët e Fakultetit të Shkencave të Kriminalistikës, kjo është para së gjithash:

- Pjesë e arsimimit dhe e kulturës së përgjithshme;
- Njohuri shkencore që do t'u mundësojë punë më të suksesshme pas përfundimit të studimeve;
- Bazë për bashkëpunim më të suksesshëm me ekspertët e tjerë nga fusha e shkencave shoqërore dhe natyrore;
- Bazë për të kuptuarit më të lehtë të përmbajtjeve nga disa module/lëndë të tjera siç janë: sociologjia, psikopatologjia, kriminologjia, kriminalistika, penologjia, etika etj.

Rezultatet e procesit mësimor nga moduli / lënda e psikologjisë do të jenë shprehje e qëllimeve të parashtruara. Njeriu në tërësinë e vet është i determinuar me faktorët

biologjikë, psikologjikë dhe faktorët e mjedisit ku jeton dhe zhvillohet. Duke i përvetësuar informatat nga moduli i psikologjisë, studentët do të kenë mundësi të njohin komponentën psikologjike të njeriut, me çka para së gjithash do të mund ta njohin veten, por edhe sjelljet karakteristike të njerëzve të tjerë. Kjo do t'ju ofrojë arsimim të gjerë të përgjithshëm, do t'ua humanizojë marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, në sajë të transferimit pozitiv të njohurive do t'ju mundësojë përvetësimin e njohurive të reja nga fushat e tjera shkencore, do t'u ndihmojë që më lehtë dhe në mënyrë më efikase t'i kryejnë punët e kriminalistikës.

Kjo skripte është e përgatitur për studentë të Universitetit të Sarajevës, të Fakultetit të Shkencave të Kriminalistikës në Sarajevë, si dhe për studentë të Universitetit AAB-ARENA E ARSIMIT BASHKËKOHOR, PRISHTINË.

Sarajevë, tetor 2006

Autor:  
Prof. dr. sci. Mujo Hasković

## KAPTINA 1

### ÇKA ËSHTEË PSIKOLOGJIA?

**Psikologjia është shkencë mbi shpirtin.**

**Psikologjia studion proceset dhe sjelljet e vetëdijshme dhe të pavetëdijshme psikike të individit.**

**Psikologjia** studion në aspektin shkencor sjelljen dhe proceset psikike. Objekti i interesimit të psikologëve përfshin sistemin nervor, ndjenjat dhe perceptimin, të mësuarit dhe kujtesën, inteligjencën, gjuhën dhe të folurit, mendimin, rritjen dhe zhvillimin, personalitetin, stresin dhe shëndetin, **çrregullimet psikologjike**, mënyrat e zbutjes dhe të mënjanimin të çrregullimeve psikologjike, sjelljen seksuale, si dhe sjelljen e njerëzve në rrethana sociale, d.m.th. në grupe të ndryshme dhe në organizata shoqërore.

### PSIKOLOGJIA SI SHKENCË

Psikologjia, si edhe shkencat e tjera, përpaket t'i përshkruajë, sqarojë, parashohë dhe kontrollojë dukuritë që i studion. Pra, psikologjia përpaket të përshkruajë, sqarojë, parashohë dhe kontrollojë sjelljen dhe proceset psikike.

Kurdoherë që kjo është e mundur, emërtimet dhe nocionet përshkruese lidhen me teorinë. Teoritë paraqesin formësimin e tërësishëm të raporteve të qarta midis dukurive të vërtetuara. Teoritë psikologjike mbështeten në supozimet mbi sjelljen dhe proceset psikike, përmbajnë pohime mbi parimet dhe ligjshmëritë që sundojnë midis tyre dhe na bëjnë të mundshëm paraqitjen e sqarimeve dhe të parashikimeve. Teoritë psikologjike mund t'i ndërlidhin pohimet mbi sjelljen (siç është të ushqyerit ose agresioni), proceset psikike (mentale) (siç janë qëndrimet ose parafytyrimet), si dhe mbi strukturat anatomike ose proceset biologjike. Për shembull, shumë prej reaksioneve tona ndaj drogës sikurse ndaj alkoolit apo marihuanës, mund të maten kur manifestohen në sjellje, e supozohet se ajo sjellje shpreh veprimin biokimik të drogave si dhe parashikimet tona (mentale) mbi ndikimin e tyre. Psikologët verifikojnë, gjithashtu, teoritë e veta të përpiluara me kujdes me anë të metodave hulumtuese, siç janë hulumtimet dhe eksperimentet në terren. Teoria e kënaqshme psikologjike na i bën të mundshme parashikimet. Për shembull, teoria e kënaqshme mbi urinë do të na bëjë të mundshëm parashikimin kur do të hanë njerëzit e kur jo. Mirëpo, në psikologji për shumë teori është konstatuar se nuk janë të afta të sqarojnë ose parashikojnë atë që është vërejtur. Për këtë arsye, ato teori janë braktisur ose janë ndryshuar.

Nocioni i kontrollimit të sjelljeve dhe të proceseve psikike është kontravers. Disa njerëz gabimisht mendojnë se psikologët kërkojnë mënyra që t'i shtojnë njerëzit e tjerë ta bëjnë atë që u urdhërohet – sikurse kukullave në pe. Kjo nuk është ashtu. Psikologët janë të prirur të besojnë në dinjitetin e qenieve njerëzore, kurse dinjiteti i njeriut kërkon që njerëzit të jenë të lirë të marrin vendime të veta dhe të zgjedhin sjelljen e vet. Tërë kohën psikologët mësojnë gjithnjë e më shumë për ndikimet në sjelljen e njeriut, por atë dijeni

ata e aplikojnë vetëm në bazë të kërkesës dhe për t'u ndihmuar njerëzve në realizimin e nevojave të tyre.

## **PSIKOLOGJIA E APLIKUAR**

Psikologët kanë interesim të shprehur të përbashkët për sjelljen, por mund të dallohen shumë mes veti. Disa psikologë në radhë të parë janë të angazhuar në **hulumtime themelore** (që ndonjëherë quhen bazike ose teorike apo hulumtime të pastra). Hulumtimet themelore nuk kanë aplikim të drejtpërdrejtë në problemet personale ose shoqërore, prandaj për këtë arsye konsiderohen hulumtime që kanë vetveten për qëllim. Psikologët e tjerë merren me **hulumtime aplikative**, që i dedikohen kërkimit të zgjidhjeve për problemet specifike personale ose shoqërore. Megjithëse hulumtimet themelore nxiten nga kureshtja dhe dëshira për dije dhe mirëkuptim, hulumtimet e sotme themelore shpeshherë përmirësojnë mënyrën e nesërme të jetesës. Për shembull, hulumtimet themelore të të mësuarit dhe të motivimit të kryera ndaj kafshëve në fillim të këtij shekulli kanë gjetur një aplikim të gjerë në sistemet e sotme shkollore. Hulumtimet themelore të veprimit të sistemit nervor i kanë zgjeruar njohuritë mbi çrregullimet siç janë epilepsia, sëmundja e Parkinsonit, sëmundja e Alzheimerit.

Shumë psikologë nuk janë inkuadruar në kurrfarë hulumtimesh. Në vend të kësaj, ata aplikojnë njohuritë psikologjike që t'u ndihmojnë njerëzve të ndryshojnë sjelljen e vet në mënyrë që të mund t'i arrijnë në mënyrë më të efektshme qëllimet e veta. Psikologë të shumtë merren kryesisht me mësim. Ata i zgjerojnë njohuritë psikologjike në klasë, seminare dhe punishte të ndryshme.

Mirëpo, të shumtë janë psikologët e inkuadruar në të gjitha këto aktivitete: hulumtim, këshillim dhe mësim. Për shembull, profesorët e psikologjisë zakonisht zbatojnë hulumtime të pastra ose të aplikuara, u japin këshilla klientëve individualë ose industrialë dhe i mësojnë.

### **Psikologët klinikë dhe psikologët këshillëdhënës**

Psikologët klinikë u ndihmojnë njerëzve që kanë probleme psikologjike në përshtatjen ndaj kërkesave jetësore. Problemet e klientëve mund të shkojnë nga ankthi dhe depresioni, vështirësitë në jetën seksuale e deri te humbja e qëllimeve jetësore. Psikologët klinikë i vlerësojnë problemet me anë të intervistave strukturore dhe të testeve psikologjike. U ndihmojnë klientëve të vet në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe në ndryshimin e sjelljes së papërshtatshme me aplikimin e **psikoterapisë dhe të terapisë biheviorale**.

### **Psikologët shkollorë dhe arsimorë**

Psikologët shkollorë janë të punësuar në sistemin shkollor dhe u ndihmojnë atyre që kanë të bëjnë me problemet që e pengojnë të mësuarit. Problemet e tilla përfshijnë problemet sociale dhe familjare, problemet emocionale dhe vështirësitë

specifike të të mësuarit. Psikologu shkollor i konstaton problemet e nxënësve me anë të intervistës me mësuesit, prindërit dhe vetë nxënësit.

### **Psikologët zhvillimor**

Psikologët zhvillimor i studiojnë ndryshimet – trupore, emocionale, kognitive dhe sociale – që ndodhin gjatë tërë jetës. Ata përpiqen të veçojnë ndikimin relativ të trashëgimisë (natyrës) nga rrethina (edukimi) në zhvillim. Psikologët zhvillimor zbatojnë hulumtime mbi ndikimin e përdorimit të drogës nga ana e nënës në embrion, përfundimet e formave të ndryshme të edukimit të fëmijëve, njohuritë e fëmijëve mbi hapësirën dhe kohën, konfliktet e adoleshentëve, përshtatjen e njerëzve më të moshuar.

### **Psikologët që merren me personalitetin dhe psikologët socialë**

Psikologët që merren me personalitetin e njeriut përpiqen t'i caktojnë tiparet njerëzore; të përcaktojnë se çka ndikon në proceset mendore të njeriut, ndjenjat dhe sjelljet, si dhe t'i sqarojnë çrregullimet psikologjike. Ata merren sidomos me problemet e njeriut sikur janë ankthi dhe agresioni, si dhe me çështjet e roleve gjinore.

Psikologët socialë në rend të parë orientohen në natyrën dhe në shkaqet e të menduarit dhe të ndjenjave të individëve dhe në sjelljen e tyre në situatat sociale. Psikologët që studiojnë personalitetin përpiqen që brenda personit t'i gjejnë disa interpretime të sjelljes, kurse psikologët socialë orientohen në ndikimet shoqërore ose të jashtme. Në sjellje veprojnë edhe ndikimet e brendshme dhe të jashtme.

### **Psikologët industrialë**

Psikologët industrialë janë të orientuar në raportet midis njeriut dhe punës. Psikologët e organizatave studiojnë sjelljen e njerëzve në organizata siç janë ndërmarrjet e ndryshme. Mirëpo, shumë psikologë janë të arsimuar për të dy fushat. Psikologët industrialë dhe ata të organizatave janë të punësuar në organizatat afariste me detyrë që t'i përmirësojnë kushtet e punës, të shtojnë produktivitetin dhe – nëse kanë arsimim për këshillime – punojnë me të punësuarit që kanë probleme në punë. Ndihmojnë gjatë punësimit, arsimimit dhe përparimit.

## **ZHVILLIMI HISTORIK I PSIKOLOGJISË**

Psikologjia ka një të kaluar të gjatë, por një histori të shkurtër.

Megjithëse duket që rezultatet e hulumtimeve dhe zhvillimi teorik ndryshojnë pamjen e psikologjisë gjatë çdo disa viteve, projektin e këtij teksti mësimor ka mundur ta shkruajë filozofi grek Aristoteli (rreth viteve 384 -322 para Krishtit). Një nga veprat e Aristotelit është quajtur Peri Psyches, që do të mund të përkthehej si “Mbi psikën”. Peri Psyches, si edhe ky libër, fillon me historinë e psikologjisë së të menduarit dhe pikëpamjet historike mbi natyrën e psikikës dhe të sjelljes.

Aristoteli gjithashtu ka pohuar se njerëzit janë të motivuar në mënyrë bazike që të kërkojnë kënaqësinë dhe t'i shmangen dhembjes, qëndrim ky që e ka shfrytëzuar teoria moderne psikodinamike dhe teoritë e të mësuarit.

Ekzistojnë edhe kontribute të tjera të grekëve të vjetër. Demokriti (rreth viteve 460-370 para Krishtit), për shembull, ka theksuar se sjellja jonë është nën ndikimin e ngacmimeve të jashtme. Ai ka qenë një nga të parët që ka parashtruar çështjen se a ekziston diçka e tillë siç është vullneti i lirë ose zgjedhja.

Platoni (rreth viteve 427-347 para Krishtit), nxënës i Sokratit (rreth viteve 470-399 para Krishtit), ka shënuar këshillën e Sokratit “njihe vetveten”. Që nga atëherë kjo është motoja e mendimit psikologjik. Sokrati ka konkluduar se ne nuk mund të arrijmë njohjen e plotë të vetvetes me anë të ndjenjave tona sepse ato nuk janë shprehje e saktë e realitetit. Edhe sot dallojmë ngacmimet që veprojnë në receptorët tonë të ndijimit nga perceptcionet dhe ndijimet tona shpeshherë të shtrembëruara. Pasi që ndijimet e bëjnë të mundshme njohjen e papërkryer, Sokrati ka propozuar që ta studiojmë vetveten me anë të të menduarit racional dhe të **introspeksionit**.

Mirëpo, le t'i kthehemi zhvillimit të psikologjisë si shkencë laboratorike në gjysmën e dytë të shekullit 19. Disa historianë vejnë datën e fillimit në vitin 1860. Atëherë Teodor Gustav Fechner (1801-1887) ka botuar librin që është gur kufitar në psikologji: “Elementet e psikofizikës”. Ajo ka treguar se në çfarë raporti janë dukuritë fizike (siç janë drita dhe zëri) me dukuritë psikologjike të ndijimit dhe të perceptcionit. Fechner gjithashtu ka treguar se si mund të masim shkencërisht efektet e atyre dukurive. Shumica e historianëve e vendos fillimin e psikologjisë moderne si shkencë laboratorike në vitin 1879. Atë vit Wilhelm Wundt (1832-1920) ka themeluar laboratorin e parë psikologjik në Leipzиг të Gjermanisë.

## **DREJTIMET MË TË RËNDËSISHME PSIKOLOGJIKE**

### **Strukturalizmi**

“Wilhelm Wundt, sikurse Aristoteli, ka konkluduar se psiqika është dukuri natyrore, që mund të studiohet shkencërisht si dhe drita, ngrohtësia dhe qarkullimi i gjakut. Wundt ka shfrytëzuar introspeksionin duke u përpjekur t'i zbulojë elementet themelore të përjetimit. I ballafaquar me drita dhe tinguj të ndryshëm, ai dhe kolegët e tij kanë vërtetuar vetveten se si do t'i përshkruanin ndijimet dhe ndjenjat e veta.

Wundt dhe nxënësit e tij e kanë themeluar shkollën psikologjike të njohur si **strukturalizëm**. Strukturalizmi përpqej të caktonte organizimin e përjetimeve të vetëdijshme. E ka zbërthyer përjetimin në ndijime **objektive** siç janë të parit ose shijimi dhe ndjenjat **subjektive** si reaksione emocionale, të vullnetit dhe të parafytyrimeve mentale (për shembull kujtimet ose ëndrrat). Strukturalistët besonin se mendja funksionon me kombinimin kreativ të elementeve të përjetimit.

Një nga nxënësit amerikan të Wundtit ka qenë edhe G. Stanley Hall (1844-1924). Interesimi kryesor i Hallit përfshinte zhvillimin psikologjik në fëmijëri, adoleshencë dhe në moshën më të shtyrë. Hallit zakonisht i atribuohet themelimi i fushës së psikologjisë së fëmijëve. Ai është edhe themelues i Shoqatës psikologjike amerikane (APA).

### **Funksionalizmi**

*Kam dëshiruar që, duke vepruar me psikologjinë si me shkencë natyrore, t'i ndihmoj të bëhet e tillë.*

#### **WILLIAM JAMES**

Nga fundi i shekullit 19, William James (1842-1910), vëllai i shkrimtarit Henry James, miraton një pikëpamje të gjerë mbi psikologjinë, duke u orientuar në raportet midis përjetimit dhe sjelljes. James pohon se ekziston një rrymë e pandërprerë e rrjedhës së vetëdijes. Introspeksioni e ka bindur se përjetimi nuk mund të zbërthehet në njësi, siç mendonin strukturalistët.

James ka themeluar shkollën e funksionalizmit që merret me sjelljen si dhe me vetëdijen. Funksionalizmi shqyrton mënyrat me të cilat përjetimet dhe përvoja na mundësojnë përshtatjen e sjelljes ndaj rrethinës në të cilën gjendemi. Funksionalizmi shfrytëzon vërtetimet laboratorike si plotësim i introspeksionit. Strukturalistët praktikojnë të pyetnin: “Cilat janë pjesët e proceseve psikike?”, kurse funksionalistët ishin më të prirur të pyetnin: “Cili është qëllimi (funksioni) i sjelljes dhe i proceseve psikike? Cilat janë efektet e tyre?”.

Funksionalistët mendojnë se ndërthurjet adaptative të sjelljes janë të mësuara dhe të pandryshueshme. Sjellja e papërshtatur anon kah zhdukja ose ndërprerja. Veprimi i përshtatur anon kah përsëritja dhe bëhet shprehje. James ka shkruar se “shprehja është një rrotë jashtëzakonisht balancuese e shoqërisë”. Shprehja e mban shoqërinë nga dita në ditë.

Krijimi i shprehjeve pasqyrohet në veprimet siç janë futja e lugës në gojë ose shtypja e dorëzës së derës. Së pari, ato veprime kërkojnë kujdes të plotë. Nëse jeni në dilemë, ndaluni me facoletën e letrës në dorë dhe vështroni pak fëmijën gjatë përpjekjes së tij që për herë të parë të ushqehet vetë. Me anë të përsëritjes, veprimi që paraqet të ushqyerit e pavarur bëhet automatik, d.m.th. bëhet shprehje. Veprimtaria e shumëfishtë e përfshirë në të mësuarit e drejtimit të automjetit me anë të përsëritjes bëhet gjithashtu rutinore. Pas kësaj mund ta realizojmë pa ndonjë kujdes të veçantë. Atëherë lirisht mund të orientojemi në konverzim interesant ose në ndonjë radio emision. Ideja mbi të mësuarit me anë të përsëritjes është ide themelore edhe për traditën bihevioriste.

### **Biheviorizmi**

John Broadus Watson (1878-1958) konsiderohet themelues i **biheviorizmit** amerikan. Funksionalizmi ishte përhapur në vend dhe dominonte në Universitetin e Çikagos. Funksionalistët merreshin me rrjedhën e vetëdijes si dhe me sjelljen e vëzhguar.



Watson hidhërohej me përpjekjet introspektive të funksionalistëve në studimin e vetëdijes, sidomos të vetëdijes së kafshëve të ulta. Pohonte se psikologjia, nëse ka për qëllim të bëhet shkencë natyrore, si fizika ose kimia, duhet të kufizohet në dukuritë e vërejtura, të matshme. Duhet të kufizohet në sjellje. Ato sjellje janë publike dhe mund të maten me anë të vërtetimit të thjeshtë ose me instrumente laboratorike. Psikologjia nuk ka nevojë të merret me “elemente të vetëdijes”. “Elementet” e tilla janë të arritshme vetëm për organizmin që i vërteton. (Bihevizistët definojnë psikologjinë si studim shkencor i sjelljes, e jo të sjelljes dhe të proceseve psikike).

Psikologu B.F. Skinner (1904-1990) nga Universiteti i Harvardit aplikon në bihevizorizëm nocionin e **mbështetjes**. Organizmat, konsideronte Skinner, mësohen të sillen në mënyrë të caktuar sepse janë të mbështetur të sillen ashtu. Shumë psikologë kanë pranuar pikëpamjen e tillë sipas të cilës, në parim, sjellja ndërlikuar njerëzore mund të sqarohet me grumbullin e të mësuarit individual me anë të mbështetjes.

### **Geshtalt psikologjia**

Në Gjermani në vitet 1920 dallohej edhe një shkollë e psikologjisë – Geshtalt psikologjia. Viteve të tridhjeta tre themelues të asaj shkolle – Max Wertheimer (1880-1943), Kurt Koffka (1886-1941) dhe Wolfgang Kohler (1887-1967) e braktisin Evropën në mënyrë që t’ju shmangen kërcënimeve naziste. E vazhdojnë punën e vet në shtetet e Bashkuara.

Wertheimer dhe kolegët e tij ishin orientuar në perceptcionin dhe në ndikimin e perceptcionit në të menduarit dhe në zgjidhjen e problemeve. Për kundër bihevizoristëve, geshtalt psikologët pohonin se askush nuk mund të shpresojë që të kuptojë karakterin e njeriut duke u orientuar vetëm në sjellje. Përkundër strukturalistëve, konkludojnë se askush nuk mund ta sqarojë perceptcionin e njeriut, emocionet ose proceset mendore me anë të njësive bazike. Perceptcionet janë më të shumta se shumata e pjesëve të tyre. Geshtalt psikologët e kuptonin perceptcionin si tërësi që u jep domethënie pjesëve.

Geshtalt psikologët dëshmonin se si jemi të prirur t’i vërejmë pjesët e veçuara të informatave si tërësi të bashkuara, duke përfshirë edhe kontekstin e pranishëm. Ata pohonin se perceptcioni i njeriut nuk mund të sqarohet në bazë të njësive bazike sepse kemi prirje të interpretojmë vërtetimin tonë të gjërave si tërësi në kuadër të kontekstit të pranishëm. Në mënyra të ndryshme do ta interpretoni vrapimin e njeriut drejt jush varësisht nga ajo se a gjendeni në një rrugë të zbrazët në mes të natës ose në stacionin e tramvajit në mëngjes kur shkoni në punë.

Geshtalt psikologët besonin se të mësuarit mund të jetë aktiv dhe i përshtatshëm, jo vetëm pasiv dhe mekanik si në eksperimentet e Pavlovit me qentë. Wolfgang Kohler dhe të tjerët kanë dëshmuar se të mësuarit është arritur shumë herë me anë të **të vërejturit** e jo me anë të përsëritjes mekanike.

## Psikoanaliza

Psikanaliza është shkollë e psikologjisë që e ka themeluar mjeku i cili në vitet 1930 ishte strehuar në Angli që t'i shmangej tiranisë naziste – Sigmund Frojd (1856-1939). Teoria e Frojdit ka depërtuar shumë më shumë në kulturën e përgjithshme se teoritë e tjera. Ndoshta tashmë jeni njohur me të. Për shembull, ndonjë person jostabil do të bëjë vrasje masive së paku në një TV-seri kriminalistike për çdo sezonë. Konkluzioni tipik i psikiatrit në seri do të jetë se vrasësi në mënyrë të “pavetëdijshme” e ka eliminuar nënën ose babait e tij. Ose ndoshta miku juaj është përpjekur “t’ua sqarojë” gabimin gjuhësor që e keni bërë ose ka pyetur çka mendoni çfarë do të mund të ishte domethënia simbolike e ndonjë ëndrre.

Ideja që njerëzit i lëvizin impulset e fshehura, dhe se gabimet verbale edhe ëndrrat i paraqesin si dëshira të pavetëdijshme në masë të madhe shpreh ndikimin e Frojdit. Psikologët akademikë i zbatojnë hulumtimet e veta kryesisht në laborator. Ndërkaq, Frojdi i kupton njerëzit me anë të bisedave klinike. Ishte i hutuar me faktin që njerëzit kanë aq pak njohuri mbi motivet e veta. Disa njerëz arsyetojnë, ose racionalizojnë sjelljen më të neveritshme me sqarime absurde. Të tjerët nuk e humbin rastin që të fajësojnë vetveten pothuaj për çdo fatkeqësi që e ka goditur gjininë njerëzore.

Frojdi krijon bindjen se proceset e pavetëdijshme, sidomos impulset primitive seksuale dhe agresive, kanë ndikim shumë më të madh në sjelljen e njeriut sesa të menduarit e vetëdijshëm. Frojdi konsideronte se shumica e psikikës është e pavetëdijshme. Ajo përbëhet nga ena e kaldajës së vluar të impulseve, të nxitjeve dhe dëshirave konfliktuale. Njerëzit janë të motivuar t'i kënaqin ato impulse, sado që disa prej tyre do të ishin të këqija. Por njëkohësisht, njerëzit janë të motivuar që vetveten ta vlerësojnë si person të ndershëm dhe të moralshëm. Aq shpesh e mashtrojnë vetveten në aspektin e motiveve të veta reale. Për shkak të forcave të supozuara themelore lëvizëse të personalitetit, teoria e Frojdit është quajtur teori psikodinamike.

Frojdi e definon veprimin psikoterapeutik të quajtur psikanaliza. Qëllimi i psikanalizës është t'u ndihmojë njerëzve të kenë mbikëqyrje mbi konfliktet e vendosura thellë dhe të gjejnë mënyrën e pranueshme shoqërore të shprehjes së dëshirave dhe të plotësimit të nevojave. Terapia psikoanalitike është proces që mund të zgjasë me vite.

Duke debatuar për strukturën e personalitetit Frojdi i definon tri instanca ose struktura:

1. “Id” ose ajo;
2. “Ego” ose unë;
3. “Super ego” ose mbi unë, që ka dy nënstruktura:
  - a) Egon ideale
  - b) Vetëdijen.

Lidhur me zhvillimin e personalitetit, Frojdi i definon pesë faza ose etapa të zhvillimit të personalitetit.

1. Faza orale;
2. Faza anale;
3. Faza faluse;
4. Faza e latencës ose e pushimit;
5. Faza e gjenitale.

## **KAPTINA 2.**

### **METODAT DHE TEKNIKAT E HULUMTIMIT NË PSIKOLOGJI**

- “Metodë shkencore quhet zakonisht grumbulli i veprimeve dhe i proceseve të ndryshme me anën e të cilave vihet deri te njohuritë dhe proceset shkencore”, (Midhat Shamiq, 1984).
- METODA – është mënyrë e përgjithshme e organizimit të hulumtimit të ndonjë problemi.

#### **METODAT I NDAJMË NË:**

1. METODA DESKRIPTIVE (deskribere – të përshkruhet)
  2. METODAT KORELATIVE (ndërlidhshmëria midis disa dukurive, variableve)
  3. METODA EKSPERIMENTALE (eksperimenti i parashtruar shkencërisht, kontrolli i mundshëm i kushtit).
- Eksperimenti natyror;
  - Eksperimenti laboratorik.

#### **METODAT DESKRIPTIVE TË HULUMTIMIT SHKENCOR JANË:**

- a) Metoda e vërtetimit natyror
- b) Metoda e vërtetimit
- c) Metoda e rastit –(case study).

### **METODA E VËRTIMIT TË NATYRSHËM**

Mund ta definojmë si metodë shkencore me anë të së cilës organizmi vërtetohet në rrethinën e vet natyrore. Sot këtë metodë e shfrytëzojnë me të madhe “psikologët ekologjikë”, kurse në sajë të vërtetimit të disa kafshëve në mjedisin e vet të natyreshëm, kemi mësuar se njeriu nuk është i vetmi që i shfrytëzon mjetet e ndryshme me qëllim të ekzistencës në planetin e tokës. Këtë e bëjnë majmunët, vidrat (e shfrytëzojnë gurin për thyerjen e guacave, etj).

Këtu është e nevojshme të vihet në dukje dallimi midis vërtetimit të përditshëm të njerëzve nga vërtetimi sistematik i ndonjë dukurie. Vërtetimi sistematik është:

- I orientuar ndaj objektit të caktuar të vërtetimit;
- Bëhet sipas planit të caktuar që më parë;
- Incizimi bëhet në mënyrë simultane, d.m.th. njëkohësisht me ndonjë dukuri;
- Hulumtuesit (vërtetuesit) janë të aftësuar për atë punë;
- Incizimet karakteristike (besueshmëria, objektiviteti, e ndonjëherë edhe vlefshmëria mund të kontrollohen në mënyrë ekzakte (sipas Vladimir Muzhiq, 1973).

## **SURVEY METHOD (SERVEJ METODA)**

- Vjen nga fjala angleze *survey*, që do të thotë *vështrim*.
- Kjo është metodë joeksperimentale. Ka një aplikim të gjerë në hulumtimet shkencore.
- Shfrytëzohet para se gjithash për hulumtimin e qëndrimeve, të besimeve, të mendimeve, të intencave të njerëzve.
- Me anë të saj hulumtohen gjithashtu problemet psikologjike dhe psiko- sociale.
- P.sh., me anë të metodës servej mund t'i hulumtojmë mendimet e shikuesve dhe të dëgjuesve mbi përmbajtjet dhe tërheqshmërinë e radio dhe TV emisioneve.
- Mund t'i hulumtojmë qëndrimet e zgjedhësve në fushatat parazgjedhore.
- Me anë të metodës servej hulumtojmë një numër të madh njerëzish. Ekzistojnë përparësitë dhe të metat e kësaj metode.

## **PËRPARËSITË E METODËS SERVEJ**

1. Hulumtimi bëhet në kushte natyrore,
2. Për një afat të shkurtër mund të marrim shumë informata,
3. Aplikimi i rezultateve të fituara në këtë mënyrë është më i efektshëm,
4. Ndikimi i hulumtimit në dukurinë e hulumtuar është shumë i vogël.

## **TË METAT E METODËS SERVEJ**

1. Nuk mund të konkludojmë me siguri cilat kushte janë qenësore për sjelljen e shprehur sepse nuk e kemi të njohur ndikimin e faktorëve të pakontrolluar.
2. Me anë të kësaj metode nuk mund t'i përcaktojmë raportet kauzale, sepse me aplikimin e saj nuk ndryshohen kushtet që ndikojnë në dukurinë e hulumtuar.
3. Nuk jemi gjithëherë të sigurt se në pyetjet e parashtruara kemi marrë përgjigje të sinqerta.
4. Për këtë arsye gjatë formulimit të pyetjeve duhet shmangur formulimet e papaqarta dhe të anshme.

## **METODA E RASTIT (CASE STUDY)**

Kjo është procedurë metodologjike në të cilën përpunohet rasti përkatës, me qëllim që ai të sqarohet në gjendjen, gjenezën dhe projeksionin e vet burimor. Aplikohet më së shpeshti në praktikën klinike dhe në punën sociale (prostitucioni, alkoolizmi, delikuenca e të miturve, mospërkujdesja sociale etj.

## **METODA KORELATIVE**

Me anë të kësaj metode studiohen raportet midis variableve. P.sh. inteligjencia e lartë a është në korelacion me suksesin në shkollë? Ose, çfarë është korelacioni midis stresit dhe shëndetit? Korelacioni shprehet me koeficientin e korelacionit që mund të fitohet nga +1 deri -1 (rrallëherë është aq absolut). Dallojmë korelacionin pozitiv dhe negativ. Korelacioni pozitiv është atëherë kur një variable rritet, kurse në të njëjtën kohë

rriten vlerat e variables tjetër. Korelacioni negativ është raporti midis dy variableve në të cilin njëra variable rritet kurse tjetra bie.

## **METODA EKSPERIMENTALE**

Eksperimenti (prova, mostra) është nxitje e qëllimshme e ndonjë dukurie në kushte rreptësisht të kontrolluara me mundësi manipulimi me disa variable, me qëllim që të konstatohet ndikimi i disa faktorëve në sjelljen e njerëzve dhe në disa veçori të tyre. Dallojmë disa lloje të eksperimenteve:

- ***Eksperimenti natyror;***

Eksperiment natyror është çdo eksperiment që zhvillohet në kushte natyrore. Vështrohen procese të ndryshme të sjelljes së përgjithshme të njerëzve në kushte të ndryshme natyrore, si. p.sh. në orën mësimore, në fabrikë gjatë prodhimit, disa forma të sjelljes grupore (në manifestimet sportive etj).

- ***Eksperimenti laboratorik;***

Eksperiment laboratorik është çdo eksperiment që bëhet në kushte rreptësisht të kontrolluara, në hapësirën e izoluar nga ndikimet e mundshme të jashtme. Kafsha eksperimentale ose hulumtuesi i kryen operacionet i (kryen detyrat dhe urdhëratë e eksperimentuesit), të cilat është e mundshme të përcillen, të ndryshojnë sistematikisht, të përsëriten dhe të kuantifikohen.

- ***Kuazi eksperimenti;***

Këtu nuk ekziston manipulimi me variablen e pavarur, por përcillet karakteri i ndikimit të ndonjë ndryshimi (të reformave të rëndësishme shoqërore, të luftës, të katastrofave natyrore dhe të sjelljeve të njerëzve në regjionet ku kanë ndodhur ato katastrofa.

Këtu kemi edhe grupin eksperimental dhe kontrollues edhe variablen e pavarur (ndonjë ngjarje e papritur) si dhe variablen e varur. Cilat ndryshime janë bërë do të konstatojmë pas krahasimit të rezultateve të fituara në mjediset ku kanë ndodhur ndryshimet me rezultatet në mjediset ku nuk kanë ndodhur ngjarjet e tilla, (sipas Ismet Dizdareviq, 1997).

- ***Ex post facto eksperimenti;***

Është i ngjashëm me kuazi – eksperimentin. Për shembull, nëse një numër i caktuar i delinkuentëve të vjetër ka shikuar filma të stërmbushur me dhunë në periudhën e pubertetit, kjo ka mundur të sjellë intensifikimin e sjelljes kriminale në periudhën e mëvonshme (variabla e varur).

## **VARIABLET NË EKSPERIMENT**

**VARIABLA E VARUR** është ndonjë dimension që ndryshon nën ndikimin e ndonjë variable të pavarur. Ajo është e ndryshueshme dhe i ekspozohet manipulimit të drejtpërdrejtë, sidomos në eksperimentet nën ndikimin e eksperimentuesit (në kuadër të planit të eksperimentit) (sipas Dragan Kërstiq, 1996).

**VARIABLA E PAVARUR** është e ndryshueshme dhe ndikon në variablet e tjera dhe cakton ndryshimet e tyre, kurse vetë nuk është e ndryshueshme, ose është e ndryshueshme në mënyrë autoktone ose e ndryshon eksperimentuesi, kur e quajmë variabël eksperimentale. Variablet tipike të pavarura janë faktorët trashëgues, gjendjet fiziologjike të organizmit, stimulimi eksperimental, kushtet e jashtme që caktojnë sjelljen, programet e stërvitjes që ndikojnë në ndryshimin e dijes etj. (sipas Dragan Kërstiq, 1996).

## **METODA E STUDIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Hulumtuesi bashkëkohor zgjidhjen e ndonjë detyre të parashtruar shkencore e fillon me grumbullimin e dokumentacionit mbi të dhënat dhe rezultatet tashmë ekzistuese, që kanë të bëjnë me problemin e tij. Qëllimi i kësaj është i dyfishtë:

- Së pari, hulumtuesi ka mundësinë që t'i aplikojë përvojat e deritashme nga ajo fushë në projektin e ri hulumtues;
- Së dyti, nuk ka nevojë që të merret me diçka që tashmë qëmoti është hulumtuar dhe është e njohur. Dokumentacioni, në kuptimin e gjerë të fjalës nënkupton punimet monografike, pasqyrimet e ndryshme sintetike, të dhënat e pasistematizuara, librat, tekstet mësimore, vjetarët, gazetat javore, gazetat ditore etj.

## **METODAT E ANALIZËS SË PËRMBAJTJEVE**

Kjo është metodë që shfrytëzohet për analizën e përmbajtjeve të komunikimit, e që mbështetet në matjen (numërimin) e sasisë së një gjëje (të dhunës në familje, të fatkeqësive në komunikacion, të vrasjeve, të manifestimeve kulturore etj.).

Analiza e përmbajtjes nënkupton përsëritjen e procedurës dhe besueshmërinë e rezultateve, si dhe mundësinë që disa hulumtues të ndryshëm të fitojnë rezultate të njëjta në të njëjtën mostër të materialit të analizuar (sipas N. Havelk, B. Kuzmanoviq dhe D. Popadiq, 1998).

## **METODA INTROSPEKTIVE**

Introspeksioni është vetë vrojtim, vetëvështrim, analizë e përvojës vetanake. Dallojmë introspeksionin simulutan – zhvillohet njëkohësisht me përjetimin (ose vonohet vetëm pak), dhe introspeksioni retrospektiv, që ka të bëjë me të dhënat psikologjike në kujtesë. Në të dy rastet subjekti jep pasqyrimin mbi gjendjen e vetëdijes vetanake, duke u përpjekur që t'i përshkruajë në mënyrë sa më të hollësishme.

## **TEKNIKAT E HULUMTIMIT SHKENCOR:**

**TEKNIKA** – është procedurë e veçantë që përdoret në fazën e caktuar të hulumtimit.

## **TEKNIKAT E METODAVE SERVEJ JANË:**

- 1. TEKNIKA E PYETËSORIT**
- 2. TEHNIKA E INTERVISTËS**
- 3. TEKNIKA E SHKALLËS SË QËNDRIMEVE**

## **PYETËSORI – KONSTRUKSIONI DHE APLIKIMI**

Me anë të pyetësorit në rastet më të shpeshta hulumtojmë: qëndrimet, mendimet dhe bindjet e njerëzve. Sinonim i termit pyetësor është anketa (rekomandohen deri në 20 pyetje, do të thotë me anë të tij grumbullojmë të dhënat e caktuara. Disa pyetësor (inventar të përshtatjes dhe të interesimit) të personalitetit kanë edhe mbi 500 pyetje.

Pyetjet në pyetësor duhet t'u përshtaten qëllimeve të hulumtimit, e mund të jenë në tri (3) forma:

1. Pyetje të formës së hapur,
2. Pyetje të formës së mbyllur,
3. Pyetje të formës së kombinuar.

Pyetjet nuk bën të jenë të dykuptimshme as sugjестive. Duhet të jenë të qarta, të drejta në aspektin gjuhësor dhe gramatikor dhe t'u përshtaten karakteristikave gjeopsikike të popullatës së hulumtuar.

## **APLIKIMI I PYETËSORIT**

- A) T'u jepen udhëzime precize hulumtuesve,
- B) Të kodohen të dhënat e fituara,
- C) Përpunimi llogaritar i të dhënave me kontrollin e atij përpunimi është i rëndomtë.

## **INTERVISTA (BISEDA)**

Intervista shkencore:

1. Zhvillohet me qëllim të caktuar që më parë,
2. Dihet kush është udhëheqës i intervistës,
3. Atmosfera psikologjike dallohet nga biseda e zakonshme.

## **LLOJET E INTERVISTAVE**

- **INTERVISTA E NDËRLIDHUR ose E STANDARDIZUAR**

Këtu pyetjet janë të përgatitura që më parë, madje edhe rënditja e pyetjeve.

- **INTERVISTA SPONTANE ose E PASTANDARDIZUAR**

Pyetjet nuk janë të përgatitura që më parë. Vetëm tema dihet. Të tjerat zhvillohen spontanisht.



Kemi edhe: intervistën faktike (hulumtimet shkencore), intervistën diagnostike, intervistën terapeutike etj.

### **FAKTORËT E INTERVISTËS JANË:**

1. Intervjuisti (ai që e zhvillon intervistën);
2. Personi i intervistuar (respondenti);
3. Procesi i intervistimit.

Disa rregulla për intervistë të suksesshme:

Pyetjet duhet të jenë të qarta;

Biseda duhet të nxitet;

Atmosfera duhet të jetë “e ngrohtë”;

Duhet të krijohet besimi midis intervjuistit dhe respondentit;

Të dhënat duhet të shënohen;

Të dëgjohet me durim i hulumtuari;

Të parashihet kohë e mjaftueshme për intervistë;

Të grumbullohen më parë disa të dhëna për personin në mënyrë që të mund të përcjellim se a po e flet të vërtetën etj.

### **SHAKLLËT E QËNDRIMEVE**

Shkallën në psikologji mund ta definojmë si cilëndo shkallë të matjes, të rregulluar sipas renditjes në rritje ose rënie të madhësive. Veçori e qenësishme metodologjike e shkallëve është se ato përmbajnë të gjitha dimensionet e aspektit psikik: njohëse, afektive dhe të vullnetshme. Përpunimi i të dhënave të grumbulluara me anë të shkallëve kryesisht mbështet në metodat statistike joparametrike (përqindjet dhe rangjet).

Ekzistojnë shumë lloje të shkallëve, e në bazë të konceptit të caktuar logjik – metodologjik dallojmë: shkallët nominale, ordinale, intervale, numerike, grafike etj.

- **Shkalla nominale**, është lloji më i thjeshtë i shkallës që përbëhet nga dy ose më shumë kategori që nënkuptojnë ndonjë shkallë të intensitetit. Shkallëzimi i niveleve të intensitetit për ndonjë fushë mund të hulumtohet me anë të kategorive, siç janë p.sh. “Merren me këtë në punë”, “Merren me këtë më tepër sesa kërkohet në punë” etj.
- **Shkalla ordinale**, përbëhet nga kategoritë e parashtruara sipas renditjes që nënkuptojnë raportet *më shumë* ose *më pak*. P.sh. nëse hulumtohen qëndrimet mbi raportin shoqëror ndaj kriminalitetit, mund të parashtrihen pyetjet se shoqëria a jep 1) mjaft, 2) aq sa mundet, 3) mjete të mjaftueshme materiale, ku i hulumtuari duke i zgjedhur përgjigjet vlerëson qëndrimin shoqëror ndaj kriminalitetit ose ndaj ndonjë aspekti tjetër.

- **Shkalla intervale**, përbëhet nga intervalet e njëjta si njësi matëse. Pikat e fundit të shkallës intervale varen nga natyra e asaj që matet, kurse intervalet caktohen me anë të teknikave të veçanta. Intervalet nuk janë gjatësi numerikisht plotësisht të njëjta të tërë shkallës matëse, por janë reale si njësi të matjes, sepse paraqiten si njësi më të vogla të vrojtimit të disa dallimeve.
- **Shkallët numerike**, paraqesin variantin e shkallës së vlerësimeve dhe përbëhen nga përshkrimi i dimensionit që duhet vlerësuar dhe përgjigjet e ofruara në formë të një vargu vlerësimesh numerike, ndër të cilat i hulumtuari zgjedh përgjigjen e vet. Formë e veçantë e këtyre shkallëve është në vlerësimin shkollor (prej 1 deri 5).

P.sh. Vlerësimi i veçorisë “sociabiliteti”

Shprehimisht	Shprehimisht
3____2____1____0____1____2____3	
sociabil	josociabil

Detyra e të hulumtuarit është që të rumbullakojë një nga numrat e ofruar në pajtim me bindjet të veta në raport me atë me të cilin ka të bëjë veçoria e ofruar.

- Shkallët grafike paraqesin manifestimin e shkallëve numerike dhe prezantimin e tyre në formën grafike. Përparësia e këtyre shkallëve qëndron në qartësinë e tyre, lehtësinë e administrimit, mundësinë e hulumtimit të subjekteve me arsimim të ulët si dhe niancimin e vlerësimeve. Në rastet më të shpeshta shfrytëzohen nivelet trishkallëshe, pesëshkallëshe, shtatëshkallëshe, dhe nëntëshkallëshe të qëndrimeve, d.m.th. është i dëshirueshëm numri tek i shkallës.

P.sh. vlerësimi i veçorisë “sociabiliteti”:

Shprehimisht	P.sh.shprehimisht
I_____I_____X_____I	
sociabil	josociabil

Detyra e të hulumtuarit është që në shkallë të shënojë vendin në pajtim me bindjet e veta në raport me atë me të cilin ka të bëjë veçoria e ofruar.

## TESTET

Në fillim të përpunimit të test-metodave na duket e natyrshme që t'i vejmë në dukje burimet e përdorimit dhe domethënien e fjalës “test”. Fjala “test” vjen nga gjuha latine (testor, -ari) që do të thotë të provohet, të dëshmohet. Tek ne si dhe në terminologjinë ndërkombëtare ka ardhur me anë të gjuhës angleze. Në gjuhën angleze fjala “test” ka domethënie të shumfishtë: përfshin nocionet e eksperimentit, të provës, të hulumtimit në kuptimin më të gjerë.

Pasi që ka hyrë në terminologjinë ndërkombëtare të shumë disiplinave shkencore dhe teknike, fjala “test” merr një kuptim specifik teknik. Kështu kemi (“test pilot” – hulumtimi i avionit të ri, “testet bërthamore” – hulumtimi i armës së re, “testi tuberkulin”, në statistikë t-test, F-test, testi hi-katror) etj.

Sipas Shoqatës Ndërkombëtare për Psikologjinë e Aplikuar: “Testi është provë e caktuar që përmban detyrën që duhet të kryhet, e cila është e njëjtë për të gjithë të hulumtuarit, me teknikë precize me të cilën caktohet suksesi ose mosuksesi ose me të cilën shprehet suksesi numerikisht”.

## LLOJET E TESTEVE

Llojet e testeve sipas veçorive të të hulumtuarve ndahen në:

1. *Teste të diturisë, (testet e diturisë në kuptimin e ngushtë, testet e aftësisë së aplikimit të dijes),*
2. *Testet e aftësisë,*
3. *Testet e personalitetit në kuptim të ngushtë.*

## TESTET E DIJES

Me këto teste dëshirohet të konstatohet se në cilën masë i ka përvetësuar i hulumtuari dituritë, shkathtësitë dhe shprehitë e caktuara. I ndajmë sipas disa kriterëve. Kriter më i shpeshtë janë disa fusha arsimore. Kështu, kemi testet të gjuhës amëtare, të gjuhës së huaj, të shkencave natyrore, të matematikës, të fizikës, etj.

Nga ana tjetër, testet e diturisë të fushave përkatëse arsimore mund të ndahen edhe në bazë të kriterëve se me to a hulumtohet kryesisht aspekti material ose funksional (formal) i arsimimit.

Që me anë të testit të mund të matet dituria, duhet të respektohen procedurat e hartimit të tij dhe kërkesat që mundësojnë përcaktimin e karakteristikave përkatëse metrike. Veçmas duhet kushtuar kujdes kësaj sa vijon:

- Pyetjet duhet të jenë të formuluar në mënyrë të qartë,
- Fjalët në pyetje nuk bënë të jenë dykuptimëshe,
- Në pyetje nuk bënë të ketë thënie që nuk janë të qenësishme,
- Pyetja për nga vështirësia duhet t’i përgjigjet nivelit të të hulumtuarit, si dhe dedikimit të hulumtimit.

Është e nevojshme, gjithashtu, të jepen udhëzimet për përgjigje korrekte në pyetjet e parashtruara dhe kjo të pasqyrohet në një ose më tepër shembuj.

Pyetjet në teste të diturisë mund të jenë:

1. Të zgjedhjes së thjeshtë të shumëfishtë (në një pyetje jepen 3-5 përgjigje nga të cilat vetëm një është e saktë),

2. Zgjidhje të ndërlikuara të shumëfishta ( në një pyetje jepen më shumë përgjigje të sakta dhe të pasakta),
3. Të zgjedhjes alternative ( për çdo pyetje ofrohen dy përgjigje),
4. Plotësime, shtime, rregullime, për kuptimin e tekstit, për interpretimin logjik etj.

## **TESTET E AFTËSISË**

Me këto teste hulumtohet gjendja e funksionimit të aftësisë së caktuar në momentin e hulumtimit në mënyrë që në atë bazë të mund të prognozohet suksesi i të hulumtuarit në disa aktivitete, sepse konsiderohet se ekzistojnë aftësi që janë kusht paraprak për disa fusha të veprimtarisë. P.sh. hulumtimi i inteligjencisë = prediksim i suksesit në shkollë, në fakultet. Shumëkush konsideron se suksesi në testin e aftësisë varet nga:

- Trashëgimia (dispozicioni),
- Aktiviteti i gjithmbarshëm i mëparshëm,
- Begatia e përvojës paraprake.

Ekzistojnë aftësitë e përgjithshme dhe speciale (p.sh. muzika, pikturimi).

Testet e aftësisë ndahen (sipas Muzhiqit, 1973) në:

- Senzoriale,
- Mentale,
- Teste të aftësive mekanike dhe
- Teste të shkathtësisë motorike.

Testet mentale i ndajmë më tutje në:

1. Teste të aftësisë së përgjithshme mentale (testet e inteligjencisë),
2. Testet të funksioneve të veçanta intelektuale.

Testet më tej mund të jenë:

- Verbale (detyrat në testin e caktuar) dhe
- Jo verbale (detyrat në formë të vizatimit).

## **TESTET E PERSONALITETIT NË KUPTIM TË NGUSHTË**

Shfrytëzohen për matjen e tipareve suptile, të ndërlikuara dhe delikate të personalitetit, siç janë: veçoritë e temperamentit, tiparet e karakterit, interesimet, aftësia e përshtatjes dhe e vetëpërshtatjes, qëndrimet, sferat emotive të jetës së njeriut dhe shumë probleme të tjera suptile të personalitetit.

## INVENTARËT E PERSONALITETIT

Termi i kuptimit themelor të *gjendet*, në të vërtetë është regjistri i përcaktuar i të gjitha elementeve për të cilat konstatohet se bëjnë një tërësi.

Në psikologji bëhet fjalë për inventarin e personalitetit – TË PËRSHTATSHMËRISË DHE TË INTERESIMIT.

Inventari i personalitetit përbëhet nga një varg pyetjesh që definojnë strukturën e caktuar të personalitetit, kurse i hulumtuari përgjigjet në mënyrë pohuese, mohuese ose të pavendosur. Analiza e përgjigjes vë në dukje strukturën ekzistuese të personalitetit dhe veçoritë e tij.

*Inventari i përshtatshmërisë* përmban regjistrin e formave të sjelljeve për të cilat sipas standardeve sunduese konsiderohet se paraqesin formular të përshtatjes së mirë ose të keqe me mjedisin. Përgjigjet mund t'i plotësojë hulumtuesi ose i hulumtuari, kurse në bazë të tyre konkludohet për shkallën e përshtatshmërisë së individit.

*Inventari i interesimit* i ofron të hulumtuarit një mostër reprezentuese të veprimtarisë në mjedisin e caktuar kulturor, kurse përgjigjet përbëhen nga dëshmia e shkallës së pëlqimit ose të refuzimit që individ ndien ndaj ndonjë lloji të profesionit. Analiza përfundimtare e përgjigjeve vë në dukje drejtimit dhe grupet e interesimeve të të hulumtuarit.

## TEKNIKAT PROJEKTUESE

Ato janë çdo procedurë e zhvilluar sistematike me të cilën hulumtohet përmbajtja e projektuar e subjektit përmes ndonjë modaliteti të sjelljes së tij. Nëse mostrat e situatave janë standarde dhe të standardizuara në mënyrë të kënaqshme, merren parasysh testet projektuese.

Interpretimi i përgjigjeve të subjekteve në pyetjet standarde të testit duhet të jetë në suaza që janë paraparë teorikisht dhe praktikisht për atë test. Për këtë arsye, çdo test projektues nënkupton specializimin më të gjatë ose më të shkurtër ku bëhet perfeksionimi i administrimit të testit dhe interpretimi i rezultateve të tij.

Testet përbëhen nga fotografitë – situatat (testi – apercepcionet tematike), të njollave të ngjyrës së derdhur (Rorshah), të fjalive ose të fotografive të papërfunduara, nga lodrat dhe lojërat, ose pyetjeve të ngjashme që mund të provokojnë dëshminë e subjektit mbi reaksionin e tij ndaj ngacmimit të dhënë. Në ndonjë fotografi të pasqyruar i hulumtuari duhet t'i përshkruajë ndjenjat e veta, asociacionet e para dhe të shkoqitura ose të rrëfejë ndonjë rrëfim të vet.

Përdorimi i suksesshëm i këtyre testeve varet nga aftësimi i hulumtuesit.

## KARAKTERISTIKAT PSIKOMETRIKE TË TESTEVE

Që ndonjë instrument të jetë instrument matës, është e nevojshme t'i plotësojë disa kërkesa, është e nevojshme që në një shkallë të mjaftueshme t'i posedojë këto karakteristika:

1. Vlefshmërinë (saktësinë, validitetin, të jetë adekuat),
2. Besueshmërinë (konsekuencën, reliabilitetin, të jetë konstant),

3. Objektivitetin,
4. Ndjeshmërinë,
5. Vlerën diskriminative të detyrës në test,
6. Bazhdarimin (standardizimi, graduimi, normimi),
7. Praktikitetin dhe ekonomikitetin.

### **VLEFSHMËRIA (validiteti) I TESTIT**

Bën pjesë në nocionet më të rëndësishme metodologjike të psikologjisë dhe siguron korrespondencën e hulumtimeve psikologjike me realitetin. Ndonjë test është i vlefshëm aq sa ai matë atë që duhet të matet. Nëse duhet t'i hulumtojmë aftësitë, instrumenti do të jetë valid nëse matë vetëm atë aftësi të cilën është dashur ta hulumtojë, e jo diçka tjetër, (p.sh. diturinë, pozitën socio-ekonomike etj).

### **BESUESHMËRIA (reliabiliteti) I TESTIT**

Me reliabilitetin e ndonjë instrumenti matës mendohet në atë se sa mund të mbështetemi në disa rezultate të fituara? Ndonjë instrument matës në dy raste të ndryshme të aplikimit a jep rezultate të ngjashme ose të njëjta? Pasi që rrallëherë jep rezultate të njëjta, është e dëshirueshme që ato rezultate të jenë sa më të ngjashme, me çka shtohet besueshmëria e tyre. Koeficienti më i ulët i ndërlidhshmërisë midis dy matjeve me të njëjtin test është 0,80. Është e dëshirueshme që të jetë edhe më i lartë.

### **OBJEKTIVITETI I TESTIT**

Shikuar në kuptim të gjerë, objektiviteti në të vërtetë është një nga aspektet e besueshmërisë. Gabimi që paraqitet nga joobjektiviteti zvogëlon në mënyrë automatike përputhjen e instrumentit me vetveten. Dallimi qëndron në faktin që aty bëhet fjalë për përputhjen e dy ose më shumë aplikimeve të testit të njëjtë tek i hulumtuari i njëjtë që e kanë kontrolluar hulumtues të ndryshëm.

### **NDJESHMËRIA E TESTIT**

Ndonjë instrument konsiderohet i ndjeshëm nëse me anë të tij mund të dallohen edhe dallimet e vogla në madhësinë e asaj që matet. Ndjeshmëria arrihet me zgjidhjen adekuate të detyrave. Testi duhet të ketë sa më shumë pyetje, kurse ato duhet të renditen sipas vështirësisë, nga më të thjeshtat deri te ato që mezi mund t'i zgjidhë i hulumtuari më i aftë.

### **VLERA DISKRIMINATIVE E DETYRAVE NË TEST**

Kur të hulumtuarit që kanë p.sh. sukses të përgjithshëm të lartë zgjidhin mirë ndonjë detyrë të caktuar, kurse ata me sukses të dobët atë detyrë nuk ia dalin ta zgjidhin, përputhja midis asaj detyre dhe tërë instrumentit do të jetë e lartë. Vlera diskriminative e asaj detyre, pra, do të jetë shumë e lartë dhe anasjelltas.

### **KAPTINA 3**

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME PERSONA TË DYSHUAR**

### **NOCIONI I ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME PERSONIN E DYSHUAR**

Biseda informative është metodë themelore në punën e policisë dhe një nga veprimet dhe masat më të rëndësishme operative. Biseda informative është institucionalizuar me ligj, si një nga veprimet metodike të grumbullimit të informatave nga qytetarët dhe të njohurive mbi rrethanat e kryerjes së veprave penale. Në bazë të njohurive dhe të provave të grumbulluara materiale, biseda informative përbën bazën e paraqitjes së fletëparaqitjeve penale.

Është i madh numri i palëve me të cilat komunikojnë punëtorët e policisë për pengimin, zbulimin dhe luftimin e kriminalitetit dhe shkeljen e rendit dhe të qetësisë publike. Kategoritë më të shpeshta dhe shumë të rëndësishme të palëve janë të dyshuarit, personat e dëmtuar, dëshmitarët dhe paraqitësit, e pastaj bashkëpunëtorët, bashkëpjesëmarrësit, informatorët dhe kategoritë e tjera. Këta persona mund të jenë të gjinive dhe të moshave të ndryshme, të profesioneve, të nivelit arsimor dhe kulturor, të statusit material dhe social, si dhe të nacionaliteteve të ndryshme etj.

Në kuadër të të njëjtës kategori, e sidomos midis kategorive, paraqiten specifika në sjelljen e këtyre palëve kur janë në kontakt me punëtorin e policisë. Përvoja dhe praktika kriminalistike dëshmojnë se, përveç karakteristikave dhe ngjashmërive të përbashkëta, secila prej kategorive të cekura shpreh karakteristika dhe specifika tipike psikologjike në sjellje dhe në reagim.

I dyshuari në kriminalistikë definohet si “person ndaj të cilit ekzistojnë bazat e dyshimit se ka kryer vepër penale, kundër të cilit nuk zhvillohet procedurë penale, e në rastet më të shpeshta nuk është paraqitur as fletëparaqitja penale”.

Punëtori operativ do të bëjë strategjinë e mirë të sjelljes dhe të zhvillimit të bisedës, nëse cakton se cilës kategori të të dyshuarëve i takon personi që hulumtohet për vepër të caktuar penale.

Ekzistojnë klasifikimet kriminalistike të të dyshuarve në recidivistë, profesionistë dhe specialistë, përkatësisht sipas llojeve të veprave penale me të cilat merren, pastaj sipas kriteriumit të përshtatshmërisë së personave të gjykuar për procesin e risocializimit, duke pasur parasysh të kaluarën e tyre kriminale etj.

Ekzistojnë, gjithashtu, edhe ndarje të kriminelëve dhe të të dyshuarve në kategori të caktuara, sipas karakteristikave psikologjike që janë dominuese në strukturën e personalitetit të tyre dhe që përcaktohen dhe veprojnë si faktorë determinues të sjelljes

kriminale. Njërin nga klasifikimet e tilla të karakterit psikologjik e ka bërë Enriko Feri (1856-1929), kriminalist italian. Ai i ka ndarë kriminelët në:

- kriminelë të lindur,
- të sëmurë shpirtëror,
- delikuentë të rastit,
- delikuentë nga shprehja,
- delikuentë nga pasioni.

### **NGJASHMËRITË DHE DIFERENCAT NË SJELLJEN E TË DYSHUARIT PAFAJSHËM DHE TË KRYERËSIT TË VEPRËS PENALE**

Sipas një autori, në aspektin psikologjik nuk ekziston dallimi global në sjelljen e të dyshuarit që është i pafajshëm dhe të dyshuarit që është kryerës i veprës penale. Megjithatë, analiza psikologjike e sjelljes dhe praktika kriminalistike vetëm pjesërisht e arsyetojnë këtë qëndrim. Pra, ekzistojnë ngjashmëri, por edhe dallime të mëdha në sjelljen dhe në pamjen simptomatike të të pafajshmit dhe të kryerësit të veprës penale.

Ngjashmëria qëndron në faktin që edhe njëri edhe tjetri, kur janë në kontakt me punëtorin e organeve të punëve të brendshme, gjenden në një gjendje të nderë emocionale, të përcjellë me tonus psikofizik. Reaksioni tjetër manifestues, i përbashkët edhe për njërin edhe për tjetrin, është shqetësimi, pasiguria dhe, në mjaft raste, ndjenja e frikës për shkak të mosnjohjes së rrethanave dhe të fakteve që i njej punëtori operativ, siç është cekur më parë.

Dallime ka mjaft. Së pari në faktin që i pafajshmi nuk shpreh rezistencë dhe nuk tregon shenja agresiviteti ndaj punëtorit operativ dhe sipas parimit është i gatshëm për bashkëpunim, sepse e di që nuk është kryerës dhe me të drejtë pret se kjo do të konstatohet. Kryerësi i veprës ndjen rezistencë ndaj punëtorit operativ dhe ndaj situatës së gjithmbarshme, me vështirësi ia del të kontrollohet dhe të fshehë rezistencën, e ndonjëherë e manifeston me qëllim dhe me vetëdije në formë të rebelimit.

#### **Të dyshuarët e tipit të ndjeshëm të personalitetit**

Personat e dyshuar që bëjnë pjesë në tipa të ndjeshëm të personalitetit, nëse janë kryerës të veprës penale, dukshëm shprehin emocione të fuqishme në kontakt me punëtorin operativ. Emocionet më të shprehura janë ndjenja e fajësisë për shkak të veprës së kryer. Kompleksi i fajësisë dhe ndjenja e pendimit i sjellin në një gjendje të trazimit që në sjellje manifestohen si shqetësim, pasiguri dhe frikësim. Në të folur bie në sy heshtja, e mund të jenë edhe mendimet dhe fjalitë e palidhura me qëllim të mbrojtjes, e cila nuk është përgatitur mirë dhe nuk është bindëse. Nëse janë në paraburgim, këta persona janë të deprimuar ose manifestojnë shqetësim psikomotorik, shëtitin, i thyejnë gishtërinjtë, janë nervoz. Shprehet çrregullimi i funksioneve fiziologjike, pagjumësia, humbja e apetitit, nevoja e shpeshtë për urinim etj.

Ekzistojnë tri kritere në bazë të të cilave është e mundur të vlerësohet se tipi i dyshuar është personalitet i ndjeshëm.



***Pamja dhe sjellja simptomatike.*** Manifestohen në procedurën e zhvillimit të bisedës informative siç është përshkruar më parë;

**Numri i veprave penale.** Ndër tipat e ndjeshëm në rastet më të shpeshta bëjnë pjesë të dyshuarët që për herë të parë kanë kryer vepër penale, përkatësisht fillestarët. Për shkak të mungesës së përvojës kriminale dhe të specifikave të trajtimit, këta persona reagojnë me reaksione të shtuara psikofizike, gjë që vërehet relativisht lehtë.

**Lloji i veprës penale.** Personat emotivë, në parim, më shpesh paraqiten si kryerës të veprave penale të shkaktimit të lëndimeve të rënda trupore, të vrasjeve, të dhunimeve, të shnderimit, të veprave penale dhe të kundërvajtjeve në komunikacion etj.

### **Tipat e pandjeshëm të personave të dyshuar**

Tipat e pandjeshëm të personave të dyshuar nuk kanë brejtje të ndërgjegjes as pendim për veprën e kryer. Ata janë kryesisht profesionistët, recidivistët ose multirecidivistët, të cilët nuk kanë skrupull moral. Në këtë grup bëjnë pjesë kryerësit e veprave penale nga lakmia e fitimit, siç janë vjedhjet, grabitjet, thyerjet e banesave, vjedhjet e automobilave etj.

### **Të dyshuarët e stilit të ndjeshëm të sjelljes**

Ndaj personave të tillë rekomandohet një qasje e ndjeshme, sepse kjo në rastet më të shpeshta i detyron të pranojnë fajin. Tek ata është aq i madh tensioni i organizmit dhe ngarkesa psikike për shkak të ndjesisë së fajit, sa pranimi i veprës së kryer është lehtësim. Me dhemshurinë dhe mirëkuptimin për pozitën e tyre, hulumtuesi duhet t'u ndihmojë ta zgjidhin problemin.

Ekzistojnë disa rregulla të cilave duhet përmbajtur në bisedë me personat e tillë:

a) Të silleni sikur jeni të bindur në fajësinë e subjektit. Këtu nuk është fjala për ndonjë qëndrim frikësues, por është e nevojshme që i dyshuari të fitojë përshtypjen se hulumtuesi është i sigurt në vete. Kjo arrihet nëse hulumtuesi nuk jep kurrfarë shenje se në te ndikon ajo që deklaron subjekti mbi pafajësinë e tij.

b) Të theksohen rrethanat që vejnë në dukje fajësinë. Duhet ndërprerë çdo monolog të gjatë të subjektit mbi pafajësinë e tij dhe të paraqiten provat e caktuara, nëse i ka.

c) të paralajmërohet subjekti për simptomat psikologjike dhe fiziologjike, si shenja të fajësisë. Nëse subjekti bindet se pamja dhe sjellja e tij po e tradhtojnë dhe se vejnë në dukje fajësinë, kjo me siguri do të ndikojë në vetëbesimin e tij. ("Nëse nuk jeni kryerës i veprës, duhet të jeni i qetë dhe i rehatshëm").

d) Të shprehet dhemshuri ndaj subjektit, duke folur se çdo njeri tjetër në rrethana të tilla do të mund të vepronte njësoj.

e) Të zvogëlohet ndjesia e fajit duke zvogëluar peshën morale të veprës. Kjo teknikë është veçanërisht e dobishme tek deliktet seksuale. Subjekti fiton bindjen se ajo

që ka bërë nuk është e pazakonshme, se dukuritë e tilla ndodhin shpesh dhe se nuk është turp të pranohet vepra.

f) Të shprehet ndjesi ndaj subjektit duke e gjykuar viktimën, bashkëpjesëmarrësin ose cilindo person tjetër, të cilit mund t'i hidhet një pjesë e përgjegjësisë. Hulumtuesi në disa raste mund të "fajësojë" edhe pushtetin ose shoqërinë në kuptim të gjerë, që lejojnë ekzistimin e kushteve dhe të dispozitave që mundësojnë kryerjen e veprave të tilla. Është e nevojshme t'i mundësohet kryerësit që në vetëdijen e tij ta ndajë përgjegjësinë me të tjerët. Tek krimet seksuale mund t'i mvishet viktimës se e ka nxitur me qëllim.

g) Të shprehen ndjenja miqësore duke i sugjeruar të dyshuarit që ta pranojë të vërtetën. Duhet thënë se si mik ose farefis e këshillon që ta flasë të vërtetën, për shkak të qetësisë, të ndërgjegjes dhe të shkarkimit të vet psikik etj.

h) T'i prezantohet të dyshuarit, si arsye që ta thotë të vërtetën, se i dëmtuari mund ta teprojë me kërkesën, nëse ai nuk i paraqet të gjitha faktet mbi ngjarjen.

i) Të mos insistohet për pranimin e përgjithshëm, por më parë të kërkojnë elemente të dorës së dytë. Në këtë mënyrë hulumtuesi vihet në rolin e atij që dëshiron t'i dijë kushtet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja, e jo vetëm pranimi dhe gjendja faktike.

j) Sistemi "ngrohtë-ftohtë". Në raste të caktuara, qëndrimi dashamirës dhe qasja e ndjeshme mund të kombinohen me qëndrimin e ftohtë, jotolerant dhe rreptësisht profesional ndaj të dyshuarit, të cilin e inskenojnë dy punëtorë operativë. Kjo është loja e rolit të të ashtuquajturit "policit të mirë" dhe "policit të keq".

Në fillim paraqitet i qetë, korrekt dhe qëllimshëm "polici engjell", i cili dëshiron që me të mirë të merret vesh me të dyshuarin. Kur sheh se ky gënjen në mënyrë të paturpshme dhe të paskrupull dhe i shmanget çdo përgjegjësie, e braktisë lokalën kinse i zhgënjyer, duke ia hedhur se është jo mirënjohës dhe i padenjë që ndaj tij të silltet mirë dhe ndershëm. Pas disa minutash në lokal përsëri hyn polici i parë duke e qortuar kolegün e vet "se me njerëz, megjithatë nuk mund të veprohet ashtu" dhe duke kërkuar ta lëshojë lokalën. Derisa kolegu i tij pa dëshirë e lëshon lokalën dhe "me hidhërim" kërcënon se do të kthehet prapë, ky, në rolin e shpëtimtarit i komunikon të dyshuarit se megjithatë ka vendosur që ai vetë ta përfundojë rastin, sepse mund të ndodhë gjithçka.

Rolet e policit të mirë dhe keq mund t'i luajë një punëtor i njëjtë operativ, dhe nëse mjeshtëria e aktrimit përvetësohet me sukses, kjo mund të ketë më shumë përparësi, sesa puna në tandem.

k) Taktika Kolombo. Kjo dhe disa taktika të tjera janë paraqitur në praktikën amerikane gjyqësore dhe kriminalistike. Taktika Kolombo është luajtja e rolit të policit naiv, të pashkathët, të ngathët e ndonjëherë edhe të marrë.

Taktika mund të jetë efikase kur është fjala për personat e dyshuar të nivelit dhe të rangut të caktuar, të cilët janë superior dhe dominant në sjellje dhe të statusit të rëndësishëm shoqëror. Personalitete të tilla ka në funksionet më të larta, ndër udhëheqësit dhe ekspertët, në fusha të ndryshme. Që të shfrytëzohet me sukses, taktika Kolombo duhet të ushtrohet mirë, sepse nuk është lehtë të bëhet njeriu i paaftë dhe naiv kur nuk është i tillë.

## **I dyshuari i stilit të pandjeshëm të sjelljes**

Biseda informative me të dyshuarin e stilit të pandjeshëm të sjelljes kërkon një qasje dhe teknikë tjetër të zhvillimit të bisedës, sepse është fjala për kryerësin profesional, i cili, përveç tjerash ka përvojë edhe me policinë.

Pasi që tek ai mbisundon gjakftohësia dhe dinakria, duhet t'ia kthejmë në të njëjtën mënyrë: të sillemi në mënyrë korrekte, por ftohtë, kurse biseda të zhvillohet në mënyrë logjike dhe profesionale.

Nga veprimet dhe teknikat e bisedës të prezantuara më parë, edhe këtu rekomandohen teknikat e cekura nën a), b) dhe c), si dhe masa operative – taktike e cekura nën h).

Do të thotë, edhe këtu është e nevojshme të sillemi sikur jemi të bindur për fajësinë e subjektit, të theksohen rrethanat që vejnë në dukje fajësinë dhe të paralajmërohet i dyshuari për simptomat fiziologjike dhe psikologjike.

Masat e tjera operative – taktike dhe teknikat e bisedës të mbështetura në parimet psikologjike të sjelljes, që janë të përshtatshme për kategorinë e të dyshuarit të tipit të pandjeshëm të reagimit, janë:

a) Të vihet në dukje se rezistenca e subjektit është e pakuptimtë. Duhet të bindet i dyshuari se faji i tij është konstatuar dhe se mund të provohet, pa marrë parasysh që ai këtë nuk e pranon.

b) Të shfrytëzohen bashkëpjesëmarrësit njëri kundër tjetrit. Recidivistët, përkundër solidaritetit dhe betimit për besnikëri, janë mjaft të pabesueshëm kur është fjala për bashkëpjesëmarrësit, sidomos në paraburgim. Frikohen që ai tjetri të mos ia hedhë fajin atij, kështu që edhe kjo duhet të shfrytëzohet.

c) Të thirremi në krenarinë dhe nderin me anë të lajkatimit dhe të aluzioneve për reputacionin, inteligjencën dhe trimërinë e tij. Teknika ka për qëllim të provokojë ndjenjën e superioritetit që intimisht është rrënjësuar në personalitetin e kriminelit profesional.

d) Të paralajmërohet subjekti për pasojat e rënda të sjelljes asociale. Duhet të zhvillohet teza se më mirë është t'i kthehet jetës së qetë dhe të ndershme, në vend të jetës së rehatshme në dukje që është përplot me pasiguri dhe frikë, që nuk shpie askund dhe është paperspektivë.

e) Me anë të rrugës së tërthortë të arrihet deri te pranimi i ngjarjes kryesore.

Të shfrytëzohen gënjeshttrat e të dyshuarit. Gënjeshttrat e të dyshuarit, që janë shpeshta, duhet të shfrytëzohen për destabilizimin e personalitetit të tij. Teknika është e thjeshtë, të lejohej që të gënjejë sa më shumë, madje edhe të provokohen gënjeshttra të reja, ashtu që të zhytet në gënjeshtra dhe pastaj nuk do të dijë më si të sillet.

g) Ti mundësohet të dyshuarit përpjekja e ikjes ose e vendosjes së kontakteve sekrete. Kjo masë operative – taktike është shumë e rrezikshme, por nëse organizohet mirë mund të japë rezultate të mira.

h) Regjistri i emrave. Kjo masë operative taktike është pak e njohur, e konsiston në provokimin psikologjik të të dyshuarit që të ballafaqohet me emrat që lidhen me ngjarjen kriminale dhe të shihet se si do të sillet lidhur me këtë. Është e njohur se

kriminelët me përvojë i shmangen përmendjes së çfarëdo emri, nga frika që nga kjo të mos dalë ndonjë informatë, e cila do të mund t'i sillte në situatë të pakëndshme.

Të dyshuarit i thuhet që të bëjë regjistrin prej 15 deri në 20 emra të personave, të miqve dhe të të afërmeve, të partnerëve afaristë dhe të të tjerëve me të cilët në kohë të fundit ka kontakte të rëndësishme. Ai është në dilemë se a din policia diçka ose jo, nuk do të dijë që të përcaktohet, kështu që bashkëpjesëmarrësin, nxitësin ose bashkëpunëtorin, e mundet edhe dëshmitarin, viktimën ose të dëmtuarin ta lë anash ose ta regjistrojë nga fundi i regjistrit.

Kjo vë në dukje faktin se kreativiteti në këtë fushë të punës kriminalistike është mjaft i shprehur, kështu që me të drejtë pritet se edhe gjeneratat e ardhshme do të japin kontribut në zhvillimin e metodave dhe të teknikave të punës me personat e dyshuar.

### **Parimet psikologjike të parashtrimit të provave materiale para personit të dyshuar**

Është parim i përgjithshëm taktik i punës që me provën ose me provat mbi ngjarjen kriminale dhe kryerësin, nëse i posedon punëtori operativ, duhet vepruar në mënyrë të mençur dhe racionale. Kjo do të thotë se provat, materiale dhe personale, duhet të parashtrihen para të dyshuarit në mënyrë graduale dhe në një moment të përshtatshëm. Në fillim duhet të parashtrihen provat më pak të rëndësishme dhe parciale, që do të shërbejnë si paralajmërim se janë të njohura të gjitha rrethanat dhe faktet mbi ngjarjen kriminale dhe kryerësin. Në rrjedhën e mëtejshme të bisedës informative duhet të parashtrihen provat më të rëndësishme, të cilat definitivisht do ta thejnë rezistencën e të dyshuarit dhe ai do ta pranojë veprën penale.

Natyrisht, kjo vlen në parim dhe në të shumtën e rasteve kështu do të zhvillohej, por mbetet fakti që punëtori operativ vendos kur do të veprojë në këtë mënyrë. Për shembull, nëse i dyshuari është person primitiv, në një nivel të ulët intelektual, nuk është e rekomandueshme që t'i prezantohen provat në fazën fillestare të veprimit, sepse është e njohur që këta persona janë kokëfortë dhe të papërshtatshëm për argumentim.

Pavarësisht nga mënyrat e cekura të qasjes ndaj të dyshuarit, mund të aplikohen edhe disa rregulla dhe teknika të zhvillimit të bisedës, si për shembull:

- Të pyetet subjekti se a e di pse është ftuar dhe në këtë mënyrë të arrihet deri te informatat e caktuara.
- Është e nevojshme të hulumtohet vendi i qëndrimit para, gjatë dhe pas krimit. Ky është, në të vërtetë, konstatimi i alibisë, me ç'rast personave të pafajshëm sipas rregullës nuk u kujtohen të gjitha hollësitë, sepse kjo nuk ka qenë e rëndësishme për ta, kurse kryerësit shpeshherë kanë alibinë e përgatitur që më parë me të gjitha detajet. Kësaj duhet kushtuar kujdes, sepse mund të jetë indikative.
- Të pyetet subjekti që të tregojë çdo gjë për ngjarjen, për viktimën, për kryerësit e mundshëm. Kjo pyetje parashtrihet në fazat fillestare të bisedës.
- Në distanca të caktuara kohore t'i parashtrihet subjektit pyetja në mënyrën sikur përgjigjet e sakta tashmë janë të njohura. Tek kjo teknikë në rastet më të shpeshta parashtrihen pyetjet që përfshijnë edhe përgjigjen, për shembull, "Ju e keni njohur Zaimoviqin, apo?", ose jepet paralajmërimi për përgjigjen e saktë.

Në pajtim me parimin e individualizimit të trajtimit, siç është theksuar më parë, duhet pasur kujdes për karakteristikat e çdo personi.

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME PARAQITËSIT**

Si paraqitës mund të jetë personi juridik ose fizik që ka njohuri se ka ndodhur vepra e caktuar penale. Me Ligjin mbi procedurën penale është përcaktuar që paraqitjen penale mund ta bëjnë subjektet e ndryshme – organet shtetërore, organizatat punonjëse dhe organizatat e tjera si dhe qytetarët sipas obligimit ligjor ose vullnetarisht.

Janë të mundshme rastet e ndryshme të paraqitjes. Mund të paraqitet vepra penale, e të mos dihet se kush është kryerës, mund të paraqitet vepra penale edhe kryerësi, pastaj personi mund të paraqesë veten si kryerës i veprës penale në të cilën ai është i dëmtuar, ose viktimja etj. Mund të paraqitet edhe vepra e rrejshme penale.

Psikologjinë kriminalistike në rastet e këtilla e interesojnë karakteristikat psikologjike të paraqitësit dhe, varësisht nga kjo, besnikëria e deklaratës. Besnikëria e deklaratës së paraqitësit së pari varet nga rregullsia e vrojtimit dhe mundësia e riprodhimit të saktë, që u nënshtrohen mjaft shtrembërimeve dhe paplotësive për shkak të rrethanave objektive dhe subjektive. Faktor plotësues, madje shumë i fuqishëm, i cili deklaratën e paraqitësit e bën relevante, është motivi ose shkasi i paraqitjes. E kur është fjala për këtë, është e qartë se në esencën e paraqitjes mund të ketë motive të ndryshme. Mund të jetë qëllimi i mirë që të ndihmohet, që të mbrohet interesi i tij ose të kompensohet dëmi, mund të jetë vetëparaqitje, sepse nuk mund të shmanget përgjegjësia ose të mënjanohet dyshimi, përkatësisht të fshihet ndonjë vepër tjetër penale, mund të jetë urrejtja ose dëshira për hakmarrje etj.

Punëtorët operativë, duke pasur parasysh faktet e cekura dhe duke aplikuar parimet e përgjithshme taktike në punën me këtë kategori të palëve, duhet të binden në mënyrë të përshtatshme në gjendjen faktike dhe në vlefshmërinë e të dhënave që janë objekt i paraqitjes.

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME DËSHMITARËT**

### **Karakteristikat psikologjike të dëshmitarëve dhe taktika e sjelljes dhe e zhvillimit të bisedës informative**

Dëshmitar është personi për të cilin supozohet se i ka të njohura faktet dhe rrethanat mbi veprën penale dhe kryerësin, të cilat i ka siguruar me anë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë shqisor ose i ka kuptuar në ndonjë mënyrë tjetër. Si dëshmitar mund të jetë i ftuar personi, në pajtim me ligjin, për të cilin ekziston vlerësimi se do të kontribuojë në ndriçimin e ngjarjes kriminale. Për këto arsye janë shkoqitur dhe përcaktuar rregullat penale – procesore dhe kriminalistike – taktike të marrjes në pyetje të dëshmitarit.

Psikologjinë kriminalistike e interesojnë rregullat, masat dhe veprimet e karakterit psikologjik në punën me dëshmitarët në procedurën parapenale, përkatësisht penale.

Në kuadër të këtyre dy kategorive të dëshmitarëve, mund të paraqiten personalitete me karakteristika specifike sipas kriteriumeve të tjera psikologjike. Nëse merren parasysh disa veçori të karakterit, të vullnetit dhe të aftësisë, si dhe karakteristikat e të folurit dhe të mënyrës së të folurit, është e mundur ndarja në këta tipa dëshmitarësh.

**Tipi i vëzhguesit.** Vëzhguesi si personalitet është preciz, konkret dhe i qartë. Është i orientuar në faktografinë e ngjarjes dhe të situatës dhe sillet me përgjegjësi dhe me ndërgjegje. Është i hollësishëm dhe i sigurt. Bën pjesë ndër dëshmitarët më të sigurt.

**Tipi i përshkruesit.** Përshkruesi është personalitet që dëshiron të hyjë në gjerësinë e dukurive dhe të ngjarjeve. Personi i këtillë në bisedë së pari bën hyrjen, pastaj paraqet rrjedhën dhe kronologjinë e ngjarjeve, duke përshkruar krejt çka ka ndodhur. Ndërkaq, shpeshherë humbet në hollësi, duke mos u kujdesur për tërësinë.

**Llomotitësit dhe heshtakët.** Llomotitës janë njerëzit që dëshirojnë të vihen në dukje, ndonjë herë edhe me çdo çmim. Për këtë arsye kujdesen që në bisedë të jenë kryesorët, pa marrë parasysh rëndësinë e temës dhe korrektësinë në sjellje.

Heshtakët si dëshmitarë sillen në mënyrë të kundërt me llomotitësit. Ndër heshtakët mund të gjenden persona introvertë që i janë kthyer më tepër vetvetes, sesa ngjarjeve të jashtme dhe të të tjerëve. Edhe disa karakteristika, qëndrime dhe shprehje të tjera mund të ndikojnë në abstenimin dhe heshtjen në bisedë.

**Tipi i interpretuesit.** Për këtë tip të personalitetit si dëshmitar në punën operative, menjëherë po vejmë në dukje se mund të jetë më tepër i dëmshëm, sesa i dobishëm, përkundër faktit që në literaturë për te jepen vlerësime më të volitshme. Sidomos mund të jetë i rrezikshëm për punëtorët operativë të papërvojë dhe të pasigurt në vetvete.

Interpretuesi në bisedë mund të njihet sipas fjalëve: “mendoj se ka ndodhur për këtë e këtë arsye ...”, “jam i sigurt se kjo nuk do të ndodhte, sikur të mos ishte ajo”, “është më së miri që të veproni kështu...”, “më besoni mua ....”, etj.

**Dëshmitari detektiv – amator.** Ky tip i dëshmitarit mund të jetë variant i interpretuesit, por s’është e thënë. Paraqitet tek disa vepra penale, sidomos tek vrasjet, dhunimet në seri, shqetësimet e ndryshme ose veprat e ngjashme me elemente enigmatike. Detektivi amator është person ambicioz dhe shpeshherë qëllimshëm që luan rolin e policit kriminalist nga motivet personale, e është i nxitur nga filmat, literatura ose ngjarjet e jashtme.

**Tipi i mbiçmuesit dhe i nënçmuesit.** Tipi i tillë të personalitetit ka mjaft dhe mund të paraqitet si dëshmitarë në punën operative. Të ngjashëm me ta janë optimistët dhe pesimistët. Mbiçmuesit flasin për çdo gjë në kategoritë ekstreme, çdo gjë është super, maksimale, e parevokueshme e kështu me radhë. Nënçmuesit, përkundër tyre, zvogëlojnë vlerat e çdo ngjarjeje dhe situatë. Ndonjëherë janë edhe nihilistë, konsiderojnë

se kjo nuk është e vlefshme për kujdes dhe nuk duhet të lodhen njerëzit me “imtësira” dhe me “marrëzira”.

**Tipi i gënjeshtarit.** Një numër i madh njerëzish shërbehen me gënjeshtria, të vogla ose të mëdha. Modalitetet e gënjeshtimit mund të jenë në formë të shtrembërimit të drejtpërdrejtë të fakteve, të të ashtuquajturit ondulimit të të dhënave, me shtimin e të dhënave të tjera (“shartimit” të të dhënave nga një ngjarje në tjetrën), me shpikjen e “fakteve” të reja, me heshtjen, etj.

Gënjeshtarët në esencë mund t’i ndajmë në të qëllimshëm dhe të paqëllimshëm.

**Tipi i kombinuar.** Ekzistojnë edhe tipa të tjerë psikologjik të dëshmitarëve, siç janë personat kokëfortë, amoralë, (vetë)lavdëruesit, frikacakët, etj. Veçoritë e cekura mund të shprehen tek disa tipa të personaliteteve të cekura më parë, kështu që në këtë rast mund të bëhet fjalë për tipin e kombinuar të dëshmitarit.

### **Faktorët psikologjik të besueshmërisë së thënies së dëshmitarit**

Hulumtimet eksperimentale në lëmin e vërtetimit dhe të studimit të procesit të kujtesës, ofrojnë një varg të dhënash që mund të shfrytëzohen në psikologjinë e aplikuar, kriminalistike dhe forenzike, që janë mjaft të rëndësishme për besueshmërinë e thënies së dëshmitarit. Pasqyrimi i disa rezultateve të hulumtimeve eksperimentale nga kjo fushë vejnë në dukje sa vijon:

1) Eksperimenti me kujtesën e fjalëve dhe të fotografive, i zbatuar tek 500 studentë të Universitetit të Uashingtonit, ka dëshmuar se me kalimin e kohës bëhet bashkimi i të dhënave nga burime të ndryshme, kështu që dëshmitari e ka të vështirë të thotë saktësisht prej nga i ka njohuritë për ndonjë hollësi të caktuar (Elizabet Loftus, 1974, Uashington).

2) Një studim, hulumtim i hollësishëm, gjithashtu nga fusha e psikologjisë së thënies së dëshmitarëve, rezultatet e të cilit janë krahasuar me rezultatet e eksperimentit të cekur, i ka dhënë këto konstatime:

a) Gjendja e nderë dhe frika e madhe zvogëlojnë aftësinë e përpunimit të informatave në memorje;

b) Kujtesa e hollësive të ngjarjeve të kaluara është më precize, nëse në momentin e vërtetimit nuk ka pasur dhunë;

c) Tek sulmet grabitqare, viktimat kujdesin më të madh e përqëndron në armën e zjarrit, sesa në fytyrën e sulmuesit;

d) Me rastin e njohjes, është më vështirë të identifikohet personi i racës tjetër sesa personi i racës së vet;

e) Kohëzgjatja e krimit mbiçmohet kur është situata e rrezikshme, sa më e tensionuar që të jetë gjendja, edhe mbiçmimi do të jetë më i madh;

f) Siguria e madhe subjektive e dëshmitarit në thënien e tij nuk është garancion se dëshmia është e saktë, përveç në situatat tejet të volitshme;

g) Të vogla janë gjasat se personi më i vjetër do ta përshkruajë ngjarjen me aq precizitet dhe plotësi si personi i ri;

h) Fëmijët më të rinj se 14 vjeç, si dëshmitarë kanë tendencën që të japin përgjigje çfarë (sipas mendimit të tyre!) priten prej tyre;

3) Personi që është njohur më parë në bazë të fotografisë, me siguri do të njihet edhe drejtpërdrejt, pa marrë parasysh se a është kryerës i veprës penale ose jo.

Ky hulumtim është zbatuar ndaj 35 gjykatësish hetues, 25 policësh, 8 gjykatësish, 16 psikologëve – ekspertë për këtë fushë, 60 studentëve dhe 60 personave më të moshuar. Përveç analizave të cekura, hulumtimi ka dhënë edhe një varg rezultatesh të tjera. Është dëshmuar se ekzistojnë dallime individuale, si dhe dallime midis grupeve, d.m.th. midis kategorive të pjesëmarrësve, gjë që ka qenë normale edhe të pritet. Është nxjerrë, p.sh. një konstatim interesant, se policët profesionistë nuk janë dëshmuar aspak dëshmitarë më të mirë se pjesëmarrësit e tjerë, edhe pse kjo, normalisht, është pritur. (A.D. Sarmes IN. T. Jones 1985, burimi Roso Zvonimir, op. cit., fq. 188).

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME FËMIJË DHE ME TË MITUR**

### **Karakteristikat psikologjike të fëmijëve dhe të të miturve**

Fëmijët dhe të miturit në pajtim me veçoritë psikologjike të moshës së vet shprehin një interes të shtuar për ngjarjet dhe ndodhitë rreth vetes. Kanë aftësi të mirë të vërtetimit dhe riprodhim të mirë të kujtesës. I mbajnë mend mirë detajet, veprimin, personalitetet dhe rrjedhën e ngjarjeve, edhe pse në kohë orientohen dobët. I njohin mirë ngjyrat, por shpeshherë nuk janë në gjenje t'i emërojnë.

Fëmijët janë të prirur të imagjinojnë, sepse janë përplotë kërsheeri dhe dëshira të ndryshme, e me mundësi të vogla. Shpeshherë humbin ndjenjën e realitetit, i përziejnë ngjarjet dhe situatat reale dhe të shpifura. Fëmijët u nënshtrohen sugjestionëve, kështu që të rriturit shpeshherë manipulojnë me ta. Është e mundur t'u imponohet versioni i ngjarjes që, në të vërtetë, nuk ka ndodhur. Në kundërshtim me këtë, fëmijët mund të jenë mjaftë komngulës dhe kokëfortë në mbrojtjen e mendimit të vet, sepse kështu provojnë dhe u kundërvihen autoriteteve dhe më të vjetërve. Në kohën e pubertetit, thëniet janë të pasigurta, sepse fëmijët dallohen me ndjenjën e krenarisë, të gjithëdijshmërisë dhe të kundërshtimit. Vajzat gjenden para ndikimit të paqartë të pasionit gjinor, prandaj vërtetimet i interpretojnë nga aspekti egocentrik dhe autistik. Veçmas duhet të jemi të kujdesshëm kur vajzat ose vajzat e mitura ankohen për ngashnjime seksuale, sepse kjo mund të jetë e pasaktë si rezultat i gjendjeve të veçanta shpirtërore.

### **Taktika e sjelljes dhe e zhvillimit të bisedës informative me fëmijë dhe të mitur**

Procedura dhe biseda me fëmijë dhe të mitur është analizuar dhe definuar mjaft në literaturë dhe është aplikuar në praktikë. Në kontekstin e shqyrtimeve të cekura, do të jetë e dobishme të shfrytëzohen edhe disa rregulla psikologjike – taktike, siç janë:

a) Biseda me fëmijë dhe me të mitur duhet të përgatitet mirë, të fiksohet në mënyrë të saktë vendi dhe koha, dhe në parim, të zhvillohet vetëm një herë. Biseda duhet të zhvillohet hollësisht dhe në mënyrë të plotë.

b) Në përgatitjen e bisedës, është e nevojshme të kontaktohet me prindërit, sepse ndihma e tyre është e domosdoshme që të vendoset një raport dhe bashkëpunim i mirë me



fëmijë. Ndonjëherë është e dobishme të kontaktohet edhe me autoritetet shkollore, drejtorin, psikologun dhe kujdestarin e klasës.

Prania e prindërve dhe e personave të tjerë, ndërkaq, nuk është asesi e dëshirueshme gjatë zhvillimit të drejtpërdrejtë të bisedës informative. Ndikimi sugjestiv i prindërve dhe qëndrimi i tyre i anshëm mund të ndikojë në sigurinë më të madhe të fëmijëve, kështu që ai mund të imagjinojë dhe të shtrembërojë faktet.

c) Biseda duhet të zhvillohet sa më parë, sidomos nëse është fjala për fëmijën më të ri dhe për të miturin. Parimi kriminalistik i operativitetit dhe të shpejtësisë në rast të fëmijëve dhe të të miturve është mjaft i rëndësishëm, sepse kujtesa e tyre dobësohet shpejt ose bllokohen nëse janë të ngjyrosura me afekte, dhe për shkak të veprimit sugjestiv të të rriturve, të farefisit dhe të moshatarëve.

d) Para vetë bisedës, duhet të zhvillohet biseda hyrëse me qëndrim të sinqertë me qëllim të krijimit të besimit që e lehtëson kontaktin.

e) Të mos lejohet që fëmija ose i mituri të ndjejë se ai është personaliteti kryesor në ngjarje dhe në veprim, sepse pastaj është vështirë të frenohen dhe të kontrollohen thëniet dhe sjelljet e tij.

f) Deklaratat kategorike dhe pohimet që nuk i përgjigjen gjendjes faktike nuk duhet të kundërshtohen menjëherë me sulmin ndaj personalitetit të tij, sepse kjo mund të shtojë kryeneçësinë dhe kokëfortësinë e tij. Thëniet e tilla duhet të kundërshtohen gradualisht me anë të rezonimit të argumentuar dhe logjik.

g) Të përdoren fjalët dhe gjuha me të cilën flet fëmija dhe e cila për te është e qartë dhe e kuptueshme.

h) Gjatë bisedës, fëmija dhe i mituri duhet të nxiten, të lavdërohet gatishmëria dhe përpjekja e tij që të ndihmojë, të lavdërohen dhe të theksohen veçoritë, inteligjencia, sinqeriteti dhe trimëria e tij, etj.

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME PERSONA TË MOSHUAR**

Konsiderohet se procesi i plakjes paraqitet pas viteve të gjashtëdhjeta, kur fillon dobësimi i ndjeshëm i funksioneve psikike dhe fizike dhe i aftësive mentale, fizike dhe shëndetësore. Njëkohësisht me këtë ngadalësohen, dobësohen dhe pushojnë shumë pasione dhe motive vitale, jetësore, si për shembull motivi për përparim, pastaj ambiciet, kënaqësitë, dëshirat dhe nevojat. Sipas disa kriteriumeve biologjike, nga fundi i viteve të pesëdhjetata, pushon aftësia e organizmit për riprodhim dhe gjenerim, e paraqiten proceset e degradimit dhe kështu fillon plakja. Karakteristikat psikologjike të personave të moshuar janë të llojllojshme dhe të shumta. Me analizën e veçorive tipike dhe për kriminalistikë të rëndësishme, mund të përpilohet ky pasqyrim.

Tek personat e moshuar janë të zvogëluara funksionet e organeve shqisore, gjë që ndikon në gabimet në vërtetim. Sidomos është i shprehur dobësimi i të parit dhe dëgjimit.

Personat më të moshuar kanë të zvogëluar kujdesin dhe koncentrimin e dobët gjatë vërtetimit.

- Procesi i riprodhimit është i vështirësuar dhe jo i plotë. Personat më të moshuar më mirë i kujtojnë ngjarjet nga e kaluara sidomos të ngjyrosura në aspektin afektiv,

sesa ngjarjet e reja që nuk mund të konsolidohen në vetëdijen e tyre për shkak të proceseve metabolike dhe të përjetimit të përciptë.

- Me rastin e riprodhimit të ngjarjes tek personat e moshuar zhvillohet procesi i kontaminimit, ngjarja në fjalë megjulohet me të dhëna nga ndonjë ngjarje tjetër, që logjikisht përputhen, me çka plotësohen “vrimat” në kujtesë.

- Personat e moshuar mund të jenë mjaft të prirur për imagjinatë, si dhe për shtrembërimin e vetëdijshëm, përkatësisht të pavetëdijshëm të ngjarjes. Mallëgjimi për atë që është humbur dhe nuk është realizuar, dhe dëshira që të pasqyrohen në dritën pozitive nga rinia, janë arsye e dukurive të tilla.

Tek personat e vjetër, përveç ndryshimeve të cekura mentale, zhvillohen edhe ndryshime psikosociale, që duhet pasur parasysh në mënyrë që taktika e sjelljes dhe e zhvillimit të bisedës me ta të jetë më e suksesshme. Ato janë:

- Ndjenja e padobishmërisë dhe e braktisjes,
- Varësia e shtuar nga të tjerët,
- Frika nga sëmurja dhe vdekja,
- Sugjestibiliteti, përkulshmëria dhe luhatshmëria, por edhe prirja për grindje,
- Zmadhimi i veçorive personale,
- Lavdërimi dhe dëshira për këshillim.

Nëse kanë dëgjim të dobët, duhet biseduar me zë normal, por duhet të shikohen direkt në fytyrë, ashtu që të mund t'i përcjellin lëvizjet e buzëve. Në bisedë me personat me shikim më të dobët, nuk duhet qëndëruar tepër afër, sepse kryesisht janë lartëpamës.

## **PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME GRA**

### **Karakteristikat psikologjike të grave dhe veprimi me to në bisedën informative**

Dallimet psikologjike midis grave dhe meshkujve janë rezultat i faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe socialë. Gratë janë si konstrukt biopsikologjik shumë më të thelluara në përjetimin e ngjarjeve, të njerëzve dhe të situatave. Manifestojnë emocione më të shumta, më të llojllojshme dhe më të fuqishme, në aspektin intelektual mendojnë më shumë, rezonojnë nga shumë aspekte, dhe shpeshherë janë më mendjeholla se meshkujt.

Në bisedë me gratë duhet pasur parasysh specifikat e gjendjes së tyre psikofizike, kështu që taktika e bisedës dhe e sjelljes t'u përshtatet atyre:

- Rekomandohet një qëndrim i qetë, i kulturuar dhe i matur i punëtorit operativ.

- Pamja e lokalit, veshja dhe sjellja e punëtorit operativ duhet të krijojnë përshtypjen se i kushtohet kujdes dhe respekt.

- Gruaja është e interesuar që të vihet re pamja, shija, veshja dhe kualitetet e tjera të saj, prandaj nuk duhet ngurrar të mos vërehet kjo dhe eventualisht të theksohet. Mund të përdoren edhe komplimente të caktuara në mënyrë diskrete dhe të paimponueshme dhe me kusht që të kenë bazë reale.

- Shpeshherë është i pranishëm koketimi i zakonshëm i grave, njëfarë imponimi, loja me sy etj. Në këtë rast, mund të përdoret edhe lajkatimi i drejtpërdrejtë, por duhet të jemi i kujdesshëm për të mos rënë në grackë të provokimeve të paramenduara, që ajo do t'i keqpërdorë dhe shfrytëzojë më vonë që të mënjanojë dyshimin dhe t'i fshehë gjurmët.

- Në rastet e dyshimit, nëse është gruaja e vrazhdë dhe e pa skrupull, e nëse në dhomë nuk ka pasqyrë transparente, rekomandohet prania e personit të tretë, për shkak të mundësisë së fajësimit të rrejshëm për ngacmim dhe dhunim.

- Kur zhvillohet biseda për delikte seksuale viktimat të cilave janë gratë, është më mirë që bisedën ta zhvillojë personi femër, për shkak të shprehjes së lirë dhe të paraqitjes së hollësive intime.

- Taktika e preferuar e grave janë lotët. Vërshimi i lotëve mund të ndërpritet në mënyrë të thjeshtë me fjalët që të qajë lirisht, nëse kështu do ta ketë më lehtë. Pastaj duhet vazhduar në mënyrë të qetë me parashtrimin e pyetjeve.

### **Psikologjia e sjelljes dhe e zhvillimit të bisedës informative me personat me sjellje specifike**

Personat me sjellje specifike janë personat që kanë anomali të caktuara të karakterit organik ose psikologjik, për shkak të të cilave manifestojnë karakteristika specifike psikologjike në sjellje dhe në përshtatjen ndaj mjedisit social. Të tillë mund të jenë personat e sëmurë, personat me të meta trupore, personat me çrregullime të ndryshme psikike, siç janë neurotikët, psikopatët, personat paranoikë, histerikët dhe çrregullimet e tjera, si dhe personat e sëmurë mental.

Kategori të tilla të personave ka më shumë në popullatën delikuede sesa në popullatën jodelikuede. Një numër i madh i tyre merren me delikte asociale dhe kriminale nga fusha e patologjisë sociale, siç janë alkoolizmi, bixhozi, homoseksualizmi dhe prostitucioni.

### **PERSONAT ME DËMTIME TRUPORE DHE TË SËMURËT**

Në këtë kategori bëjnë pjesë personat me forma të ndryshme të të metave të lindura trupore ose të dëmtimeve organike gjatë jetës për shkak të sëmundjes ose të lëndimeve mekanike. Hendikepi mund të shprehet në formë të butë ose në masë më të madhe, kështu që mund të gjenden invalidët dhe të sëmurët kronikë të shkallëve të ndryshme.

Këta persona formojnë filozofinë jetësore të inferioritetit, ndonjëherë deri te pafuqia dhe privimi nga të gjitha kënaqësitë. I përcjell ndjenja e lënies pasdore dhe e braktisjes për ç'arsye janë vazhdimisht të pakënaqur, shpeshherë edhe të indinjuar, gjë që është rast me invalidët e rëndë dhe me të sëmurët. Hapësira e ngushtuar jetësore dhe pafuqia ndikojnë që vazhdimisht të ankohen dhe të jenë të indinjuar për shkak të moskujdesit dhe johumanitetit. Të lënë pas dore, janë të mbyllur në botën e tyre të imagjinatës dhe të botëkuptimeve morale.

Vështirësitë në përshtatjen e këtyre personave i bëjnë bashkëpunëtorë të dobët në punën operative. Në bisedë dhe në sjellje me këta njerëz punëtori operativ duhet të jetë i kujdesshëm dhe taktik. Teprimi në cilindo aspekt dhe sjellja në shabllon mund të shkaktojë ofendimin dhe refuzimin e bashkëpunimit. Nëse kujdesemi për momentet e

cekura dhe vlerësojmë mirë personalitetin e personit të hendikepuar, mund të bëhet një taktikë e mirë e bisedës dhe e sjelljes me këta persona.

## **KARAKTERISTIKAT PSIKOLOGJIKE TË HOMOSEKSUALËVE**

Për homoseksualët është bërë fjalë me rastin e shqyrtimit të çrregullimeve dhe të deformimeve të instinktit seksual. Gjithashtu është bërë fjalë edhe për delikuncën dhe pasojat shoqërore të kriminalitetit, të mbështetur në lidhjet homoseksuale të njerëzve që gjenden në vende të rëndësishme të punës në ekonomi dhe në veprimtari të tjera. Viteve të fundit qëndrimi ndaj homoseksualizmit është më liberal, më pak i gjykueshëm dhe moralisht i anatemuar për shkak të njohurive shkencore mbi organizmin dyseksor të njeriut si dukuri normale, e jo si anomali (patologji). Varet vetëm se cilat karakteristika dhe me të cilën shkallë mbisundojnë tek personi i caktuar, a janë ato mashkullore ose femërore.

Në disa vende, homoseksualizmi është legalizuar edhe me ligj. Megjithatë, homoseksualët duke ndier pabaraspeshën biologjike hormonale, psikologjikisht janë të destabilizuar dhe në këtë aspekt janë të hutuar me gjendjen e vet, të pasigurt dhe të frikësuar, kurse duke ndier gjykimin moral të shoqërisë, janë hipokrit dhe dyftyrësh. Në esencë janë qyqarë, por mund të jenë edhe mjaft kokëfortë.

Mirëpo, në kontaktet me policinë në bisedën informative dhe me raste të tjera është e pranishme dhe e dukshme pasiguria në dhënien e deklaratave, si rezultat i pasigurisë së përgjithshme, i fshehjes dhe i kompleksit të fajit. Janë të shpeshta rastet e shantazheve e të shfrytëzimit edhe të veprave lidhur me alkoolizmin dhe narkomaninë.

Homoseksualizmi, sidomos në qytete, është dukuri mjaft e përhapur dhe formë e rëndësishme e patologjisë sociale dhe e veprimit kriminal.

## **KARAKTERISTIKAT PSIKOLOGJIKE TË PROSTITUTAVE**

Prostitutat shpeshherë shfrytëzohen si lidhje operative me qëllim të fitimit të të dhënave të caktuara për veprat e ndryshme penale. Ato kanë kontakte me kategori mjaft të llojllojshme të qytetarëve nga mjediset e ndryshme, kështu që shumë gjëra i dëgjojnë, i shohin ose janë në situatë ti njohin. Për këtë arsye mund të jenë burim mjaft i mirë i informatave. Mirëpo, është problem i madh të përfitohen këta persona për bashkëpunim, e edhe më vështirë të ruhen kontaktet për një kohë më të gjatë për këto qëllime.

Prostitutat janë nën vështirimin e vazhdueshëm të makrove të tyre dhe të kriminelëve, prandaj frikohen nga hakmarrja, e shpeshherë ka edhe solidarizm për shkak të rezistencës ndaj policisë. Për këtë arsye bashkëpunimi me prostitutat nuk është i thjeshtë, as i lehtë, siç mund të mendohet në shikim të parë. Edhe kur pranojnë bashkëpunimin, ky mund të jetë më tepër në fjalë, në mënyrë që të mos shqetësohen nga policia dhe të jenë të dyshimta për punëdhënësit e tyre, e kur duhet të hyjnë në punë dhe të japin të dhënat, zhagisin dhe arsyetohen në mënyra të ndryshme.

Punëtori operativ pikërisht mund të shfrytëzojë këtë kontekst të situatës së saj jetësore dhe t'i qaset si qenie e denjë për respekt. Momenti tjetër i përshtatshëm është aluzioni në njëfarë lloji të pozitës së ngjashme dhe të fatit të përbashkët, sepse profesioni u imponon që të sillen në botën e kriminalitetit dhe të merren me njerëz “nga ana tjetër e ligjit”.

Megjithatë, mbetet fakti që me prostituta është vështirë të punohet, e sidomos të zhvillohet biseda informative. Karakteristikat tipike psikologjike që manifestohen në sjellje dhe në bisedë janë këto:

- Prostitutat kanë karakter mjaft labil, janë të prirura të gënjejnë dhe janë të pabesueshme.

- Janë mjaft të ndjeshme ndaj ofendimeve, insinuatave dhe qëndrimit jotaktik, sidomos lidhur me punën me të cilën merren.

- Ofendimet dhe përluljet nuk i falin dhe nuk i harrojnë, prandaj nuk ka kuptim përpjekja që gabimi të korigjohet dhe të vendoset raporti i mëparshëm.

- Janë refuzuese dhe cinike ndaj personaliteteve autoritative, institucioneve dhe ndaj pjesëtarëve të statusit të rëndësishëm shoqëror, gjë që mund të jetë e volitshme për punëtorin operativ.

- Janë të ndjeshme ndaj padrejtësive sociale, kanë dashamirësi ndaj të rrezikuarve dhe janë të gatshme që t'u ofrojnë ndihmë njerëzve me halle.

- Janë solidare me njerëzit që merren me veprimet asociale dhe kriminale.

- kur ndjejnë se janë të manipuluar ose të zbuluar, tërhiqen dhe pastaj është vështirë t'u bihet në gjurmë dhe të përfitohen për bashkëpunim.

- Tema e preferuar e tyre është “mjerimi, raportet e këqija familjare dhe jeta e rëndë në fëmijëri”, për ç'arsye kanë qenë “të detyruara” t'i jepen prostitucionit. Punëtori operativ mund ta shfrytëzojë këtë mekanizëm të fuqishëm të mbrojtjes dhe me “mirëkuptimin dhe përfilljen” e vet të problemeve jetësore të fitojë simpatinë dhe besimin e saj.

- Kur e pranon punëtorin operativ si mik dhe njeri, prostituta është e gatshme për bashkëpunim dhe mund të bëhet informator i mirë. Në këtë kontekst, duhet t'i vihet në dijeni se në një mënyrë të caktuar mund t'i ndihmohet kur ka nevojë për mbrojtje nga makrot, për kthim në rrugë të drejtë etj.

- Në kontakte me prostitutat duhet të jemi të kulturuar në sjellje, taktik, tolerant ndaj ofendimeve të tyre dhe të kujdesshëm ndaj provokimeve. Duhet vepruar në mënyrë profesionale dhe zyrtare dhe të mos hyhet në intimitete për arsye shëndetësore dhe profesionale, edhe pse sfida e tyre mund të jetë e madhe.

## **PERSONAT ME JONORMALITETE PSIKIKE**

Punëtorët e policisë, kriminalistët dhe policët në praktikën e vet ballafaqohen me persona që shprehin jonormalitete të lehta ose të rënda të llojeve të ndryshme. Disa prej personave të tillë janë raste në kufijë normal prandaj është vështirë të vërehen në vështrim të çrregullimit të caktuar psikik, ndërkaq ekzistojnë persona me çrregullime të shprehura dhe të qarta, si dhe mentalisht të sëmurë.

- Kur është fjala për këta persona si kategori të palëve në procedurën kriminalistike, duhet pasur parasysh dy gjëra:

- a) Është e vështirësuar zgjidhja e veprave penale në të cilat si kryerës, bashkëpjesëmarrës ose në ndonjë mënyrë tjetër janë të përzier personat mentalisht jonormal.

- b) Besueshmëria e thënieve të personave mentalisht jonormal mund të jetë problematike për shkak të specifikave të vrojtimit, të përjetimit, të kujtesës dhe të mundësisë së deklarimit. Vrojtimet mund të jenë të shtrembëruara dhe të paplota,

përjetimet specifike, kujtesa me zbraztësi dhe e plotësuar me fantazi, shprehja pa kontinuitet dhe denjësi, etiologjia e gënjeshtres paarritshme, etj.

## **VEPRIMI ME PERSONAT MENTALISHT JONORMAL**

Për punëtorët operativë, të njohur me dukuritë dhe format e çrregullimeve mentale dhe të aftësuar për njohjen e tyre, është e rëndësishme të dinë çfarë janë sjelljet tipike dhe çka mund të pritët në kontaktet me këta persona kur gjenden si palë në punën operative. Disa prej udhëzimeve më të rëndësishme që mund të ceken janë:

- Duhet të jemi veçanërisht i kujdesshëm në punën me skizofrenët, psikopatët, personat paranoik, të marrët, maniakët dhe personat gjaknxehtë, sepse ekziston mundësia e humbjes së vetëkontrollit dhe e sjelljeve të papritura si dhe e deklaratave verbale. Në gjendje të emocionalitetit, këta persona veprojnë në mënyrë agresive, prandaj është i mundur shkaktimi i lëndimeve trupore, e në rastet më të rënda edhe vrasja. Mund të ndodhë edhe vetëvrasja, për shembull tek skizofrenët dhe psikozat e burgut, por më rrallë.

Përkundër të gjitha maturive dhe udhëzimeve praktike, duhet edhe njëherë të theksohet se puna me personat mentalisht jonormalë është e vështirësuar dhe e rrezikshme, kurse besueshmëria e thënieve të tyre është relative dhe problematike.

## KAPTINA 4.

### BAZAT ORGANIKE TË JETËS PSIKIKE TË NJERIUT

Duhet pranuar singërisht se ne ende nuk e dimë se çka është ajo “psikike”, pra çka janë në të vërtetë përjetimet tona. Mirëpo, ajo që e dimë me siguri është se *psikikë nuk ka pa disa parakushte organike, fiziologjike*.

Ato parakushte fiziologjike janë: *Ekzistimi i sistemit nervor, dhe i pjesës së tij kryesore, d.m.th. të trurit*. Nëse nuk ka sistem nervor mund të jemi kryesisht të sigurt se nuk ka as përjetime, pra nuk ka jetë psikike. Njeriu të cilit i pushon truri t’i funksionojë, psikikisht është i vdekur, dhe ai nuk ka kurrfarë përjetimesh. Siç dihet, në disa ente shëndetësore për vendimin definitiv lidhur me atë se a ka vdekur dikush ose jo, nuk është aq i rëndësishëm pushimi i punës së zemrës, sa pushimi i valëve të trurit.

Shembull tipik për një sjellje të tillë, që *duket* i arsyeshëm, por nuk është, as që ka lidhje me përjetimet, është eksperimenti me bretkosën të cilës i pritët koka, por trupi funksionon normalisht, zemra i rrahë normalisht.

Kur para shumë kohësh hulumtuesit, fiziologët bënë eksperimente të këtij lloji, nuk habiste fakti që sjellja e tillë, në shikim të parë *e arsyeshme* e bretkosës, kishte lënë aq përshtypje sa disa prej tyre pohonin se është e pamundur që bretkosa gjatë asaj kohe fare të mos ketë ndier asgjë, por që tek bretkosa duhet të ekzistojë – përveç në tru -edhe një qendër tjetër, d.m.th. “shpirti në boshtin kurrizor” (Wirbelseele).

## NDARJA E SISTEMIT NERVOR

Sistemi nervor zakonisht ndahet në sistemin *qendror dhe periferik* (shih fotografinë 2.1.).




Fig. 2.1. SISTEMI NERVOR QENDROR DHE PERIFERIK

Sistemin nervor qendror, e njëherësh edhe kryesor, e përbëjnë truri i madh dhe i vogël dhe boshti kurrizor (dikur i quajtur “palcë kurrizore”), kurse pjesa periferike (janë ato nervat që shtrihen përgjatë trupit) zakonisht ndahet në sistemin nervor trupor ose *somatik* (greq. Soma=trup) dhe *vegjetativ*.

**Nervat somatikë** janë ata nerva me të cilët (a) *i marrim* informatat nga rrethina dhe nga trupi, dhe që quhen nerva sensorë (lat. sensus = ndjenjë), ose (b) ata, me të cilët *i drejtojmë* me vetëdëshirë muskujt dhe lëvizjet tona, prandaj quhen edhe *nerva motorik*.

**Nervat vegjetativë** (autonomë) janë ata nerva në të cilët kryesisht nuk kemi ndikim (për shembull nervat që rregullojnë punën e zemrës, të tretjes, të frymëmarrjes, të temperaturës trupore, të presionit të gjakut etj). Thamë “kryesisht”, sepse nuk është krejtësisht e saktë se në disa prej tyre nuk mund të veprojmë asesi: në frymëmarrje p.sh. mund të ndikojmë me dëshirën tonë (disa dhjetra sekonda), e në disa funksione të tjera



mund të veprojmë me anë të trajnimit, t'ia dalim të arrijmë një veprim të caktuar: p.sh. disa fakir indianë ia dalin që me anë të trajnimit afatgjatë aq shumë të zvogëlojnë shpenzimin e oksigjenit, sa mund të qëndrojnë gjatë të mbyllur në një hapësirë të vogël, p.sh. në arkivol . Disa njerëz ia dalin që me ushtrime këmbëngulëse të zvogëlojnë p.sh. presionin e vet të gjakut, në atë mënyrë që të mësojnë “të bëjnë diçka” në mënyrë që aparati i cili regjistron shtypjen e gjakut të tregojë uljen. Ata nuk mund të përshkruajnë çka bëjnë në të vërtetë në mënyrë që t'u bie shtypja e gjakut, por – kur njëherë e kanë mësuar atë teknikë – terapia e tyre (bashkë me barëra) konsiston në faktin që disa herë në ditë “vetvetes ia ulin tensionin”. Kjo metodë sot shfrytëzohet gjithnjë e më tepër dhe është e njohur me emërtimin si metoda e shërimit “bio-feed-back”. (në gjuhën tonë për feed-back është pranuar shprehja “veprimi retroaktiv”, por nuk jam mjaft i kënaqur me një emërtim të tillë, p.sh., për uljen e tensionit të gjakut).




FIG. 2.2. SKEMA E NDARJES SË SISTEMIT NERVOR

Sistemi nervor vegjetativ më tej ndahet në sistemin *simpatik* (greq. *simpateo* = bashkëndjejë), d.m.th. ai që i *mobilizon* aktivitetet trupore (p.sh. në qastin e rrezikut, të luftës për jetesë, të motivimit të fuqishëm etj), dhe *parasimpatik* (greq. *para* = kundër), e ky është ai që deri dikund është i kundërt me sistemin simpatik, pra kryesisht është aktiv në fazat e *pushimit dhe të këndelljes së organizmit*. Skema e kësaj ndarjeje të sistemit nervor është pasqyruar në fig. 2.2.

## TRURI

Truri anatomik dhe fiziologjik mund të pasqyrohet në mënyra të ndryshme, por një nga ndarjet e mundshme i cek tri ndarje themelore (shih fig. 2.3.).




FIG. 2.3. NJË NGA NDARJET  
THEMELORE TË TRURIT

A. **Palca e zgjatur.** Kjo është pjesë që shtrihet nga mbarimi i sipërm i boshtit kurrizor dhe sipas të gjitha gjasave, deri te baza e trurit. Kjo pjesë është përgjegjëse për funksionet themelore jetësore dhe për mbijetesë. Nëpër atë pjesë kalojnë rrugët kryesore nervore të ndjeshmërisë dhe të lëvizjes, aty kryqëzohen nervat, kështu që nervat e anës së majtë të trupit hyjnë në anën e djathtë të trurit, dhe anasjelltas; nëpër atë pjesë kalon e ashtuquajtura “substanca retikulare”, përgjegjëse për “vigjilencë” të organizmit, si dhe për fjetje, aty janë qendrat e frymëmarrjes, pulësi, tensioni i gjakut, disa qendra të përjetimeve, qendrat e punës së zorrëve etj.

B. **“Truri i vogël”.** Ai është i domosdoshëm për lëvizjet tona dhe për rregullimin reflektiv të tyre. Mirëpo, për te do të themi diçka më tepër më vonë.

C. **Truri imadh.** Ai ndahet në dy pjesë kryesore: në **korën e trurit (ose korteksin)** dhe në **strukturat nën korteks**. Pjesa kryesore dhe më e rëndësishme e trurit të madh është **korteksi**. Ai është përgjegjës për ato karakteristikat psikike të njeriut që janë *specifike njerëzore*, e ato janë p.sh. parashikimi, të folurit, planifikimi, të menduarit, zgjidhja e problemeve, etj. Trashësia e korës së trurit është 2-3 mm.

*Strukturat nën korteks* (që marrin pjesën më të madhe të trurit të madh) përmbajnë një numër të madh të pjesëve të ndryshme të rëndësishme, si p.sh. “talamusi”, i cili në njëfarë mënyre është “qeliza e relejit” që i merr të gjitha informatat dhe i dërgon në pjesë përkatëse të trurit, “hipotalamusi”, i cili drejton mbajtjen e baraspeshës midis proceseve të ndryshme trupore (me anë të gjëndrës kryesore hormonale hipofizës); përveç kësaj është i rëndësishëm edhe për disa shqisa primare. Aty gjendet edhe i ashtuquajti “sistemi limbik”, i rëndësishëm për kujtesë, disa emocione spontane etj. Aty janë edhe gjëndrat për motivim, ngrënie, pirje, sjellje seksuale, agresivitet dhe joagresivitet.

Shikuar në aspektin anatomik, truri i madh përbëhet prej dy pjesësh (hemisferash), të majtë dhe të djathtë, që nuk janë plotësisht të ndara, por – sipas gjasave në qendër të trurit janë të lidhura në mes veti me të ashtuquajturin “trupin lythor (korpus callosum), që përbëhet prej disa qindra miliona fijesh nervore, që lidhin hemisferën e majtë dhe të djathtë dhe mundësojnë komunikimin midis tyre.

Në një përmasë shumë të zvogëluar disa autorë e krahasojnë ndërtimin dhe pamjen anatomike të trurit të madh me pamjen e *bërthamës së arrës*: edhe arra përbëhet nga pjesa e majtë dhe e djathtë, janë të lidhura, edhe e rrudhur është sikur truri. (Sikur korteksi të mos ishte i rrudhur, sipërfaqja e trurit të madh do të ishte rreth 1,5 metër katror).

**Figura 2.4. pasqyron pamjen e jashtme të hemisferës së majtë të trurit, kurse figura 2.5. pjesën e brendshme të hemisferës së djathtë të trurit.**

Në historinë e njerëzimit truri i janë mveshur role të ndryshme, mirëpo tashmë kahmoti është e qartë se ai është organ që ekspertët bashkëkohorë – siç thamë – e konsiderojnë *strukturën më komplekse në mbarë gjithësinë*. Nuk është e mundur as të *paramendohet* kompleksiteti i këtij organi i cili – me më tepër se 100 miliardë qeliza nervore, nga të cilat secila ka lidhje me madje disa mijëra qeliza të tjera – i kryen detyrat që apsolutisht është e pamundur të zhvillohen me çfarëdo kompjuteri ose roboti. Tashmë edhe në fushën thjesht trupore truri kryen detyra të tilla që asnjë kompjuter as “në gjurmë” nuk do të mund t’i zhvillonte (p.sh. loja në piano, ku është e nevojshme njëkohësisht të rregullohet puna muskulore e dhjetë gishtërinjve. Por, në operationet për të cilat nuk është i programuar, kompjuteri është plotësisht i paaftë. Ja një shembull i përshtatshëm i dallimit midis punës së trurit të njeriut dhe të ndonjë kompjuteri të përsosur: nëse kompjuterit, fjala vjen, i japim për detyrë që të na gjejë numrin telefonik të faraonit Ramzes II, kompjuteri për disa sekonda do t’i kontrollojë të gjithë regjistrat telefonik dhe të na lajmërojë se atë zotëri nuk e ka në regjistrin e parapaguesve. Kurse njeriu, nëse i ia japim të njëjtën detyrë - *as që do ta kërkojë numrin*, sepse e ka të qartë se është kjo detyrë e pakuptimtë. Kompjuteri, pra, nuk është i programuar që të kuptojë kuptimësinë ose pa kuptimësinë e detyrës, dhe ky është dallimi themelor midis punës së trurit dhe punës së kompjuterit.

Filozofët e mëdhenj Platoni dhe Aristoteli kanë pasur koncepte të paqarta mbi funksionin e trurit. Platoni konsideronte se selia e “shpirtit” është në kokë, në zemër dhe

në bark, kurse Aristoteli shpirtin e vendoste vetëm në zemër, kurse trurit ia mvishte rolin e organit për ftohjen e gjakut.

Veçanërisht është interesant se sa filozofë dhe hulumtues dikur në kohën e vet konsideronin se *zemra* është seli e “shpirtit”. Ky mendim është ruajtur edhe deri më sot, e është e qartë pothuaj në të gjitha gjuhët e botës: flasim për njeriun me “zemër të mirë”, ose “zemër të fortë”, për atë që dikujt “i ka pëlsitur zemra nga pikëllimi”, për njeriun me frikë të madhe thuhet se “i ka rënë zemra te thembra”, etj, etj. Edhe njerëzit e sotëm *të shkolluar* (sidomos poetët) *arsyen* e vendosin në tru, kurse emocionet në zemër.

Kjo është dukuri plotësisht e kuptueshme: emocionet tona në një masë të madhe janë të përcjella me dukuri përcjellëse trupore (fiziologjike), e ndër to ndryshimet në punën e zemrës *më së shumti ndihen*. Nga frika zemra fillon të rrahë më shpejt, nga zemërimi njeriu mund të skuqet ose të zbehet – dhe e gjithë kjo ka lidhje me qarkullimin e gjakut, pra edhe me zemër.

Mirëpo, për për zhgënjim të disa njerëzve, zemra është vetëm një *pompë* ; e përsosur dhe shumë e komplikuar, por megjithatë pompë, dhe nuk ka kurrfarë lidhjes me përjetimet tona. Thënë në mënyrë më të saktë, puna e zemrës mund të jetë *pasojë* e disa përjetimeve tona, por shumë rrallë është edhe shkak i tyre (p.sh. disa njerëz mund të ndjejnë frikë ose ndonjë shqisë tjetër të fuqishme nëse zemra për shkak të ndonjë arsyeje të caktuar fillon t’u rrahë më shpejtë dhe më fuqishëm).

Truri i madh i njeriut mesatar peshon rreth 1.400 gram dhe është pjesë relativisht e vogël (nën 2%) e peshës së përgjithshme të njeriut. Kjo është e nevojshme të thuhet për arsye se dikur vite me radhë zhvilloheshin diskutime mbi atë se çka është ajo që trurin e njeriut e bën aq të ndryshëm nga truri i kafshëve të tjera. Do kohë mendohej se ajo është pesha e tij absolute (madhësia), por është konstatuar se disa kafshë (elefanti, kiti) e kanë trurin më të madh dhe më të rëndë se njeriut. Pastaj është thënë se është e rëndësishme pesha *relative* e trurit, d.m.th. pesha e tij në krahasim me peshën e përgjithshme të trupit, por është konstatuar se p.sh. miu ka peshën e ngjashme relative të trurit si edhe njeriu. Pastaj kanë filluar të bëhen spekulime mbi atë se *sipërfaqja* e trurit të njeriut është më e madhja, dhe se ajo është arsye që truri i njeriut më së shumti dallohet nga ai i kafshëve, por është konstatuar se p.sh. se delfini ka trurin e sipërfaqes së ngjashme dhe njësoj të rrudhur. Definitivisht është konstatuar se numri *i qelizave nervore* në tru është ajo që më së shumti e dallon trurin e njeriut nga truri i kafshëve.

Numri i vlerësuar i qelizave nervore të turit është rritur paralelisht me zbulimin e metodave gjithnjë më të mira të ngjyimit të qelizave nervore dhe të mundësisë së numërimit të tyre, kështu që gjatë disa vjetra viteve është rritur prej dhjetra miliardësh (numër që edhe sot mund të gjendet si e dhënë në disa tekste mësimore) në 100 miliardë, sa vlerësohet sot.





FIGURA 2.4 – HEMISFERA E MAJTË E TRURIT ME NDARJET NË LOBE PËRKATËSE

Edhe pse numri i qelizave nervore është sigurisht një nga faktorët më të rëndësishëm nga i cili varet shkalla e zhvillimit të kafshës ose të njeriut, si duket ai *nuk është i vetmi faktor më i rëndësishmi vendimtar*, por më e rëndësishmja është *ndërlidhja funksionale dhe bashkëpunimi midis atyre qelizave, si dhe llojllojshmëria e detyrave* që e kanë qelizat përkatëse nervore në tru.

Masa kryesore e trurit (që përmban rreth 80% ujë) nën korën e trurit përbëhet nga fijet e panumërta nervore, që i lidhin mes veti pjesët përkatëse të trurit, e të cilat (për shkak se lidhen, d.m.th. “asociojnë”) quhen edhe fije asociative, si dhe nga të ashtuquajturat fije “projektive”, e ato janë fijet që e lidhin trurin me të gjitha pjesët e trupit tonë, dhe me anë të tyre i marrim informatat nga trupi (nervat sensorë) ose i dërgojmë porositë në trup (nervat motorikë).



**FIGURA 2.5. – PJESA E BRENDËSHME E HEMISFERËS SË DJATHTË TË TRURIT, NË TË CILËN SHIHET CORPUS CALLOSUM**

Nga vetë truri dalin 12 palë nervash (të ashtuquajturit nervat kranialë), që i marrin informatat dhe e drejtojnë një pjesë të madhe të organeve tona që gjenden në kokë, në qafë, në fytyrë, (sytë dhe lëvizja e syve, të parët, dëgjimi, përbirja, muskujt e fytyrës dhe të qafës, muskujt e gjuhës, shijimi etj), por me një pjesë edhe organet në trup.

Nga boshti kurrizor dalin 31 palë nervash (për anën e majtë – dhe të djathtë të trupit), që i marrin informatat dhe i dërgojnë komandat në pjesët përkatëse të trupit.

*Korteksi (kora)* është pjesa më e përsosur dhe më e re zhvillimore e trurit, në të cilën gjenden trupat e qelizave nervore (dhe për këtë arsye është e ngjyrës së përhimtë), dhe numri më i madh i *qendrave* të rëndësishme për disa funksione shqisore dhe motorike. Përveç kësaj, siç është thënë, korteksi është përgjegjës për të menduarit, të folurit, zgjidhjen e problemeve etj, pra në përgjithësi për funksionet e nivelit më të lartë. Në mënyrën më të dukshme ato qendra gjenden para dhe pas të ashtuquajturës “hullisë qendrore”, e kjo është ajo që sipas gjasave në midis të ashtit parietal muror ndan pjesën e përparme nga pjesa e prapme e trurit (shih fig. 2.4. ku disa qendra janë hijezuar).

*Para* asaj hullie gjenden qendrat e shumta *motorike*, ato që i drejtojnë lëvizjet. Prekja ose ngacmimi i lehtë elektrik i disave prej atyre qendrave (gjë që është e mundur të zbatohet gjatë kohës së operacionit të trurit, kur kafa pak a shumë është e hapur dhe truri i arritshëm) shkakton lëvizje ose lëkundje të ndryshme të dorës, të këmbës, të gishtërinjve përkatës ose të pjesëve të tjera të trupit. Ato lëvizje nuk është e mundur të pengohen me dëshirë.

Ndërkaq, pas hullisë qendrore gjenden edhe qendrat e *ndijimit* për ato pjesë të trupit për të cilat ekzistojnë dhe qendrat motorike. Ngacmimi i atyre pjesëve shkakton ndijime të ndryshme: njeriu p.sh. ndien prekjen në ndonjë pjesë të trupit ose në buzë, hundë, gjuhë etj.

Sipërfaqet si të qendrave motorike, ashtu edhe të atyre senzore nuk i përgjigjen as përafërsisht raportit e madhësisë së atyre sipërfaqeve në vetë trupin, por janë proporcionale me *rëndësinë dhe "finesën"* e funksionit, kështu që p.sh. në zonën motorike gishtërinjtë kanë në korën e trurit sipërfaqe më të madhe se shpina, kurse në zonën senzore buzët kanë sipërfaqe më të madhe se e tërë pjesa tjetër e trupit.

Gjithashtu në tru është definuar në mënyrë mjaft të saktë dhe të ndjeshme zona e të parit, që gjendet në pjesën zverkut të trurit. Lëndimi i kësaj pjese mund të shkaktojë pengesa shumë komplekse të të parit, si p.sh. pamundësinë e njohjes së gjësendeve, humbjen e disa pjesëve të fushës së të parit etj. Zona e *dëgjimit* gjithashtu është e definuar në mënyrë mjaft të qartë në pjesën tëmtore të korës së trurit. Gjithashtu e ashtuquajtura qendra Broka (Broca), që sipas gjasave është në rrafshin e lobit të majtë tëmtor, e drejton të folurit, madje vetëm *shqiptimin* e fjalëve, prandaj dëmtimi i kësaj qendre shkakton çrregullime në të folur, d.m.th. shkakton të folurit e tillë që pak a shumë është i pakuptueshëm - që është dukuri e njohur te disa njerëz që kanë përjetuar "sulm nervor". Për të folurit (p.sh. për të kuptuarit e fjalëve) janë përgjegjëse edhe disa pjesë të tjera të trurit.

Duke i njohur *rrugët* e nervave deri te qendrat përkatëse në tru, neurologët shpeshherë mundën që nga vetë *simptomat* tek të sëmurët të caktojnë ku gjendet dëmtimi (që mund të paraqitet p.sh. për shkak të shpimit të kokës). Kjo ua lehtëson në mënyrë të konsiderueshme vendimin për ndërmarrjen eventuale të operacionit. Tek të parët kjo është e njohur mjaft mirë: sipas asaj se njeriu pas ndonjë lëndimi ose ndonjë procesi në kokë e ka humbur, fjala vjen, vetëm fushën e majtë të të parit, ose fushën e djathtë të të parit, ose te dyja fushat temporale (të jashtme) të të parit, ose është i verbër vetëm në njërin sy (e nëse syri është i shëndoshë dhe i ruajtur) etj, eksperti mund ta caktojë me mjaft saktësi se ku gjendet defekti dhe të ndërmarrë masa përgatitore për operim.

## QELIZA NERVORE (NEURONI)

Tani, kur i kemi cekur disa nga karakteristikat më të rëndësishme të sistemit nervor, radha është të themi atë më të rëndësishmen mbi *elementet* nga të cilat përbëhet sistemi nervor.

Sistemi nervor përbëhet nga qelizat nervore (neuronet). Për dallim nga qelizat trupore, qelizat nervore nuk ndahen. Janë formash të ndryshme, por në rastet më të shpeshta pranë bërthamës stacionuese (në të cilën gjenden kromozomet) kanë bisqet, me të cilat udhëton "informata", d.m.th. shqetësimi nervor (impulsi); d.m.th. bisqet në një anë të qelizës janë të ngjashëm me degët e drurit dhe quhen *dendrite* (greq. dendron = dru), e nga ana tjetër zakonisht është një fije më e gjatë, që quhet (*neurit ose akson*).

Qelizat nervore mikroskopikisht janë të vogla, kurse aksonët janë më të hollë se fijet e merimangës dhe për nga gjatësia mund të jenë të gjata prej një pjese të milimetrit e deri mbi një metër (p.sh. 2 deri 3 qeliza nervore nga truri deri te thembra). Udhëtimi i impulsit nervor përmes stacionit është “ i njëkahëshëm”, d.m.th. nga dendriti përmes bërthamës së qelizës dhe përmes aksonit deri te dendriti i qelizës së ardhshme. Shpejtësia e udhëtimit të impulsit nervor ndryshon nga lloji i nervave dhe është midis 10 dhe 100 m/sek (pra disa miliona herë është më i ngadalshëm se shpejtësia e udhëtimit të rrymës elektrike). Është interesant se qelizat nervore nuk *preken* mes veti, por impulsi bartet përmes një sinapse të imtë në stacionin tjetër me ndihmën e substancave, që quhen neurotransmetues.

Roli i neurotransmetuesve, të zbuluar diku nga mesi i shekullit të njëzet , është shumë i rëndësishëm dhe ato disa herë do të përmenden në këtë libër, pra, prej tyre varen shumë karakteristika të ndjesive, motiveve, disponimeve, sëmurjeve tona nervore dhe shpirtërore etj.



## KAPTINA 5.

### PERSONALITETI

#### NOCIONI DHE DEFINICIONI I PERSONALITETIT

Në literaturë mund të gjenden shumë definicione të personalitetit, me anën e të cilave bëhen përpjekje të caktohet ky nocion. Do t'i përmendim vetëm disa. Psikologu francez Pjeron (*Pieron*) e definon personalitetin si unitet i integruar i personalitetit të njeriut me të gjitha karakteristikat e tij të përhershme diferenciale (në inteligjencë, karakter, temperament, konstitucion) dhe mënyrat e saja karakteristike të sjelljes. Psikologu Anglez Ajzenk (*Ejzenck*) definon personalitetin si, më pak ose më shumë, organizim të fortë dhe të përhershëm të karakterit, të temperamentit, të intelektit dhe të konstitucionit fizik të individit, që cakton përshtatjen e tij specifike me mjedisin. Psikologu amerikan Olport (*Alport*) definon personalitetin si organizim dinamik të atyre sistemeve psikofizike të individit, që caktojnë mënyrat e veçanta të përshtatjes me mjedisin.

Asnjë nga definicionet e përmendura të personalitetit nuk është i gabueshm. Madje, të gjitha ato shënojnë disa cilësi të përbashkëta që më për së afërmi caktojnë nocionin e personalitetit. Ato cilësi, që më së afërmi janë caktuar në definicionin e Olportit mbi personalitetin, janë: uniteti, veçantia dhe konsekuenca.

**Uniteti** ose integriteti nënkupton individin si tërësi, tek i cili të gjitha veçoritë përkatëse derdhen në një mënyrë të caktuar të sjelljes dhe bashkarisht caktojnë sjelljen e tij. Gjatë vrojtimit të personalitetit nuk veçohen proceset e tij përkatëse psikike ose format e sjelljes që janë caktuar me anë të tyre, por sjellja e gjithmbarshme e individit që është determinuar me të gjitha veçoritë e tija fizike dhe proceset psikike.

**Veçantia** ose uniteti i personalitetit nënkupton që çdo individë dallohet nga çdo individ tjetër, duke pasur parasysh atë se çfarë cilësish ka dhe si janë të ndërlidhura ato në mes veti. Çdo njeri është personalitet në vete, me të gjitha veçoritë e veta karakteristike dhe me strukturën e atyre veçorive. Ajo veçanti nuk është absolute. Individët nuk dallojnë mes veti në atë masë sa të mos mund të krahasohen.

E lidhur ngushtë me unitetin dhe veçantinë, është edhe **konsekuenca** në sjelljen e individit. Ajo dallohet në veprimet e njëjta ose së paku të ngjashme dhe në sjelljen në situatat e njëjta, karakteristike për një individ. Është karakteristike se tek individë dallohen forma të caktuara të sjelljes në situata të ngjashme dhe, pikërisht, në bazë të kësaj ne flasim për konsekuencën si karakteristike të përbashkët të personalitetit. Dallimet që paraqiten në sjelljen e individit në situata të ndryshme, dalin nga nevoja e përshtatjes së individit në situatën konkrete, e kjo mbështetet në përvojën paraprake. Përkundër dallimeve në sjellje, tek çdo individ mbisundon mënyra e caktuar e sjelljes që bën të mundshëm jo vetëm njohjen, por edhe parashikimin e sjelljes së individit në situata të caktuara.

Duke i sistematizuar këto karakteristika qenësore të personalitetit, shohim se personaliteti është organizim unik i cilësive të individit që është prodhim i ndikimit të organizimit dhe i rrethinës në të cilën ai jeton.

**Duke marrë parasysh faktin që sjelljen e individit e caktojnë jo vetëm veçoritë e tij, por edhe përvoja e tij, është i pranueshëm edhe definicioni i Z. Bujas (1959), i cili cakton personalitetin si sintezë dhe formë të përbashkët të të gjitha synimeve, impulseve, kujtimeve dhe përjetimeve të njeriut.**

## **STRUKTURA E PERSONALITETIT**

Uniteti, veçantia dhe konsekuenca në sjellje dalin nga struktura ose strukturat e personalitetit, që është caktuar me një numër më të madh ose më të vogël të veçorive themelore. Tek shumica ekziston mospajtimi në aspektin e numrit dhe të llojit të veçorive themelore që determinojnë sjelljen e individit në situata të ndryshme. Ky mospajtim del, në rastet më të shpeshta, nga mënyra e qasjes në studimin e veçorive të personalitetit. Kështu, disa autorë janë të prirur që “ta zbërthejnë” personalitetin në një numër të madh komponentesh, të cilat, në të vërtetë, caktojnë sjelljen e individit, por vetëm në një numër të kufizuar situatash. Janë të panumërta komponentet ose karakteristikat e tilla të personalitetit që caktojnë sjelljen e individit dhe që janë të matshme dhe të kapshme për vërtetim.

Ngjashëm si Pjeroni dhe Ajzenku, edhe Guilford (*Guilford, 1959*) ka dhënë ndarjen e personalitetit. Ai i ndan veçoritë e personalitetit sipas asaj se ato, në radhë të parë, a tregojnë se si, në ç’mënyrë punon individi, dhe ato veçori i numron ndër veçoritë e **temperamentit**. Më tej i cek veçoritë që tregojnë se si dikush punon diçka mirë, dhe i numron në **aftësi**. Përveç tyre, Guilford dallon dy lloje të veçorive somatike dhe tri lloje të veçorive të **motivacionit**. Me veçoritë somatike nënkupton karakteristikat morfologjike, siç janë lartësia, pesha dhe ngjyra e lëkurës, dhe fiziologjike, që kanë të bëjnë me funksionet organike (puna e zemrës, metabolizmi bazal dhe temperatura e trupit). Veçoritë e motivacionit i përbëjnë nevojat si shprehje të dëshirave për komoditet, rëndësi shoqërore dhe bashkëpunim; interesat si shprehje të përpjekjeve që njeriu të merret me ndonjë aktivitet, dhe qëndrimet ndaj dukurive, njerëzve dhe gjërave të caktuara.

Edhe ne e kemi pranuar një ndarje të tillë, të cilës i shtojmë edhe veçoritë e **karakterit**, në të cilat pasqyrohet qëndrimi i njeriut ndaj punës, ndaj vetvetes dhe ndaj të tjerëve. Kjo ndarje është pasqyruar në fig. 3.1. ku është skematizuar edhe raporti reciprok i disa veçorive të personalitetit. Veçoritë e personalitetit përbëjnë unitetin në kuadër të personalitetit dhe çështja e përfshirjes së tyre varet nga drejtimi i qasjes në studimin e personalitetit. Çdo veçori ka karakteristika të caktuara që caktojnë ndikimin e saj në sjelljen e individit.




Fig. 3.1. – Pasqyrimi skematik i komponentëve themelore të personalitetit

- 1.Aftësitë
- 2.Karakteri
- 3.Temperamenti
- 4.Qëndrimet
- 5.Interesat
- 6.Nevojat
- 7.Karakteristikat trupore

**Temperamenti** . Zakonisht mendohet se veçoritë e temperamentit shprehin vetëm mënyrën dhe karakteristikat e reagimit emocional në aspektin e shpeshtësisë, të kohëzgjatjes, të intensitetit dhe të lehtësisë me të cilën paraqiten emocionet. Pastaj, temperamentit i mvishet edhe toni emocional që mbisundon tek individ: a paraqiten, kryesisht, emocionet pozitive që i përjetojmë në formë të ndjeshmërisë së kënaqësisë ose emocionet negative në formë të ndjenjave të pakënaqësisë. Është dëshmuar, ndërkaq, se nuk është e arsyeshme të kufizohet temperamentit vetëm në sferën emocionale të reagimit. Ai manifestohet në të gjitha llojet e reagimit të njeriut. Përveç reaksioneve emocionale, këtu duhet numëruar edhe të gjitha proceset e tjera psikike dhe reaksionet motorike, kurse temperamentit shpreh **shpejtësinë** dhe fuqinë me të cilën ato procese zhvillohen. Pasi që reaksionet e individit varen nga shpejtësia me të cilën njeriu mobilizon energjinë, disa autorë me arsye e definojnë temperamentin si mënyrë e mobilizimit të energjisë të cilën e disponon njeriu. Duke pasur parasysh faktin që nga mënyra e mobilizimit të energjisë varen reaksionet e njeriut, temperamentit, sipas N. Rot (1963), do të mund të caktohej si mënyrë karakteristike e reagimit të individit në situata të ndryshme të ngacmimit (definicioni).

Njerëzit dallohen sipas karakteristikave të reagimit në situata të caktuara, kështu që kahmoti ekzistojnë përpjekjet për kategorizimin e temperamentit në disa lloje.

Klasifikimi më i njohur dhe më i përhapur i temperamentit vjen nga mjeku dhe filozofi i Greqisë së vjetër Hipokrati, që më vonë është plotësuar nga mendimtari antik Galen. Sipas Hipokritit duhet dalluar katër tipa të temperamentit: kolerik, sangvinik, flegmatik dhe melankolik. Secili prej këtyre tipave të temperamentit karakterizohet me mënyrën e caktuar të reagimit.

**Temperamenti kolerik** karakterizohet me ndjenjat e fuqishme, me vendimmarrje të lehtë të aksionit dhe me shqetësime të shpeshta. Kolerikët hidhërohen lehtë dhe e manifestojnë fuqishëm hidhërimin e vet, prandaj shpeshherë vinë në konflikt me të tjerët. Shkurtimisht, koleriku karakterizohet me reaksione të hovshme dhe të fuqishme.




Fig. 3.2. Pasqyrimi skematik i mënyrave karakteristike të reagimit të tipave përkatës të temperamentit

**Temperamenti sangvinik** ka të përbashkët me të parin – shpejtësinë me të cilën reagon ndaj situatave të ndryshme ngacmuese, por reaksionet e sangvinikut janë të dobëta dhe afatshkurtra. Sangvinikët e ndryshojnë lehtë disponimin, por manifestimet e disponimeve të tyre janë mjaft të dobëta. Tek ata mbisundojnë emocionet pozitive dhe janë të prirur, në përgjithësi, për disponim të qiltër. Përgjithësisht, sangvinikët reagojnë shpejt dhe dobët.

**Temperamenti flegmatik** karakterizohet me reaksione të rralla, të ngadalshme dhe të dobëta. Flegmatikët janë të qetë, stabil, pak të ndjeshëm dhe pak të lëvizshëm. Shkurtimisht, ata i karakterizojnë reaksionet e dobëta dhe të ngadalshme.

**Temperamenti melankolik** ka të përbashkëta me temperamentin flegmatik – ngadalësinë e reagimit dhe ajo që rrallë reagon, por kur reagon atëherë këtë e bën me ndjenja të fuqishme që zgjasin shumë. Melankoliku reagon, para se gjithash, lidhur me atë që ka të bëjë me personalitetin e tij. Tek ai mbisundojnë emocionet negative, ndjenjat e pikëllimit dhe të brengosjes. Shkurtimisht, melankolikun e karakterizojnë emocionet e ralla, të ngadalshme dhe të fuqishme.

Duke marrë parasysh shpejtësinë dhe fuqinë që i karakterizojnë tipat përkatës të temperamentit, lehtësinë e reagimit, llojin e emocioneve që mbisundojnë, aktivitetin dhe komunikimin, katër tipat e temperamentit mund të pasqyrohen në mënyrë skematike, siç është pasqyruar kjo në fig. 3.2. Ndarjen e ngjashme të temperamentit e gjejmë edhe tek hulumtuesit e tjerë. Filozofi dhe psikologu i njohur sovjetik Pavlov dallohen katër funksionime të sistemit nervor, që u përgjigjen tipave të temperamentit të Hipokratit. Tipit të **gjallë** të funksionimit i përgjigjet temperamenti sangvinik. Tipit të **qetë** të

reagimit i përgjigjet temperamenti flegmatik. Tipit të **papërmbajtur** të funksionimit të sistemit nervor i përgjigjet temperamenti kolerik dhe tipit të **dobët** temperamenti melankolik. Në karakteristikat e tipave përkatës të reagimit, ndërkaq, Pavlovi përfshin vlerësimin e vlerave dhe të dobisë shoqërore të temperamenteve përkatëse, gjë që hulumtuesit e mëparshëm kësaj nuk i kanë kushtuar rëndësi. Kështu, p.sh. Pavlov konsideron se flegmatiku është tip më i vlefshëm, më i dëshirueshëm dhe më i dobishëm shoqëror se melankoliku, i cili është joaktiv, apatik dhe për jetën shoqërore dhe për përparimin është personalitet i parëndësishëm dhe i padobishëm.

Me gjithë që është vështirë të gjenden në mesin e njerëzve përfaqësuesit tipik të temperamentit të caktuar, duhet pranuar se njerëzit mes veti dallojnë sipas mënyrae të reagimit që përafërsisht u përgjigjen tipave përkatës të temperamentit. Me siguri këtij fakti duhet t'i mvishet ajo që ndarja e Hipokratit ka qëndruar deri në ditët e sotme.

Në përpjekjet që të sqarohen shkaqet e reagimit tipik të njerëzve që u përgjigjen tipave përkatës të reagimit, është përcaktuar konstitucioni, ndërtimi fiziologjik i organizmit si bazë e shpejtësisë, të shpeshtësisë dhe të fuqisë së reagimit. Në këtë aspekt rolin më të rëndësishëm e ka sistemi vegjetativ nervor i cili i lëviz të gjitha organet vitale të organizmit të njeriut dhe i cili rregullon punën e sistemit endokrin. Sistemi endokrin përbëhet nga gjëndrat që tajojnë hormone në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjak dhe me këtë rregullon gjendjen e përgjithshme të organizmit në aspektin e gatishmërisë për reagim dhe përcaktimit për mënyra të caktuara të reagimit. Nga ky aspekt mund të sqarohet përpjekja e disa autorëve që temperamentin t'ia mveshin, ekskluzivisht, trashëgimisë, sepse veçoritë fiziologjike të organizmit në pjesën më të madhe varen nga trashëgimia. Mirëpo, tipat e reagimit, përveç karakteristikave fiziologjike të organizmit, varen edhe nga një varg veçorish psikike të personalitetit, siç janë motivet, qëndrimet dhe interesat. Temperamenti gjatë jetës në një masë mund të ndryshojë, jo vetëm për shkak të ligjshmërive në ndryshimet e funksioneve fiziologjike, por edhe për shkak të zhvillimit të përgjithshëm të personalitetit.

**Karakterit.** Asnjë komponentë e personalitetit nuk ka shkaktuar aq mospajtime ndër psikologët siç është karakteri. Disa autorë me karakterin nënkuptojnë veçoritë e tilla që tregojnë sjelljen karakteristike të individit duke pasur parasysh normat morale dhe botëkuptimet morale të shoqërisë së caktuar, prandaj si për karakteristika të karakterit flitet për ndershmërinë, egoizmin, joegoizmin, modestinë, ndërgjegjen etj. Me veçoritë e karakterit, prandaj, shënohen veçoritë me të cilat shprehet respektimi ose mosrespektimi i normave që sundojnë në një shoqëri të caktuar.

Psikologu amerikan Gilford është përpjekur që me anë të hulumtimit sistematik me ndihmën e një veprimi të veçantë statistikë, të të ashtuquajturës analizës së faktorit, t'i veçojë veçoritë themelore që shënojnë karakterin e njeriut. Ai ka gjetur katër veçori që për nga përmbajtja e tyre do të mund të konsideroheshin si të karakterit:

**Së pari,** kjo është nevoja për liri, që manifestohet në dëshirën për lirinë nga kufizimi, në synimin që të lirohet nga kallupet dhe në përpjekjet që njeriu të jetë krijues i lirë;

**Së dyti,** nevoja për t'u mbështetur në forcat vetanake, tendenca që njeriu të mbështetet në vetveten, për dallim nga synimi i kundërt i saj për t'u mbështetur në të tjerët dhe për të shkuar pas të tjerëve;

**Së treti,** ky është synimi për konformizëm në kulturë dhe në zakonet sunduese. Kjo manifestohet në pranimin e parimeve konvencionale, etike dhe të synimeve që të gjithë t'u përmbahen këtyre parimeve. Njeriu tek i cili është e zhvilluar kjo nevojë, nuk ka synime për veprim të pavarur, për veprim pa marrë parasysh mendimin e të tjerëve. Në vend të kësaj, ekziston synimi që të veprohet sipas parimeve të miratuara të përgjithshme sunduese. Nevoja për konformizëm manifestohet edhe në përpjekjet që të punohet në mënyrë të vetëdijshme në çdo punë që kryhet, qoftë edhe nëse nuk lejohet qëllimi për të cilin ajo bëhet, dhe

**Së katërti,** kjo është ndershmëria që në mënyrën më të përgjithshme mund të karakterizohet si shmangie për të gënjyer dhe mashtruar. Megjithëse këto dy veçori janë mjaft të ndërlidhura, disa hulumtime kanë dëshmuar se, së paku tek fëmijët, ka sish që gënjejnë, por nuk mashtrojnë dhe, anasjelltas, disa janë të prirur të mashtrojnë por kur nuk gënjejnë.




Fig. 3.3. Pasqyrimi skematik i veçorive të karakterit

1. Dobishmëria e veprimeve
2. Zellshmëria
3. Aktiviteti
4. Modestia
5. Prirja për t'u dalluar
6. Besimi në forcat vetanake
7. Qëndrimi ndaj të dobëtve
8. Prirja për bashkëpunim
9. Çiltëria

Duke vështruar kështu karakterin e njeriut, është e arsyeshme të dallohen veçoritë pozitive dhe negative në raport me atë se a është njeriu aktiv ose joaktiv, i zellshëm ose dembel, a merret me punë të dobishme ose të padobishme shoqërore etj. Gjithashtu veçoritë pozitive dhe negative të karakterit gjejnë shprehje në raport me të tjerët dhe pasqyrohen në hapjen ndaj të tjerëve ose në shmangien e shoqërisë, në prirjen për bashkëpunim ose punë të pavarur dhe në qëndrimin e individit ndaj bashkësisë shoqërore dhe pasqyrohen në zhvillimin e ndjenjave të patriotizmit, në qëndrimin ndaj pjesëtarëve të nacionaliteteve të tjera, në kontributin në forcimin e kolektivit etj. Qëndrimi ndaj

vetvetes pasqyrohet në përpjekjet e individit që të arrijë sukses sa më të mirë, në besimin në forcat vetanake, në prirjen për t'u dalluar, në modestinë, në të kuptuarit e gabimeve dhe dobësive të veta, kënaqjen me suksesin e arritur etj. Shkurtimisht, veçoritë e karakterit duhet të vështrohen në raport me normat morale të shoqërisë të cilës i takon individi.

**Veçoritë trupore.** Me veçoritë trupore nënkuptojmë karakteristikat e jashtme ose morfologjike dhe të brendshme ose fiziologjike të organizmit. Në karakteristikat morfologjike bëjnë pjesë: lartësia, pesha, vëllimi i kokës, vëllimi i krahavorit, gjatësia e ekstremiteteve dhe, në përgjithësi, masat e pjesëve përkatëse të trupit. Karakteristikat fiziologjike janë ato që dalin nga funksioni i sistemit brenda organizmit që e drejtojnë aktivitetin e tij. Ato janë: sistemi vegjetativ nervor, sistemi endokrin dhe aktiviteti elektrik i trurit. Kahmoti i ka interesuar psikologët lidhja midis karakteristikave trupore të organizmit dhe të jetës psikike. Përpjekjet që të gjenden këto lidhje, të shumtët i kanë quar në lajthim, sepse në bazë të disa karakteristikave morfologjike kanë konkluduar për karakteristikat psikike të personalitetit, gjë që nuk është e arsyeshme.




Fig. 3.7 Katër tipa të ndërtimit të organizmit sipas Sheldonit

Ajo që duket e arsyeshme, është përpjekja që të provohet ndikimi i disa karakteristikave morfologjike në veçoritë e temperamentit dhe në sjelljen e individit. Ato përpjekje i kanë bërë doherë Kreçmer (*Kretchmer*) dhe Sheldon (*Sheldon*).

Studimet e tyre kanë qenë të mbështetura në supozimin se ndaj njerëzve të temperamentit të caktuar dhe të ndërtimit të caktuar fizik mjedisi vepron në mënyrë të caktuar, dhe se qëndrimi i mjedisit ndaj individit varet pikërisht nga ato karakteristika trupore. Mjedisi me ndikimin e vet kontribuon në zhvillimin e personalitetit në drejtim të

caktuar dhe në formimin e karakteristikave përkatëse të personalitetit, kështu që përmes kësaj mund të gjendet varësia e caktuar midis veçorive trupore dhe psikike të personalitetit. Kjo e sqaron dukurinë që njerëzit e mëdhenj dhe të fuqishëm zakonisht janë të mirë, kurse njerëzit e vegjël shpeshherë janë grindavec për arsye se të parët nuk i rrezikon mjedisi për shkak të karakteristikave të veta fizike, kurse të dytët u ekspozohen sulmeve ose së paku ndjehen të pasigurt dhe të dobët që t'i kundërvihen sulmit nga mjedisi.

**Nevojat.** Sipas Gilfordit (1959) nevojat janë kohëzgjatje e dëshirës për kushte të caktuara, të jemi të vërejtur, të jemi të përfillur ose të kemi rehati. Me analizën e tyre i njëjti autor ka konstatuar pesë kategori të nevojave: organike, nevojat për mjedisin, të arriturat, vetëpërcaktimin dhe nevojat sociale.

Nevojat organike	Nevojat në raport me mjedisin	Nevojat për të mbërrimet	Nevojat për vetëpërcaktim	Nevojat sociale
Ushqimi Uji Seksi	Rehatia Rendi Ngrohtësia Përkrahja e të tjerëve	Ambiciet e përgjithshme komngulësia në përpjekje Qëndrueshmëria	Liria Vetëbesimi Konformizmi kulturor Ndershmëria	Besnikëria Qëllimrësia Disiplina Agresiviteti

Tabela 3.1. – Klasifikimi i nevojave sipas Gilfordit

**Nevojat organike** lidhur me mirëmbajtjen e organizmit. Ato janë nevojat për ushqim, për ujë dhe nevojat seksuale. Është karakteristike se njerëzit dallohen mes veti për nga intensiteti i këtyre nevojave organike, por ato dallojnë në intensitet tek çdo individ, varësisht nga situata në të cilën gjendet.

Nevojat në raport me **mjedisin** kanë të bëjnë me kushtet e mjedisit që i konvenojnë individit. Disa njerëzve u konvenon mjedisi i qetë, e duan rehatinë, rendin, ngrohtësinë dhe përkrahjen e të tjerëve. Ata janë të paaftë që t'ju përshtaten kushteve të vrazhda të jetës, siç është fushimi, mënyra ushtarake e jetesës ose jeta në grup ku sundojnë raporte të vrazhda midis njerëzve. Në raport me mjedisin, disa njerëz i karakterizon pedantëria e tepruar: nevoja për rend, pastërti, sistem, rregullsi. Ata njerëz, njëkohësisht, janë të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm, kujdesen për rendin dhe sistemin, kërkojnë standarde të larta për veten dhe janë të motivuar shumë që të arrijnë diçka në jetë. Të tjerët, ndërkaq, në raport me rrethinën dëshirojnë që të jenë më të dalluar se të tjerët dhe me kaq mbarojnë nevojat e tyre.

Nevojat për **arritje** (disa këte e quajnë nivel i aspiratave), manifestohen në tri forma: ambiciet e përgjithshme, këmbëngulësia në përpjekje dhe qëndrueshmëria. Ambiciet e përgjithshme manifestohen në dëshirën për sukses që shprehet në padurueshmëri, punë, iniciativë, pagatishmëri për t'u ofruar ndihmë të tjerëve, mosbesimin në çudira. Këmbëngulësia në përpjekje tek të rriturit dhe fëmijët manifestohet në gjatësinë e kohës së kaluar në punë ose në ndonjë aktivitet. Qëndrueshmëria manifestohet në gatishmërinë e individit që t'iu bëjë ballë vështirësive në mënyrë që të realizojë një qëllim të caktuar.

Nevoja për **vetëpërcaktim** ose vetëdeterminim manifestohet përmes disa formave: nevoja për liri (që tregon pavarësinë e personalitetit), vetëbesim (që shprehet në nevojën që njeriu të varet nga forcat e veta), konformizmi kulturor (që manifestohet në



gatishmërinë për pranimin e normave etike të shoqërisë në të cilën jeton individi), ndershmëria (që definohet si mungesë e gënjeshtërs dhe e mashtrimit) etj.

Përmes disa formave të nevojave për vetëpërcaktim përcaktohet qëndrimi i individit ndaj normave morale të shoqërisë, kështu që ato qysh më parë janë përfshirë si veçori të karakterit.

Nevojat **sociale** manifestohen në faktin që njerëzit të bashkëpunojnë me të tjerët, të punojnë për të tjerët dhe, në përgjithësi, të participojnë në aktivitetin grupor. Edhe këto nevoja gjejnë shprehje në forma të ndryshme. Kështu, në nevojën sociale numërohen përkushtimi – dëshira për të qenë me të tjerët, për të cilën shumica e autorëve konsideron se është e trashëguar dhe instinktive. Qëllimëmirësia si nevojë sociale manifestohet në gjentilitetin, simpatinë dhe ndjeshmërinë ndaj të tjerëve. Është konstatuar edhe nevoja për disiplinë, por edhe agresiviteti, që manifeston nevojën për t'i detyruar të tjerët, prirjen për dhunë fizike, luftarakë, negativizëm, destruktivitet.

Këto veçori bashkërisht i përbëjnë nevojat që, në formë të fuqive të motivacionit, ndikojnë në aktivitetin e njeriut.

**Interesat** . Interesat shprehin raportin momental pozitiv të individit ndaj disa objekteve dhe përmbajtjeve, si dhe synimin që të merret me to. Kjo nuk shpreh aktivitetin konkret dhe anticipimin fizik në ndonjë përmbajtje. Individi mund të ketë interes dhe t'ë kënaq interesin e vet vetëm me anë të mendimeve ose me ndonjë lloj të pjesëmarrjes pasive në ndonjë përmbajtje.

Interesi për jetë ushtarake mund të kënaqet edhe me leximin e gazetave dhe të revistave ushtarake, dhe me përcjelljen e TV emisioneve nga jeta e pjesëtarëve të armatës. Mirëpo, interesi i tillë shpeshherë gjen shprehje edhe në pjesëmarrjen aktive në ndonjë veprimtari, pra edhe në përcaktimin profesional të individit, në ç'rast nuk pushon motivi i veprimit i cili pak a shumë është i përhershëm.




Tabela 3.2. Klasifikimi i interesave sipas Shprangerit

Janë bërë përpjekje të klasifikimit të interesit. Një klasifikim i tillë i interesave të përgjithshëm lidhet me emrin e Shprangerit (*Spranger*), sipas të cilit ekzistojnë gjashtë interesa themelore: interesi **teoretik** ose interesi për njohjen e të vërtetës; interesi **ekonomik** ose interesi për theksimin e të mirave materiale; interesi estetik ose interesi për atë që është e harmonishme dhe e bukur; interesi **social** ose interesi për njerëz dhe ndihmë të njerëzve; interesi **politik** ose interesi për arritjen e pushtetit dhe të fuqisë;

interesi **religjioz** ose synimi që njeriu ta përfetëjë veten si pjesë e unitetit të përgjithshëm.

Klasifikimi i dytë, dhe nga aspekti praktik më i përdorshëm, është klasifikimi në interesa **profesionale** dhe **joprofesionale**. Interesat profesionale janë interesa për profesione të caktuara në të cilat njerëzit i ekonomizojnë mjetet për jetë dhe me të cilat merren si punë të rregullt. Intereset joprofesionale janë ato që tregojnë qëndrim pozitiv të njerëzve ndaj aktiviteteve që u ofrojnë kënaqësi, pa marrë parasysh përcaktimin e vet profesional. Ndër ato interese joprofesionale janë konstatuar: interesi për hulumtim, për udhëtim, për rrezikim, për lloje të caktuara të argëtimit, për ndryshime, për ndryshimet e aktiviteteve dhe të detyrave, për kulturë, për aktivitet intelektual, artistik dhe shoqëror, për mendim dhe meditim, për mahi dhe humor.

**Qëndrimet.** Sipas Z. Bujas (1959) qëndrimi është tendencë e përvetësuar e reagimit pozitiv ose negativ ndaj ndonjë gjëje, personi ose përmbajtjeje (definicioni). Karakteristika e qëndrimit që ai paraqet tendencën e përcaktuar të reagimit, flet për faktin që qëndrimet janë veçori të krijuara në bazë të përvojës individuale ose sociale të individit, dhe se për to është përgjegjës individi dhe mjedisi social të cilit ai i takon.

Për arsye se disa qëndrime i përvetësojnë të gjithë pjesëtarët e një mjedisi shoqëror, shumë autorë i cekun, përveç qëndrimeve personale, edhe ato sociale.

Qëndrimet personale janë ato që janë karakteristike për individin, kurse qëndrimet sociale janë të përbashkëta për një grup më të madh personash.

- 
- a. Qëndrimi ndaj dukurive të rëndësishme shoqërore,
  - b. Qëndrimi ndaj sistemit shoqëror që sundon në vend ose ndaj sistemeve shoqërore në përgjithësi,
  - c. Qëndrimi ndaj kombeve përkatëse ose ndaj çështjes së kombësisë në përgjithësi,
  - d. Qëndrimi ndaj religjioneve përkatëse ose ndaj çështjes së religjionit në përgjithësi,
  - e. Qëndrimi ndaj racave,
  - f. Qëndrimi ndaj martesës dhe familjes,
  - g. Qëndrimi ndaj sistemit të edukimit,
  - h. Qëndrimi ndaj luftës dhe çështjes së çarmatosjes dhe
  - i. Qëndrimi ndaj institucioneve dhe problemeve të ndryshme sociale.
- 

Tabela 3.3. Klasifikimi i qëndrimeve sipas N. Rot

Sipas N. Rot (1963) midis qëndrimeve sociale për njohjen dhe kuptimin e sjelljes së njerëzve, më të rëndësishme janë këto qëndrime: ndaj dukurive relevante (të rëndësishme) shoqërore; ndaj sistemit shoqëror që sundon në vend ose ndaj sistemeve shoqërore në përgjithësi; ndaj kombeve të caktuara ose ndaj çështjes së kombësisë në përgjithësi; ndaj religjioneve përkatëse ose çështjes së religjionit në përgjithësi, ndaj racave; ndaj martesës dhe familjes; ndaj sistemit të edukimit; ndaj luftës dhe çështjes së çarmatimit; ndaj institucioneve dhe problemeve të ndryshme sociale. Në bashkësinë tonë shumë nacionale rëndësi të veçantë kanë qëndrimet e njerëzve ndaj kombeve përkatëse ose ndaj çështjes së nacionalitetit në përgjithësi, sepse nga këto qëndrime varet uniteti

dhe kohezioni i bashkësisë sonë multietnike, e me këtë edhe të aftësisë ekonomike dhe mbrojtëse.

Nga qëndrimi varet, në një masë të madhe, si do ta vlerësojmë ndonjë dukuri ose ide, pavarësisht nga vlera e tyre objektive. Nga qëndrimi i individit ose i grupit të njerëzve dalin vlerësimet e tyre subjektive të vlerave përkatëse, prandaj për këtë arsye shpeshherë qëndrimet dominojnë mbi sjelljen e gjithmbarshme të individit. Qëndrimi negativ ndaj disa gjërave ose dukurive kontribuon në prirjen e individit për zhvlerësimin e vlerës objektive dhe zvogëlimin e peshës së argumenteve në të cilat, objektivisht, mund të provohet vlera e asaj dukurie. Nga qëndrimi i pjesëtarëve të Armatës ndaj agresorit varet sjellja e tij e gjithmbarshme në luftë dhe efikasiteti i tij luftarak. Kështu, p.sh. në luftën e Koresë shumë pilotë të dalluar të aviacionit luftarak të SHBA-ve kanë qenë luftëtarë joefikas, sepse kanë pasur qëndrim negativ ndaj asaj lufte.

**Uniteti i personalitetit.** Skema fillestare (fig. 3.1. ) që i thekson grupet e veçorive nga të cilat është strukturuar personaliteti, tregon se këto veçori ndërlidhen në mes veti dhe përbëjnë tërësinë unike. Shqyrtimi i grupeve përkatëse të veçorive të personalitetit na mundëson vetëm qasjen më të lehtë dhe më të thjeshtë në zgjidhjen e sjelljes së njerëzve dhe të shkaqeve të sjelljes së tyre. Sjellja, në të vërtetë, është e determinuar me praninë, drejtimin dhe nivelin e zhvillimit të veçorive përkatëse të personalitetit, por edhe me harmonizimin e tyre reciprok. Kur flasim për harmonizimin e veçorive të personalitetit, atëherë në të vërtetë mendojmë në **unitetin** e personalitetit si tërësi.

Uniteti i personalitetit që del nga harmonia e veçorive përkatëse nga të cilat është strukturuar personaliteti, pasqyrohet në **konsekuencën** dhe sjelljen e individit. Ajo kurrë nuk është e plotë. Uniteti zhvillohet gjatë zhvillimit të gjithmbarshëm individual të individit dhe arrin shkallën më të lartë ose më të vogël, varësisht nga karakteristikat individuale të individit dhe nga ndikimi i shoqërisë. Shoqëria që ka norma të caktuara të qarta dhe të fuqishme të sjelljes sociale, kontribuon në unitetin më të madh të personalitetit. Kështu mjedisi i armatës, ku një nga karakteristikat themelore është qëndrueshmëria e normave sociale, i konvenon unitetit më të shpejtë dhe më të fuqishëm të personalitetit sesa që kjo arrihet në mjedisin liberal, në të cilin më shpesh ndryshojnë normat sociale.

## KAPTINA 6.

### MOTIVACIONI

Sjellja e njeriut nuk është e mundur të sqarohet as të parashihet vetëm në bazë të njohjes së intelektit, të karakterit, të temperamentit, të veçorive trupore dhe të veçorive të tjera të tij që e krijojnë konstruktin e personalitetit të tij. Për të kuptuar sjelljet është e nevojshme të depërtohet në natyrën e forcave që e iniciojnë njeriun për aktivitete. Ato forca nuk janë drejtpërdrejtë të kapshme për vërtetim, kështu që për praninë e tyre konkludojmë nga rrëfimet dhe sjelljet e individëve. Rëndësia e forcave që e iniciojnë njeriun për aktivitete është aq e madhe, sa pa ndikimin e tyre as që mund të merret me mend jeta dhe ekzistenca e tij. Kapacitetet intelektuale dhe trupore, me të cilat disponon çdo person në një masë më të madhe ose më të vogël, do të mbetnin të pashfrytëzuara sikur diçka brenda personalitetit ose nga mjedisi i tij të mos e nxiste njeriun për aktivitete. Nga fuqia e atyre nxitjeve varet se a do të përdorë dhe në çfarë mase do ta përdorë njeriu energjinë me të cilën disponon dhe sa do të zgjasë aktiviteti i tij, kurse nga lloji i nxitjes varet drejtimi i aktivitetit të tij.

Procesi i inicimit të aktivitetit të njeriut, i orientimit të aktivitetit në objekte të caktuara dhe rregullimi i atij aktiviteti për arritjen e qëllimeve të caktuara, quhet motivim. Fuqitë lëvizëse që shkaktojnë aktivitetin, dhe e orientojnë dhe e drejtojnë atë, quhen me një emërtim të përgjithshëm, - motive. (N. Rot, 1963). Motivet japin vulën e sjelljes së gjithëmbarshme të njeriut.

Motivet veprojnë në sjelljen e njeriut në mënyrë të caktuar. Prania e tyre përcillet me gjendjen e tensionuar të organizmit, që e bën të gatshëm për aksion. Ai aksion është i përshtatshëm dhe i orientuar në arritjen e ndonjë qëllimi të caktuar. Që të arrihet ndonjë qëllim më i afërt ose më i largët, më lehtë ose më vështirë i realizueshëm, është e nevojshme që të harmonizohet sjellja ashtu që të mposhten pengesat në rrugën deri te qëllimi.




Fig 4.1. Qarku i motivimit

Lloji dhe format e sjelljes së orientuar në arritjen e ndonjë qëllimi varen edhe nga lloji dhe natyra e qëllimit, kurse intensiteti dhe kohëzgjatja e sjelljes nga fuqia e motivit që e nxitë njeriun për aktivitet. Edhe në njërin edhe në shembullin tjetër motivi cakton sjelljen

që bën të mundshme arritjen e qëllimit të dëshiruar. Sjelljen që është e caktuar me ndonjë motiv të veprimit dhe që është e orientuar në realizimin e ndonjë qëllimi, do ta quajmë sjellje **instrumentale**. Varësisht nga fuqia e motivit dhe nga veçoritë e tjera të individit, sjellja instrumentale do të jetë, më shumë ose më pak, e harmonizuar me kërkesat e arritjes së qëllimit të parashtruar, dhe individi do të këmbëngulë më shumë ose më pak në një sjellje të tillë.

Arritja e qëllimit të dëshiruar shkakton ndryshime në sjellje. Ajo përcillet me uljen e tensionit të pranishëm gjatë aksionit për arritjen e qëllimit. Me uljen e tensionit paraqitet ndjenja e rehatisë, e cila është gjithnjë e më e madhe sa më shumë që ka qenë i shprehur tensioni i mëparshëm. Kjo kënaqësi, përveç lirimit nga tensionit, del edhe nga fakti që me arritjen e qëllimit njeriu i kënaq disa dëshira dhe nevoja të veta të brendshme nga të cilat del edhe vetë motivi i veprimit.

Ulja e tensionit dhe kënaqësia, ndërkaq, nuk janë i vetmi produkt i sjelljes instrumentale. Arritja e qëllimit zakonisht përcillet me paraqitjen e motivit të ri, që shërben si nxitje për aktivitet të mëtejshëm. Në këtë mënyrë formohet rrethi i mbyllur, i cili fillon me **motivin**. Motivi nxitë sjelljen **instrumentale**, kurse ajo shpie deri te **qëllimi i caktuar**. Qëllimi, ndërkaq, inspiron motivin e ri, me çka fillon rrethi i ri i motivimit që është pasqyruar në mënyrë skematike në fig. 4.1.

Nga karakteristikat e qëllimit të arritur varet se çfarë motivevsh do të formohen pas arritjes së atij qëllimi. Sa më e madhe që të jetë vlera etike dhe shoqërore e qëllimit të arritur, edhe motivet e reja do të orientohen në qëllimet më të larta shoqërore, e shpeshherë edhe fuqia e motivit do të jetë më e madhe. Qëllimet që kanë karakter të plotësimit të nevojave themelore fiziologjike (uria, etja, seksi), nuk janë gjithherë iniciues të fuqishëm të aktivitetit të mëtejshëm të njeriut, prandaj arritja e tyre mund të shkaktojë pasivitetin si pasojë e plotësimit të atyre nevojave.

## MENDIMET MBI MOTIVET

Sjellja e njeriut varet nga lloji dhe karakteristikat e motiveve që janë në esencën e veprimtarisë së tij. Për këtë arsye është e nevojshme, në rend të parë, të studiohen motivet e veprimit të njeriut që e iniciojnë dhe e rregullojnë sjelljen e orientuar në arritjen e qëllimeve të caktuara.

Janë të ndryshme mendimet lidhur me atë se çka janë motivet. Disa autorë me motivin nënkuptojnë **nevojat** që dalin nga mungesa ose teprica e një gjëje në organizëm. Çdo organizëm ka cilësinë që të shprehë baraspeshën (balancin) në kushte të brendshme: temperaturën, tensionin e gjakut, të ushqyerit e indeve, sasinë e metaboliteve të tharta, etj. Tendenca e organizmit që në mënyrë automatike të ruajë balancin në kushtet e brendshme fiziologjike quhet **homeostazë** (Munn, 1951). Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm fiziologjikë përmes të cilëve realizohet homeostaza. Termoregulatorët e mekanizmit mundësojnë që me anë të avullimit të djersës dhe të rrezatimit të nxirret teprica e nxehtësisë nga organizmi, kurse me tkurrjen e enëve të gjakut në sipërfaqe të trupit dhe me aktivitetin automatik visceromotorik (me rënqethjen e lëkurës) të pengohet nxjerrja e nxehtësisë, përkatësisht të ngritet temperatura e trupit. Mekanizmat ekskretor – neutralizues bëjnë të mundshëm që me anë të frymëmarrjes, të djersitjes dhe të urinimit të mënjanoen nga organizmi produktet e zbërthimit (acidi karbonik, kripërat,

metabolitetet e tharta). Këto dhe mekanizmat e tjerë rregullojnë në mënyrë automatike balansin e brendshëm në kushtet fiziologjike, kështu që, jashtë aktivitetit të njeriut, i plotësojnë nevojat e tij. Për këtë arsye ato nevoja plotësohen në mënyrë automatike, me anë të mekanizmave të ndryshëm fiziologjikë, nuk e nxisin njeriun për aktivitet dhe ato nuk është e arsyeshme që të konsiderohen motive.

Mirëpo, në organizëm paraqiten edhe nevoja intensive që nuk është e mundur të plotësohen në mënyrë automatike. Nevoja për ushqim plotësohet në mënyrë automatike vetëm derisa organizmi disponon me sasi të mjaftueshme të elementeve ushqyese, me zbërthimin e të cilave lirohet energjia që i nevojitet. Kur mungon ushqimi, atë duhet futur në organizëm. Njësoj me një termoregullim automatik mbrohet organizmi nga ftohja deri në një masë të caktuar, kurse temperatura optimale mbahet me anë të veshjes dhe me burime të ngrohjes që mundësojnë ruajtjen e kushteve të volitshme të temperaturës.

Mënyra e këtyllë e plotësimit të nevojave implikon aksionin e orientuar në ndonjë qëllim të caktuar. Aksioni bëhet atëherë kur nevoja bëhet aq e fuqishme sa nuk është e mundur të plotësohet në mënyrë automatike, përkatësisht kur pabaraspesha biologjike në organizëm bëhet e ndjeshme. Nga nevojat që janë të ndjeshme dhe mjaft intensive paraqitet tendenca e aktivizimit të organizmit për plotësimin e atyre nevojave. Kjo tendencë e aktivizimit të organizmit, që del nga pabaraspesha e ndjeshme biologjike, quhet **instinkt**. Instinkti nënkupton aksionin që është i orientuar në plotësimin e ndonjë nevojë biologjike në organizëm: të nevojës për ushqim, ujë, seks, të nevojës për pushim etj. Duke pasur parasysh faktin që instinkti përfshin aksionin që është i orientuar në arritjen e ndonjë qëllimi të caktuar, shumë autorë e quajnë me arsye motiv të veprimit.

Nevojat intensive fiziologjike e iniciojnë njeriun në aksion qëllimi i të cilit është që ato të plotësohen. Plotësimi i ndonjë nevojë të organizmit është e mundur të realizohet në mënyra të ndryshme. Mënyra e plotësimit të nevojave varet nga kushtet në të cilat njeriu jeton dhe nga mundësia që ia ofrojnë ato kushte. Në një shoqëri të civilizuar njeriu i plotëson nevojat e veta në mënyrën që është përcaktuar me kodeksin e normave shoqërore dhe moralin e shoqërisë në të cilin jeton. Në procesin e plotësimit të instinkteve themelore fiziologjike paraqitet tendenca që njeriu të gjejë rrugën më efikase për plotësimin e tyre. Kjo përpjekje e njeriut përcillet me fitimin e përvojës mbi mënyrat e plotësimit të instinkteve dhe me paraqitjen e nevojave të reja si produkte të aktivitetit të njeriut. Nevojat e krijuara përmes aktivitetit të zhvilluar për plotësimin e instinkteve themelore fiziologjike, disa autorë i quajnë **motive të zhvilluara**. Ndërkaq, ato paraqiten përmes aktivitetit në shoqëri që i përcakton mënyrat e plotësimit të instinkteve themelore fiziologjike.

Shoqëria e detyron njeriun që t'i pranojë normat e caktuara të sjelljes, dhe për atë pranim e shpërblen me mundësinë që t'i plotësojë instinktët e tij. Ky ndikim është aq i fuqishëm sa disa norma të sjelljes jo vetëm që bëhen pronësi, por edhe nevojë e individit. Mënyrat e plotësimit të instinkteve fiziologjike bëhen kështu edhe vetënxitje për aktivitete dhe paraqiten si nevoja intensive të individit. Pasi që këto nevoja janë paraqitur nën ndikimin e mjedisit social në të cilin njeriu është i lindur dhe në të cilin jeton, shumë autorë me arsye i quajnë **motive sociale**.

Janë të llojllojshme, duke marrë parasysh llojin dhe gjenezën e tyre. Disa prej atyre motiveve janë paraqitur në evolucionin e llojit të njeriut, kurse të tjerat janë të lidhura me kulturën e grupeve përkatëse sociale. Motivet paraqitja e të cilave daton nga fillimi i llojit të njeriut, disa autorë, pak a shumë në mënyrë të arsyeshme, i konsiderojnë

të lindur. Arsyeshmërinë e pohimit se këto motive janë të lindura e gjejmë në paraqitjen që ato janë karakteristike për llojin e njeriut, pa marrë parasysh përkatësinë etnike. Megjithatë, duhet pranuar se ato motive i ka fituar<sup>1</sup> njeriu gjatë socializmit të tij dhe se në zhvillimin individual të individit disa prej atyre motiveve mund të zhvillohen dhe të shmangen, gjë që nuk na jep të drejtë të jemi kategorik. Motivet sociale të fituara

Nevojat fiziologjike	Instinktet	Motivet
Ushqimi Uji Rehativa etj.	Uria Etja Pushimi etj.	Motivet sociale Motivet personale

Tabela 4.1. Bazat e sjelljes së motivuar

në një shoqëri të caktuar, që i ka imponuar normat e sjelljes së pjesëtarëve të vet, pa dyshim janë motive të fituara. Ato bartin vulën e shoqërisë në të cilën jeton njeriu, dhe motivet, dëshirat, caqet dhe qëllimet e tij janë shprehje e nevojave shoqërore.

Instinktet	Motivet sociale	Motivet personale
Instinkti i etjes Instinkti i urisë Instinkti i gjumit Instinkti i seksit Instinkti i amësisë Instinktet e tjera	Motivi i vetdëshmisë Motivi shoqëror, Motivi i agresivitetit Motivi i sigurisë	Motivi për futboll Motivi për fluturim Motivi për muzikë etj.

Tabela 4.2. Ndarja e motiveve

Çdo njeri ka rrugën e vet individuale brenda mjedisit social të cilit i takon. Në çdo individ ndikon mjedisi në mënyrë specifike. Ai ndikim varet nga veçoritë e individit dhe aktivitetet e tij. Specifika e ndikimit të rrethit pasqyrohet në socializmin specifik të individit, që ka për pasojë kërkimin e rrugës individuale për plotësimin e motiveve themelore të veprimit. Instinktet themelore fiziologjike siç janë uria, etja, seksi etj., dhe motivet sociale siç janë vetëpërcaktimi, agresiviteti etj, mund të plotësohen në mënyra të ndryshme dhe me anë të rrugëve të ndryshme. Rrugët që individët i zgjedhin për plotësimin e instinkteve të tyre fiziologjike dhe të motiveve sociale, inspirohen me **motivët personale**. Motivët personale determinojnë rrugën jetësore të çdo individi, e paraqiten si rezultat i përvojës individuale që e fiton individi në mjedisin social në të cilin jeton. Në bazë të këtij shqyrtimi do të mund t'i definonim motivet si faktorë organik ose psikologjik që iniciojnë dhe rregullojnë sjelljen me qëllim të arritjes së qëllimeve të caktuara (definicioni). Duke pasur parasysh llojin dhe natyrën, motivet mund t'i ndajmë në tri grupe: instinkte, motive sociale dhe motive personale.

**Instinktet** mund të definojnë si tendencë e aktivizimit të organizmit që del nga pabaraspesha e brendshme biologjike. Pabaraspesha biologjike shkakton tensionin e organizmit. Kur ai tension bëhet aq intensiv sa është i padurueshëm, organizmi

aktivizohet në drejtim të plotësimit të nevojës, d.m.th. të vendosjes së baraspeshës biologjike. Në këtë mënyrë tensioni i organizimit paraqet jo vetëm përgatitjen, por edhe nxitjen e drejtpërdrejtë për aktivitetet. Sa më i madh që të jetë tensioni i organizmit, edhe aktiviteti i tij është më intensiv.

Instinktet janë të lindura dhe karakteristike për llojin e njeriut. Tek të gjithë pjesëtarët e homosapijensit është e nevojshme të konstatohet prania e disa instinkteve themelore fiziologjike që shënojnë sjelljen e tyre, dallimet që ekzistojnë midis individëve kanë të bëjnë me intensitetin dhe mënyrën plotësimit, por jo edhe me llojin e instinktit. Njëkohësisht, instinktet janë privilegje të njeriut. Ato i dallojnë edhe tek të gjitha llojet e zhvilluara të kafshëve.

Megjithëse instinktet janë të lindura dhe të kushtëzuara biologjikisht, ato i nënshtrohen socializimit në aspektin e mënyrës së plotësimit dhe të intensitetit të tyre. Me ndikimin e mjedisit social njeriu i pranon normat e caktuara të sjelljes, që shprehen edhe në mënyrën e plotësimit të instinkteve të tij fiziologjike. Ato norma ndonjëherë kufizojnë njeriun në plotësimin e instinkteve të tij, gjë që ka për pasojë, me më pak ose më shumë sukses, në shtypjen e disa instinkteve dhe caktimin e hierarkisë së tyre në raport me motivet e tjera të veprimit dhe të hierarkisë së tyre reciproke.

Hierarkia natyrore të instinkteve është vështirë të përcaktohet. Janë bërë hulumtime të shumta mbi kafshët dhe njerëzit, në mënyrë që të përcaktohet fuqia e instinkteve përkatëse. Rezultatet e atyre hulumtimeve tregojnë se më të fuqishmet janë ato instinkte që dalin nga nevoja momentalisht më intensive të organizmit, dhe se intensiteti i tyre ndryshon varësisht nga gjendja dhe nevoja e organizmit. Megjithatë, ekzistojnë dallime në mundësinë e kontrollit dhe të shtypjes së instinkteve përkatëse dhe të cilat njëherësh nuk janë edhe shenjë e fuqisë së tyre. Derisa, p.sh., instinkti seksual është e mundur të shtypet për një periudhë më të gjatë kohore, madje edhe të sublimohet në ndonjë lloj tjetër aktiviteti, instinkti i etjes dhe i urisë është e mundur të shtyhet vetëm për një kohë shumë të kufizuar.

Duke u nisur nga baza e formimit të instinktit, që e gjejmë në pabaraspeshën biologjike në organizëm, tek njeriu i gjejmë disa instinkte themelore që dominojnë në sjelljen e tij: ato janë: instinkti i etjes, i urisë, instinkti i gjumit, instinkti seksual, instinkti i amësisë dhe disa instinkte të tjera fiziologjike.

**Instinkti i etjes** fillon nga nevoja për ujë, e paraqitet atëherë kur në organizëm paraqitet mungesa e ujit. Ajo mungesë paraqitet shumë shpejtë nëse uji nuk futet në organizëm, sepse me mekanizma të ndryshëm fiziologjik (përmes lëkurës, gojës, urinës etj) uji del nga organizmi. Mungesa e ujit shkakton ndryshime në organizëm, të cilat nxisin aksionin për plotësimin e nevojave për ujë. Për nga intensiteti i vet ky është instinkt shumë i fuqishëm. Etja nuk mund të durohet gjatë. Prandaj në situatat ku është i kufizuar furnizimi i ushtarëve, duhet pasur parasysh se asnjë element jetësor nuk është i rëndësishëm sa uji.

**Instinkti i urisë** paraqitet si nevojë e mungesës së ushqimit në organizëm. Ushqimi shpenzohet dhe është e nevojshme që kohë pas kohe të futet në organizëm. Megjithëse shumë i fuqishëm, ky instinkt ngecë për nga intensiteti i vet pas instinktit të etjes, sepse organizmi disponon me rezerva të caktuara që i shpenzon në mungesë të ushqimit dhe, në këtë mënyrë, mund të qëndrojë për një periudhë relativisht të gjatë pa marrjen e ushqimit.



**Instinkti i gjumit** është instinkt tipik fiziologjik njësoj\* si tek etja dhe uria. Kanë ekzistuar pohimet se fjetja është shprehi e keqe. Një hulumtues ka bërë trajnime të mosfjetjes dhe, në periudhën prej 7 ditësh, e ka ngrehë orën që e ka zgjuar në çdo 10 minuta. Gjatë kohës së këtij eksperimenti hulumtuesi – eksperimentuesi ka filluar të bëjë halucinacione dhe, në fund, nuk ka mundur më ta durojë zilen e orës që e ka sjellë “në çmendi”. Gjumi është i domosdoshëm për njeriun dhe atij mund t’i shmangemi vetëm për një kohë të caktuar. Nga gjumi i luftëtarëve varet edhe efikasiteti i tyre luftarak, kurse për gjumin duhet kujdesur njësoj si për ushqimin dhe ujin me të cilin furnizohen luftëtarët.

**Instinkti seksual.** Në sjelljen seksuale ndikojnë dy faktorë themelor: hormonet dhe shprehia. Hormonet seksuale i tajojnë gjëndrat gonade, të ndryshme tek gratë dhe meshkujt. Te gratë vezoret tajojnë hormonin ekstrojen, kurse tek meshkujt testisi taton hormonin testosteron. Hormonet ndikojnë në zhvillimin e shenjave sekundare seksuale (të qenët leshtak të meshkujve, gjinjtë e grave, ndryshimet në zë etj.), dhe një sjelljen seksuale, që manifestohet në interesimin e shtuar për gjininë e kundërt. Për dallim nga instinktet për të cilat folëm më parë, instinkti seksual është e mundur të shtypet në kufij mjaft të gjerë.

**Instinkti i amësisë.** I lidhur ngusht me instinktin seksual, është instinkti i amësisë. Ai diferencohet në nevojën e gruas që të ketë fëmijë (instinkti i paraamësisë), dhe nevojën për kujdesin për fëmijë (instinkti i pasamësisë).

**Instinktet e tjera.** Përveç këtyre instinkteve themelore, nga të cilat varet vetëruajtja dhe përtëritja e llojit, ekzistojnë edhe disa nevoja biologjike që njeriu duhet t’i plotësojë që ta ruajë organizmin në baraspeshë funksionale. Një nga nevojat e tilla, që është mjaft intensive të krijojë instinktin, është nevoja për **aktivitet**, d.m.th. për angazhimin e funksioneve: senzore, mentale, motorike. Ky instinkt plotësohet përmes lojës, sportit, vallëzimit, ritmikës ose ndonjë veprimtarie tjetër që i angazhon funksionet e njeriut. Instinkti për aktivitet ka rëndësi të madhe, sepse aftësitë e njeriut, veçoritë e tjera dhe personaliteti në tërësi zhvillohen përmes aktivitetit dhe, në një masë të madhe, varen nga aktivitetet.

Përveç instinktit për aktivitet, shumica e autorëve konsideron se njeriu e ka të lindur **kërshtërinë**, si nevojë biologjike për hulumtim. Kjo nevojë është e mundur të veçohet tek kafshët, sidomos ato të zhvilluara. Rëndësia e saj qëndron në faktin që pikërisht kërshtërisë së njeriut, në një pjesë të madhe, mund t’i atribuohen zbulimet në fushën e shkencës, madje edhe i gjithë progresi i njerëzimit.

**Motivet sociale.** Nevojat fiziologjike që e përbëjnë bazën e ruajtjes biologjike të jetës dhe bazën e sjelljes instinktive njeriu i plotëson në shoqëri. Me plotësimin e këtyre instinkteve në mjedisin e caktuar shoqëror, në mënyrën që e imponon ai mjedis, njeriu fiton përvojë sociale që manifestohet në përvetësimin e normave shoqërore dhe të normave të sjelljes, si pronësi të çdo anëtarit të shoqërisë. Njeriu si qenie sociale përvetëson edhe mënyrat e plotësimit të nevojave fiziologjike, gjë që pasqyrohet në socializmin e sjelljes së tij instinktive. Instinkti i urisë, i etjes, instinkti seksual dhe instinktet e tjera të gjithë pjesëtarët e një bashkësie shoqërore i manifestojnë dhe i plotësojnë në mënyra që janë përcaktuar me norma të asaj shoqërie. Përvoja shoqërore, prandaj, manifestohet në rend të parë në përvetësimin e mënyrës së plotësimit të nevojave të caktuara biologjike. Ajo e mëson njeriun edhe për mënyrat se si mundet në mënyrën më efektive dhe më të lehtë t’i plotësojë nevojat e veta biologjike. Njeriu mëson që

prestigji dhe autoriteti shoqëror ofrojnë mundësi të plotësimit të instinktit seksual, kështu që kjo bëhet nevojë e tij. Nevojat e krijuara si produkt i përvojës sociale të individit, që dalin nga instinktet themelore fiziologjike dhe janë tipike për mjedisin e caktuar social, quhen  **motive sociale**. Edhe në të njëjtën shoqëri ndryshon domethënia e motiveve përkatëse sociale me ndryshimet që me kohë ndodhin në atë shoqëri.

**Motivi i vetëkonfirmimit.** Në këtë grup bëjnë pjesë motivet në të cilat pasqyrohet synimi i individit që ta pranojë shoqëria në të cilën jeton. Format e këtyre motiveve janë të ndryshme, sepse janë të ndryshme mënyrat në të cilat njeriu mund ta realizojë afirmimin shoqëror. Motivi i vetëkonfirmimit ose, siç e quajmë disa, motiv për afirmim personal, mund të manifestohet në formë të synimit të individit që të dallohet midis të tjerëve dhe t'i jepet mirënjohje e veçantë dhe t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Në këtë rast flasim për motivin për **prestigj**.

Motivi i vetëkonfirmimit mund të gjejë shprehje në synimin e individit për të sunduar mbi të tjerët, synimin për pushtet dhe dominim dhe, në këtë rast flasim për motivin e **dominimit**.

Prestigji shoqëror fitohet, zakonisht, përmes sukseseve që i arrinë individi në aktivitetet me të cilat merret: në mësim, sport, veprimtari profesionale, prandaj është e mundshme të shprehet motivi për **vetarritje**.

I lidhur ngushtë me motivin e vetarritjes është edhe motivi i **vetaktualizimit**, që manifestohet në synimin e individit që aftësitë e tij të gjejnë shprehje dhe të përdoren në ndonjë aktivitet të dobishëm.

Përveç këtyre, shpeshherë hasin një motiv në të cilin përmbahen komponentet tashmë të përmendura të motivit të vetëkonfirmimit. Ky është motivi për **pavarësi**. Ai manifestohet me synimin e individit që të jetë i pavarur, personalitet i pavarur, me të drejtë vendosjeje mbi veprimet e veta.

**Motivi për shoqëri**, që disa e quajnë motiv afiliativ ose gregar, pasqyrohet në synimin e individit që të jetë në shoqëri me të tjerët. Origjinën e këtij motivi duhet kërkuar në pamundësinë e njeriut që të ekzistojë vetë, pa ndihmën e pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë, çka do të thotë se paraqitja e këtij motivi lidhet me paraqitjen e llojit të njeriut. Së këndejmi, pohimet e shumë autorëve se ky është motiv i lindur, që vjen që nga të parët tanë shtazor. Të tjerët, ndërkaq, konsiderojnë se motivi për shoqëri fitohet në procesin e socializmit të personalitetit, dhe se baza e krijimit të tij është në pamundësinë e fëmijës që varet edhe nga kujdesi i prindërve, përkatësisht kujdesi i anëtarëve të tjerë të shoqërisë.

**Motivi i agresivitetit** pasqyrohet në synimin që të sulmohen, të thyhen dhe të shkatërrohen pjesëtarët e tjerë (fizikisht ose verbalisht), dhe t'u shkaktohet dëm. Disa filozofë gjermanë, ndër ta edhe Niçe (*Nietzsche*), paraqesin pikëpamjen se agresiviteti është motiv i lindur dhe se duhet t'i atribuohet domosdoshmëria e luftërave, me të cilat është e mbushur historia e shumicës së popujve, gjë që fashistët e kanë përdorur si bazë të ideologjisë së vet.

**Motivi i siguri** manifestohet në synimin e individit që ta ruajë të pandryshuar gjendjen që i siguron ekzistencën dhe plotësimin e motiveve përkatëse themelore. Për këtë arsye konsiderohet se motivi i siguri bashkon një varg motivesh të tjera sociale, siç janë: motivi për fitim, motivi për dominim, motivi për vetarritje, motivi i pavarësisë dhe

të tjerë, sepse me plotësimin e atyre motiveve automatikisht plotësohet edhe motivi i sigurisë.

**Motivi personal.** Duke e shqyrtuar natyrën e paraqitjes së motiveve sociale, kemi konstatuar se ato janë zhvilluar nga instinktet fiziologjike dhe janë paraqitur si rezultat i përvojës sociale të individit në mënyrën e plotësimit të instinkteve përkatëse fiziologjike. Ngjashëm me këtë, edhe motivet sociale që përbëjnë karakteristikat e pjesëtarëve të një mjedisi social është e mundur të plotësohen në mënyra të ndryshme. Arritshmëria dhe pesha e qëllimeve që individi përpiqet t'i realizojë, varet nga niveli i **aspiratave** të tij.

## KAPTINA 7.

### EMOCIONET

#### NOCIONI DHE DEFINICIONI I EMOCIONEVE

Emocionet përcjellin dhe janë pjesë përbërëse e sjelljes dhe e përjetimit të njeriut. Ne për çdo ditë, në çdo moment përjetojmë, më pak ose më shumë ndjenja të fuqishme të gëzimit, të pikëllimit, të dashurisë, të ngushëllimit, të simpatisë, të krenarisë, të dashaligësisë, të mendjemadhësisë, të turpit, të falënderimit, të brengosjes, të frikës, të pritjes, të shpresës etj. Të gjitha këto dhe shumë ndjenja të tjera që i përjeton njeriu, janë të lidhura me objekte, persona ose situata të caktuara që janë shkas i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i atyre përjetimeve. Emocionet nuk paraqiten vetëvetiu, pa shkas. Ato shkaktohen me ndonjë ngjarje nga rrethina. Ç'është e vërteta, nuk është e mundur çdo herë që të vërehet lidhja e drejtpërdrejtë midis emocionit që është i pranishëm dhe ngjarjes me të cilën është shkaktuar ai emocion, por ajo lidhje gjithmonë ekziston. Emocionet reflektojnë vlerën e ngjarjeve të caktuara, pa marrë parasysh sa janë të dukshme lidhjet e tyre. Në bazë të kësaj mund të themi se emocionet janë procese psikike në të cilat shprehet vlera që për përjetuesin e ka realiteti objektiv (definicioni).

Ato dallime në përjetim nuk manifestohen vetëm në intensitetin dhe në drejtimin e përjetimeve emocionale, por edhe në llojin e tyre. Derisa dikush ndjen frikë në praninë e armikut, tjetri mund të ndjejë urrejtje dhe përbuzje, zemërim ose krenari. Është i madh repertoari i ndjenjave që njerëzit e ndryshëm mund ta përjetojnë në praninë e ngjarjeve të njëjta objektive në rrethinë. Bazën e të gjitha përjetimeve emocionale e përbëjnë: shqetësimi dhe qetësimi si shprehje e **intensitetit**, dhe e këndshmja dhe e pakëndshmja si shprehje e cilësisë. Me këto aspekte të emocioneve duhet të dallohet edhe **kohëzgjatja**, **burimet** e paraqitjes dhe **orientimi**, për çka do të bëhet fjalë më vonë kur të flasim për klasifikimin e emocioneve.

Me vetë faktin që emocionet përcjellin çdo përjetim dhe veprim, ato ndikojnë në cilësinë e sjelljes së njeriut. Emocionet e iniciojnë njeriun për aktivitet me synim që të përjetojë kënaqësinë ose të shmang pakënaqësinë. Pa emocione jeta do të ishte e mërzitshme.

#### MANIFESTIMET FIZIOLOGJIKE TË EMOCIONEVE

Njeriu përjeton emocionet subjektivisht në formë të frikës, të gëzimit, të pikëllimit etj. Përveç përjetimit subjektiv, paraqiten ndryshimet edhe në gjendjen e organizmit dhe të funksioneve të organeve përkatëse. Ato ndryshime janë objektive, dhe ato është e mundur të vërehen dhe të përcillen. Proven e kësaj e gjejmë në rezultatet e anketës që e kanë zbatuar psikologët amerikanë në mbi 4 000 pilotë dhe anëtarë të tjerë të ekuipazheve të bombarderëve, që i kanë kryer detyrat luftarake gjatë kohës së Luftës së dytë botërore, duke kërkuar prej tyre që të cekin reaksionet organike që i kanë vërejtur në vete në situatat objektivisht të rrezikshme. Në bazë të raporteve të tyre është përpiluar

tabela nga e cila shihet lloji dhe shpeshtësia e ndryshimeve organike që paraqiten me ndjenjën e frikës. Rezultatet e anketës janë pasqyruar në tabelën 5.1. .

NDRYSHIMET E VËREJTURA ORGANIKE	SHPESH %	NDONJËHERË
Rrahja e zemrës dhe pulsi i shpeshtuar	30	56
Tensioni i lartë i muskujve	30	53
Shqetësimi i lehtë, zemërimi ose pikëllimi	22	58
Terja e fytit dhe e gojës	30	50
Djersitja nervoze dhe djersët e ftohta	26	53
»Fluturat» në stomak	23	53
Ndjenja e jorealitetit – sikur kjo nuk do të mund të ndodhte	20	49
Nevoja për urinim shumë të shpeshtë	25	40
Dridhja	11	53
Hutia	3	50
Dobësia dhe alivanosja	4	37
Pamundësia e kujtesës së hollësive pas fluturimit	5	34
Mundimi në stomak	5	33
Pamundësia e koncentrimit	3	32

*Tab. 5.1. Ndryshimet e vërejtura organike gjatë përjetimit të fikës gjatë kohës së kryerjes së fluturimeve luftarake (L. F. Shaffer, J. consufti Psych. 1947. 11.).*

Këto ndryshime vejnë në dukje në mënyrë të qartë aspektin organik ose fiziologjik të emocioneve, përveç subjektives, të të përjetuarës. Me hulumtimin sistematik është konstatuar se prania e emocioneve mund të vërehet në punën e të gjitha organeve të brendshme dhe në gjendjen e tërë organizmit. Me rastin e emocioneve paraqiten ndryshime në punën e zemrës dhe të sistemit të enëve të gjakut, të mushkërive dhe të organeve të frymëmarrjes, të lukthit dhe të organeve të tretjes, të sistemit të gjëndrave me tajitje të brendshme (të sistemit endokrin), dhe me tajitje të jashtme (të sistemit egzokrin) dhe të gjendjes së indeve të muskujve, që, përndryshe janë nën kontroll. Paraqitja e këtyre ndryshimeve i atribuohet funksionit të sistemit vegjetativ nervor.

**Sistemi vegjetativ nervor** përbëhet nga shumë neurone në korën e trurit të madh (a), në bërthamat e hipotalamusit (b), në vazhdimin e palcës kurrizore, (c), në palcën kurrizore (d) dhe të nervave që, në formë të zinxhirit, shtrihen përgjatë boshtit kurrizor (e). Siç është pasqyruar kjo në mënyrë skematike në figurën 5.1, nervat vegjetativ gjenden në sy, në gjëndrat jargore dhe në gjëndrat e pështymës, gjëndrat e djersitjes, enët e gjakut, zemër, mushkëri, mëlçi, lukth, gjëndrat mbiveshkore, veshkët, barkun, zorrën e trashë, fshikëz, dhe në të gjitha ato organe të brendshme zhvillohet aktiviteti në mënyrë refleksive, jashtë kontrollit të vullnetshëm të njeriut. Sistemi vegjetativ nervor funksionalisht përbëhet nga dy pjesë, që janë në antagonizëm: **pjesa simpatike** e sistemit vegjetativ nervor është aktive atëherë kur organizmi është në aksion dhe ai shkakton këto ndryshime në punën e organeve të brendshme: shpejton punën e zemrës, rritë qarkullimin e gjakut, zgjeron enët e gjakut në muskuj, por i turrë në lukth, zorrë dhe në organe të brendshme, rritë tensionin e gjakut, shpejton ritmin e frymëmarrjes, i zgjeron bebëzat, shkakton tharjen e fytit dhe të gojës, shkakton ngërçe të lukthit dhe lëshimin e

sfinkterit, pastaj tajiten e sasive të mëdha të adrenalinës nga gjëndrat mbiveshkore gjë që ka për pasojë rritjen e sasisë së sheqerit në gjak.

**Parasimpatikusi** parasimpatikusi hyn në aksion atëherë kur organizmi është pasiv, kur nuk janë të pranishme emocionet, dhe funksioni i tij manifestohet në grumbullimin (akumulimin) e energjisë së nevojshme për aksion.

Veprimi i këtyllë i sistemit vegjetativ nervor në prani të emocioneve ka për pasojë një ndikim shumë të rëndësishëm të emocioneve në sjelljen e njeriut. Në saje të këtij veprimi, emocionet e bëjnë organizmin të gatshëm për aksion. Me ndikimin e simpatikusit bëhet aktiviteti i shtuar i atyre pjesëve të organizmit, që janë të nevojshme në aksion (sistemi i enëve të gjakut, organet e frymëmarrjes, muskulatura etj.), kurse inhibohet funksioni i atyre pjesëve të organizmit që janë të tepërt dhe do të bënin pengesa, siç janë organet e tretjes etj. Veprimit të simpatikusit duhet t'i atribuohet paraqitja që i plagosuri në luftë më ngadalë gjakon se në rrethanat normale, sepse në praninë e emocioneve bëhet tkurja e enëve të gjakut në sipërfaqe të trupit dhe për këtë arsye paraqitet gjakderdhja më e vogël.

### **Detektori i gënjeshtërs – poligrafi**

Ndryshimet organike që paraqiten me rastin e emocioneve janë bërë përpjekje të shfrytëzohen për qëllime të hulumtimit objektiv të natyrës dhe të përmbajtjes së tyre. Mirëpo, që në përpjekjet e para është dëshmuar se në bazën e ndryshimeve organike është e mundur të konstatohet prania e emocioneve, madje edhe intensiteti i tyre, por jo lloji dhe karakteristikat e tyre. Megjithatë, edhe mundësia e konstatimit objektiv të pranisë së emocioneve janë bërë përpjekje të përdoret për qëllime praktike në kriminalistikë. Ndërkaq, duhet nisur nga supozimi se emocionet mund ta zbulojnë delikuentin që vërtetë ka kryer veprën penale. Në këtë bazë Ibau më 1942 e ka konstruktuar aparatën, të quajtur **detektor i gënjeshtreve**, i cili përbëhet nga stabilimenti për regjistrimin e pulsit dhe të tensionit të gjakut, të rritmit të frymëmarrjes dhe të aktivitetit elektrik të organizmit. Të hulumtuarin, i cili është i lidhur në aparat, eksperimentuesi e provokon (e ngacmon) me situatën në të cilën është kryer krimi, kurse aparati i matë reaksionet e tij. Situata në të cilën është kryer vepra përmbahet në vargun e fjalëve ngacmuese që eksperimentuesi ia jep të hulumtuarit, kurse i hulumtuari ka për detyrë që në to të përgjigjet me asociacione të lira, d.m.th. në çdo fjalë ngacmuese përgjigjet me fjalën e parë që i bie ndër mend. Në vargun e fjalëve ngacmuese përmbahen edhe të ashtuquajturat fjalët **kritike**, që kanë lidhje me rrethanat në të cilat është kryer krimi. Fjalët kritike zakonisht shkaktojnë reaksione të bujshme emocionale tek i hulumtuari që vërtetë e ka kryer veprën.

Detektori i gënjeshtreve i regjistron ato reaksione dhe kështu ndihmon në zbulimin e delikuentit. Të hulumtuarit që ndaj fjalëve kritike nuk shqetësohen, ose janë të pafajshëm ose emocionalisht të ftohtë. Në këtë rastin e dytë, detektori i gënjeshtreve nuk na ndihmon. Mirëpo, shumica e kriminelëve janë primitiv dhe “dorëzohen” para se detektori fillon të punojë, kështu që ky aparat është shumë i dobishëm në kriminalistikë atëherë kur ai përdoret profesionalisht. Ana e tij e mirë qëndron në faktin që më parë mund të “gabojë” tek fajtori sesa të “akuzojë” të pafajshmin.

**Sëmurjet psikosomatike.** Deri më tash kryesisht i pamë efektet e dobishme të ndryshimeve organike që paraqiten gjatë emocioneve. Mjerisht, ndryshimet organike shpesh kanë edhe pasoja negative për gjendjen e organizmit. Ato dalin nga mosharmonizimi i ndryshimeve organike, të paraqitura me rastin e emocioneve, me gjendjen e përgjithshme të organizmit. Kështu, gjatë emocioneve bëhet tajitja e shtuar e lëngut të lukthit, edhe pse në lukth nuk ka ushqim për zbërthimin e të cilit lëngu është i nevojshëm; shkaktohet puna shpejtuar e zemrës, edhe pse organizmi realisht nuk u nënshtrohet përpjekjeve të shtuara për të cilat është e nevojshme sasia më e madhe e gjakut në inde; shkaktohet tharja e fytit dhe e gojës, edhe pse pështyma është e nevojshme për punën normale të organit të të folurit, etj. Gjatë gjendjeve të pakëndshme emocionale (brengave, ankthit, frikës) që zgjasin shumë, janë të gjata edhe ndryshimet që paraqiten në punën e disa organeve të brendshme. Puna jopërkatëse e organeve të brendshme shkakton dëmtimin e tyre dhe çrregullimin e funksioneve të tyre.

Pasi që ato çrregullime shkaktohen me anë të emocioneve, përkatësisht të ndikimeve psikologjike, i quajmë çrregullime **psikosomatike**. Në rastet më të shpeshta ndër to paraqiten sëmurje të organeve të tretjes në formë të tretjes së çrregulluar, të pengesave gastritike, të të thatit në lukth dhe në zorrën dymbëdhjetgjishtore etj, por mund të paraqiten edhe çrregullime në punën e zemrës dhe të sistemit të enëve të gjakut, pengesa astmatike, hemorroidet etj. Është rregull e përgjithshme se pengesat psikosomatike paraqiten në ato organe që janë më pak rezistente në organizëm.

Që të njihet më mirë natyra e paraqitjes së sëmurjeve psikosomatike, është bërë një eksperiment me katër qifte majmunësh të lidhur për karrige, nëpër të cilët në intervale prej 20 sekondash është lëshuar rryma. Para goditjes së rrymës paraqitej drita e kuqe që mund ta shihnin majmunët. Njëri nga secili qift i majmunëve ka pasur mundësinë që ta shkyç rrymën dhe kështu të shmanget goditja e rrymës ndaj tij dhe qiftit të tij, kurse majmuni tjetër në qift nuk ka pasur mundësi që këtë ta bëjë. Me ritmin e këtillë eksperimenti ka zgjatur 6 orë, pastaj ka pasuar një pushim po aq i gjatë, në mënyrë që eksperimenti prapë të vazhdojë. Rezultatet e eksperimentit janë paraqitur shumë shpejtë dhe kanë qenë shumë drastike. Ditën e nëntë të eksperimentit ka ngordhur majmuni i parë nga ata katër majmunët që kanë pasur mundësi të shkyçin rrymën, e pas tij kanë pësuar të tjerët kështu që i dyti ka ngordhur ditën e 23, kurse i treti ditën e 25 të eksperimentit. Majmuni i katërt nga ata që kanë pasur mundësi ta shkyçin rrymën ka jetuar edhe 48 ditë pas eksperimentit. Tek këta majmunë është gjetur ithati aktiv në lukth, i cili ka qenë shkaktar i ngordhjes. Njëkohësisht, tek katër majmunët që nuk kanë pasur mundësi ta shkyçin rrymën, nuk janë vërejtur kurrfarë çrregullimesh.

Nga rezultatet e këtij eksperimenti mund të nxirret mësimi se shqetësimet afatshkurta, intensive, çfarë i kanë përjetuar majmunët që nuk kanë pasur mundësi t'i shmangen goditjes së rrymës elektrike, nuk janë të dëmshme dhe nuk lënë pasoja në organizëm. Ajo që vepron dëmshëm, janë brengat dhe preokupimet e përhershme që e ngarkojnë njeriun, nga të cilat ai nuk mund të lirohet.

## EKSPRESIONET EMOCIONALE

Lidhur ngushtë me ndryshimet organike që paraqiten me rastin e emocioneve, është edhe shprehja e jashtme e emocioneve ose ekspresionet emocionale. Duke pasur parasysh faktin që me rastin e emocioneve paraqiten ndryshime të mëdha në punë dhe në gjendjen e organeve dhe të mbarë organizmit, duhet pritur edhe manifestimin e caktuar të jashtëm të atyre ndryshimeve. Ndryshimet në punën e organeve të brendshme janë reflektive, dhe për këtë arsye edhe manifestimet e tyre të jashtme janë jashtë kontrollit të vullnetshëm të njeriut. Për shkak të rëndësisë që i kanë manifestimet e jashtme (ekspresionet emocionale) në njohjen e emocioneve, ato kanë qenë objekt i shumë studimeve. Kështu, Landis më 1993 ka konstatuar se befasia manifestohet me reaksione të jashtme karakteristike: me mbylljen e qerpikëve të syrit, me lëvizjen e kokës mbrapa, me shtrembërimin e mjekrrës, me shtrëngimin e muskujve të qafës. Edhe tek emocionet e tjera është e mundur të gjendet shprehja karakteristike. Mirëpo, shprehja e emocioneve në një pjesë të mirë është nën ndikimin e konvencionit, që është i ndryshëm në mjedise të ndryshme kulturore, kështu që kjo në një pjesë të mirë e zvogëlon vlerën e ekspresioneve në njohjen e emocioneve. Pjesëtarët e kulturave të ndryshme shpeshherë shfrytëzojnë manifestimet e njëjta që të shprehin emocione të ndryshme. Kështu, p.sh. me duartrokitje ne shprehim lumturinë dhe kënaqësinë, kurse kinezët brengën dhe zhgënjimin; kruarja pas veshit tek ne është shprehje e hutisë, kurse te kinezët shprehje e kënaqësisë; fishkëllima tek ne është shprehje e mospajtimit, kurse te amerikanët shprehje e miratimit dhe e kënaqësisë etj. Për këtë arsye gjatë njohjes së emocioneve në bazë të ekspresioneve duhet të merret në konsiderim edhe ndikimi i konvencionit.

Ekspresionet emocionale janë të shumta dhe të lidhura me funksionin e organeve të ndryshme në organizëm. Ato manifestohen në forma të ndryshme dhe, në bazë të kësaj, është e arsyeshme të ndahen në: ekspresione të fytyrës ose ekspresionet faciale, ekspresionet e organit të folurit ose ekspresionet vokale, dhe ekspresionet e trupit ose ekspresionet posturale.

**Ekspresionet faciale.** Mika e fytyrës i zbulon emocionet tona. Këtë e ka vërejtur edhe piktori i madh italian, ndërtuesi dhe konstruktori Leondardo Davinçi dhe me vizatime të thjeshta ka ilustruar se si muskujt e fytyrës, sidomos rreth gojës dhe syve zbulojnë emocionet. Muskujt e lëshuar i shprehin emocionet e pakëndshme, kurse muskujt e ngritur emocionet e këndshme.




Fig. 5.2. Shprehja skematike e fytyrës gjatë emocioneve të pakëndshme dhe të këndshme



Rukmik (*Ruckmick*) më 1931 hulumtoi në mënyrë eksperimentale mundësinë e njohjes së emocioneve në bazë të ekspresioneve faciale. Rezultatet e atij eksperimenti kanë treguar se në bazë të ekspresioneve faciale është e mundur të dallohen emocionet e këndshme nga ato të pakëndshmet, por ekspresionet janë të pasigurta kur duhet të dallohen madje emocionet themelore, elementare siç janë: gëzimi, pikëllimi, zemërimi dhe frika. Nga kjo mund të konkludohet se ekspresionet faciale nuk kanë as për afërsisht aq domethënie për njohjen e emocioneve që zakonisht u atribuohen.

**Ekspresionet vokale.** Për dallim nga ekspresionet faciale, ekspresionet vokale janë indikatorë më i sigurt i emocioneve, kështu që gati me arsye është përhapur mendimi se “njerëzit i shprehin emocionet e veta me anë të zërit”. Disa nga ekspresionet vokale janë tipike. Kështu zëri i lartë, zakonisht, shprehë befasinë dhe frikën; rënkimi – vuajtjen dhe fatkeqësinë, dënosa - pikëllimin; qeshja – gëzimin; dridhja e zërit – pikëllimin e thellë; bërtima – zemërimin. Përveç këtyre shprehjeve tipike vokale, emocionet shprehen edhe me ndryshimet që paraqiten në shprehjen e ndonjë përmbajtjeje me anë të zërit. Kështu, për zemërimin është karakteristik zëri i ngritur, por përveç kësaj shkurtohen fjalët, zvogëlohen pauzat midis tërësive foljore, të folurit bëhet i ndërprerë dhe i paartikulluar; kur njeriu është i pikëlluar, tempoja e të folurit është e ngadalësuar, kurse pauzat midis fjalëve të zgjatura, etj. Në saje të këtyre ekspresioneve karakteristike që paraqiten me disa lloje të emocioneve, ekspresionet vokale në tërësi janë indikatorë mjaft i sigurt i emocioneve. Për këtë arsye artistët shfrytëzojnë më shumë ekspresionet vokale sesa faciale, sepse mund t’i shprehin në mënyrë më të suksesshme llojet përkatëse të emocioneve.

**Ekspresionet posturale .** Përveç mimikës dhe ndryshimeve karakteristike në zë, gjatë emocioneve bëhen ndryshime karakteristike në qëndrimin e trupit dhe në lëvizje. Ato lloje të shprehjes quhen ekspresione dhe gjeste posturale. Ngjashëm si edhe tek ekspresionet vokale, edhe këtu ekzistojnë mjaftë shprehje karakteristike gjestikuluese për disa emocione elementare ose themelore. Kështu, për zemërimin është karakteristik shtrëngimi i grushtit, bërja e lëvizjeve luftarake, kurse te kafshët kreshpërimi e qimeve, ulërima, tregimi i dhëmbëve. Për pikëllimin janë karakteristik muskujt e lëshuar të trupit, lëvizjet e ngadalshme, lëshimi i kokës dhe i krahëve. Përkundër kësaj, **gëzimi** karakterizohet me lëvizje të gjera, të forta, me qëndrim të drejtë, me lëvizje të shpejta. Tek **frika** kemi dy mënyra të ndryshme të reagimit që në mënyrë tipike gjejnë shprehje gjatë përjetimit intensiv të këtij emocioni. Frika mund të shkaktojë shtangimin e funksioneve psikike dhe trupore, me ç’rast bëhet bllokimi i lëvizjeve, i mendimeve, i aksioneve. Ky reaksion quhet **iktus**. Përkundër kësaj, gjatë frikës mund të paraqiten reaksione shumë intensive në formë të vrapimit ose të lëvizjes, që zakonisht janë të pakontrolluara, kaotike dhe të papërshtatshme. Reaksioni i tillë quhet **raptus**. Me rastin e raptusit njeriu mund të përdorë rezervat e energjisë që, në gjendje normale, nuk i shfrytëzon dhe të realizojë një efekt më të madh të punës nga ai i zakonshmi. Kështu, janë të njohura rastet që nga frika njeriu të shprehë “ fuqinë mbinjerëzore”, me të cilën i tejkalon pengesat në mënyrë që të shpëtojë.

Për ekspresionet postulare dhe gjestikulare, ndërkaq, është karakteristike që ato janë nën ndikimin e madh të konvencionit. Kështu, për shembull, indianët amerikanë janë shumë koprrac në shprehjen e emocioneve, kurse francezët dhe italianët i shprehin në mënyrë shumë të bujshme.

Për shkak të ndikimit të konvencës në mënyrën e shprehjes së emocioneve, gjatë studimit të tyre në bazë të shprehjes së jashtme, duhet pasur kujdes edhe për situatat emocionale. Megjithëse emocionet janë individuale dhe subjektive, përkatësisht situatat e njëjta mund t'i përjetojnë në mënyra të ndryshme personat e ndryshëm, megjithatë marrja parasysh e situatave emocionale mund të na ndihmojë gjatë njohjes së emocioneve. Situatat e rrezikshme tek shumica do të shkaktojnë emocionin e frikës, që do të thotë se e dhëna mbi situatën emocionale mund të ndihmojë që të interpretojmë domethënien e ekspresioneve të atyre që gjenden në atë situatë.

## KLASIFIKIMI I EMOCIONEVE

Ndërlíkueshmëria e emocioneve nuk lejon klasifikimin vetëm një bazë të një kriteri, sepse me klasifikimin e tillë do të lireshin anash shumë aspekte të rëndësishme të emocioneve. Për këtë arsye ndarja e tyre është bërë brenda disa aspekteve, gjë që mundëson diferencimin e emocioneve sipas: llojit, intensitetit dhe kohëzgjatjes, dhe sipas ngjarjeve që i kanë shkaktuar. Në pajtim me këto kritere, sipas **llojit** dallojmë emocionet primare ose elementare nga ato të ndijimit, estetike e të tjera. Sipas **intensitetit** dhe kohëzgjatjes dallojmë afektet, disponimet dhe pasionet. Dhe, më në fund, sipas **ngjarjeve** që i kanë shkaktuar, dallojmë emocione të orientuara nga personaliteti vetanak dhe të orientuara nga të tjerët.

**Emocionet primare ose elementare** . Në këtë kategori bëjnë pjesë emocionet që kanë karakteristikat më të qarta dhe paraqesin bazën e jetës emocionale. Ndër emocionet primare bëjnë pjesë: frika, zemërimi, gëzimi dhe pikëllimi.

**Frika.** Në formën e vet themelore, frika paraqitet si reaksion ndaj situatave të papritura, të rrezikshme në të cilat njeriu nuk është në gjendje t'i kundërvihet rrezikut. I porsalinduri reagon me frikë ndaj zërit intensiv dhe gjatë humbjes së shpejtë të mbështetëses. Të rriturit e përjetojnë frikën gjatë rreziqeve nga humbja e ekzistencës personale ose e humbjes së personave të dashur, të gjërave, të gjendjeve ose të dukurive. Subjektivisht, frika ka cilësi të pakëndshmërisë intensive. Objektivisht, paraqiten një varg ndryshimesh në punën e organeve të brendshme. Bëhet frymëmarrja e shpejtuar dhe aritmike, shtimi i presionit të gjakut, tharja e fytyrës dhe e gojës, rrënoqethja e lëkurës, zgjerimi i bebëzave, të muskujve, lëvizjet e shpeshtuara të duarve dhe të këmbëve dhe, eventualisht ikja. Ato reaksione sqarohen në mënyrë evolutive si përgatitje e organizmit për rezistencë ndaj burimit të rrezikut.

Frika ndikon në shumë funksione dhe procese të tjera psikike. Zvogëlon nivelin dhe shtangon aktivitetin intelektual, mendimi bëhet më pak i gjallë dhe i përshtatshëm, dobësohen parimet e përvetësuara morale. Ajo ndikon edhe në aktivitetin motorik, kështu që lëvizjet bëhen më pak të integruara dhe më pak të përshtatshme.

Frika, që e kemi definuar si reaksion ndaj situatave të rrezikshme, zhduket kur zhduken situatat e rrezikshme që e kanë shkaktuar, përkatësisht kur ndërmarrim aksionin e nevojshëm me të cilën mënjanojmë burimin e rrezikut. Nëse aksioni që e kemi ndërmarrë nuk është i mjaftueshëm në vështirësi të mënjanimin të rrezikut, atëherë thellohet ndjenja e frikës dhe ajo, zakonisht, shndërrohet në një formë më të lartë – tmerri ose paniku. Në panik ekzistojnë dukuritë e theksuara përcjellëse të frikës, kështu që ndikimi i saj në funksionet e tjera psikike mund të jetë shumë intensiv.

Përkundër ndikimit negativ të frikës intensive në pothuaj të gjitha funksionet psikike dhe veprimet motorike, frika e intensitetit të butë në formë të tremës së lehtë mund të jetë e dobishme, sepse e ngritë nivelin e aktivitetit të njeriut, dhe arrihen efekte më të mëdha në punë. Trema e butë që paraqitet tek studentët në provim, ligjëruesit, aktorët, këngëtarët etj. gjatë paraqitjeve publike, mund të kontribuojë në suksesin e tyre më të mirë.

Parashtrohet pyetja prej nga frika tek njeriu. Në çfarë mase ajo është e lindur, e në çfarë mase njerëzit mësojnë se prej se duhet të frikohen. Shumë hulumtime kanë treguar se frika është e lindur, por njeriu mëson se prej se duhet të frikohet. Njeriu lind me frikën refleksive prej dy situatave: zërit të fuqishëm dhe humbjes së papritur të mbështetëses. Vetëm më vonë, me fitimin e përvojës mbi situatat e rrezikshme, d.m.th. të përvojës negative, njeriu mëson se cilat situata e rrezikojnë dhe ato situata fillojnë tek ai të shkaktojnë frikë. Rapllima e dyerve gjatë natës tek fëmija mund të shkaktojë frikë nga terri, kurse fatkeqësia në komunikacion mund të shkaktojë tek njeriu frikën nga ngasja e automobilin. Është karakteristike se përvojat e tilla mund të gjeneralizohen, dhe frika që është krijuar në një situatë mund të zgjerohet edhe në të gjitha situatat e ngjashme. Në literaturë përmendet “rasti Albert” që shërben për ilustrimin e paraqitjes dhe të gjeneralizimit të frikës. Alberti ka qenë një fëmijë njëmbëdhjetë muajsh që luante me dëshirë me minjtë e bardhë në laborator të Votsonit (Watson). Hulumtuesi në momentet kur Alberti luante me mijë të bardhë disa herë i mëshonte fuqishëm tavolinës me vizore. Pas disa përsëritjesh vëren se djaloshi kishte pushuar të luante me mijë dhe kishte filluar të tregonte frikë nga prania e tyre. Pas një kohe djaloshi fillon që të frikohet edhe nga një hulumtues me mjekërr të thime me të cilin më parë pajtohej mirë. Sa më shumë që njeriu u ekspozohet situatave të rrezikshme, që objektivisht e rrezikojnë, ka më shumë mundësi ta njohë frikën. Mirëpo, duke i njohur situatat e rrezikshme njeriu i njeh edhe mënyrat si t’u kundërvihet, dhe kështu krijon në vete edhe mbrojtjen nga frika. Megjithatë, shumë përvojë negative tek individit mund të shkaktojë frika të përhershme iracionale në formë të anksozitetit ose në formë të fobisë.

**Anksoziteti** është dukuri e frikës së tepruar. Njerëzit anksoz ndiejnë praninë e frikës nga të gjitha situatat e reja dhe të panjohura. Çdokund presin rrezik. Kjo është karakteristikë e personalitetit e fituar si pasojë e përvojës negative gjatë zhvillimit individual. Prindërit tepër të rreptë i edukojnë personalitetet anksoze, sepse dënimi i vazhdueshëm drastik shkakton tek fëmijët frikën nga dënimi, që zgjerohet në frikën nga prindërit, frikën nga të rriturit, frikën nga çdo autoritet.

Për dallim nga anksoziteti që paraqet karakteristikë të personalitetit, **fobitë** janë frika të fuqishme iracionale nga ndonjë gjë ose situatë, që janë krijuar si pasojë e përvojës negative që është harruar. Origjina e fobisë zakonisht është nga fëmijëria e hershme. Përjetimet e fuqishme emocionale nga fëmijëria zhduken zakonisht nga vetëdija, por vazhdojnë nga nënvetëdija të veprojnë në sjelljen e individit. Në saje të këtij kushti, njeriu frikohet nga disa situata e të mos e dijë arsyen e vërtetë të frikës dhe nuk mund të lirohet nga ajo frikë. Fobitë janë individuale dhe fillojnë në përvojën individuale, por disa paraqiten më shpesh si p.sh. : klaustrofobia – frika nga hapësira e mbyllur, akrofobia – frika nga lartësia, kancerofobia – frika nga kanceri, etj. Frika, pra është emocion i ndërlikuar që ka forma të ndryshme dhe ndikon fuqishëm në sjelljen e njeriut.

**Zemërimi** . Ky është emocion që paraqitet si pasojë e pengimit të planeve tona dhe e kufizimit në plotësimin e motiveve tona. Edhe fëmijët edhe të rriturit reagojnë me zemërim kur i kufizojmë për diçka, por që me moshën ndryshon mënyra e shprehjes, e manifestimit të hidhërimit. Kështu, për moshën e fëmijëve është karakteristike këllitja, inati dhe sjellja tiranike. Tek të rriturit kemi urrejtjen, nënçmimin, përqeshjen etj. Subjektivisht, zemërimi është ngjarje ambivalente: njëkohësisht e pakëndshme dhe e këndshme. Objektivist, tek zemërimi mund të regjistrohen ndryshime në formën e qarkullimit të shpejtuar të gjakut dhe të ndryshimeve që e përcjellin atë dukuri, të frymëmarrjes të shpejtuar dhe të ndaljes së aktivitetit të organeve të tretjes.

**Gëzimi dhe pikëllimi.** Këto janë emocione shumë të shpeshta që ndërrohen në përjetimin tonë. Gëzimi paraqitet si pasojë e arritjes së ndonjë qëllimi dhe përcillet me ndjenjë të këndshme. Intensiteti i tij varet nga vlera e qëllimit që e kemi arritur. Qëllimet e arritura me vështirësi dhe sukseset e papritura shkaktojnë përjetimin më intensiv të kënaqësisë, gëzimin më të madh. Për gëzimin janë karakteristike lëvizjet e gjera, vendosja e lehtë e kontakteve, ecja e fuqishme.

**Pikëllimi** është ndjenjë që paraqitet si pasojë e humbjes së ndonjë gjëje ose të dikujt që e kemi të dashur, kurse intensiteti i tij varet nga vlera e asaj që është humbur. Për pikëllimin janë përgjithësisht karakteristike pasiviteti, ngadalësia dhe pagatishmëria për aksion. Mirëpo, ekziston edhe i ashtuquajti pikëllimi aktiv, që përfshin aksionin për kompensimin e asaj që është humbur.

**Emocionet si motive të veprimit** . Emocionet primare ose themelore shpeshherë janë motive të veprimit. Kështu, frika determinon sjelljen në vështirësi të shmangies së rrezikut. Njerëzit anksioz iu shmangen profesioneve dhe aktiviteteve që lidhen me rreziqet. Zemërimi është motiv i sjelljes agresive, që mund t'i drejtohet burimit real ose të supstituiuar të frustrimit. Me veprimin e zemërimit njerëzit i zgjedhin profesionet e gardianve të burgut, xhelatëve etj. Gëzimi determinon sjelljen në drejtim të kërkimit të përjetimeve të këndshme. Pikëllimi, gjithashtu, mund të jetë motiv i sjelljes në atë mënyrë që njerëzit në të kërkojnë situata në të cilat mund të provokojnë situatën e vet të dhembshme. Kërkojmë drama, tragjedi dhe kënaqen në to. Shkurtimisht, emocionet janë baza të sjelljes së motivuar dhe paraqesin nxitëset themelore për aksion.

**Emocionet sipas intensitetit dhe kohëzgjatjes.** Emocionet primare janë bazë jo vetëm për sjelljen e motivuar, por edhe bazë e gjendjeve emocionale. Gjendjet emocionale i dallojmë në bazë të intensitetit dhe të kohëzgjatjes së emocioneve përkatëse brenda kualitetit të caktuar. Në bazë të këtyre kriterëve, është e mundur të dallohen tri gjendje emocionale: afektet, disponimet dhe pasionet.

**Afektet** janë gjendje emocionale të intensitetit të madh dhe të kohëzgjatjes së shkurtër. Ato janë erupcion, vërshim i emocioneve, siç ndodhë kjo gjatë tërbimit ose gëzimit të papërmbajtur dhe frikës në panik. Në të gjitha këto raste emocionet ndikojnë intensivisht në proceset e tjera psikike. Mendimi bëhet rigid (i ngurtë) dhe njeriu me këmbëngulje mbetet i fiksuar në një kuadër të caktuar të ideve. Dobëson kontrolli i sjelljeve dhe i veprimeve. Njëkohësisht, në afekte paraqiten ndryshime intensive në punën e organeve të brendshme. Për shkak të këtyre karakteristikave, afektet mund të shkaktojnë edhe efekte të dobishme dhe efekte të dëmshme. Dobishmëria e afekteve manifestohet në zbrazjen e elektrizimit emocional dhe në uljen e tensionit, që grumbullohet gjatë pranisë më të gjatë të emocioneve negative të intensitetit më të dobët. Veprimi i dëmshëm i afektit mund të paraqitet në ato raste kur njeriu, për shkak të

kontrollit të dobësuar të sjelljes, bën diçka që është në konflikt me normat shoqërore, kështu që kjo e sjellë në situatë të vështirë.

**Disponimet** janë gjendje emocionale të intensitetit të dobët, por me kohëzgjatje relativisht të gjatë. Ato mund të zgjasin me ditë, javë, muaj dhe vite, përkatësisht mund të marrin formë të përhershme të përjetimit dhe të sjelljes. Realizimi i ndonjë qëllimi që e synon njeriu, mund të shkaktojë disponim të përhershëm pozitiv. Humbja e ndonjë personi të dashur mund të shkaktojë pikëllimin që zgjatë aq shumë sa merr formë të disponimit të përhershëm negativ. Mirëpo, disponimet mund të shkaktohen edhe me ngjarje relativisht të parëndësishme, siç është, p.sh. partia e fituar e shahut, fitorja e ekipit sportiv për të cilin simpatizon individi, madje edhe kostelacioni i ngjarjeve siç është fillimi i ditës, mbarimi i javës etj.

**Pasionet** janë gjendje emocionale që kanë disa karakteristika të përbashkëta të afekteve dhe të disponimeve. Ato janë gjendje që kanë një intensitet të madh të përjetimit emocional, por edhe zgjasin shumë. Pasionet mund të shkaktohen në dy mënyra: në mënyrë artificiale – me futjen e agjenseve të caktuara në organizëm, dhe me ndikimin sistematik, përkatësisht me zhvillimin e emocioneve përkatëse elementare. Kështu është e mundur që me marrjen e nikotinit, të alkoolit, të drogës në organizëm për një kohë mjaft të gjatë, të krijohet nevoja intensive për ato mjete. Ajo nevojë shkakton përjetimin e kënaqësisë intensive atëherë kur është e plotësuar, përkatësisht të pakënaqësisë intensive atëherë kur nuk plotësohet. Në të dyja raste sjellja e njeriut ka karakteristika të sjelljes emocionale, intensiteti i së cilës arrinë forcën që e hasim te afekti. Njëkohësisht, pasioni është përherë i pranishëm. Në mënyrë artificiale është e mundur të krijohen pasionet edhe tek kafshët. Kështu, për qëllime eksperimentale shimpanzeve u është dhënë droga dhe pas një kohe janë bërë narkomane.

Përgjithësisht, pasionet mund t'i definojmë si besnikëri emocionale ndaj një gjëje, personi ose dukurie. Duke pasur parasysh vlerën e tyre etike, mund t'i ndajmë në dy pika: fisnike (shkenca, artti, aktivitetet e dobishme, dashuria), të dëmshme (bixhozi, alkooli, droga) dhe neutrale (sporti, grumbullimi, shahu).

Urrejtja dhe dashuria janë pasione tipike që rregullojnë sjelljen tonë. Urrejtja është gjendje emocionale që s'është e thënë të jetë e lidhur me ndonjë interes ose me shkaqe të drejtpërdrejta, por e cila determinon sjellje agresive ndaj personave, gjërave dhe dukurive të caktuara. Dashuria ka dy forma: dashuria ndaj gjinisë së kundërt, dhe dashuria prindërore, përkatësisht, dashuria fëmijërore. Dashuria ndaj gjinisë së kundërt ka për bazë komponentet seksuale, kurse dashuria prindërore dhe dashuria e fëmijëve ndaj prindërve kanë për bazë nevojën për ofrimin e mbrojtjes ose pranimin e asaj mbrojtjeje.

**Orientimi i emocioneve.** Emocionet mund të drejtohen ndaj personalitetit vetanak dhe ndaj personave të tjerë. Emocionet e drejtuara ndaj personalitetit vetanak lajmërohen me përjetimin suksesit dhe të mossuksesit. Suksesi zgjon emocione pozitive, kurse mossuksesi emocione negative. Mirëpo, përjetimi i suksesit dhe i mossuksesit varet më shumë nga vlerësimi subjektiv i individit dhe nga niveli i aspiratave të tij, sesa nga vlera reale e suksesit dhe e mossuksesit. Vlerësimi i njerëzve me autoritet mbi vlerën e të arriturës luan rol të rëndësishëm për individin dhe për këtë arsye mirënjohjet e ndryshme zgjojnë emocione pozitive. Suksesi veçanërisht i shprehur shkakton përjetimin e krenarisë dhe, anasjelltas, mossuksesi shkakton ndjenjë të turpit. Ato emocione në një pjesë të mirë janë të caktuara me normat morale të shoqërisë në të cilën jeton individi. Nëse individi me veprimet e veta gabon mbi normat morale të shoqërisë, kjo shkakton

ndjenjën e fajit që është gjithnjë e më e madhe sa më shumë që individ i ketë përvetësuar normat e shoqërisë të cilës i takon.

Emocionet e drejtuara ndaj personave të tjerë shprehen në qëndrimin e individit ndaj personave të tjerë. Emocioni më i rëndësishëm është dashuria për të cilën tashmë kemi bërë fjalë. Intensiteti i dashurisë varet nga ajo se sa është “investuar” në te. Kështu, kemi besnikërinë jashtëzakonisht të madhe të prindërve ndaj fëmijëve të sëmurë ose të mashkullit ndaj gruas që e ka përvetësuar me vështirësi. E lidhur ngusht me dashurinë është edhe xhelozia që paraqitet atëherë kur dashuria nuk kthehet në masën përkatëse ose kur individ, për shkak të dobësive të veta, është i pasigurt në mundësinë e vet që ta ruaj partnerin vetëm për vete. Xhelozia ka karakteristika të qëndrimit ambivalent – të dashurisë dhe të urrejtjes njëkohësisht dhe nuk është e thënë të ketë bazën seksuale. Është e mundur të ekzistojë midis vëllezërve, prindërve, bashkëpunëtorëve, por në ato raste xhelozia zgjerohet nga personat në gjëra, situata dhe dukuri që janë të lidhura me ata persona. Emocione shprehimisht negative nga të cilat dalin qëndrimet ndaj personave të tjerë janë urrejtja, zilia, dashaligësia, përbuzja, dhe emocionet e tjera që paraqiten midis njerëzve.

## KAPTINA 8.

### INTELEGJENCIA

Njerëzit dallohen mes veti për nga elasticiteti në shfrytëzimin e dijes, e me këtë edhe në efikasitetin e zgjidhjes së problemeve. Ato dallime në efikasitetin e zgjidhjes së problemeve, sipas autorëve sovjetikë, varen nga dallimet në aftësinë e të menduarit dhe nga karakteristikat e mendimit të individit. Si karakteristika qenësore të të menduarit, ata i cekun këto: elasticitetin, kritikizmin, pavarësinë, konkurrencën, gjerësinë, thellësinë dhe shpejtësinë e të menduarit. **Elasticitetin** e definojnë si aftësi për gjetjen e zgjidhjeve të reja dhe të llojllojshme në një problem. **Kritikizmi** është veçori e verifikimit të konceptioneve, të konkluzioneve dhe e dallimit të arsyeve të mira dhe të dobëta për konkluzionet e miratuara. **Pavarësia** manifestohet në të vërejturit e problemit dhe zhvillimin e përpjekjeve vetanake për zgjidhjen e problemit. **Konkretësia** është marrje në konsiderim e kushteve të veçanta të rëndësishme. **Gjerësia e mendjes** manifestohet në suksesin e të menduarit në fusha të ndryshme. **Thellësia** shpreh depërtimi në esencën e çështjes. **Shpejtësia** manifestohet në zgjidhjen e shpejtë të problemit.

Kjo ndarje e njerëzve sipas karakteristikave të të menduarit është e logjikshme dhe e pranueshme, por është bërë në sajë të inventivitetit dhe të luciditetit të autorit, me anë të rrugës spekulative, pa prova empirike. Kjo paraqet më parë komunikim të përvojës së përditshme sesa rezultatet e hulumtimit.

Përkundër këtij interpretimi të diferencave në efikasitetin e të menduarit midis njerëzve, qëndron nocioni i aftësisë unike mendore, të mjaftueshme që të mund të diferencoheshin njerëzit sipas suksesit të gjetjes në situata të reja dhe të efikasitetit të zgjidhjes së problemeve. Kjo është **inteligjencia**.

Ndihmë në sqarimin e strukturës së inteligjencisë ka ofruar **analiza e faktorit**. Ky është veprim matematikor statistik me të cilin caktohet numri minimal i dimensioneve themelore të personalitetit ku përmbahen edhe të gjitha veçoritë e tjera të individit nga të cilat varet sjellja e tij. Aplikimi i saj është i arsyeshëm në bazë të disa supozimeve: ndryshimi rezultateve në teste që aplikohen tek një numër i madh i të hulumtuarëve determinohet me një lloj të caktuar të aftësisë të të hulumtuarëve; rezultatet e ngjashme të të hulumtuarëve në disa teste janë caktuar me aftësi të njëjta, që do të thotë se testet janë të ngopura me faktorin e përbashkët i cili determinon rezultate të ngjashme të të hulumtuarëve; prania e këtij faktori konstatohet në bazë të lartësisë së relacionit midis testeve. Analiza e faktorit bën të mundshëm të përcaktohet madhësia e faktorit që determinon ndërlidhje midis variabileve (teksteve) dhe lejon që të konstatohet natyra e këtij faktori. Faktori është interaksioni midis aftësisë së të hulumtuarëve dhe testit që provokon dhe matë atë aftësi.

Me metoda të ndryshme të analizës së faktorit është përcaktuar natyra e inteligjencisë. Kështu, psikologu amerikan Spirman (*Spearman*) me metodën e dy faktorëve ka konstatuar se inteligjencia është aftësi që përbëhet nga një faktor i përgjithshëm ose gjeneral (G), dhe një varg faktorësh që gjejnë shprehje me rastin e kryerjes së punëve specifike. Ndërkaq, ai ka konstatuar se ekziston korelacioni pozitiv edhe midis faktorëve specifikë, me korelacionin e tyre me faktorin (G) dhe, në bazë të kësaj, ka konkluduar se ekzistojnë të ashtuquajturit faktorët grupor të inteligjencisë.




Fig. 7.3. – Pasqyrimi skematik i teorisë dyfaktorëshe sipas Spearmanit




Fig. 7.4. – Pasqyrimi skematik i teorisë së faktorëve grupor sipas Terstonit

Terston (*Thurstone*) ndërton teorinë e vet mbi natyrën e intelgjencisë në hulumtimet që dëshmojnë ekzistencën e faktorëve **gruporë**. Ai me anë të të ashtuquajturës analizës multifaktore ka konstatuar se ekzistojnë shtatë faktorë që marrin pjesë në veprimet intelektuale. Kështu Terston, duke mos përjashtuar ekzistimin e faktorit (G) si faktor i përbashkët, që pak a shumë gjen shprehje në të gjitha aktivitetet intelektuale, konsideron se inteligjencën e bën kombinimi i shtatë faktorëve gruporë. Ata faktorë paraqesin aftësitë themelore intelektuale: R- faktori i rezonimit, P- faktori perceptiv, N- faktori numerik, S- faktori special, V- faktori verbal, W – faktori i elokuencës dhe M- faktori i kujtesës.

Dallimet në konceptonet e këtyre dy autorëve dalin nga dallimi në qasjen në funksionin që e hulumtojnë. Ekzistojnë testet që masin, kryesisht, faktorin e përgjithshëm dhe mbetjen në formë të faktorëve specifikë. Me analizën e tyre do të konstatohet ekzistimi i faktorit të përgjithshëm dhe të faktorëve specifikë. Me analizën e testeve që i hulumtojnë faktorët gruporë do të konstatohet ekzistenca e faktorëve gruporë.

Në kohën më të re problemit të natyrës së intelgjencisë i qasemi nga aspekti i ashtuquajturës teorisë multidimensionale të aftësisë, autorë i së cilës është psikologu amerikan Guilford (J.P. Guilford), sipas të cilës inteligjencia përbëhet nga një numër i madh i komponenteve që e përbëjnë intelektin. Guilford konsideron se intelektin përbëhet prej 50 faktorëve, të cilët mund t'i rëndisim në pesë grupe: aftësia e kujtesës, aftësitë kognitive nga të cilat varet të vërejturit e të dhënave dhe ndjeshmëria për problemet, aftësia e të menduarit konvergjent – konsekuenca në drejtimin që shpie në zgjidhjen e problemit; aftësia e të menduarit divergjent, begatia e ideve, origjinaliteti, kreativiteti dhe aftësia që për problemin e dhënë të gjenden disa zgjidhje; aftësia e të menduarit evaluativ, që pasqyrohet në kritikën dhe vlerësimin e saktë çka është e drejtë e çka nuk është.

**Aftësitë.** Nocioni aftësi është bërë në bazë të dallimeve në suksesin e njerëzve që punojnë në rrethana të njëjta objektive dhe të cilët njësoj gjatë janë aftësuar për punën e caktuar. Ato dallime paraqiten edhe atëherë kur, me faktorët e përmendur, edhe synimet e njerëzve që të arrijnë sukses janë të njëjta. Duke pasur parasysh faktin që ato dallime në sukses të njerëzve paraqiten edhe atëherë kur ata janë të barazuar edhe për nga përvoja, nga nocioni aftësi duhet përjashtuar dijet, shkathtësitë dhe karakteristikat e tjera të fituara



përmes aktivitetit të caktuar. Aftësitë, pra, duhet të kuptohen si mundësi potenciale të individit për mësim dhe për kryerjen e ndonjë veprimtarie, e këto nuk janë as dituritë, as shkathtësitë, as shprehjet e fituara. Kjo do të thotë se aftësitë janë diçka tjetër dhe diçka më shumë se rezultatet e të ushtruarit dhe të të mësuarit. Mirëpo, natyra reale të aftësive të njeriut është e mundur të kuptohet vetëm me shqyrtimin e gjenezës së tyre dhe të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e tyre.

Me zhvillimin në mjedisin e caktuar shoqëror dhe rrethinën natyrore, njeriu i parashtron vetes qëllime dhe detyra të caktuara, dhe aktivisht e orienton sjelljen e vet në realizimin e tyre. Në këtë mënyrë aktiviteti i njeriut bëhet faktor që ndikon në zhvillimin e aftësive të tij.

Dispozicionet, që janë themeluar në strukturat trashëguesë të sistemit nervor, janë determinante potenciale për zhvillimi e aftësive të caktuara. Ato determinante janë vetëm potenciale sepse për disa prej tyre gjithëherë, e për të tjerat vetëm në kushte të caktuara të rrethinës gjenden rrethana të volitshme për zhvillim. Përveç kësaj, midis dispozicioneve dhe rrethinës ekziston jo vetëm kushtëzimi i njëanshëm, por i dyanshëm. Kur diskutohet për ndikimin e rrethinës, atëherë me rrethinën rregullisht nënkuptohen rrethanat e caktuara objektive, pa marrë parasysh ndaj kujt ato veprojnë. Për formësimin e aftësisë, ndërkaq, është e rëndësishme në radhë të parë rrethina **efikase**, d.m.th. ndikimet përreth që i përshtaten zhvillimit të dispozicioneve të caktuara. Është e kuptueshme se individët e ndryshëm, sipas mundësive të veta të dispozicionit, e shfrytëzojnë në mënyrë të ndryshme rrethinën e vet. Ata individë që disponojnë dispozicione për zhvillimin e aftësive të caktuara, më shumë do të shfrytëzojnë ndikimin efikas të rrethinës se ata që ato dispozita nuk i posedojnë. Fakti që kualiteti i rrethinës varet pjesërisht edhe nga faktori i dispozicionit, bën që rrethina objektive në të gjitha rastet nuk është e thënë të jetë njësoj efikase.

Për zhvillimin e disa aftësive elementare siç është për shembull aftësia e të vërejturit vizual të ndryshimeve në rrethinë, është e mjaftueshme që qenia e gjallë t'u ekspozohet atyre ndryshimeve dhe të nxitet për aktivitetin e llojit të caktuar dhe përmes atij aktiviteti do të strukturoren dispozicionet në aftësitë e caktuara elementare. Me rastin e fitimit të aftësive të tilla elementare për të cilat ekzistojnë dispozicionet specifike, njeriu është relativisht pasiv. Mirëpo, njeriun gjatë zhvillimit të vet, natyra, e sidomos rrethina shoqërore e vë para detyrave të reja, komplekse, me të cilat është e mundur të plotësohen aktivitete të reja, komplekse.

Fitimi i aftësive komplekse, të nevojshme që njeriu t'i plotësojë kërkesat e ndryshme shoqërore, kërkon vetaktivitet, d.m.th. aktivitetin e drejtuar në mënyrë të vetëdijshme, që do t'i ndërlihdë dispozicionet dhe të krijojë kombinimet të tyre, që pa vetaktivitet kurrë nuk do të aktualizoheshin. Në këtë mënyrë aktiviteti, që në sistemin e thjeshtë të formimit të aftësisë ka qenë rezultat i faktorëve të dispozicionit dhe të ndikimeve përreth, paraqitet si faktor i veçantë në zhvillimin e aftësive të ndërlikuara. Aktiviteti jo vetëm që kontribuon në zhvillimin e dispozicioneve në aftësi, por edhe në ndryshimin e strukturës së dispozicioneve dhe ndryshimin e vet rrethinës. Këto raporte janë komplekse dhe reciproke, dhe mund të pasqyrohen në skemën e thjeshtë: në të cilën *a* shënon aktivitetin, *d* dispozicionet, kurse *s* mjedisin social në të cilin individ i jeton dhe zhvillohet.

Nga kjo del se aktiviteti si faktor i zhvillimit të aftësisë është rezultat i dispozicioneve dhe i rrethinës efikase, me ç'rast ky raport është i dyanshëm, d.m.th. aktiviteti nga ana e vet vepron në ndërtimin e strukturave dispozicionale dhe bën të mundshëm ndryshimin e rrethinës. Në këtë mënyrë arsyetohet pohimi se aftësitë e njeriut nuk janë të caktuara vetëm me dispozicionet dhe mjedisin, por edhe me aktivitetin e vet, dhe së këndejmi çdo individ me një pjesë është përgjegjës për zhvillimin e aftësive të veta.




Fig.3.4.- Faktorët e zhvillimit të aftësisë

Në bazë të këtij sqarimi të gjenezës së aftësisë dhe të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e tyre, që e ka dhënë Z. Bujash (1959), mund të pranojmë edhe definicionin e aftësisë së të njëjtit autor, si sisteme potenciale dinamike për kryerjen e veprimtarive të caktuara, të fituara përmes aktivitetit, në bazë të dispozicioneve të trashëguara dhe nën ndikimin e rrethinës.

Aftësitë e definuara në këtë mënyrë pothuaj e kufizojnë mundësinë e klasifikimit të tyre, sepse zhvillimi i tyre nuk kufizohet në dispozitat që janë në një numër të kufizuar, por varen nga lloji i aktivitetit, gjë që lejon shumësinë e kombinimeve. Megjithatë, analizat shkencore kanë dëshmuar se në bazë të çdo veprimtarie njerëzore gjendet një numër i kufizuar aftësish që, secila për vete, paraqesin pak a shumë unitet funksional. Ato komponente kryesore të aftësive të njeriut, që determinojnë sukses në veprimtari të ndryshme, janë quajtur kategori ose faktorë themelorë. Domethënia psikologjike e këtyre kategorive ose faktorëve themelorë, si edhe numri i tyre, ende nuk është përcaktuar definitivisht. Me veprime të ndryshme të të ashtuquajturës analizës së faktorit, që mundëson një depërtim të konsiderueshëm në strukturën e aftësive të njeriut, është fituar një inventar i ndryshëm i faktorëve themelorë. Megjithatë, përkundër mospajtimit në hollësi, rezultatet e fituara të këtyre analizave japin orientimin aq të qartë mbi natyrën e aftësive të njeriut sa është mundësuar matja e tyre dhe, në bazë të rezultateve të kësaj matjeje, edhe parashikimi i suksesit në veprimtaritë që varen nga këto aftësi.

Ndër faktorët e aftësive që janë përcaktuar deri më tash, në vend të parë është faktori relativisht i gjerë **i përgjithshëm**, i cili shënohet me G dhe u jep një karakteristikë të përbashkët të përgjithshme të gjitha aktiviteteve intelektuale, kështu që shumë autorë me të drejtë e identifikojnë si faktor i **inteligjencisë së përgjithshme**. Duhet thënë se ky faktor kontribuon në suksesin jo vetëm në të ashtuquajturat veprimtari intelektuale, por ka ndikim në sukses dhe në të gjitha llojet e tjera të veprimtarisë. Përveç faktorit të përgjithshëm, në fushën e funksioneve komplekse intelektuale është konstatuar një varg të ashtuquajturish faktorësh gruporë, që kontribuojnë në sukses në llojet e caktuara të operacioneve intelektuale. Kështu, është konstatuar faktori i **rezonimit** (R) që

manifestohet në të kuptuarit e raporteve midis gjërave dhe dukurive, dhe zbulimin e ligjshmërive që ekzistojnë midis tyre; faktori i **elokuencës** (W), që manifestohet në lehtësinë e shprehjes gjuhësore dhe në begatinë e simboleve të të folurit; faktori **verbal**(V) nga i cili varet lehtësia e të kuptuarit të simboleve të të folurit; faktori **numerik** (N) nga i cili varet suksesi në operacionet e thjeshta llogaritëse, ku është i




Fig. 3.5 – Pasqyrimi skematik i faktorëve të aftësive intelektuale.

nevojshëm përdorimi i numrave; faktori **mnemonik** (M) i cili shpreh aftësinë e kujtesës së përmbytjeve të palidhura kuptimore, dhe faktori i **shpejtësisë**, nga i cili varet suksesi në një numër të madh operacionesh që duhet të kryhen në një kohë të caktuar.

Në fushën e vrojtimit janë definuar, gjithashtu, disa faktorë të aftësive themelore, ndër të cilët në vend të parë është faktori **perceptiv** (P), nga i cili varet suksesi në vrojtimin e dallimeve të vogla në strukturat e vëzhguara vizualisht, pastaj faktori **special** (S) që paraqet aftësinë e paraqitjes së objekteve në hapësirën tredimensionale, dhe faktori i **diskriminacionit** të intensitetit dhe të kualitetit, që manifestohet në të gjitha fushat e vrojtimit, e bën të mundshëm veçimin e suksesshëm të dallimeve në kualitetin dhe intensitetin e ngacmimeve.

Ndër aktivitetet motorike janë veçuar, gjithashtu, disa faktorë të aftësive themelore, nga të cilat varet suksesi në aktivitetet që përfshijnë aktivitetin dinamik të muskujve. Është konstatuar faktori i **shkathhtësisë së dorës**, që manifestohet në shkathhtësinë e zhvillimit të lëvizjeve me dorë dhe në koordinimin psikomotorik; faktori i **shkathhtësisë së gishtërinjve** që determinon suksesin në punët që zhvillohen me përdorimin e gishtërinjve nën kontrollin e të parit; faktori i **vizualitetit**, që paraqet aftësinë e zhvillimit të lëvizjeve të shpejta dhe precize nën kontrollin e të parit; faktori i **reagimit të shpejtë vijues motorik**, që manifestohet në shpejtësinë me të cilin njeriu mund të përsërisë ndonjë veprim të thjeshtë motorik, dhe faktori i **ambideksitetit**, i cili gjen shprehje në shkathhtësinë e punës me dorë që nuk është dominante (e majta tek djathtakët dhe e djathta tek mëngjarashët). Përveç këtyre, disa autorë kanë identifikuar edhe faktorin mekanik, nga cili varet suksesi në detyrat që kërkojnë të kuptuarit e parimeve mekanike me rastin e përdorimit të stabilimenteve të ndryshme teknike.

Këta faktorë të aftësisë nuk duhet të kuptohen si pasqyrim i plotë dhe i hollësishëm i strukturës së aftësive themelore, që i mundësojnë njeriut zgjidhjen e të gjitha detyrave para të cilave e sjellin aktivitetet e tija profesionale dhe aktivitetet e tjera. Kufizimi i këtij pasqyrimi konsiston në faktin që aftësitë nuk janë kategori statike të

përcaktuara njëherë e përgjithmonë, të pandryshueshme dhe tek të cilat ekzistojnë dallime vetëm në shkallën e zhvillimit. Aftësitë, siç e pamë, janë sisteme potenciale dinamike, prandaj është e arsyeshme të priten ndryshime në kualitetin dhe strukturën e tyre. Megjithatë, ajo që është stabile dhe e përcaktuar në mënyrë të padryshimtë, është ekzistimi i disa faktorëve kryesorë primarë, në bazë të të cilëve mund të caktohen




Fig. 3.6. Lokalizimi i funksioneve psikike në koren e trurit të madh

mundësitë e njeriut në aktivitete të ndryshme, e ato janë : faktori G, V, N, S, P. Realitetin e ekzistimit të këtyre faktorëve e përcaktojnë edhe hulumtimet e funksionit të trurit. Në funksionimin e trurit si aparat suprem integrativ i organizmit ekziston uniteti operativ me të cilin mund të interpretohet ekzistimi i një faktori të përgjithshëm i cili u jep atë karakteristikën e përbashkët të gjithë operacioneve intelektuale, siç është faktori G. Faktorët e tjerë, më të ngushtë, varen nga shkalla e zhvillimit të fushave përkatëse të trurit, që janë përgjegjëse për kryerjen e operacioneve të vrojtimit, të të folurit, të operacioneve numerike etj. Mirëpo, duhet kuptuar se pas suksesit në aktivitetet e ndryshme komplekse nuk fshihen aftësi të tjera primare të izoluara, por numri më i madh i atyre faktorëve që me integrimin, zhvillimin dhe shkallën e pjesëmarrjes së vet caktojnë suksesin në ato veprimtari.

## KAPTINA 9

### NDIJIMET DHE PERCEPTIMET

Ashtu siç duhet të fillojë studimi i materies nga grimcat më të imta të molekulës dhe të atomit, ashtu edhe studimi i proceseve të njohjes duhet të fillojë nga **ndijimi** si proces më elementar psikik. Ndiijimi është produkti i fundit i analizës së përjetimeve të gjithmbarshme, përmes të cilave e njohim realitetin në rrethinë (definicioni i Z. Bujash). Ai paraqitet si pasojë e veprimit të gjërave dhe të dukurive nga bota e jashtme në organet tona të ndijimit, e me këtë, shpreh në vetëdijen tonë cilësitë e gjërave dhe të dukurive që na rrethojnë. Bota objektive paraqet lëvizjen e energjisë, që zhvillohet në formë të proceseve të ndryshme kimike dhe fizikale. Disa prej atyre proceseve, që janë sidomos të rëndësishme për përshtatjen e njeriut në rrethinën objektive, i regjistrojnë organet tona të ndijimit, dhe në këtë mënyrë, realizohet kontakti ynë me rrethinën.

Ndiijimet kanë dy karakteristika të rëndësishme. E para është që ndijimi nuk paraqitet si pjesë e izoluar dhe e pavarur e jetës sonë psikike. Deri te ndijimet vijnë vetëm me analizën suplementare të përjetimeve të gjithmbarshme. Dhe e dyta është interpretimi i ndijimeve, që pasqyrohet në faktin që ato, edhe pse të determinuara me realitetin objektiv, nuk janë pamje besnike e këtij realiteti.

Përveç këtyre karakteristikave themelore, që caktojnë natyrën e ndijimit si proces elementar psikik, tek ndijimet duhet të dallohet kualiteti dhe intensiteti i tyre. **Kualiteti i ndijimit** është cilësi që cakton llojin e përjetimit. Ai varet nga faktori i rrethinës dhe cilësia e organizmit që janë në raport të caktuar. Analizatorët shqisorë të njeriut janë të specializuar vetëm për lloje të caktuara të ndryshimeve në rrethinë, dhe së këndejmi edhe pohimi që kualiteti i ndijimit varet nga struktura specifike e analizatorit të ndijimit. Ndërkaq, supozohet se në rrethinë ndodhin ndryshime në të cilat analizatorët e ndijimit janë të ndjeshëm, kurse lloji i përjetimit varet nga ajo se cili prej analizatorëve të ndijimit është angazhuar. Kështu, p.sh., të parit varet nga struktura specifike e analizatorit të shqisës së të parit, kurse dëgjimi varet nga struktura specifike e analizatorit të shqisës së dëgjimit, por me supozim që në rrethinë janë të pranishme ndryshimet që i ngacmojnë këta analizatorë.

**Intensiteti** i ndijimit është i caktuar me intensitetin dhe kohëzgjatjen e ngacmimit që vepron në organet e ndijimit. Që të arrijë deri te ndijimet, ngacmimi duhet të ketë një intensitet të caktuar. Ky intensitet i ngacmimit varet nga ndjeshmëria e organit të ndijimit. Ndjeshmëria e organit të ndijimit matet me intensitetin e ngacmimit që është i mjaftueshëm të shkaktojë ndijimin.

Njësia për matjen e ndjeshmërisë është pragu **absolut** i ndijimit. Ky është ai intensiteti më i vogël i ngacmimit që pikërisht është i mjaftueshëm të shkaktojë ndijimin (definicioni, Z. Bujash, 1942). Me shtimin e intensitetit të ngacmimit, shtohet edhe intensiteti i ndijimit, por ky raport nuk është linear. Sipas rezultateve të hulumtimeve të Gehnerit (Fechner), për shtimin linear të intensitetit të ndijimit është i nevojshëm shtimi gjeometrik i intensitetit të ngacmimit. Fechner këtë ligj e shpreh me anë të formulës.

$O(\text{ndijimi}) = K(\text{konstanta}) \times \log. e \text{ intensitetit të ngacmimit.}$

Deri te ligji mbi rritjen konstante të intensitetit të ndijimit në bazë të rritjes konstante (edhe pse katrore) të intensitetit të ngacmimit, Fehner ka ardhur në bazë të hulumtimeve të mëparshme të Veberit (Weber), i cili ka gjetur se **dallimet** në intensitet që ne i vërejmë paraqesin pjesën **konstante** të intensitetit **themelor** të ngacmimit. Fehner këtë konstatim të Veberit e shpreh me anë të formulës

$$\frac{Dp}{P} = K, \text{ ku është :}$$

$Dp$  — dallimi në intensitetin e ngacmimit themelor  
 $P$  — intensiteti i ngacmimit themelor, dhe  
 $K$  — konstanta.

Nga kjo formulë shihet se ndryshimi në intensitetin e ngacmimit themelor që e përjetojmë, paraqet pjesën konstante të intensitetit të ngacmimit themelor. Për dallim nga ndjeshmëria absolute që matet me prapun absolut të ndijimit, këtu flasim për **ndjeshmërinë diferenciale** ose ndjeshmërinë për dallimet në intensitetin e ngacmimeve. Ndjeshmëria diferenciale matet me prapun **diferencial** të ndijimit. Ky është ai ndryshimi më i vogël në intensitetin e ngacmimit themelor, që pikërisht është i mjaftueshëm të hetojmë dallimin nga ai themelor (definicioni).

Këto zbulime të Veberit dhe të Fehnerit në fushën e ndjeshmërisë absolute dhe diferenciale janë të rëndësishme edhe për arsye se ata kanë konstatuar që ekziston rregullsia në zhvillimin e proceseve psikike dhe se është e mundur të konstatohet njëfarë raporti midis karakteristikave të proceseve psikike dhe karakteristikave të mjedisit që i shkakton.

Përveç intensitetit të ngacmimit, në intensitetin e ndijimit në kufij të caktuar vepron edhe **kohëzgjatja** e ngacmimit. Me pranimin më të gjatë të ngacmimit bëhet shumëzimi i efekteve të atij ngacmimi në analizatorin e ndijimit, kështu që shtohet kuantumi i përgjithshëm i ndikimit nga mjedisi dhe, në këtë mënyrë, ngacmimi i intensitetit më të vogël megjithatë mund të shkaktojë ndijimin.


## ZONAT E NDIJIMIT

Struktura e specializuar e organeve të ndijimit i bën të ndjeshëm për lloje të caktuara të ndryshimeve në mjedisin tonë: syrin për valët elektromagnetike, veshin për zë, organet e shijimit dhe të nuhatjes për materiet kimike etj. Cilësitë specifike funksionale të organeve të ndijimit janë rezultat i evolucionit të gjatë biologjik në drejtim të përshtatjes më të plotë të organizmit në kushtet e botës objektive. Sipas Sheqenovit (Bikov, 1948) çdo analizator i ndijimit është sistem unik që përbëhet nga tri pjesë: pjesa periferike ose receptori, pjesa përcjellëse me qendrat artificiale nervore, dhe pjesa e palcës ose pjesa qendrore në korën e trurit të madh. Pjesa **periferike** është aparat receptor i ndjeshëm ndaj llojit të caktuar të ngacmimit. Ai është transformator i specializuar i energjisë së jashtme në procesin nervor. Pjesa **përcuese** përcjell shqetësimin nervor drejt qendrave artificiale. Pjesa e **palcës** ose pjesa kortikale është pjesa më e lartë e analizatorit, në të cilën shqetësimi nervor merr kualitete të reja dhe bëhet ndijim.

Të gjithë receptorët janë pranues specifik, që dallohen për nga ndërtimi i vet morfologjik, por të gjithë në mënyra të ndryshme janë mbarime të formësuara të fijeve nervore, të cilat i përcjellin shqetësimet nga periferia drejt strukturave qendrore nervore. Ata mund të jenë të furnizuar edhe me krijime speciale që sigurojnë qasje të ngacmimeve, siç është rasti tek organet e ndijimit të të parit, të dëgjimit dhe tek disa organe të tjera të ndijimit.

Nga numri i madh i organeve të ndijimit të organizmit të njeriut, më hollësisht do t'i përshkruajmë vetëm ato që gjejnë shprehje sidomos në praktikën profesionale të pjesëtarëve të armatës. Ato janë: organi i të pamrit, të dëgjimit, të pozitës dhe të lëvizjes, organi kinestetik dhe organi taktil i ndijimit.

**Organi ndijues i të parit** . Sipas disa vlerësimeve rreth 90% nga të gjitha të dhënat nga rrethina njeriu i merr me anë të të parit. Për këtë arsye organi i ndijimit të të parit konsiderohet më i rëndësishmi për orientimin e njeriut në rrethinë të drejtpërdrejtë dhe për orientimin e tij në praktikën profesionale. Kjo është e theksuar sidomos tek pjesëtarët e armatës, aktiviteti i gjithmbarshëm i të cilëve është i lidhur me funksionin e të parit.



Syri mund t'i regjistrojë valët elektromagnetike të distancë prej afro 400 deri 750 milimikronësh që u përgjigjet ngjyrave të spektrit nga e vjollca deri te e kuqja. Pjesa periferike e organit të ndijimit të të parit është aparat mjaft kompleks, që mundëson marrjen e ngacmimeve të dritës në kushte të caktuara. Mollëza e syrit i merr dhe me ndihmën e thyerzës bën thyerjen e dritës, ashtu që objekti bie në vendin më të ndjeshëm në retinë. Retina përmban elemente që janë të ndjeshme në dritë. Ato elemente janë dy lloje të qelizave të specializuara nervore (të ndijimit) : shkopinjte dhe konet, që funksionojnë në kushte të ndryshme të shikimit. **Konet** gjenden në qendër të retinës. Ata gjatë dritës reagojnë në valët elektromagnetike të gjatësive të ndryshme dhe me këtë mundësojnë dallimin e ngjyrave.




Fig.6.2.-Unazat e Landoltit


**Shkopinjtë** janë të vendosur në periferi të retinës dhe hyjnë në aksion kur zvogëlohet drita e ditës. Në pjesën e tyre të jashtme gjendet substanca kimike e quajtur purpur i të parit ose rodopsin, që gjatë veprimit të dritës humb ngjyrën. Karakteristikat e rodopsinit janë në lidhje të drejtpërdrejtë me aftësinë e syrit për të shikuar natën. Rodopsini shtresohet atëherë kur syri është në errësi. Ky proces i grumbullimit të rodopsiit paraqet adaptimin e syrit për të shikuar natën. Për adaptimin e plotë të syrit nevojitet shumë kohë, por si normë praktike merren 30 deri 40 minuta. Gjatë kësaj kohe purpuri i të parit shtresohet në atë masë sa syri mund t'i dallojë gjësendet edhe në errësi. Purpuri i të parit është shumë i ndjeshëm në veprimin e dritës, prandaj vetëm një shkëlqim i dritës së ditës ose të dritës vjollce është i mjaftueshëm që të shkatërrojë plotësisht adaptimin syrit për të shikuar natën. Këtë duhet pasur parasysh gjatë ushtrimeve të natës, për të cilat është e nevojshme të përshtaten sytë dhe të ruhet ai adaptim gjatë tërë kohëzgjatjes së ushtrimit.

Përveç këtyre karakteristikave të organit të ndijimit të të parit, duhet përmendur edhe **qartësinë e të parit**. Qartësia e të parit është cilësi e syrit që t'i dallojë gjësendet e imëta. Ajo matet me madhësinë e këndit të rënies që mbulon syrin me gjësendin e vështruar. Që syri të mund t'i dallojë dy objekte, këndi i rënies nuk bën të jetë më i vogël se një minutë. Për hulumtimin e qartësisë së të parit për qëllime klinike dhe eksperimentale, përdoren unazat e Landoltit (fig. 6.2.).

Përveç qartësisë së shikimit, syri ka edhe gjerësinë e caktuar të fushës së shikimit. Me fushën e shikimit nënkuptohet hapësira që syri e përfshin njëkohësisht. Madhësia e fushës së shikimit varet nga ndjeshmëria **në dritën e periferisë së skajshme** të retinës së syrit. Ajo është më e madhja për dritën e bardhë, e zvogëlohet për të gjitha ngjyrat e tjera spektrale edhe nën ndikimin e fuqisë së gravitacionit që tejkalon madhësinë 3 G.

Sistemi Binokular, që mbështetet në ekzistimin e dy syve të vendosur në një pozitë të caktuar në kafkën e njeriut, ka domethënie të veçantë, për çka do të bëhet fjalë diçka më tepër me rastin e shqyrtimit të perceptimit të thellësisë.






**Organi i ndijimit të dëgjimit.** Organi i ndijimit të dëgjimit mund t'i pranojë dhe diferencojë tingujt frekuenca e të cilëve është prej 20 deri 20.000 vibracione në sekondë. Megjithatë, aparati i dëgjimit të njeriut është më i ndjeshmi për tingujt e frekuencës prej 2000 deri 4000 vibracione në sekondë, në të cilën distancë zëri i njeriut, instrumentet muzikore dhe tingujt e tjerë, në rastet më të shpeshta ngacmojnë veshin tonë.

Analizatori i ndijimit të dëgjimit përbëhet prej aparatit kompleks periferik detyra e të cilit është që t'i sjellë valët e zërit deri te qelizat e specializuara nervore të ndjeshme në këtë lloj të ngacmimit. Qelizat nervore, që gjenden në veshin e brendshëm, i regjistrojnë ngacmimet e zërit, i transformojnë në impulse nervore dhe i përcjellin në qendrën nervore ku paraqitet përjetimi i dëgjimit.

Ndër karakteristikat e dëgjimit duhet përmendur **ndjeshmërinë** që ndryshon varësisht nga veprimi i tingullit. Në qetësi ndjeshmëria rritet, kurse në zhurmë zvogëlohet. Nëse veshi për një kohë të gjatë u ekspozohet ngacmimeve intensive të zërit, bëhet adaptimi më i qëndrueshëm, d.m.th. dobësimi i ndjeshmërisë së dëgjimit, që ka karakter të lodhjes. Me anë të pushimit, përkatësisht shmangies së zhurmës, mënjanohet ky zvogëlim i përkohshëm i ndjeshmërisë. Mirëpo, nëse veshi për një kohë të gjatë u ekspozohet ngacmimeve shumë intensive të zërit, mund të bëhet dëmtimi i organit të dëgjimit në formë të ndryshimeve degjenerative. Ato ndryshime kanë për pasojë shurdhimin, që nuk është e mundur të mënjanohet me anë të pushimit ose me anë të çfarëdo terapie. Për këtë arsye është e nevojshme që të gjithë ata që gjatë kryerjes së punës së vet të rregullt i ekspozohen zhurmës (artiljerët, aviomekanikët, tankistët etj.), t'i shfrytëzojnë mjetet mbrojtëse kundër zhurmës, sepse në kushtet në të cilat ata punojnë është i pashmangshëm dëmtimi i dëgjimit.

Përveç ndijimit të dëgjimit, për praktikën profesionale të ushtarëve është interesant edhe fenomeni i **maskimit** të zërit. Maskimi është dukuri e shurdhimit të një toni gjatë tingëllimit të tjetrit. Kjo është e shprehur në mënyrë të pabarabartë tek tonet e frekuencave të ndryshme, kështu që tonet e intensitetit të njëjtë, e të frekuencave të ndryshme, mund të diferencohen shumë mirë, kurse tonet e frekuencës së njëjtë ose të përafërt reciprokisht maskohen. Ky fenomen është e mundur të shfrytëzohet në të gjitha ato situata kur është e nevojshme të mbetemi të pavërejtur nga ana e armikut, atëherë kur ai përgjon praninë tonë.

Efekti i **biozërit** është, gjithashtu, fenomen i dëgjimit që është me interes të madh për ushtarinë, e mbështetet në ekzistimin e dy veshëve. Në saje të dallimeve të intensitetit të zërit dhe të fazës në të cilën arrin zëri në të dy veshët, është e mundur të lokalizohet burimi i zërit.



**Fig.6.4.- Kanalet gjysmërrethore të aparatit vestibular**

**Organi i ndijimit për pozitë dhe lëvizje.** Përveç pjesës së analizatorit të ndijimit të dëgjimit, në veshin e brendshëm gjendet edhe aparati **vestibular**. Ai përbëhet prej tri kanalesh gjysmërrethor, të mbushura me lëngun që quhet endolimfë. Në muret e kanaleve gjenden qeliza ndijimi që regjistrojnë lëvizjen e endolimfës. Lëvizja e endolimfës bëhet gjatë ndryshimeve të pozitës së kokës dhe të mbarë trupit, mirëpo nëse kjo lëvizje është e ngadaltë dhe e barabartë, qelizat e ndijimit nuk janë në gjendje ta regjistrojnë lëvizjen e endolimfës, as të na informojnë për

ndryshimin e pozitës së trupit. Aparati vestibular regjistron shpejtimet dhe ngadalësimet e hovshme në lëvizjen drejtvizore dhe rrethore, dridhjen, luhatjen, si dhe ndryshimet e hovshme të pozitës. Ky aparat është i lidhur me qendrat e sistemit vegjetativ nervor, kështu që ngacmimi i tij i tepërt mund të shkaktojë pengesa në formë të mundimit, të vjelljes, të marramendjes. Pengesat e këtij lloji, të cilat në fillim të stërvitjes praktike i përjeton një numër i konsiderueshëm i pilotëve, tenkistëve, marinarëve të ardhshëm, duhet t'i atribuohen aparatit vestibular.

Përveç efekteve negative që mund të paraqiten me ndërmjetësimin e aparatit vestibular, funksioni i tij është i rëndësishëm për orientimin mbi pozitën dhe drejtimin e lëvizjes së kokës dhe të trupit në të gjitha ato situata kur forcat e jashtme (në formë të vibrimeve, të forcës centrifugale dhe centripetale) nuk veprojnë në organizëm. Përveç këmbësorëve, aparatit vestibular e shfrytëzojnë shumë edhe zhytësit, parashutistët, kurse pilotëve u bën mjaft pengesa në orientimin mbi pozitën e aeroplanit në kushte të fluturimit pa pashmëri të jashtme.

**Organi kinestetik i ndijimit.** Në caktimin e pozitës dhe të drejtimit të lëvizjes së trupit dhe në caktimin e intensitetit të lëvizjes dhe të reaksioneve të muskujve, ndihmojnë ndijimet kinestetike. Qelizat e ndijimit që regjistrojnë ndryshimet në gjendjen e muskujve, gjenden në muskuj, në glicë, ligamente dhe nyja. Ato reagojnë në çdo ndryshim në gjendjen e muskujve, lëvizjen e tyre pasive dhe aktive dhe në veprimin e forcave përkatëse në organizëm.

Ndryshimet në gjendjen e muskujve bëhen pothuaj në të gjitha situatat në të cilat ushtari kryen veprimtarinë profesionale. Gjatë gjuajtjes së këmbësorisë pozitën e armës dhe të trupit, forcën e shtypjes së këmbëzës, shenjëtari e cakton në bazë të ndijimeve kinestetike. Gjatë drejtimit të automjetit motorik (kamionit, mjeteve të blinduara, tanksës

etj), lëvizjen adekuate vozitësi e cakton në bazë të ndijimeve kinestetike. Në aeroplan bëhen ndryshime në gjendjen e muskujve nën ndikimin e shpejtimit dhe të ngadalësimit, në lëvizjen e duarve, të këmbëve dhe të mbarë trupit. Nga saktësia e të dhënave që japin ndijimet kinestetike varet, në një masë të madhe, kualiteti i aktivitetit motorik që është i pranishëm gjatë manipulimit me teknikën dhe mjetet ushtarake.


**Organi taktil i ndijimit.** Të dhënat mbi ndryshimin e pozitës së pjesëve përkatëse të trupit i marrim me anë të ndijimeve taktile, në kuadër të të cilave bëjnë pjesë: ndijimet e prekjes, të presionit dhe të vibracionit. Qelizat ndijore që janë përgjegjëse për ndjeshmërinë taktile gjenden në lëkurë dhe janë të ndjeshme në ndryshimet e presioneve që vijnë nga jashtë, si dhe në ndryshimet në shtrëngimin dhe zgjatjen e muskujve. Ngacmimet që i marrin ato qeliza ndijimi gjatë shtrëngimit dhe zgjatjes së muskujve, kanë rëndësi sekundare dhe u “ndihmojnë” të dhënave kinestetike në njohjen e ndryshimeve në pozitën e trupit. Funkzioni i tyre primar është regjistrimi i prekjes dhe i presionit që e bëjnë objektet përreth në sipërfaqen e lëkurës.

Ndijimet taktile luajnë rol të rëndësishëm në të gjitha ato situata kur duhet që, në bazë të prekjes, të njihen objektet nga rrethina. Gjatë manipulimit me mjete të ndryshme kjo gjen shprehje të duhur.

## NOCIONI DHE DEFINICINI I PERCEPTIMIT

Analizatorët e ndijimit janë mekanizma fiziologjikë që mundësojnë kontaktin me botën e jashtme. Me ndihmën e analizatorëve të ndijimit njeriu i regjistron ndryshimet që paraqiten në rrethinën e tij. Ky regjistrim bëhet me anë të ndijimeve, që shprehin karakteristikat përkatëse të strukturave objektive. Objektet dhe dukuritë, ndërkaq, nuk janë shumë e pastër e karakteristikave të tyre, as që ne i përjetojmë si grumbull i karakteristikave të tyre përkatëse. Përjetimet tona të objekteve dhe të dukurive nga rrethina janë unike dhe të tërësishme. Vetëm me analizën plotësuese të përjetimeve të tërësishme mund të vijmë deri te ndijimet, d.m.th. te karakteristikat përkatëse të objekteve dhe të dukurive. Grumbulli i karakteristikave përkatëse duhet të jetë i organizuar në mënyrë të caktuar, në mënyrë që përjetimi i tërësishëm të ketë për ne domethënie të caktuar. Të njëjtat elemente (ndijime) të renditura në mënyra të ndryshme, kanë domethënie të ndryshme në përjetimet tona. Kështu, p.sh., të njëjtat tone të kompozura në mënyra të ndryshme krijojnë melodi të ndryshme, kurse të njëjtat shkronja të renditura në mënyra të ndryshme përbëjnë fjalë dhe përmbajtje të ndryshme.

Prandaj, perceptimi mund të definohet si tërësi e organizuar ndijimi, në të cilën çdo e dhënë ndijimi ka domethënien e vet të veçantë të caktuar me tërësinë (definicioni, Z. Bujash, 1942). Ndryshimet e vendit të ndonjë të dhëne ndijimi në tërësi, mungesa ose shtesa e të dhënave të reja, ndikojnë në perceptimin e objekteve dhe të dukurive nga rrethina jonë. Kështu, katër pika në fig. 6.5. i përjetojmë si një figurë gjeometrike (katrorin), kurse me mungesën e njëres pikë nga kjo tërësi ndryshohet përjetimi dhe në fig. b përjetojmë një figurë tjetër gjeometrike (treëndëshin). Nëse këto tri pika i rendisim si në figurën c, atëherë përjetojmë një përmbajtje krejtësisht të re – linjën me pika.



**Fig. 6.5.- Ndikimi i numrit dhe i renditjes së elementeve në perceptimin e përjetimit të tërësishëm**


Me këtë karakteristikë të perceptimit, që vendosja e elementeve në tërësi cakton kualitetin e përjetimit, duhet thënë se edhe tërësia ndikon në domethënien e elementeve nga të cilat ajo përbëhet. Kështu, p.sh., ngjyra e njëjtë e kuqe në dy piktura artistike mund të ketë domethënie krejtësisht tjetër, nëse në njëren pikturë paraqitet gjaku e në tjetrën me te është ngjyrosur lulja.

Perceptimi paraqitet si reaksion psikik në shumë procese fizikale që, njëkohësisht ose në suksesion, veprojnë në organet tona të ndijimit. Me anë të tij përfshijmë formën e objekteve, meloditë, relacionet hapësinore dhe kohore, si dhe dallimet në kualitet, intensitet dhe madhësi të konfiguracioneve objektive të ngacmimeve.

### **DETERMINANTET E PERCEPTIMIT**

Hulumtimet dhe përvoja e përditshme tregojnë se perceptimi i disa objekteve ose përmbajtjeve nuk është njësoj i qartë, i saktë dhe i plotë tek personat e ndryshëm. Ato dallime në kualitet dhe në plotësinë e perceptimit paraqiten edhe tek personat e njëjtë, që perceptojnë objektet e caktuara në situata të ndryshme. Nga kjo vjen interesimi që të konstatohet se cilët faktorë determinues ndikojnë gjatë vrojtimit të botës së jashtme dhe çfarë është ndikimi i tyre. Me studimin e hollësishëm janë konstatuar tri lloje të determinanteve: fizikale, fiziologjike dhe psikologjike.

**Determinantet fizikale.** Kualiteti, qartësia dhe plotësia e perceptimit varen, në rend të parë, nga veçoritë e objekteve ose të përmbajtjeve që i perceptojmë, domethënë nga karakteristikat e proceseve fizikale dhe kimike që veprojnë në receptorët tanë. Ato karakteristika të proceseve përreth manifestohen në forma të ndryshme dhe, secili prej tyre, kontribuojnë në masë të konsiderueshme gjatë vrojtimit. **Intensiteti** i ngacmimeve është një nga faktorët që kontribuon në qartësinë e përjetimit. Ngacmimet intensive shkaktojnë ndryshime intensive fiziologjike në analizatorin e ndijimit, gjë që ka për pasojë përjetimin më të qartë të përmbajtjes që e perceptojmë. Intensiteti i ngacmimit mund të ndryshojë nga ato, që nuk janë të mjaftueshme ta shkaktojnë ndijimin, deri te ngacmimet e intensitetit shumë të madh, që në disa raste mund të shkaktojnë dëmtime të pjesës periferike të analizatorit të ndijimit. Ngacmimet e intensitetit të mesëm, për të cilat organet tona të ndijimit janë përshtatur më së miri, shprehen në mënyrën më të volitshme në qartësinë e perceptimit.



**Fig. 6.6. – Ndikimi i shkallës së organizimit në qartësinë e perceptimit**

**Kohëzgjatja** e ngacmimit. Në disa kufij të caktuar, kohëzgjatja dhe intensiteti i ngacmimit kompensohen reciprokisht. Ngacmimet e intensitetit të dobët mundën ndonjëherë të nxisin ndijimin, nëse për një kohë mjaft të gjatë ngacmojnë organin e ndijimit. Mirëpo, kohëzgjatja e ngacmimit vetëm në disa kufij kontribuon në shtimin e qartësisë së perceptimit. Nëse ngacmimi zgjatë tepër gjatë, shkaktohen të ashtuquajturat reaksionet reversibile në organin e ndijimit, me të cilat edhe indi i gjallë i kundërvihet veprimit të ngacmimit. Ato reaksione në disa fusha (dëgjimi, prekja, ngrohtë, ftohtë), bëjnë adaptimin e organit të ndijimit, që ka për pasojë zvogëlimin ndjeshmërisë e me këtë edhe qartësinë më të vogël të perceptimit.

Përveç intensitetit dhe kohëzgjatjes së ngacmimit, qartësia dhe plotësia e perceptimit varen edhe nga **shkalla e organizimit** të proceseve fizikale që veprojnë në analizatorët e ndijimit. Të dhënat e organizuara më mirë nga rrethina mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në qartësinë dhe plotësinë e perceptimit. Ky fenomen është ilustruar në fig. 6.6. në të cilën gjenden 9 pika në variantin *a* të organizuara ashtu që është e mundur me një shikim të përfshihet numri i tyre, kurse në variantin *b* janë shkapërderdhur dhe është e nevojshme shumë më tepër kohë që t'i numërojmë. Me shfrytëzimin e këtij fenomeni është e mundshme që, në një masë të madhe të përmirësohet efikasiteti i vrojtimit. Organizimi më i mirë i fushës së perceptimit mund të realizohet gjatë konstruksionit të mjeteve të ndryshme në të cilat nga tabelat komanduese lexohen të dhënat e ndryshme (p.sh.) instrumentet dhe sinjalet e dritave në kabinën e aeroplanit, llogaritësit komandues për drejtimin e armatimit altirelik, etj). Njëkohësisht organizimin më të mirë të fushës së perceptimit e me këtë edhe efikasitetin më të madh të vrojtimit mund ta arrijë ai, që sipas një sistemi të caktuar i vështrohet instrumentet, sinjalet dhe , në përgjithësi rrethinën e vet. Kështu, është konstatuar se piloti më së lehti e vlerëson distancën e aeroplanit nga toka gjatë aterimit nëse e shikon token 20-30% majtas nga boshti i gjatësisë së aeroplanit dhe 25-30 metra para hundës së aeroplanit.

Me organizimin e fushës së percepcionit nuk shterohen të gjitha mundësitë që percepcioni të bëhet më i qartë dhe më i plotë. Kësaj mund t'i kontribuohet edhe me **strukturimin** e të dhënave të ndijimit të kualitetit të ndryshëm në tërësi. Kështu një përjetim vizual mund të përjetohet në mënyrë më të qartë, më të plotë dhe më përmbajtjesore, nëse përcillet me përmbajtjen akustike. Stuhinë e borës në film, p.sh. do ta përjetojmë në mënyrë më të plotë kur përmbajtja vizuale përcillet me fishkëllimën e

erës, e ky përjetim është edhe më i plotë nëse e shikojmë filmin në një sallë të ftohtë. Nga kjo vjen rëndësia e madhe që ka muzika në film, sepse muzika përkatëse e plotëson përmbajtjen vizuale. Kjo dukuri quhet konfigurim i proceseve fizikale dhe në ushtri shfrytëzohet qoftë si mjet i luftës psikologjike, kur në aeroplan vendosen sirenat shurdhuese që e bëjnë bombardimin më të tmerrshëm sesa është në të vërtetë, qoftë anasjelltas, për maskimin e disa objekteve sekrete me përshtatjen e tyre në mjedisin ekzistues. Gjithsesi veçoritë e rrethinës, që vepron në organet tona të ndijimit, kanë ndikim shumë të rëndësishëm në qartësinë dhe plotësinë e vrojtimit.

**Determinantet fiziologjike.** Në qartësinë, saktësinë dhe plotësinë e vrojtimit ndikon edhe gjendja e analizatorëve ndijues dhe të tërë organizmit. Nëse i përjashtojmë dëmtimet dhe ndryshimet degjenerative në analizatorin ndijues, në të cilat raste bëhen deformime të përhershme gjatë vrojtimit, mbetin shumë ndryshime reversibile (retroaktive) në analizatorin ndijues që kanë ndikim të rëndësishëm në qartësinë dhe plotësinë e perceptimit. Kështu lodhja ndikon në funksionin e analizatorëve të ndijimit. Gjykuar sipas ndryshimeve që paraqiten nga lodhja, veprimi i tij në radhë të parë është i orientuar në pjesën qendrore të analizatorit të ndijimit dhe çrregullon funksionin e qendrave sensorale kortikale. Personi i lodhur ka vështërsi në të kuptuarit e domethënies së dukurive dhe të ndryshimeve, përndryshe, të njohura të mjedisit objektiv. Njeriu percepton elementet e ndonjë situatë, por nuk ka mundësi t'i sintetizojë në tërësi dhe të kuptojë domethënien e tyre reale.

Ngjashëm me lodhjen në perceptim vepron edhe **alkooli**, proporcionalisht me shkallën e marrjes së alkoolit. **Sëmurjet dhe droga**, që ndikojnë në statusin e përgjithshëm fiziologjik të organizmit, shprehen negativisht edhe në gjendjen funksionale të analizatorëve të ndijimit, e me këtë ndikojnë në mënyrë të pavalitshme edhe në kualitetin e perceptimit.

**Determinantet psikologjike.** Përveç gjendjes fiziologjike të analizatorit të ndijimit dhe të tërë organizmit, në vrojtimit ndikojnë edhe një varg veçorish psikologjike të personit që bën perceptimin. Edhe pse ky ndikim nuk është aq i drejtpërdrejtë, si te determinantet fiziologjike, ai është shumë i rëndësishëm. Ndër faktorët psikologjikë, ndikimin më të rëndësishëm në perceptim e kanë: përvoja, përshtatja e perceptimit, inteligjencia, emocionet, motivacioni dhe kujdesi.

**Përvoja** vepron në perceptim në dy mënyra, edhe pse në të dy rastet pozitivisht. Përvoja, në vend të parë, i bën të mundshëm subjektit që ta njohë ndonjë objekt ose përmbajtje vetëm në bazë të një numri të vogël të të dhënave. Kështu, p.sh., inxhinieri me përvojë me një shikim do t'i vlerësojë vendet kritike në urën në të cilën duhet të vendoset eksplozivi, në mënyrë që rrënimi i urës të jetë i suksesshëm. Përvoja vepron edhe në atë drejtim që lehtëson vërejtjen e ndryshimeve që bëhen në ndonjë situatë komplekse. Kështu, p.sh., vëzhguesi me përvojë më lehtë do t'i vërejë ndryshimet që janë bërë në ndonjë terren për shkak të ndërtimit të objekteve të reja, sesa fillestari. Vëzhguesi me përvojë e njeh më herët terrenin dhe çdo ndryshim në të e përjeton si risi, kurse fillestari e mëson at terren bashkë me ndryshimet, d.m.th. edhe ndryshimet i përjeton si një nga karakteristikat e përhershme të terrenit.

Shkurtimisht, përvoja përfshin në perceptim dijen, dhe kjo bën të mundshëm përjetimin më të plotë. Në sajë të përvojës perceptimi merr një kuptim të caktuar, kurse

nga përvoja varet se sa të dhëna janë të nevojshme nga një situatë e caktuar në mënyrë që për te të kemi përjetimin e plotë.

Në perceptim ndikon edhe **përshtatja perceptivë**, d.m.th. pritja ose bindja paraprake se diçka do të ndodhë. Përshtatja perceptivë mund të ndikojë pozitivisht dhe negativisht në perceptim. Veprimi pozitiv është atëherë kur në rrethinën tonë paraqiten ngjarjet që janë në pajtim me parashikimet tona, e negative, kur kjo është e anasjelltë.

Në perceptim ndikon shumë edhe inteligjenca, në ato raste kur elementet e situatës së perceptimit nuk janë strukturuar në tërësi të cilat që më herët kanë përmbajtur të njohur ose të qartë. Në situatat e tilla paraqiten diferenca mjaft të mëdha në perceptim midis individëve, që mund t'iu mvishen diferencave në intelegjencinë e tyre.

Ndikim shprehimisht negativ në perceptim kanë **emocionet**. Ato janë, zakonisht, shkak jo vetëm i perceptimit jo të plotë, por edhe të deformacioneve në perceptim sepse, zakonisht, shkaktojnë përshtatjen e gabueshme perceptivë.

**Motivimi**, gjithashtu, ndikon në perceptim. Ky ndikim pasqyrohet në dukurinë që nevojat, dëshirat dhe parashikimet të kontribuojnë në seleksionimin e caktuar të ngacmimeve, në organizimin e tyre përkatës në tërësi dhe në interpretimin e atyre tërësive. Hulumtimet kanë treguar se tek të uriturit rritet ndjeshmëria e nuhatjes së ushqimit. Fëmijët e prindërve të varfër në SHBA i perceptojnë pjesët e parave metalike më të mëdha sesa fëmijët e prindërve të pasur, sepse për të varfrit para ka vlerë më të madhe sesa për të pasurit.

Ndikim të rëndësishëm në perceptim ka edhe **vëmendja**. Vëmendja nuk është kategori e veçantë e jetës psikike, siç mendojnë disa, por përqendrim i vetëdijes dhe i aktivitetit tonë në përmbajtjen dhe objektin e caktuar. Prandaj, vëmendja ndikon pozitivisht në perceptim, ashtu që perceptimi është më i qartë dhe më i plotë sa më intensive që të jetë vëmendja. Mirëpo, kjo ligjshmëri nuk vlen në të gjitha rastet për shkak të karakteristikave të vëmendjes. Njeriu në një moment mund ta përqëndrojë vëmendjen vetëm në një numër të kufizuar të dhënash. Volumi i vëmendjes së tij për këtë arsye është i kufizuar. Me shtimin e numrit të të dhënave që duhet të përcillen njëkohësisht, dobësohet intensiteti i vëmendjes. Shumë situata kërkojnë, pikërisht, që njëkohësisht ose në një suksecion të afërt, të përcillet dhe perceptohet një numër më i madh objektesh. Ndonjëherë numri i atyre objekteve rritet në atë masë sa kalon vëllimin e vëmendjes së njeriut. Në rastet e tilla suksesi i perceptimit varet nga lëvizshmëria e vëmendjes, që në të vërtetë është aftësi e kalimit të shpejtë të vëmendjes nga një përmbajtje në tjetrën. Lëvizshmëria e madhe e vëmendjes mundëson që perceptimi të jetë i plotë edhe në situatat që përmbajnë një numër më të madh objektesh, sepse në mënyrë indirekte rrit vëllimin e saj.

Koncentrimi i vëmendjes, gjithashtu është karakteristikë që ndikon në efikasitetin e perceptimit. Orientimi vëmendjes në ndonjë përmbajtje ose aktivitet, do të thotë angazhimi i organeve tona të ndijimit dhe të tërë organizmit në një drejtim të caktuar. Edhe pse koncentrimi i vëmendjes kontribuon përgjithësisht në perceptimin më të mirë, koncentrimi i tepërt mund të jetë edhe i dëmshëm, sepse me rritjen e tij zvogëlohet lëvizshmëria e saj, gjë që zakonisht ndikon negativisht në plotësinë e perceptimit.


Në këtë mënyrë kemi shtuar shumicën e faktorëve psikologjikë që ndikojnë në kualitetin, saktësinë dhe plotësinë e vërtetimit. Nga kjo shihet se perceptimi nuk është proces i izoluar, që zhvillohet pavarësisht nga proceset e tjera psikologjike, por ai është nën ndikimin e gjendjes fiziologjike dhe fizike, por edhe psikike të njeriut që vërtet.

## ILUZIONET

Determinantet fizikale, fiziologjike dhe psikologjike ndikojnë në qartësinë, plotësinë dhe saktësinë e perceptimit. Ky ndikim mund të jetë pozitiv ose negativ. Ndikimi negativ i ndonjërës nga determinantet ose të disave prej tyre, mund t'i nxisë mashtrimet sensoriale që i quajmë iluzione. Iluzionet janë, në të vërtetë, perceptime të gabueshme. Ato mund të nxiten nga këta faktorë: me renditjen e pavolitshme dhe organizimin e pavolitshëm të ngacmimeve nga mjedisi (determinantet fizikale), me gjendjen e pavolitshme fiziologjike të organeve të ndijimit dhe të tërë organizmit (determinantet fiziologjike) ose me ndikimin negativ të proceseve përkatëse psikike dhe të veçorive të individëve (determinantet psikologjike).

Ka shumë iluzione dhe dallohen sipas shkaqeve të paraqitjes dhe të situatave në të cilat paraqiten më së shpeshti.

Ndër iluzionet që shkaktohen me determinantet fizikale, përkatësisht me renditjen dhe organizimin e pavolitshëm të ngacmimeve nga rrethina është i njohur në fushën e të parit një numër i madh i të ashtuquajturave iluzioneve gjeometrike. Ato manifestohen në vlerësimin e gabuar të madhësisë së figurave gjeometrike të organizuara në mënyra të ndryshme. Kështu, vijat në fig. 6.7. *a* i vlerësojmë me gjatësi të ndryshme, edhe pse gjatësia e tyre është plotësisht e njëjtë. I njëjti rast është edhe me figurat në fotografitë *b*, *c*, *d*, ku të dyja vijat janë në qift dhe bazat e katrorëve janë plotësisht të madhësisë të njëjtë, por ne i përjetojmë si të ndryshme për arsye se secila prej tyre është e organizuar në mënyrë të ndryshme.



**Fig. 6.7. – Iluzionet vizuale**

Nga iluzionet që janë shkaktuar me anë të determinanteve fiziologjike është i njohur iluzioni optik – kinestetik i Sharpanties (*Charpentie*). Ai manifestohet në nënçmimin e peshës së trupave me vëllim të vogël, përkatësisht mbiçmohen peshat e trupave me vëllim të madh. Gjithashtu është i njohur iluzioni taktil – kinestetik i Aristotelit, që e përjetojmë atëherë kur e kryqëzojmë gishtin e mesëm dhe gishtin tregues, dhe në mes tyre vendosim një kokër bizele (ose lapsin). Atëherë objektin që gjendet midis dy gishtërinjve e përjetojmë sikur të ishin dy objekte, për shkak të përvojës



prekëse dhe kinestetike që me pjesët e jashtme të gishtërinjve gjithmonë t'i prekim dy objekte.

Iluzione të shkaktuara me determinantet psikologjike ka shumë, dhe ato janë aq më të shpeshta dhe më të rënda sa më i pavolitshëm që të jetë ndikimi i determinantes psikologjike. Për arsye se ato shkaktohen me karakteristikat personale të individëve, që në situata të ndryshme gjejnë shprehje në mënyra të ndryshme, janë jotipike dhe individuale dhe paraqesin çdo deformim të perceptimit që shkaktohet, kryesisht, nga faktorët psikologjikë.

## NDARJA E PERCEPTIMEVE

Sipas llojit të përmbajtjes që vështrojmë perceptimet mund ti ndajmë në receptim të hapësirës dhe perceptim të kohës. Perceptimi i hapësirës është proces i ndërlikuar, i përbërë nga perceptimi i disa dimensioneve të ndryshme nga të cilat përbëhet hapësira: forma, madhësia, pozita e objektit, largësia dhe thellësia. Perceptimi i secilit prej atyre dimensioneve është i mundur me ndihmën e çelësave të ndryshëm.





Figura 6.8 Grupimi i elementeve në tërësi

**Perceptimi i formës.** Format e objekteve i përjetojmë, në radhë të parë, në saje të fotografisë që projektohet në retinë e syrit tonë. Thjerëza, nëpër të cilën kalon drita e objektit, i then rrezet e dritës ashtu që figura e anasjelltë e objektit bie në pjesën më të ndjeshme të retinës. Në saje të përvojës së fituar nën ndikimin e gravitacionit të Tokës gjatë zhvillimit individual të çdo individi, ne në vetëdije orientojmë pozitën e objektit në raport me fuqinë e gravitacionit dhe e përjetojmë ashtu siç ai gjendet në natyrë. Në perceptimin e formës, ndërkaq, përveç karakteristikave fiziologjike të syrit dhe të përvojës sonë, sipas Verthajmerit (*Wertheimer*) marrin pjesë edhe karakteristikat e objektit që ai i quan kritere të lehtësisë në perceptim. Verthajmer cek një varg faktorësh të rëndësishëm për perceptimin e formës. Faktori i **afërsisë** (në fushën e të parit) – pikat që janë të afërta shihen lehtë si grupe; faktori i **njëjtësisë** ose i ngjashmërisë –

pikat e të njëjtës ngjyre ose formë i përjetojmë si grupe; **fati i përbashkët** - pikat që lëvizin së bashku në të njëjtin drejtim, përjetojnë lehtë si grupe; **kontinuiteti** – ose forma e mirë, ka të bëjë me simetrinë ose baraspeshën e tërësisë së figurës; **përshtatja momentale** - ka të bëjë me formën e mirë ose simetrinë, por sipas përshtatjes momentale, dhe **përvoja** - ose shprehia në përjetimin e formës, që kontribuon në përjetim. Disa prej këtyre kritereve janë ilustruar në fig. 6.8.




**Fig.6.9.- Perceptimi i madhësisë së objekteve**

**Perceptimi i madhësisë.** Përjetimi i madhësisë së objektit sqarohet nga këndi i disa faktorëve. Në rend të parë me madhësinë e fig. në retinën e syrit, si një nga çelësat fiziologjik. Ndër çelësat fiziologjik bën pjesë edhe interpretimi, e ashtuquajtura teoria e lëvizjes së syve që sqaron se përshtypja e madhësisë së objektit fitohet me lëvizjen e syve përgjatë objektit që e perceptojmë. Kjo do të thotë se mbështetemi në të dhënat kinestetike që paraqiten gjatë lëvizjeve të syve. Nga faktorët psikologjikë ceket përvoja që e shfrytëzojmë gjatë caktimit të madhësisë së objekteve të panjohura në bazë të madhësisë së objekteve të njohura. Përvoja na ndihmon edhe gjatë vlerësimit të madhësisë së objekteve të larta që, për shkak të largësisë, duken iluzorisht më të vogla. Kjo është ilustruar në fig. 6.9.

**Perceptimi i pozitës së objekteve.** Pozitën e objekteve e caktojmë në raport me trupin tonë: mbi – nën, djathtas – majtas, para – prapa. Gjatë përjetimit të pozitës së objektit merr pjesë projeksioni i objektit në retinë, por për caktimin e pozitës janë përgjegjës, në rend të parë, ndijimet kinestetike, që na informojnë për pozitën e trupit tonë dhe lëvizjet me të cilat ndryshohet domethënia: para – prapa, mbi – nën etj.

**Perceptimi i largësisë.** Kur është fjala për objektet e njohura, me ç’ rast mund të shfrytëzojmë përvojën, në perceptimin i lartësisë kontribuon projeksioni i objektit në retinën e syrit. Kur është fjala për objektet e panjohura, ato i krahasojmë me objektet e njohura dhe, në bazë të madhësisë, vlerësojmë largësinë.

**Perceptimi i thellësisë.** Procesi i perceptimit të thellësisë bashkon shumë faktorë që përmbahen në perceptimin e formës, të madhësisë, të pozitës së objektit dhe të largësisë. Ka zgjatur shumë mosmarrëveshja midis filozofëve dhe hulumtuesve lidhur me atë se si retina e syrit në të cilën projektohet figura dydimensionale mund të regjistrojë dimensionin e tretë të hapësirës. Sot është e qartë se gjatë shikimit të thellësisë shfrytëzohen disa mekanizma të njëjtë si edhe tek figurat dydimensionale, por aty paraqitet shikimi në largësi dhe në afërsi, me ç’ rast bëhen ndryshime konstante në funksion të organit të ndijimit të të parit. Gjatë perceptimit të thellësisë shfrytëzohen dy grupe çelësash: çelësat monokularë dhe çelësat binokularë.




**Fig.6.10.- Perspektiva lineare**

Çelësat **monokularë** kontribuojnë në perceptimin e thellësisë kur ajo është e kufizuar në funksionin e një syri. Në këtë rast gjejnë shprehje karakteristika të ndryshme të rrethinës, të cilat kontribuojnë në të vërejturit e dimensionit të tretë të hapësirës. Një nga ato karakteristika është perspektiva **lineare**, që paraqitet si pasojë e zvogëlimit të këndit të rënies nën të cilin i shikojmë objektet me rritjen e largësisë së tyre. Këndi i rënies nën të cilin e shikojmë objektin zvogëlohet linearisht nga largësia, gjë që krijon përshtypjen e perspektivës lineare. Perspektiva e **dritës** manifestohet në qartësinë me të cilën shihen

objektet e larta. Gjatë dukshmërisë së dobët objektet duken më shumë të larguar sesa gjatë dukshmërisë së mirë (pas furtunës kur ajri është i spastruar nga pluhuri, tymi dhe kristalet që i thyejnë rrezet e dritës). **Hijet** tregojnë drejtimin e ardhjes së dritës dhe theksojnë reliefin e objektit, sepse janë të gungëzuara objektet më të ndritshme, kurse të thelluara objektet më të errëta, gjë që krijon përjetimin e thellësisë. **Mbulimi i objektit** është, gjithashtu, një nga faktorët që ndihmon në dallimin e thellësisë, sepse objektet më të afërta i mbulojnë ato më të largëta dhe kjo bën të mundshëm të caktojmë pozitën e tyre reciproke.

Përveç një vargu çelësash monokularë lidhur me karakteristikat e rrethinës që e perceptojmë, konsiderohet se në përjetimin e thellësisë kontribuon vështirimi i objektit kur gjendemi në lëvizje. Gjatë lëvizjes kemi përshtypje se objektet e largëta udhëtojnë bashkë me ne, për shkak të shpejtësisë së vogël të këndit në raport me to dhe, anasjelltas, objektet e afërta lëvizin në drejtim të kundërt. Kjo dukuri e lëvizjes iluzore e objekteve të largëta dhe të afërta krijon përshtypjen e thellësisë.

Çelësat **binokularë** mbështeten në ekzistencën dhe funksionin e dy syve. Gjatë vështirimit të objektit figura e objektit projektet në të dy sytë. Ato dy figura dallohen, se me syrin e majtë e përfshijmë objektin më tepër nga ana e majtë, kurse me syrin e djathtë më tepër nga ana e djathtë. Ato figura, gjithashtu, bien në vende të ndryshme në retinën e syrit të majtë dhe të djathtë. Me fuzionin e atyre dy figurave paksa të ndryshme, krijohet përjetimi i dimensionit të tretë, d.m.th. përjetimi i thellësisë. Gjatë shikimit me të dy sytë paraqitet fenomeni i pamjes stereoskopike e njohur nga fizika, ku



**Fig.6.11.-Parimi i të pamit stereoskopik**

me fuzionin e dy figurave të incizuara me dy kamera dhe disparative, krijohet përjetimi i thellësisë.

Roli i shikimit binokular ka rëndësi të pakompensueshme për perceptimin e thellësisë në të gjitha ato raste kur bien çelësat monokularë që ndihmojnë në të vërejturit e dimensionit të tretë. Kjo ndodhë natën, kur humbin të gjitha ato cilësi të rrethinës objektive që lehtësojnë të vërejturit reliefit.

**Perceptimi i kohës.** Deri më tash nuk ka interpretim unik lidhur me atë se si e perceptojmë kohën. Një grup autorësh konsideron se baza e përjetimit të kohës është kohëzgjatja dhe rrjedha e procesit në strukturat nervore, që shprehen edhe në punën e të gjitha organeve të rëndësishme për jetën. Proceset e organeve vitale të organizmit zhvillohen në një ritëm të caktuar dhe kjo krijon orientimin në kohë. Sipas kësaj shfrytëzohen çelësat fiziologjik në perceptimin e kohës.

Mirëpo, ka autorë që sqarojnë përjetimin e kohës me anë të çelësave psikologjikë. Njeriu posedon kapacitete të caktuara, të cilat i mundësojnë që në njësinë e caktuar të kohës t'i kryejë disa punë: të punojë një numër të caktuar prodhimesh ose të lexojë një numër të caktuar faqesh. Kontrolli mbi efektin e aktivitetit të punës i mundëson njeriut orientimin në kohë. Verifikimin për këtë interpretim e gjejmë në dukurinë kur mungojnë këta çelësa, në rastin kur njeriu qëndron në birucë, bëhet dezorientimi në kohë. Mirëpo njëkohësisht, përjetimi mbi kohëzgjatjen e intervaleve kohore kushtëzohet edhe me numrin dhe ngjarjet interesante. Numri më i madh i ngjarjeve krijon përshtypjen

e kohëzgjatjes më të madhe në të kaluarën, e më të vogël në të tashmen. Nëse ngjarjet që na rrethojnë janë interesante, koha kalon shpejt.

Për arsye se shpeshherë bëhet çrregullimi në ritmin e aktiviteteve të njeriut dhe ndryshimi në ndikimin e disa çelësave, njeriu shfrytëzon orën, kalendarin etj. dhe me anë të tyre orientohet në kohë.

## KAPTINA 10.

### TË MENDUARIT

Dikur konsiderohej se proceset e brendshme mendore është e mundur të sqarohen vetëm me vetëvështrimin dhe me introspeksion. Në këtë drejtim i ka zhvilluar metodat e veta një grup psikologësh në Vizburg, me përfaqësuesit: Killpe (*Kiilpe*), Marbe (Marbe). Ash (Ach) dhe të tjerë, orientimi i të cilëve, për shkak të metodës të introspeksionit, është quajtur shkolla introspeksioniste. Përfaqësuesit e asaj shkolle i kanë shfrytëzuar në eksperimentet e tyre të hulumtuarit e trajnuar, studentët e psikologjisë dhe të filozofisë, të cilëve u kanë dhënë për detyrë të përcjellin përmbajtjen e mendimeve të veta gjatë sqarimit të problemeve të dhëna. Me gjithë pastërtinë shkencore, me të cilën përfaqësuesit e shkollës introspeksioniste i janë qasur studimit të të menduarit, baza themelore në qasjen ndaj objektit të hulumtimit ka qenë e gabuar, e edhe vetë metoda introspeksioniste nuk ka ofruar mundësinë e depërtimit në natyrën e proceseve mendore. Introspeksionistët e kanë definuar psikologjinë si “shkencën mbi vetëdijen”, e të mos kenë qenë në gjendje të caktojnë nocionin e vetëdijes.


Mundësia e depërtimit në natyrën e të menduarit me anë të metodës së vetëvështrimit del nga karakteristika e kësaj metode. Gjatë vetëvështrimit të proceseve vetanake mendore domosdo bëhet ndarja e personalitetit në vështrues dhe në të vështruar, gjë që vetvetiu pengon rrjedhën normale të proceseve mendore. Nëse shmanget ndarja e proceseve psikike në atë mënyrë që në mënyrë retrograde (prapa) i hulumtuari vështron rrjedhën e mendimit, atëherë introspeksioni kufizohet në retrospeksion, që deformon procesin e të menduarit në raport me rrjedhin e mendimit kur ai zhvillohet në procesin e zgjidhjes së problemit. Mirëpo, edhe atëherë kur me anë të introspeksionit dhe të retrospeksionit do të mund të përfshiheshin të gjitha elementet qenësore të proceseve mendore, me këto metoda nuk arrihet ajo e nënvetëdijshmja që ekziston në procesin e të menduarit, gjë që është pjesë përbërëse e këtij procesi.

**Matjet fiziologjike.** Metodës introspeksioniste, si metodë e skajshme subjektive për studimin e procesit të të menduarit, me të cilën janë bërë përpjekje të përfshirjes së drejtpërdrejtë në esencën e këtij procesi, i kundërvihet një grup metodash objektive dhe indirekte që gjenden në ekstremin tjetër në qasjen e studimit të procesit të të menduarit. Këto metoda mundësojnë përfshirjen e ndryshimeve manifestuese në organizëm që paraqiten në procesin e të menduarit.

Një nga ato metoda konsiston në matjen e lëvizjeve të muskujve që e përcjellin aktivitetin mendor. Është dëshmuar, pra, se rrjedha e mendimit përcillet me ndryshimet në gjendjen e muskujve, që në një masë të caktuar janë në pajtim me përmbajtjen e proceseve mendore. Kështu, p.sh, nëse i hulumtuari shtrihet i qetë dhe me atë rast paramendon se po e ngritë dorën e djathtë, në muskujt e dorës së djathtë mund të regjistrohen ndryshime që për nga natyra e vet janë të afërta me ndryshimet në muskuj që bëhen gjatë ngritjes reale të dorës. Proceset mendore përcillen edhe me mimikën karakteristike të fytyrës, dhe shprehen në pozitën e trupit dhe në gjendjen e muskulaturës së tërë organizmit, prandaj nga kjo del përpjekja që me hulumtimin e komponentës motorike të proceseve mendore të bëhen përpjekje për të depërtuar në natyrën e rrjedhës së tyre dhe në përmbajtjen e tyre.

**Matja e aktivitetit elektrik të trurit.** Metoda tjetër e qasjes indirekte në procesin e të menduarit, konsiston në matjen e aktivitetit elektrik të trurit, të kësaj qendre më të lartë integrative në të cilën zhvillohen edhe proceset mendore) me incizimin e ritmeve elektrike ose të rrymave të aksionit. Çdo gjendje e aktivitetit të organizmit: gjumi – zgjuarësia, aktiviteti – pasiviteti relativ, ka një ritëm karakteristik me të cilin zhvillohet aktiviteti elektrik i trurit. Kjo i ka shtyrë hulumtuesit që, me hulumtimin e karakteristikave të aktivitetit elektrik të trurit, të përpiqen të depërtojnë edhe në përmbajtjen e aktivitetit të tij, në radhë të parë të atij mendor, që është më pak manifestues se proceset e tjera psikike.

Si rezultat i këtyre hulumtimeve janë definuar tipat e ritmeve që zhvillohen varësisht nga lloji i aktivitetit, atëherë kur truri është në gjendje normale, dhe janë



**Fig. 7.1.- Rrymat aksionale të trurit**

konstatuar ndryshime karakteristike të ritmeve atëherë kur është i pranishëm çrregullimi në funksionin e trurit që paraqitet për shkak të ndryshimeve patologjike në strukturë. Më shumë se kaq, kjo metodë, nga e cila në fillim është pritur shumë, nuk ka shkuar në drejtim të studimit të përmbajtjeve të proceseve psikike,

Shkurtimisht, matjet fiziologjike të aktivitetit muskular dhe elektrik të trurit kanë ofruar të dhëna mbi llojin e vet, por jo edhe për përmbajtjen e të menduarit dhe natyrën e proceseve mendore.

**Zgjidhja e problemit.** Në kohë të fundit studimit të natyrës së të menduarit i qasemi nga një bazë krejtësisht tjetër. Nisemi nga rrjedha e njohur e të menduarit dhe vështrohet sjellja e individit, dmth. eksperimentuesi vështron dhe matë sjelljen e individit që është si pasojë e rrjedhës së caktuar të të menduarit. Të hulumtuarit vihen para problemit për zgjidhjen e të cilit është e nevojshme rrjedha e njohur e mendimit. Problemi është kufizuar në disa elemente të njohura, që paraqesin fazat e proceseve

mendore. Me përcjelljen e sjelljes së të hulumtuarit gjatë zgjidhjes së problemit të tillë, është e mundur të konkludohet për fazat e të menduarit gjatë zgjidhjes së tij. Problemi para të cilit e vejmë të hulumtuarin mund të përmbajë disa zgjidhje që kërkojnë forma të ndryshme të të menduarit, madje edhe nivel të ndryshëm të proceseve mendore. Në bazë të zgjedhjes së zgjidhjes konkludojmë për rrjedhjen e proceseve mendore të hulumtuarit.

Kjo vënie e të hulumtuarve para problemeve dhe vështirimi i sjelljeve të tyre, mundëson përcjelljen e procesit të të menduarit në mënyrën që ka vlerën e caktuar objektive. Qasja e këtillë është më pak indirekte se matjet fiziologjike, dhe me te përfshihet në mënyrë më të drjetëpërdrejtë rrjedha dhe natyra e proceseve mendore.

**Definicioni i të menduarit.** Qasja në procesin e të menduarit me anë të zgjidhjes së problemit ka bërë të mundshëm njohjen e natyrës së këtij procesi. Përkundër fshehtësisë së tij, procesi i të menduarit ndërlidhet në procesin e njohjes së realitetit përreth që e arrijmë me anë të vëzhgimit. Mendimi bën të mundshëm njohjen më të plotë të realitetit përreth dhe orientimin më të suksesshëm në situata të reja. Me anë të mendimit kuptohen raportet midis dukurive të vështtruara dhe konkludohet për domethënien e tyre. Për këtë arsye përmes procesit të të menduarit njihet në mënyrë më të plotë rrethina objektive dhe është i mundshëm orientimi më i suksesshëm në te.

**Në bazë të kësaj mund të definojmë të menduarit si proces psikik me anë të të cilit zbulojmë karakteristikat qenësore të gjërave dhe të dukurive dhe i kapim raportet e tyre reciproke.**

## **KARAKTERISTIKAT E PROCESIT TË TË MENDUARIT**

Në krahasim me proceset e tjera psikike, në radhë të parë me perceptimin, të menduarit ka disa karakteristika specifike. Derisa në perceptim operojmë me karakteristikat konkrete dhe elementet e gjërave dhe të dukurive nga rrethina jonë, në të menduarit largohemi nga kjo dhe operojmë me karakteristika të kontraktuara domethënien e të cilave duhet ta mësojmë. Derisa në perceptim i shfrytëzojmë format, madhësitë, raportet hapësinore dhe kohore dhe karakteristikat e tjera të objekteve në të menduar shërbejmi me simbole që për ne kanë domethënie të caktuar të kontraktuar. Ato simbole mund të jenë verbale, në formë të fjalëve dhe të numrave, ose në formë të disa shenjave që shënojnë dukurinë, situatën, ndalimin etj. Kështu, p.sh. fjala **pushkë** simbolizon një lloj arme dedikimi i së cilës është i njohur për çdo ushtar, kurse drita e kuqe mund të jetë “stop”, që detyron për sjellje të caktuar. Fjalët paraqesin simbole, në




Fig.7.2.-Krijimi i kuptimeve

të cilat janë të kodenzuara shpeshherë karakteristikat më themelore të objekteve dhe të dukurive. Në këtë rast fjalët shënojnë kuptimet. Kuptimet janë kategori në të cilat përmbahen karakteristikat e përgjithshme dhe të përbashkëta të gjërave dhe të dukurive. Ato mund t'i paraqesin objektet konkrete veçoritë e të cilave përmbahen në disa karakteristika konkrete, siç është rasti me pushkën. Veçoritë qenësore të pushkës janë se me atë mund të gjuhët dhe se paraqet armën themelore të ushtarit. Ndërkaq, kuptimet mund t'i shënojnë edhe dukuritë, gjendjet, ndjenjat dhe disponimet, si, p.sh. krenaria, shoqërimi, respektimi, martesë etj. Që të vihet deri te ndonjë kuptim, është e nevojshme, së pari të apostrohohen veçoritë e paqenësishme të gjërave dhe të dukurive, dhe kjo ndihmon t'i zbulojmë karakteristikat e tyre të përbashkëta dhe të qenësishme, me gjeneralizimin e të cilave vijmë deri te kuptimi. Kështu, në fig. 7.2. , shohim se figurat 1,4,6, dhe 8, që dallohen në mes veti për nga forma, kanë karakteristikë të përbashkët se te dy pikat gjenden brenda figurës, dhe kjo është karakteristikë qenësore në raport me fig. 2,3,5 dhe 7, që kanë një pikë brenda, e një pikë jashtë figurës.

Vebster (*Webster*) konsideron se të menduarit është një varg simbolesh që paraqesin kuptimet, dhe të cilat renditen sipas disa parimeve të caktuara. Mirëpo, do të ishte e gabueshme të kuptohet se të menduarit zhvillohet, kryesisht, në formë të vargut të simboleve që shënojnë kuptime të caktuara, konkrete. Procesi mendor na ndihmon që të vijmë deri te kuptimi për ndonjë gjë ose dukuri, d.m.th. të zbulojmë cilat janë veçoritë e tyre të përbashkëta dhe të qenësishme.

Janë tri momente karakteristike në procesin e të menduarit: operimi me simbole, orientimi i procesit dhe kuptimi i raporteve. **Operimi** me simbole (ose me perceptime, parafytyrime, fjalë, nocione dhe rezultate të tjera të përvojës) na sjellë deri te njohja e caktuar, që shënon zgjidhjen e problemit.

**Orientimi** i procesit të të menduarit nënkupton mënyrën e qasjes ndaj problemit, d.m.th. lokalizimin e problemit sipas vendit që fsheh zgjidhjen e mundshme. Nga ajo se në ç'mënyrë e shohim problemin, ku e vërejmë vështirësinë, varet në një pjesë të madhe zgjidhja e problemit.

Momenti i tretë është të **kuptuarit** e raporteve. Me anë të të menduarit konstatojmë se a është diçka ose s'është, a është e ngjashme ose e ndryshme, a është në raport të caktuar ose nuk është, domethënë konstatojmë disa lidhje dhe raporte. Të kuptuarit e ndonjë përmbajtjeje (teksti), do të thotë të dallohen lidhjet që më parë nuk i kemi pasur të njohura. Për shkak të dallimit të lidhjeve të reja, me anë të të menduarit fitojmë më shumë në vështrim të njohjes sesa me anë të perceptimit, prandaj të menduarit konsiderohet si proces më i lartë intelektual.



## LLOJET E TË MENDUARIT

**Ndarja e të menduarit duke pasur parasysh llojin e simboleve me të cilat operohet.** Varësisht nga lloji i materialit me të cilin operojmë, të menduarit mund ta ndajmë në konkret dhe abstrakt. Me të menduarit **konkret** nënkuptojmë proceset mendore në të cilat, në radhë të parë, shfrytëzojmë perceptimet dhe reproduksionet e tyre, pra, me elemente konkrete të ndonjë situatë të caktuar. Të shumtë janë ata që këtë formë të të menduarit e quajnë të menduar perceptiv, për shkak të konkretësisë së elementeve me të cilat operohet.

Të menduarit **abstrakt** karakterizohet me faktin që shfrytëzohen simbolet e kuptimeve abstrakte me të cilat operojmë gjatë të menduarit. Me kuptimet abstrakte nënkuptohen dukuritë me të cilat operon njeriu si me kategori të vlefshme ose të rëndësishme, por që nuk janë të kapshme dhe të matshme në relacionet perceptive. Kuptimet abstrakte janë pa dimensione dhe ato, vetvetiu, janë fryt i proceseve mendore. Për arsye se kuptimet abstrakte nuk janë të arritshme për vëzhgim dhe nuk i nënshtrohen përputhjes në ndonjë situatë perceptiv, të menduarit abstrakt konsiderohet formë më e lartë e të menduarit se të menduarit konkret. Kjo është formë më e lartë e të menduarit edhe për arsye se këtu kryesisht operohet me simbole, gjë që nuk është rast në të menduarit konkret.

**Ndarja e të menduarit duke pasur parasysh dobinë e produkteve të tij.** Definicioni i të menduarit nënkupton që çdo mendim rezulton me ndonjë produkt, që konsiston në zgjidhjen problemit ose në ndonjë njohje të re. Mirëpo, nëse përpiqemi të përfshijmë në mënyrë introspektive të menduarit, do të shohim se ka edhe të menduar të tillë që nuk rezulton me kurrfarë përvojë.

Mirëpo, në procesin e të menduarit, ne, zakonisht, zbulojmë diçka të re, diçka që deri më atëherë nuk e kemi ditur, dhe vijmë deri te njohjet të reja. Në këtë rast bëjmë fjalë për të menduarit **produktiv**. Të menduarit produktiv domosdo nënkupton ndonjë rezultat në formë të zbulimit, të zgjidhjes ose të njohjes. Zgjidhja dhe njohja, deri te cilat vihet në procesin e të menduarit, mundësojnë, në radhë të parë, orientimin më të mirë dhe më të suksesshëm në rrethinën e vet. Zbulimet, zgjidhjet dhe njohjet e individëve mund të jenë të rëndësishme dhe të dobishme për shoqëri në përgjithësi dhe të paraqesin vepra artistike, zbulim ose risi. Në këtë rast të menduarit merr domethënie tjetër për njeriun dhe shoqërinë, dhe atëherë flasim për të menduarit **krijues**. Të gjitha të arriturat e civilizimit bashkëkohor janë realizuar në sajë të të menduarit dhe të punës krijuese të njerëzve që kanë pasur aftësi të depërtojnë në raporte komplekse që sundojnë midis dukurive nga bota përreth.

Çdo mendim, ndërkaq, s'është e thënë të jetë produktiv, kurse të menduarit produktiv mund të jetë i dobishëm vetëm për individin ose me dobi të përgjithshme për shoqërinë dhe në këtë rast flasim për të menduarit krijues.

**Ndarja duke pasur parasysh të menduarit realist.** Të menduarit është e mundur dhe e arsyeshme të ndahet edhe në bazë të realitetit, duke pasur parasysh botën objektive në të cilën jeton njeriu. Atë mendim që është i kufizuar në kohë, në hapësirë dhe në ndonjë mënyrë tjetër për situatën e caktuar objektive, e quajmë mendim realist. Ai karakterizohet me një varg mendimesh dhe idesh, që zhvillohen sipas ligjshmërive të caktuara, si dhe me kufizimin dhe përcaktimin kohor dhe hapësinor.

Të menduarit **imangjinativ** dallohet nga të menduarit realistik për faktin që është më i lirë në kombinimin e lidhjeve, më pak varet nga qëndrueshmëria e ligjeve dhe e parimeve, dhe më tepër është nën ndikimin e nevojave dhe të dëshirave personale të individëve.

Një formë e të menduarit imagjinativ është imagjinata. Ajo është kombinim i shfaqjeve me qëllim dhe kuptim të caktuar, dhe kjo konsiderohet si proces i të menduarit. Me karakteristikat e përgjithshme të të menduarit imagjinativ se ajo është nën ndikimin e dëshirave dhe të nevojave të individit dhe se zhvillohet në formë të kombinimit më të lirë të shfaqjeve, imagjinata përmban elemente të realitetit. Imagjinata mund të jetë joproduktive, por kjo është vetëm një formë e saj – ëndërimi. Atë e hasim në të gjitha moshat e jetës, por që ajo është më e zhvilluar në periudhën kalimtare nga fëmija tek i rrituri në kohën e pubertetit.

**Ëndrrat.** Formë e veçantë e të menduarit imagjinativ janë ëndrrat. Organizmi i lodhur mbrohet nga molisja e plotë me anë të gjumit, e nga zgjimi me anë të ëndrrës. Konsiderohet se ëndrrat shkaktohen nga tri lloje shkaqesh: me ngacmimet e jashtme, ngacmimet e brendshme dhe konfliktet psikike. Me ngacmimet e jashtme nënkuptohen të gjitha ndryshimet në rrethinë që veprojnë në organet tona të ndijimit: zëri, drita, ftohtësia, prekja etj. Ato ngacmime, nëse janë mjaft intensive, shkaktojnë zgjimin. Nëse intensiteti i tyre është i pamjaftueshëm shkaktojnë ëndrrën që nga përmbajtja “ arsyeton” ngacmimet.

Kështu, p.sh. mund të ndodhë që luftëtari që është zbuluar në lokalin e ftohtë dhe ëndërron se është i shtrirë në ujë deri sa e kërcënon armiku, dhe kjo ëndërr zgjatë derisa të mos zgjohet dhe të mbulohet me batoni. Ngacmimet e brendshme në formë të urisë, të ngirjes së tepërt, të dhembjeve të boshtit kurrizor etj., shkaktojnë në mënyrë të ngjashme ëndrra që mund të vihen në lidhje me gjendjen fiziologjike të organizmit ose të jenë shkak i fjetjes jo të qetë ose të ëndrrave të ndërprera. Konfliktet psikike ndikojnë jo vetëm në paraqitjen e ëndrrave, por diktojnë edhe përmbajtjen e tyre.

Kështu ndodhë që njeriu të cilin e mundon ndonjë problem i pazgjidhur disa ditë, gjen zgjidhjen e atij problemi që, mjerisht, e ka pranuar vetëm në ëndërr. Përfaqësuesi i shkollës psikoanalitike në psikologji Sigmund Frojd (S. Freud) konsideron se ëndrrat kanë edhe kuptimin e vet latent ( të fshehtë) në plotësimin e dëshirave, që në gjendje të zgjuar nuk mund t'i realizojë njeriu për shkak të censurës së ndërgjegjes. Ëndrrat kanë edhe përmbajtjen e vet simbolike. Kështu, njeriu të cilit në luftë i është hequr një pjesë e ekstremitetit seksual, ëndërron se lufton me shpatë të thyer. Disa autorë konsiderojnë se ëndrrat janë shprehje e dëshirës që deri në fund ta qartësojë atë që ka mbetur e paqartë.

## KAPTINA 11.

### TË MËSUARIT – KUJTESA – HARRESA

#### NOCIONI DHE DEFINICIONI I TË MËSUARIT

Zhvillimi i organizimit të njeriut shënohet me ndryshime relativisht të përhershme të sjelljes. Ato shkaktohen me ndikimin e dy grupeve të faktorëve: faktorët biologjike dhe faktorët e rrethinës. Ndër faktorët **biologjikë** janë ata që shkaktojnë ndryshime afatshkurtra dhe retroaktive në sjelljen e individëve, siç është rasti me sëmurjen, lodhjen, ndikimin e alkoolit etj., si dhe ata ndikimi i të cilëve është relativisht i përhershëm, permanent, siç është pjekuria dhe pleqëria. Pjekuria është proces i vendosjes së funksioneve fiziologjike të organizmit që manifestohet në shtimin dhe shumëzimin e qelizave nervore, mielinizimin e fijeve nervore, zhvillimin e indit muskular, ashtërimin e etj. Pleqëria është proces i kundërt nga pjekuria, dhe manifestohet në rënien e funksioneve në formë të zvogëlimit të shpejtësisë së reagimit motorik, të zvogëlimit të ndjeshmërisë së organeve të ndijimit, rënien e intelegjencisë, dobësimin instinktit seksual etj. Këto ndryshime shprehen në sjelljen e individit, kështu që ndryshon qëndrimi i tij ndaj rrethinës dhe mënyra e aktivitetit në raport me objektet, njerëzit dhe situatat që e rrethojnë njeriun.

Lloji tjetër i ndryshimeve të sjelljeve shkaktohen me ndikimin e **rrethinës**. Ato manifestohen në fitimin e përvojës dhe ndryshimin e sjelljes nën ndikimin e asaj përvoje. Kjo mund të jetë përvoja sociale dhe të shprehet në ndryshimet e njëkohshme në sjellje të të gjithë pjesëtarëve të një grupacioni social ose përvojë individuale në të cilin rast edhe ndryshimet në sjellje kanë karakter individual.

**Ndryshimi relativisht i përhershëm i sjelljes nën ndikimin e përvojës është të mësuarit. Ky është proces themelor në të kuptuarit e sjelljes së njeriut, sepse nëse përjashtojmë ndikimin e pjekurisë dhe të pleqërisë, të gjitha ndryshimet në sjellje janë pasojë e të mësuarit.**

I porsalinduri vjen në botë me disa reflekse dhe instinkte, që i mundësojnë përshtatjet e para në rrethinë. Me zhvillimin biologjik krijohet baza për vendosjen e funksioneve përkatëse: të hecjes, të folurit, të kapjes, etj. që zhvillohen përmes të mësuarit, nën ndikimin e rrethinës. Kështu, pa të mësuarit nuk është e mundur as të merret me mend zhvillimi i organizmit.


Të mësuarit është proces kompleks nëpër të cilin kalon njeriu dhe fiton dije, shkathtësi dhe shprehje, formon emocione, motive dhe karakteristika të personalitetit, dhe përmes të cilit formohet personaliteti në tërësi. Këtij kompleksiteti dhe kësaj gjerësie të ndikimit të të mësuarit në zhvillimin e organizmit duhet t'i atribuohet edhe rëndësia e madhe që ka ai për të kuptuarit e sjelljes së njeriut dhe të interesimit që e tregojnë për këtë proces të gjithë ata që i mësojnë karakteristikat e sjelljes së njeriut.

**Dijen** e definon Z. Bujash si lëndë të mësuar që përbëhet nga kuptimet, faktet, parimet dhe modelet e jetës intelektuale. Me rastin e fitimit të dijes inkuadrohen, në radhë të parë, funksionet intelektuale dhe proceset që zhvillohen në planin intelektual. **Shkathtësitë** janë struktura të fituara psikomotorike ose sensorimotorike që mundësojnë zhvillimin më të shpejtë dhe më të suksesshëm të atyre veprimeve, në bazë të të cilave janë fituar ato struktura. Shkathtësitë përfshijnë aktivitetin e muskujve dhe kryerjen e lëvizjeve. Lëvizjet bëhen me anë të ushtrimit të organizuar gjithnjë e më mirë në hapësirë dhe në kohë dhe kështu gradualisht automatizohen. Atëherë kur lëvizjet e shkaktuara me ndikimin e ushtrimit bëhen automatike, flasin për shprehinë. Në këtë mënyrë **shprehia** është shkathtësi e automatizuar.

## FORMAT E TË MËSUARIT

Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm përmes të cilëve realizohet ndikimi i rrethinës në ndryshimin e sjelljes së njeriut. Ato mekanizma i quajmë forma të të mësuarit. Ato varen, kryesisht, nga lloji dhe niveli i funksionit që është përfshirë gjatë të mësuarit. Kjo është caktuar pjesërisht me shkallën e zhvillimit evolutiv të qenies që mëson, por edhe pjesëtarët e llojit të caktuar shtazor, madje edhe njeriu i shfrytëzojnë mekanizmat e ndryshëm të të mësuarit. Ato dallohen sipas ndërlikueshmërisë, prandaj shumica e autorëve i numëron ndër format e **thjeshta** të të mësuarit mekanik dhe të mësuarit e kushtëzuar me refleksë, kurse format e **ndërlikuara** të të mësuarit zhvillohen me anë të përpjekjeve dhe të gabimeve dhe me anë të gjykimit.

**Të mësuarit mekanik** . Kjo është forma më e thjeshtë e të mësuarit dhe mbështetet në ndërlidhjen e përjetimeve që janë në ndonjë raport. Paraqitja e dy ose e më shumë përmbajtjeve njëkohësisht ose në rrjedhën kohore shkakton kujtesën nëse kjo përsëritet shumë herë. Këtu një përmbajtje paraqet **ngacmimin** , kurse përmbajtja që paraqitet njëkohësisht ose në ndonjë rrjedhë kohore paraqet **reaksionin** . Konsiderohet se **përsëritja** është parakusht themelor i të mësuarit që nënkupton NGACMIMIN – REAKSIONIN e njëkohshëm.



**Fig.8.1.-Lakorja e të mësuarit sipas Ebbinghaus-it**

Sqarimin i këtij mekanizmi të të mësuarit e ka dhënë qysh Aristoteli përmes ligjeve të tij të asociacionit. Me anë të atyre ligjeve Aristoteli është përpjekur të sqarojë se si zhvillohet procesi i kujtesës. Sipas ligjit të afërsisë kohore dhe hapësinore – dy përjetime që paraqiten njëkohësisht ose në vijim, ose në të njëjtin vend, shkaktojnë që përjetimi i njërit të ftojë në ndërgjegje atë tjetrin. E njëjta gjë është edhe me përjetimet e ngjashme dhe përjetimet e kundërta. Në kohën më të re psikologu amerikan Torndajk (*Thorndike*) i ka dhënë disa interpretime të reja të të kuptuarit asociativ të procesit të mësimit. Sipas Torndajkut është e rëndësishme **shpeshësia** ose frekuentimi me afrinë kohore, por të mësuarit duhet të jetë **i motivuar** në mënyrë që të arrihet kujtesa.

Karakteristikat e të mësuarit mekanik i ka studiuar në mënyrë sistematike njëri nga autorët më të vjetër që është marrë me problemet e të mësuarit, Ebbinghaus (*Ebbinghaus*). Ai i ka bërë eksperimentet me vetveten, duke i mësuar rrokjet pa kuptim përmes një numri më të madh ose më të vogël përsëritjesh. Duke matur efektin e këtij mësimi në funksion të përsëritjes, Ebbinghaus ka fituar lakoren e shpejtësimi negativ, që tregon se me përsëritje rritet efekti i të mësuarit, por kjo rritje është gjithnjë më e ngadalshme me rritjen e numrit të përsëritjeve.

Të mësuarit mekanik e shfrytëzojnë njerëzit dhe kafshët. Njerëzit, zakonisht, e shfrytëzojnë gjatë të mësuarit të materies verbale pa kuptim, që në kurrfarë mënyre nuk mund të kuptohet.

**Reflekset e kushtëzuara** . Edhe pse bën pjesë ndër format e thjeshta të të mësuarit, reflekset e kushtëzuara janë formë më komplekse e mësimit se mësimi mekanik. Ky mekanizëm i të mësuarit mbështetet në përvetësimin e veprimeve të reja refleksive, gjë që është e lidhur me funksionin e korës së trurit të madh.

Organizmi vjen në botë me instinkte themelore dhe me reflekse të thjeshta. Ato reflekse, që janë të lindura, quhen reflekse **të pakushtëzuara** . E paraqesin reaksionin motorik ose sekretolik (tajitja e gjëndrave). Ai zhvillohet ashtu që ngacmimi nga receptorët përcillet me anë të rrugës më të shkurtër, që është caktuar me trashëgimi, në organin ekzekutiv (muskuli ose gjëndra). Kështu, p.sh., ngacmimi i dritës shkakton refleksin orientues – në paraqitjen e dritës njeriu ose kafsha kthen kokën në drejtim të burimit të dritës; paraqitja e ushqimit shkakton tajiten e pështymës tek kafshët e uritura ose njeriu. Ato janë reaksione të natyrshme, të lindura, karakteristike për njerëzit dhe kafshët. Ato janë refleksive, zhvillohen jashtë kontrollit tonë të vullnetshëm dhe i quajmë reflekse të pakushtëzuara. Ngacmimet në formë të ushqimit, të dritës, të zërit etj. që shkaktojnë reflekset e pa kushtëzuara, i quajmë **ngacmime të pakushtëzuara**. Nëse para paraqitjes së ngacmimit të pakushtëzuar të një lloji p.sh. të **ushqimit** paraqitet ngacmimi i pakushtëzuar i llojit tjetër, p.sh. **zëri** dhe kjo përsëritet disa herë, tingulli do të shkaktojë të njëjtin reaksion që e shkakton ngacmimi me ushqim – tajiten e pështymës. Tajitja e pështymës me paraqitjen e zërit nuk është reaksion i natyrshëm. Ky është reaksion i **pamësuar**, reaksion që kushtëzohet me praninë e kushtëzuar të ngacmimit të kushtëzuar para ngacmimit të pakushtëzuar dhe quhet **refleks i kushtëzuar**. Ky fenomen është i pasqyruar në fig. 8.2. Paraqitja e ushqimit shkakton tajiten e pështymës si reaksion i natyrshëm – refleks i pakushtëzuar. Në skemën *b* është pasqyruar kushtëzimi në të cilin së pari paraqitet tingulli i ziles (ngacmim i kushtëzuar), pas të cilit në një interval të caktuar kohor paraqitet ushqimi (ngacmimi i pakushtëzuar). Pas një numri të caktuar të përsëritjes ato dy ngacmime ndërlidhen (asociojnë), kështu që në fund

edhe vetë paraqitja e ziles shkakton tajitje e pështymës (refleks i kushtëzuar), gjë që shihet në skemën c.

Deri te paraqitja e kushtëzimit vihet në atë mënyrë që me ngacmimin e kushtëzuar, që nuk është i efektshëm në vështirim të shkaktoimit të reaksionit të dëshiruar, ndërlidhet me ngacmimin e efektshëm të pakushtëzuar që natyrisht e shkakton atë reaksion, madje edhe vetë bëhet i efektshëm. Nëse para ngacmimit të kushtëzuar, i cili




Fig. 8.2. - Pasqyrimi skematik i krijimit të refleksve të kushtëzuara

është bërë i efektshëm, jepet çfarëdo ngacmimi i ri i paefektshëm, ai me kohë edhe vetë do të bëhet i efektshëm dhe do të shkaktojë të njëjtin reaksion që e shkakton ngacmimi i pakushtëzuar, në bazën e të cilit është krijuar refleksi i kushtëzuar. Këtë reaksion e quajmë refleksi i kushtëzuar i **rendit të dytë**. Në të njëjtën mënyrë është e mundur të krijohet refleksi i kushtëzuar i rendit të tretë. Refleksat e kushtëzuara tek të cilat bëhet ndërlidhja e dy ose më shumë ngacmimeve të kushtëzuara, quhen reflekse të kushtëzuara **të rendit më të lartë**, dhe ato janë bazë e sqarimit fiziologjik të procesit të të mësuarit.

Eksperimentet e shumta që në fushën e refleksve të kushtëzuara i kanë bërë filozofët sovjetik Seçenov dhe nxënësi i tij Pavlov dhe interpretimet e tyre të rezultateve të fituara, i sqarojnë mekanizmat fiziologjikë të procesit të të mësuarit. Sipas mendimit të këtyre autorëve, janë dy momente vendimtare në procesin e të mësuarit: i pari është mundësia e vendosjes së lidhjeve të reja në sistemin qendror nervor, lidhje që nuk janë të caktuara në mënyrë konstitucionale, dhe e dyta, që të bëhet vendosja e këtyre lidhjeve, duhet të ekzistojë motivimi. Ky **motivim** mund të jetë pozitiv, në formë të ushqimit tek kafshët e uritura, ose të parave, të lavdëratave, të shpërblimeve tek njerëzit, ose negativ, në formë të shokut elektrik tek kafshët, përkatësisht të ndëshkimit, të qortimit, të qëndrimit negativ të mjedisit shoqëror tek njeriu.

Refleksat e kushtëzuara janë studiuar përmes eksperimenteve ndaj kafshëve, por kjo është formë e të mësuarit që zbatohet edhe tek njerëzit. Përfaqësuesit e teorisë së

reflekseve të kushtëzuara konsiderojnë se tek njerëzit mund të krijohen reflekse të kushtëzuara të rendit më të lartë, që tejkalojnë shumë refleksin e kushtëzuar të provuar me anë të eksperimentit të rendit të tretë, dhe se atyre mund t'u atribuohet paraqitja e simpatisë dhe e antipatisë së njerëzve për situata të caktuara, ngjarje ose persona të caktuar, që me anë të kushtëzimit vihen në lidhje me përjetimet e mëhershme të këndshme ose të pakëndshme.

**Përpyjekjet dhe gabimet.** Të mësuarit me anë të përpyjekjeve dhe të gabimeve numërohet ndër format komplekse të të mësuarit. Kjo formë e të mësuarit mund të ilustruhet në mënyrën më të thjeshtë me eksperimentimin me macen e uritur të mbyllur në kafaz që është e mundur të hapet në shtypjen e levës së caktuar. Jashtë kafazit gjendet peshku i cili e nxitë macen të gjejë daljen. Këtë eksperiment e ka zhvilluar Vinslou (*Winslow*). Sipas vëzhgimit të tij, maceja lëvizë nëpër kafaz derisa të mos e prekë rastësisht levën dhe të hapë derën. Me përsëritjen e eksperimentit me të njëjtën mace, është konstatuar se gradualisht shkurtohet koha që i nevojitet maces për ta hapur kafazin. Nga kjo autori konkludon se kafsha gjatë çdo përsëritjeje ka mësuar diçka për mënyrën e zgjidhjes së problemit. Në çdo përsëritje kafsha ka bërë një varg përpyjekjesh të gabueshme dhe përmes kësaj ka fituar përvojë me të cilën i redukton gabimet dhe në bazë të të cilës vjen deri te reaksioni i vërtetë. Duke interpretuar këtë dukuri, Skinner (*Skinner*) thotë se përpyjekjet që i bëjnë kafsha nuk janë të rastit; kafsha i evoluon përpyjekjet dhe përmes atij evoluimi i hedh zgjidhjet e padobishme dhe vjen deri te zgjidhja e drejtë.

Përpyjekjet s'është e thënë që domosdo t'i përfshijnë veprimet motorike. Ato mund të jenë ide ose parasupozime, të cilat i shfrytëzon njeriu për të zgjidhur ndonjë problem. Në vend të aktivitetit motorik, përpyjekjet mund të zhvillohen në nivel të proceseve mendore në të cilat njeriu evoluon qëllimin dhe dobinë e hipotezave të parashtruara. Parashtrimi i një numri të madh të hipotezave dhe verifikimi i tyre është formë e të mësuarit me anë të përpyjekjeve dhe të gabimeve.

Për arsye se tek njerëzit në procesin e të mësuarit me anë të përpyjekjeve dhe të gabimeve zakonisht inkuadrohen proceset mendore dhe aktiviteti i ndërlikuar perceptues-motorik, kjo formë e të mësuarit numërohet ndër format e ndërlikuara të të mësuarit. Megjithatë, Kliford Morgan (*C. Morgan, 1956*), këtë formë të të mësuarit si, tek e fundit, edhe dy format e përmendura më parë, i quan "mësim i marrë", në mënyrë që të theksojë nivelin në të cilin zhvillohet mësimi me anë të gjykimit.

**Gjykimi.** Të mësuarit me anë të gjykimit përfshin funksionet intelektuale. Bazën e tij e përbëjnë proceset mendore dhe sipas kësaj kjo formë dallohet në mënyrë të qenësishme nga të gjitha format e tjera të mësimit. Sepse, edhe të mësuarit me anë të përpyjekjeve dhe të gabimeve përfshin proceset mendore, por ato këtu shërbejnë vetëm si mjet manipulimi që mund t'i zëvendësojë veprimet manuale, e jo si bazë e të mësuarit. Të mësuarit me anë të gjykimit konsiston në zbërthimin dhe ristrukturimin mendor të përmbajtjeve të dhëna.

Gjykimin si formë të të mësuarit e gjejmë tek situatat problemore që kërkojnë zgjidhjen, por edhe si mënyrë e paramendimit të kuptimit të materies që duhet të mësohet. Kështu, kur gjendemi para detyrës që të mësojmë një varg numrash, mënyra më e thjeshtë është që me anë të përsëritjes mekanike të përpiqemi t'i mësojmë. Mirëpo, nëse është e mundur që në ndonjë mënyrë të paramendohet një varg numrash që i mësojmë, të mësuarit tonë do të jetë shumë më efikas, kurse rezultatet më të qëndrueshme. Kështu, p.sh., një varg i tillë i numrave: 1, 4, 9, 16, 25, 36, 49, 64, 81, 100,

është mundur të paramendohet me gjendjen e ligjshmërisë me të cilën rriten numrat në varg. Me vështirimin e kujdesshëm mund të vërehet se numrat në varg po rriten për madhësinë e numrit tek duke filluar nga numri 3, e më tutje. Edhe në mënyrë tjetër është e mundur të paramendohet ai varg i numrave, sepse numrat në varg paraqesin katrorët e numrave prej 1 deri në 10. Me paramendimin e vargut të numrit jo vetëm që do ta mësojmë përnjëherë, por do ta mbajmë mend përherë.

Në bazë të këtij shembulli të vetëm është e mundur të vërehen disa karakteristika qenësore të të mësuarit me anë të gjykimit. Me rastin e mësimit me anë të gjykimit deri te zgjidhja e problemit arrijmë **menjëherë**, hovshëm. Materialin e mësojmë përnjëherë **plotësisht**. Dijen e fituar mund ta **aplikojmë** në situata të ngjashme, dhe më në fund, kjo formë e të mësuarit mbështet në të menduarit, që do të thotë se njeriu mendon për atë çka të mësojë dhe çka duhet të arrijë me anë të mësimit.

Siç kemi thënë edhe më parë, kjo formë e të mësuarit është efikase sidomos në situatat problemore. Për këtë arsye, me qëllim të njohjes më të mirë të kësaj mënyre të të mësuarit, janë kërkuar përvojat e njerëzve që kanë dëshmuar aftësinë e vet në zgjidhjen e problemeve. Ato përvoja vejnë në dukje se procesi i të mësuarit me anë të gjykimit i përmban disa faza, pak a shumë të pashmangshme. Sipas mendimit të matematikientit të madh francez Poankarea (*Poincare*), ekzistojnë katër faza në zgjidhjen e problemit, njohja, inkubacioni, iluminacioni dhe verifikimi. Në fazën e parë **njihemi** me problemin, elementet e situatës, ashtu që e arrijnë orientimin në problem. Kjo fazë mund të zgjasë për një kohë më të gjatë ose më të shkurtër. Faza e **inkubacionit** karakterizohet me qetësimin iluzor, sepse nuk jemi të vetëdijshëm për proceset psikike që zhvillohen në zgjidhjen e problemit. Për praninë e atyre proceseve konkludojmë sipas mënyrës së zgjidhjes së problemit, që zhvillohet në formë të përjetimit të befasishëm, “aha”, të përjetimit, të **kuptimit të situatës**. Për shkak të këtyre karakteristikave faza e tretë, në të cilën gjejmë zgjidhjen e problemit, quhet **iluminacion**. Në fazën e katërt **verifikohet** saktësia e zgjidhjes të cilën e kemi gjetur, sepse nuk përjashtohen konkluzionet e gabueshme nëse i marrim në shqyrtim elementet e gabueshme të situatës. Këto katër faza zakonisht i takojmë në procesin e zgjidhjes së problemit, edhe pse të gjitha fazat nuk janë të domosdoshme. Gjithashtu, ndonjëherë, mungon faza e inkubacionit kur problemi është aq i lehtë sa që zgjidhjen e gjejmë menjëherë, e ndonjëherë faza e verifikimit kur zgjidhja është padyshim e saktë, prandaj nuk duhet të verifikohet.

## LLOJET E TË MËSUARIT

Nga aspekti i funksioneve që kryesisht inkuadrohen në procesin e të mësuarit, është e arsyeshme të dallohen disa lloje të të mësuarit. Kështu, kemi të mësuarit **perceptiv** që, në radhë të parë, angazhon analizatorët e ndijimit. Të mësuarit **verbal** nënkupton se lënda është formësuar në simbole verbale me të cilat shërbehem që të mbajmë mend ndonjë përmbajtje. Të mësuarit **motorik** përfshin lëvizjet dhe veprimet dhe rezultati i tij manifestohet në përpjekjen e shkathtësive të caktuara. Të mësuarit **instrumental** ka marrë emërtimin sipas asaj që zhvillohet në kushte rreptësisht eksperimentale, e shpeshherë përfshin funksione të ndryshme, sipas përmbajtjes që mësohet. Nga disa lloje të përmendura të të mësuarit do të njihemi më hollësisht me të mësuarit verbal dhe motorik.



**Të mësuarit verbal.** Pothuaj i tërë materiali që mësohet është e mundur të verbalizohet, kështu që ky lloj i të mësuarit nuk është i lidhur aq me material, sa me mundësinë e përdorimit të simboleve verbale (gjuhësore) – të fjalëve dhe të numrave. Në të mësuarit verbal numërojmë vetëm atë të mësuar që zhvillohet në përdorimin e simboleve gjuhësore.

Në suksesin në të mësuarit verbal ndikon edhe kohëzgjatja e të mësuarit. Fulko (*Faulcault*) ka konstatuar ligjshmëri interesante që sundojnë në raport me sasinë e materialit dhe kohën e nevojshme që ai material të mësohet. Rezultatet e hulumtimeve të tij janë pasqyruar në tabelën 8.1.

Numri i fjalëve të ofruara	Koha e nevojshme për mësimin e të gjitha fjalëve	Koha e nevojshme për mësimin e 100 fjalëve
100	9 min.	9 min.
200	24 "	12 "
500	65 "	13 "
1000	165 "	16 "

*Tab. 8.1 — Rezultatet e hulumtimit të ndikimit të kohës në efektet e të mësuarit*

Këto rezultate deri dikund vërtetojnë ligjshmërinë që sundon në raport të sasisë së materialit dhe të numrit të nevojshëm të përsëritjeve në mënyrë që të mbahet mend përmbajtja e caktuar.

**Vendi në varg** ka, gjithashtu, ndikim në suksesin tek të mësuarit verbal. Nuk mësohen njësoj lehtë të gjitha pjesët e vargut. Fillimi dhe mbarimi i vargut mësohen më lehtë sesa mesi. Kjo dukuri sqarohet me ndikimin e disa faktorëve. Në vend të parë fillimi dhe mbarimi i vargut theksohen, dhe për këtë arsye është më lehtë të dallohen dhe të vërehen. Pastaj, fjalët në fillim të vargut kanë më pak fjalë përpara, kurse fjalët në fund të vargut kanë më pak fjalë pas, që ndikojnë negativisht në të mbajturit mend.

Ndikim të madh në efikasitetin e të mësuarit ka **kuptimi** i materialit. Materiali i kuptimtë mësohet më shpejt nga ai i pakuptimtë. Madje edhe fjalët e pakuptimta që përkujtojnë ose mund të vihen në lidhje me fjalët e kuptimshme, është më lehtë të mësohen se materiali plotësisht i pakuptimtë. Për këtë ekzistojnë arsyet. Pjesët e materialit të kuptimshëm që më parë janë të njohura, prandaj kuptohen më lehtë. Më lehtë mësojmë sipas lidhjeve për nga kuptimi, sesa sipas lidhjeve në hapësirë dhe në kohë.

**Të mësuarit motorik.** Për dallim nga të mësuarit verbal, që nënkupton përdorimin e simboleve gjuhësore, të mësuarit motorik është proces i fitimit të shkathtësive dhe të shprehive që i përfshijnë lëvizjet dhe veprimet. Me rastin e fitimit të shkathtësive mund të inkadrohen, në një masë më të madhe ose më të vogël, edhe proceset intelektuale, por janë dominante lëvizjet motorike me të cilat zhvillohen veprimet motorike. Përveç lëvizjeve motorike rëndësi të madhe kanë edhe proceset sensoriale, në rend të parë ato vizuale, e pastaj proceset taktile dhe kinestetike, sepse kontrolli sensorial është i domosdoshëm për zhvillimin e drejtë të disa veprimeve të ndërlikuara.

Fitimi i shkathtësive është proces që përbëhet nga disa faza. Në vend të parë bëhet integrimi i lëvizjeve në një sistem ose strukturë të caktuar, që mundëson zhvillimin e vrazhdë të disa veprimeve të ndërlikuara. Në procesin e mëtejshëm bëhet mënjanimi i

lëvizjeve dhe i veprimeve të tepërta dhe të gabueshme, me të cilat shkathtësia në fillim është përplotë. Në pajtim me këtë, gradualisht bëhet organizimi më i mirë i lëvizjeve në kohë dhe në hapësirë. Me përsëritjen e mëtijshme paraqitet automatizimi që karakterizohet me pjesëmarrjen më të vogël të proceseve intelektuale, mendore në zhvillimin e lëvizjeve dhe të veprimeve të ndërlikuara.

Ligjshmëritë që sundojnë në të mësuarit motorik ose në fitimin e shkathtësive janë të dukshme në lakoret e ushtrimit, që tregojnë përparimin në funksionin e përsëritjes ose të kohës së të mësuarit. Ato lakore dallohen për kah forma varësisht nga lloji dhe ndërlikueshmëria e shkathtësive që i fitojnë gjatë procesit të të mësuarit. Kështu, lakorja e akceleracionit **negativ** është tipike për ushtrimet relativisht të thjeshta. Tek shkathtësitë e thjeshta shumica në grupin e individëve i shfrytëzojnë elementet e njohura më parë të cilat, në fillim, kontribuojnë në përparimin e shpejtë. Kur pushon ndikimi pozitiv i




Fig.8.3. - Lakorja tipike e ushtrimit gjatë fitimit të shkathtësive të thjeshta




Fig.8.4.- Lakorja tipike e ushtrimit gjatë fitimit të shkathtësive të ndërlikuara

elementeve të njohura, përparimi bëhet gjithnjë më i ngadalshëm. Rënia relative në përparim bëhet edhe më e theksuar nga fundi i trajnimit, kur shkathtësia është në atë shkallë të përvetësimit, sa përsëritja e mëtijshme nuk mund të kontribuojë në përmirësimin e saj. Në këtë fazë lakorja bëhet paralele me apscisën dhe merr formën e **platosë**. Këto ligjshmëri janë të dukshme në figurën 8.3.

Tek shkathtësitë e ndërlikuara, ndërkaq, lakorja e përparimit ka zakonisht formë tjetër. Në fillim të fitimit të shkathtësive të ndërlikuara nxënësit njihen me përmbajtjen e ushtrimit, dhe në këtë fazë përparimi është i ngadalshëm. Kur nxënësit përvetësojnë numrin më të madh të elementeve nga të cilat përbëhet shkathtësia, vjen përparimi i shpejtuar. Kjo tempo e ndryshuar e përparimit gjatë përvetësimit të shkathtësive të ndërlikuara shprehet në lakoren e ushtrimit në atë mënyrë që ajo merr formë të lakores së akcelerationit **pozitiv**. Mirëpo, edhe shkathtësitë e ndërlikura arrijnë fazën e ngadalësimit në përparim, që pasqyrohet në lakore në formë të platosë. Kjo plato kontribuon që lakorja tipike e ushtrimit gjatë fitimit të shkathtësive të ndërlikuara më parë të marrë formën “S”, sesa formën e akcelerationit pozitiv, siç është pasqyruar kjo në fig. 8.4.

Parashtrohet pyetja a është e dobishme të ushtrohet edhe më tej ndonjë shkathtësi në fazën kur lakorja e ushtrimit arrin platonë? Hulumtimet kanë treguar se, përkundër efektit të padukshëm në formën e përmirësimit të rezultateve, përsëritja e mëtejshme është e dobishme. Dobia nga përsëritja manifestohet në stabilitetin më të madh të shkathtësisë dhe në rezistencën më të madhe ndaj harresës. Stabiliteti më i madh i shkathtësisë manifestohet në rezistencën e saj ndaj ndikimeve të faktorëve të ndryshëm interferues, që mund të shprehen negativisht në kualitetin e zhvillimit të saj. Shkathtësia e ushtruar aq mirë nuk është e ndjeshme ndaj indisponimit të atij që e zhvillon, më pak është e ndjeshme ndaj ndikimeve të kushteve të pavolitshme biofizikale në të cilat zhvillohet, ndaj ndikimit të lodhjes dhe të faktorëve të tjerë të ngjashëm. Njëkohësisht, në kualitetin e saj nuk do të shprehet negativisht as ndërprerja e gjatë e zhvillimit.

Përparimi në ushtrim varet në masë të madhe edhe nga orari kohor. Me orarin kohor nënkuptojmë tre faktorë. Kohëzgjatjen e ushtrimit, gjatësinë e pushimit dhe kohën e pushimit. Ndërkaq, duhet organizuar ushtrimin ashtu që çdo element i shkathtësisë, vetvetiu, të paraqesë tërësinë logjike, e të mos ndahet në mënyrë arbitrare sipas intervaleve kohore me të cilat është e mundur të përfshihen pjesët përkatëse të tij. Në aspektin e **gjatësisë** së pushimit është konstatuar se pushimet e shkurtra, çfarë janë më të shumta, janë më efikase se numri i vogël i pushimeve të gjata. Me shkurtimin e pushimeve, ndërkaq, nuk bën të teprohet, sepse nëse pushimi është aq i shkurtër sa organizmi nuk mund të rehabilitohet, efekti i pushimit të tillë është i pamjaftueshëm. Me rastin e dhënies së pushimit duhet pasur kujdes se kur ai është më i efektshmi. Në këtë aspekt duhet të respektohet parimi që pushimi të jepet para se të paraqiten shenjat e para të lodhjes. Në këtë rast organizmi më së shpejti do të kthehet në gjendje të freskisë, d.m.th. pushimi do të jetë më i efektshmi.

## TRANSFERI I TË MËSUARIT

Me ligjshmëritë që janë specifike për dy lloje, për mësimin verbal dhe motorik, është i pranishëm edhe fenomeni që paraqet karakteristikë të përgjithshme dhe, sipas mendimit të shumë autorëve, problemin më të rëndësishëm të psikologjisë së të mësuarit. Ky është **transferi** i të mësuarit ose transferi i ushtrimit. Në mënyrë plotësisht të përgjithshme do të mund të thonim se transferi është bartje e veprimit të të mësuarit të mëhershëm në të mësuarit ose aktivitetin e mëvonshëm në përgjithësi. Ndërkaq, supozohet se ekzistojnë dy aktivitete reciprokisht të ndryshme: aktiviteti A dhe aktiviteti B, nga të cilat secili paraqet një fushë të të mësuarit. Transferi konsiston në ndikimin pozitiv ose negativ të aktivitetit A në aktivitetin B. Aktiviteti A mund të jetë mësimi i

nxënësve të shkollës së mesme, kurse aktiviteti B i kadetëve të akademisë ushtarake, njësoj siç aktiviteti A mund të jetë atletika, kurse aktiviteti B stërvitja ushtarake. Në të dy rastet fjala është për aktivitete të ndryshme, në të cilat, me siguri, aktiviteti A ndikon pozitivisht në aktivitetin B. Ndikimi negativ i të mësuarit paraprak në mësimin e mëvonshëm zakonisht nuk manifestohet në raportet e aktiviteteve të gjithmbarshme, por më parë në pjesët e tyre. Kështu, p.sh., derisa vozitja e automobilit përgjithësisht ndikon pozitivisht në drejtimin e tanksës, shprehia e fituar e frenimit të automobilit do të ndikojë negativisht në teknikën e drejtimit të tanksës.

Fenomeni i ndikimit pozitiv të të mësuarit paraprak në mësimin e mëvonshëm kahmoti i ka preokupuar hulumtuesit dhe ka qenë arsye e shumë mosmarrëveshjeve, madje edhe e teorive të gabueshme në të cilat mbështetej organizimi i mësimit në shkolla. Kështu, qysh Platoni, pasi që kishte vërejtur ndikimin pozitiv të disa aktiviteteve në suksesin dhe në kryerjen e aktiviteteve të tjera, parashtron pohimin se aritmetika, muzika dhe astronomia përsosin aftësinë e të menduarit spekulativ. Ky pohim, i parashtruar kahmoti, ka pasur ndikim në orientimin e mendimtarëve të mëvonshëm që janë marrë me problemet e të mësuarit dhe të edukimit. Kështu, Xhon Lok (John Lock) ka parashtruar formulën e disiplinës si qëllim kryesor i edukimit, duke nënkuptuar me disiplinën formale aktivitetet dhe shkathtësitë e ndryshme klasike dhe fisnike. Këtij orientimi i ka kontribuar edhe teoria e gabuar në psikologji, e njohur me emërtimin **psikologjia e aftësisë**. Sipas kësaj teorie, kujtesa, perceptimi, parashtrimi, mendimi, vëmendja, vullneti etj, janë kategori të veçanta të jetës psikike, përkatësisht të aftësisë që janë të pavarura njëra nga tjetra dhe unike.

Në bazë të të kuptuarit e tillë konsiderohej se ndikimi pozitiv i të mësuarit të mëhershëm në mësimin e mëvonshëm, përkatësisht transferi pozitiv është rezultat i rritjes së aftësisë psikike që vjen përmes aktiviteteve të mëhershme. Ky konstatim ka pasur ndikim në koncipimin e programeve shkollore, të përbëra nga një numër më i vogël i lëndëve të organizuara mirë për të cilat konsiderohej se kanë sidomos ndikim pozitiv në zhvillimin e aftësisë psikike. Orientimi teorik që ka shërbyer si bazë e konstatimit se me anë të ushtrimit mund të perfeksionohen aftësitë përkatëse psikike, është e njohur me emërtimin teoria e **disiplinave formale**. Ndikimi i teorisë nuk ka qenë i kufizuar vetëm në përmbajtjen e programeve shkollore, por edhe në mënyrën e qasjes ndaj nxënësit si objekt i edukimit dhe i arsimimit. Ithtarët e saj konsideronin se interesi dhe motivimi nuk kanë kurrfarë rëndësie për suksesin në mësim, dhe se shkopi është i vetmi mjet nxitës në të cilin mund dhe duhet të detyrohet nxënësi të mësojë. Edhe pse joshkencore dhe e gabueshme, ajo teori aq shumë e kishte pushtuar praktikën pedagogjike dhe njerëzit e arsimuar, sa është dashur të kalojë shumë kohë dhe të bëhen një numër i madh eksperimentesh shkencore që të dëshmohej lajthitja në të cilën kishin rënë. Sipas disa të dhënave deri në vitin 1951 janë bërë mbi 200 eksperimente me të cilat është dashur të dëshmohet gabimi i punëtorëve pedagogjikë që e kanë bërë me pranimin e teorisë së disiplinave formale. Ne do t'i përmendim disa prej atyre hulumtimeve.

Nga këto hulumtime të përgjithshme të mundësisë së përmirësimit të rezultateve të mësimit, bëhet kalimi në lëndët shkollore. Ithtarët e teorisë së disiplinave formale pranojnë pohimin se me lëndët e latinishtes dhe të matematikës zhvillohet aftësia e të menduarit. Që të mohojë këtë pohim, Xhonson (*Johanson*) katër grupe hulumtuesish i ka ushtruar në mënyrë sistematike në: konkludimin aritmetik, konkludimin logjik, interpretimin e fabulave dhe gjykimin e drejtë në situatat problemore. Rezultatet e këtij

hulumtim kanë treguar se rezultatet më të mira të të gjitha grupeve janë arritur në ato aktivitete që i kanë ushtruar, por ky përmirësim nuk është paraqitur në tri llojet e tjera të aktivitetit. Nga kjo Xhonson konkludon se të mësuarit e disa lëndëve shkollore mund të shprehet pozitivisht në suksesin dhe mësimin e atyre lëndëve, por jo edhe në përmirësimin e përgjithshëm të rezultateve të mësimin.

Nga këto disa eksperimente shihet se teknika e punës, e përvetësuar me të mësuarit paraprak, kontribuon në shkallën më të lartë në mësim atje ku kjo është e mundur të aplikohet. Pasi që shkolla, në rend të parë është burim i dijes, hulumtuesit i ka interesuar se ndikimi pozitiv i të mësuarit të mëhershëm në mësimin e mëvonshëm a mund t'i mvishet dijes, madje, në rend të parë, asaj dijeje që është fituar në shkollë. Lidhur me këtë janë hulumtuar tri probleme: a ekziston transferi pozitiv nga një lëndë shkollore në lëndët e tjera shkollore, a ekziston transferi nga shkollat më të ulëta në ato më të larta, dhe a ekziston transferi i dijeve shkollore në praktikën jetësore? Është e qartë se të trijat këto probleme kanë aspekte praktike, sepse përgjigjja në këto pyetje mundëson harmonizimin e programeve shkollore në shkollat e ulëta me kërkesat e shkollimit të mëvonshëm dhe harmonizimet e programeve të shkollimit të lartë me kërkesat e praktikës së punës.

Duke i analizuar këto probleme, hulumtuesit kanë konstatuar se dija e vjetër mund të ndikojë pozitivisht në mësimin dhe aktivitetin e mëvonshëm në dy mënyra: (1) përmes fakteve dhe informatave që paraqesin elemente identike në risinë e përmbajtjeve, dhe (2) përmes dijes së gjeneralizuar në parime të përgjithshme, ligje dhe rregulla, që mund të aplikohen me sukses gjatë fitimit të dijeve të reja.

## KUJTESA

E lidhur ngusht me mësimin është kujtesa. Atë do të mund ta definonim si kohëzgjatje e ndryshimeve që paraqiten në procesin e të mësuarit, ose si aftësi e ruajtjes në kujtesë të përmbajtjeve të përjetuara më herët. Është e mundur të definohet edhe në mënyrë tjetër. Kështu, disa autorë thonë se kujtesa është dispozicion ose gatishmëri për ruajtjen e përshtypjeve. – Gjithsesi, ky është proces i ndërlikuar, që përbëhet nga disa elemente: **ruajtja** e asaj që është mësuar, si shprehje e përpjekjeve për ndryshimin në procesin e të mësuarit; **harresa**, që është e domosdoshme dhe paraqet përpjekjen për ndryshime të krijuara si pasojë e të mësuarit; **rinjohja**, paraqet aktivizimin e ndryshimeve të krijuara dhe **riprodukimi**, me të cilin manifestohet ajo që është mbajtur mend.

Nga aspekti fiziologjik, kujtesa manifestohet në formë të ndryshimeve në korën e trurit të madh, që manifestohen në lidhjet e reja funksionale midis neuroneve. Kujtesa konsiston në formimin e zinxhirit të neuroneve, ndër të cilat krijohet lidhja funksionale. Gjurma në sistemin qendror nervor në formë të lidhjeve midis neuroneve quhet engram ose mnemogram.

**Llojet e kujtesës.** Ngjashëm me ndarjen e të mësuarit, edhe kujtesa është e arsyeshme të ndahet në kujtesën **motorike** (që manifestohet në aftësinë e riprodhimit të lëvizjeve dhe të veprimeve të caktuara) dhe **mentale** (që paraqet procesin intelektual). Kujtesa mentale është e mundur të ndahet më tej, sipas materialit që mbahet mend, në kujtesën **verbale** (që paraqet aftësinë e ruajtjes në kujtesë të simboleve verbale) dhe **figurative** (që ka të bëjë me figurat).

Ndër të gjitha llojet e kujtesës, kujtesa figurative meriton kujdes të veçantë, sepse paraqet një kategori të veçantë të jetës psikike dhe proces jashtëzakonisht të rëndësishëm psikik. Kujtesa figurative manifestohet në formë të **parafytyrimit** ose të shfaqjes. Parafytyrimi është i ngjashëm me perceptimin, prandaj është më lehtë të sqarohet me anë të krahasimit me perceptimin. Zakonisht e definojmë si riprodhim i perceptimit ose i pjesëve të tij. Parafytyrimi paraqet aftësinë e riprodhimit të disa përmbajtjeve të perceptuara në formë vizuale, akustike ose në formë tjetër të përjetimit pak a shumë të qartë. Në krahasim me perceptimin, parafytyrimi është më pak i gjallë, më pak i plotë dhe më pak i qëndrueshëm, dhe kurrë nuk përfshin tërë përmbajtjen e të perceptuarës. Megjithatë, dallimi themelor midis perceptimit dhe parafytyrimit qëndron në faktin që tek perceptimi është i pranishëm ngacmimi, kurse parafytyrimi është përjetim që nuk shkaktohet me ngacmim të drejtpërdrejtë.

Ekzistojnë dallime shumë të mëdha individuale në aftësinë e parafytyrimit, duke pasur parasysh intensitetin dhe qëndrueshmërinë e parafytyrimit. Kështu, artistët zakonisht kanë shumë të zhvilluar kujtesën figurative. Piktorët mundën shumë qartë t'i paraqesin përmbajtjet e mëhershme të përjetuara vizuale, kurse disa muzicentë në vetëdije në mënyrë plotësisht të saktë i riprodhojnë meloditë që vetëm njëherë i dëgjojnë. Parafytyrimet jashtëzakonisht të qarta që bëjnë të mundshëm riprodhimin e përmbajtjeve të caktuara në hollësi, quhen figura **ejdetike**, kurse njerëzit që i përjetojnë quhen ejdetistë. Ejdetizmi është dukuri që ndryshon me moshën. Kështu, fëmijët deri në pubertet kanë shumë të zhvilluar aftësinë e parafytyrimit, që shkon deri në nivelin e ejdetizmit. Kjo aftësi dobësohet me moshën, me ç'rast veçohet një përqindje e njerëzve që kjo u mbetet veçori e përhershme. Hulumtimet kanë treguar se aftësia e parashtrimit tek fëmijët varet në një masë të madhe nga mënyra e ligjërimit, d.m.th. nga plasticiteti me të cilin arsimtarët në shkollë ua tregojnë nxënësve gjërat përkatëse për të cilat u ligjërojnë. Mënyra figurative e ligjërimit kontribuon në zhvillimin e parafytyrimeve tek nxënësit.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e kujtesës, janë bërë përpjekje që me ndihmën e analizës së faktorit të konstatohen komponentet, përkatësisht faktorët që përbëjnë atë aftësi. Është konstatuar ekzistimi i një faktori të përgjithshëm të kujtesës, që pak a shumë është i pranishëm në të gjitha situatat në të cilat ruhet në kujtesë përmbajtja e përjetuar. Përveç faktorit të përgjithshëm, janë gjetur edhe faktorët grupor të kujtesës, që mundësojnë ruajtjen në kujtesë: të përshtypjeve vizuale, të përshtypjeve auditive dhe të ideve. Me analiza të mëtejshme është konstatuar se brenda përmbajtjeve vizuale ekzistojnë faktorët specifikë që janë interpretuar si aftësi e kujtesës: fizionomia, raportet hapësinore, ngjyrat e etj. Ndërkaq, gjatë atyre analizave është konstatuar prania e **interesit**, që ka një ndikim shumë të madh në mbamendjen e përmbajtjeve të dhëna.

## HARRESA

Procesi kundër nga kujtesa është harresa. Harresa është, në të vërtetë, **zhdukja** e ndryshimeve të krijuara me anë të mësimit. Ndërkaq, me këtë rast nuk bëhet vetëm zvogëlimi i vëllimit të dijes ose të shkathtësive të fituara përmes mësimit, por edhe i ndryshimeve kualitative në përmbajtjen e asaj që është mësuar. Bertlit (*Bartlet*) ka konstatuar se me rastin e harresës paraqiten tri lloje të ndryshimeve në përmbajtjen e

kujtesës. Përmes harresës vihet deri te **thjeshtësimi** i përmbajtjeve dhe ndërlikdhja e mbetjeve në tërësi logjike. Pastaj, vihet deri te **racionalizimi**, d.m.th. konstruimi i sqarimeve për atë që s'është e qartë dhe definitive, dhe deri te **theksimi** i asaj që individit i duket e rëndësishme.

Ato ndryshime në përmbajtjen e kujtesës, që paraqiten si rezultat i harresës, varen nga dija, qëndrimet dhe të kuptuarit e çdo individi, që do të thotë se nga çdo individë varet se çka do të ruajë në kujtesë nga ndonjë përmbajtje që e ka mësuar, dhe si do ta riprodukojë atë. Për këtë arsye bëhen deformime në përmbajtje që ritregohen, sepse në atë ritregim çdo individë lë anash diçka nga përmbajtja dhe shton diçka të veten. Këto deformacione bëhen edhe tek përmbajtjet vizuale, figurat, që nën ndikimin e harresës bëhen më tepër të përgjithshme, simetrike dhe të ngjashme me objektet e njohura.




Fig.8.5.- Lakorja e harresës sipas Ebbinghaus-it

Procesi i harresës fillon një kohë të shkurtër pas ndërprerjes së të mësuarit. Ajo është e pabarabartë, në fillim më e shpejtë, e më vonë gjithnjë e më e ngadalshme. Ebbinghaus ka përcaktuar në mënyrë eksperimentale tempon e harresës dhe, në bazë të kësaj, ka konstruktuar lakoren e harresës, të pasqyruar në fig. 8.5. Duke matur sasinë e materialit të harruar në funksion të kohës, i ka konstatuar këto raporte:

20 min.	Pas pushimit të mësimit janë harruar	42%
1 orë	Pas pushimit të mësimit janë harruar	56%
9 orë	Pas pushimit të mësimit janë harruar	64%
1 ditë	Pas pushimit të mësimit janë harruar	66%
2 ditë	Pas pushimit të mësimit janë harruar	72%
6 ditë	Pas pushimit të mësimit janë harruar	75%
1 muaj	Pas pushimit të mësimit janë harruar	79%

Siç tregojnë rezultatet e hulumtimit të Ebbinghausit, pas gjysmë orës së parë të ndërprerjes së mësimit njeriu e harron gati gjysmën e materies së mësuar, kurse brenda një muaji i harron edhe 40% të tjera. Ky hulumtim është zhvilluar me të hulumtuarit që kanë mbajtur mend fjalët e pakuptimta, kështu që rezultatet nuk është e arsyeshme të gjeneralizohen për të gjitha llojet e materialeve, sepse kuptimi i materialit ndikon si në

kujtesë, ashtu edhe në harresë, por, pa dyshim, harresa është më e shpejta pas ndërprerjes së mësimi.

Hulumtuesit i ka interesuar pse harrojmë. Në fillim është konsideruar se koha është shkaktari i harresës. Mirëpo, kësaj i kundërvihen disa argumente. Në vend të parë është dukuria e **reminishencës**, e cila manifestohet në mbamendjen më të mirë të përmbajtjeve pas pauzës, sesa drejtpërdrejtë pas ndërprerjes së mësimi. Kjo dukuri sqarohet me perzistencën (ngecjen) e proceseve fiziologjike për një kohë pas ndërprerjes së mësimi, që kontribuojnë në mbamendjen më të mirë të përmbajtjes së mësuar. Argumenti tjetër është dukuria që njerëzit e vjetër i mbajnë mënd më mirë përjetimet nga fëmijëria sesa përjetimet nga e kaluara e drejtpërdrejtë. Dhe më në fund, argument paraqet edhe dukuria që në momente të caktuara, të lidhura me rrezikun ose me momente të rëndësishme në jetë për përparimin tonë në karrierë, mund të kthejnë në kujtesë përjetimet e kamotshme.

Me qëllim të përcaktimit të shkaqeve reale të harresës, Xherikins (*Jenkins*) ka bërë një eksperiment të thjeshtë, me të cilin ka hulumtuar se çfarë është efekti i harresës pas punës, e çfarë pas fjetjes. Eksperimenti ka treguar se të hulumtuarit e njëjtë pas punës kanë harruar 70% kurse pas fjetjes 46% të materies së mësuar. Në bazë të këtyre rezultateve autori ka konkluduar se aktiviteti që pason pas mësimi kontribuon në harresën më të shpejtë të të mësuarës. Nga kjo është paraqitur dukuria e inhibimit **retroaktiv**, që manifestohet në dukurinë që mësimi i mëvonshëm ndikon negativisht në kujtesën e përmbajtjeve të mësuara më herët.

Sqarimin tjetër të dukurisë së harresës e gjejmë në karakteristikat fiziologjike të strukturave qendrore nervore nga të cilat zhduken lehtë lidhjet që nuk janë mjaft intensive. Vërtetimin për këtë e gjejmë në superfiksimin, domethënë në dukuritë që përsëritja e përmbajtjes, që tashmë është mësuar, kontribuon në mbamendjen e saj më të përhershme.

Përfaqësuesi i shkollës psikoanalitike në psikologji S. Frojd sqaron harresën me shtyrjen nga vetëdija të përjetimeve të pakëndshme. Për këtë arsye ndodhë që ushtari nuk mund të kujtohet për veprimet e pandershme dhe që njerëzit i harrojnë detyrimet që janë të pakëndshme.

Shkurtimisht, mund të thuhet se harresa nuk shkaktohet na koha që kalon nga ndërprerja e të mësuarit, por nga ngjarjet që kanë ndodhur gjatë asaj kohe.



## KAPTINA 12.

### ÇRREGULLIMET PSIKOLOGJIKE

Frustrimet në disa raste mund të kenë pasoja të rënda për përjetimin dhe sjelljen e individit dhe të bëjë të pamundshëm çdo adaptim me rrethinën. Atëherë sjellja e papërshtatur merr forma të rënda dhe ne flasim për sjelljen e çrregulluar. Ajo shkaktohet me çrregullimet psikike, për të cilat, frustrimet mund të jenë shkak ose vetëm shkas që, pak a shumë, kontribuon në paraqitjen e gjendjes së sëmurë. Atëherë kur frustrimet janë shkak i paraqitjes së çrregullimeve të psikës, flasim për **neurozat** (ose psiko – neurozat), kurse atëherë kur shkaqet e çrregullimeve psikike janë komponentet patogjene të personalitetit që mund t'i aktivizojnë frustrimet, flasim për **psikozat**.

**Neurozat.** Me neurozën ose psikoneurozën nënkuptohen ndryshimet psikopatologjike të personalitetit që individit i krijojnë vështirësi në përshtatjen e tij në rrethinë. Tek neurozat nuk ka komponente organike as çfarëdo komponentesh të tjera patogjene që do të mund të ishin shkak i sëmurjes. Ato paraqiten si pasojë e frustimeve të shtuara deri në atë shkallë sa shkaktojnë ndryshime psikopatologjike të personalitetit.

Midis disa llojeve të neurozave do t'i përmendim vetëm disa që, më së shpeshti mund të takohen në mjedisin e armatës.

**Neurastenia** është lloj i neurozës e cila, përveç pengesave psikike, ka edhe simptoma trupore siç janë rëndimi i kokës, dhembjet në disa pjesë të trupit, marramendja, dridhja, djersitja e tepruar, kruarja, ndjenja e rëndimit dhe e ligështisë së trupit, humbja e apetitit etj. Këto simptoma ekzistojnë vetvetiu pa ndonjë sëmurje organike, por tek ushtarët këto nuk duhet të merren si simulim, por si shenja neuroze. Simptomat psikike paraqiten në formë të ndjenjës së lodhjes, të pamundësisë së koncentrimin, të dobësimin të kujtesës, të ndjenjës së paaftësisë për punë.

**Neurozat profesionale** manifestohen në formë të pamundësisë së kryerjes së disa veprimeve nga të cilat përbëhet veprimtaria profesionale e të sëmurit. Kështu, p.sh., violinisti me profesion merr shtangimin e gishtërinjve gjatë tërheqjes së harkut, kurse ai që në punë duhet të shkruajë shumë merr shtangimin e gishtërinjve gjatë shkrimit. Simptomat e tjera që paraqiten janë më pak të rëndësishme, sepse ato vetvetiu, vështirësojnë mjaft përshtatjen e individit.

**Psihozat** . Për dallim nga neurozat, janë sëmurje shpirtërore që shkaktohen me komponentet patogjene të personalitetit. Ato komponente patogjene herë-herë janë të dukshme në formë të substraktit fiziologjik (të ndryshimeve organike), kurse në raste të tjera supozohet se ekzistojnë disa baza organike të sëmurjes.

**Paraliza progresive** është sëmurje shpirtërore që paraqitet si pasojë e përfshirjes së strukturave nervore dhe të korës së trurit të madh me sifiliz. Dëmtimet e trurit të madh kanë për pasojë shkatërrimin progresiv të funksioneve psikike kështu që vie deri te pengesat e mbamendjes dhe të kujtesës, mendimi bëhet më pak efikas dhe humbë elasticitetin. Kjo, në radhë të parë, pasqyrohet në format më të ndërlikuara të menduarit, në të menduarit abstrakt, në të kuptuarit e detyrave të rënda, rezonimin kritik etj. Me përparimin e sëmurjes, ato simptoma bëhen gjithnjë më të theksuara dhe sjellin dobësimin e funksioneve intelektuale, gjë që pengon të sëmurin në kryerjen e detyrave të tij.

**Psikoza maniake depressive** është sëmurje shpirtërore shkaktarët e së cilës nuk janë përcaktuar. Kjo sëmurje manifestohet në ndryshimet drastike të disponimit prej melankolisë deri te mania. **Melankolia** manifestohet me disponim të pikëllueshëm në të cilin funksionet janë të ngadalësuara. Mimika shpreh disponimin e pikëllueshëm, lëvizjet janë të ngurta, të ngathta, të ngadalta, kurse mendimi dhe motivimi të frenuara. I sëmuri ndjehet më pak i vlefshëm dhe çdo gjë i duket e pamundshme dhe joreale. Përkundër kësaj, **mania** manifestohet me disponimin e hareshëm, në të menduar paraqitet e ashtuquajtura ikja e ideve, është e theksuar nevoja për të folur dhe është i shtuar aktiviteti motorik. I sëmuri maniak ndjehet i kënaqur, i lumtur dhe përplot fuqi. Në këtë aktivitet të shtuar, ndërkaq, mungon frenimi normal dhe veprimi kritik, për ç'arsye i sëmuri tejkalon masën dhe vjen në konflikt me rrethinën.

**Skizofrenia** paraqet grupin e sëmurjeve shpirtërore nga të cilat disa dallohen plotësisht sipas simptomatologjisë nga të tjerat. Konsiderohet se sindromi i përgjithshëm për sëmurjet skizofrene është përçarja (disociacioni) i disa funksioneve psikike dhe i sjelljes së gjithëmbarshme. **Simpleks skizofrenia** paraqitet në kohën e rinisë ose tek të rriturit e moshës së re. Sëmurja manifestohet me humbjen e interesimit për punë, argëtim, shoqëri. I sëmuri tërhiqet në vetmi, e lë pas dore pamjen e tij të jashtme. Në rrjedhën më të vonshme të sëmurjes paraqitet disociacioni i mendimit dhe indiferenca emocionale. Është karakteristike për këtë formë të skizofrenisë që zakonisht nuk ka përmirësim të sëmurjes. **Skizofrenia katatone** është formë e sëmurjes në të cilën është i theksuar çrregullimi i motorikës. Ky çrregullim manifestohet edhe në formë të stuporit (shtangimit) ose në formë të shqetësimit dhe të ngacmimit psikomotorik. Gjatë stuporit shtangohen të gjitha funksionet, i sëmuri nuk lëviz (ose lëviz shumë ngadalë), nuk han, nuk pin, nuk i kryen funksionet fiziologjike. Ndërkaq, i sëmuri sillet negativisht ndaj rrethinës dhe refuzon çdo kontakt. Tek shqetësimi kataton, përkundrazi, i sëmuri është së tepërmi aktiv, shtrihet për tokë, i heq veshjet prej trupit, ik nga dhoma ose shtëpia. Në gjendjen e tillë të sëmurët mund të jenë shumë agresiv dhe të rrezikshëm për rrethinën. **Skizofrenia paranoike** karakterizohet me idetë e ndjekjes. I sëmuri konsideron se e ndjekin armiq të ndryshëm, organizatat, forcat e ndryshme, agjencionet e jashtme etj. Të gjitha ngjarjet rreth vetes i sëmuri i interpreton në mënyrë paranoike. Për këtë formë të skizofrenisë janë karakteristike **halucinacionet** në të gjitha zonat e ndijimit. Pra, të sëmurët shohin, dëgjojnë ose në mënyrë tjetër i ndjejnë ngjarjet në rrethinën e vet që, objektivisht nuk ekzistojnë dhe, në atë mënyrë, i shtojnë dhe i plotësojnë qëndrimet veta paranoike.

**Format e tjera të sjelljes së çrregulluar.** Përveç neurozave dhe psikozave që karakterizohen me forma specifike të sjelljes së çrregulluar të shkaktuar me këto sëmurje, në ushtri ballafaqohen edhe disa forma të sjelljes së çrregulluar që janë më pak specifike dhe paraqesin, zakonisht, rezultatën e ndikimit të disa faktorëve. Ato janë simulimet, deliktet e ndryshme disiplinore, duke përfshirë edhe dezertimin, prirja për t'u lënduar, alkoolizmi, manitë seksuale, vetëvrasjet etj. Sjellja e tillë mund të shihet edhe tek personalitetet normale, si dhe tek neurotikët dhe psikotikët. Personalitetin normal mund ta shtyjnë për një sjellje të tillë motivimi i dobët dhe konfliktet e rënda nga të cilat ai nuk mund të lirohet duke i shfrytëzuar mekanizmat e mbrojtjes së personalitetit të vet. Për neurotikët dhe psikotikët disa prej këtyre formave të sjelljes janë mënyrë e manifestimit të gjendjes së tyre të sëmurë.

## KAPTINA 13

### STRESI DHE SHËNDETI TRUPOR

Është e njohur se shpeshherë nuk jemi në gjendje t'iu shmangemi situatave të ndryshme të stresit, të cilave u ekspozohemi për çdo ditë. Stresi për njerëzit është bërë i përditshëm, si në shoqëritë e rregulluara mirë, ashtu edhe në shoqëritë në tranzicion, çfarë është momentalisht shoqëria jonë.

Një nga temat më aktuale në psikologji sot është “STRESI” dhe “STRESI PROFESIONAL”. Kjo problematikë është objekt i shumë debateve shkencore, ku shkencëtarët parashtrojnë shumë pyetje të tipit:

1. Si reagojnë njerëzit kur kuptojnë se së shpejti do t'u ekspozohen rreziqeve serioze?
2. Cilët faktorë ndikojnë në efikasitetin e individëve gjatë situatave të rrezikshme?
3. Pse disa persona i nënshtrohen frikës me panik, kurse të tjerët jo?
4. Cilët faktorë ndikojnë në shpejtësinë e vendosjes së nivelit normal të stabilitetit emocional pas përjetimit të ndonjë situatë stresi?

**“NË KUPTIMIN MË TË GJERË STRESI ËSHTË REAKSION TRUPOR DHE PSIKOLOGJIK NDAJ STRESORËVE TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM. KJO PRA NUK ËSHTË SITUATË NË TË CILËN ËSHTË GJENDUR INDIVID, POR REAKSION NDAJ ASAJ SITUATE. KJO ËSHTË FORCË NEGATIVE, DESTABILIZUESE QË NËSE DEL NGA KONTROLI KA VEPRIM TË DËMSHËM PËR PERSONALITETIN E INDIVIDIT”.**

ME NOCIONIN E STRESIT JANË TË LIDHURA NOCIONET:

- NGACMIMI STRESOR
- SITUATA STRESORE DHE
- PËRJETIMI STRESOR.
- NGACIMI STRESOR OSE STRESORI ËSHTË ÇDO NGACMIM TRUPOR, PSIKIK OSE SOCIAL QË E SJELL INDIVIDIN NË GJENDJE STRESI.

STRESORËT MUND T'I NDAJMË NË:

**FIZIK, ZHURMA E MADHE, NXEHTËSIA OSE FTOHTËSIA E MADHE, DHEMBJA E MADHE, FATKEQËSITË OSE KATASTROFAT ELEMENTARE, etj.**

**PSIKOLOGJIK, KONFLIKTET E NDRYSHME NDËRNJERËZORE, NË FAMILJE, NË PUNË, EKSPOZIMI NDAJ MOSUKSESEVE, KONFLIKTEVE PSIKOLOGJIKE DHE FRUSTRACIONEVE etj.**

SOCIALE, EKSPozIMI NDAJ NDRYSHIMEVE TË MËDHA SOCIALE, KRIZAVE EKONOMIKE, LUFTRAVE, NDRYSHIMEVE TË HOVSHME TË MARRËDHËNIEVE SHOQËRORE, etj.

REAKSIONET NDAJ STRESIT MUND TË JENË:

REAKSIONET FIZIOLOGJIKE: (PUNA E SHTUAR E ZEMRËS DHE E MUSHKËRIVE, TENSIONI I SHTUAR ARTERIAL I GJAKUT, NIVELI I SHTUAR I SHEQERIT NË GJAK, ZGJERIMI I BEBZAVE TË SYRIT, TENSIONI I SHTUAR I MUSKUJVE (E GJITHË KJO ËSHTË ENERGJI SHITESË PËR “LUFTË OSE IKJE”).

REAKSIONET PSIKIKE:

EMOTIVE (FRIKA, DROJA, DEPRIMIMI) dhe KOGNITIVE (NDRYSHIMI I VËMENDJES, I KONCENTRIMIT DHE I GJYKIMIT),

NDRYSHIMET E SJELLJES (MANIFESTOHEN NË LUFTËN ME SHKAKTARIN E STRESIT OSE IKJEN NGA SHKAKTARI I STRESIT).

STRESET I NDAJMË NË AKUTE DHE KRONIKE.

**SIPAS FUQISË I NDAJMË NË:**

- STRESE - BEZDISJE TË VOGLA TË PRËDITSHME;
- STRESET E MËDHA JETËSORE (SËMURJA, VDEKJA, HUMBJA E PUNËS, HUMBJET E MËDHA MATERIALE, URIA, NDJEKJA, REFUGJATËT );
- STRESET JETËSORE TRAUMATIKE (LUFTA, DHUNIMI, PRANIA E DHUNËS, EKSPozIMI NDAJ DHUNËS, MUNDIMIT ETJ).

**Duke hulumtuar fenomenin e stresit, psikologu kanadez Hans Seli ka definuar: SINDROMIN E PËRGJITHSHËM ADAPTUES** SI REAKSION NDAJ SITUATËS STRESORE. AI PËRMBAN TRI FAZA TË VEÇANTA:

1. FAZËN E ALARMIT;
  2. FAZËN E REZISTENCËS;
  3. FAZËN E RRASKAPITJES
- NË FAZËN E ALARMIT SË PARI PARAQITEN NDRYSHIMET E NDRYSHME TRUPORE (ARRITMIA), TEMPERATURA E SHTUAR, FRYMËMARRJA E SHPEJTUAR), SI DHE MUNGESA E LUFTËS PËR MPOSHTJEN E SITUATËS SË STRESIT. KJO ËSHTË SHENJË SE PO BËHEMI TË VETËDIJSHËM PËR STRESIN QË PO E PËRJETOJMË.
  - FAZA E REZISTENCËS DO TË THOTË SE JEMI TË GATSHËM TË LUFTOJMË KUNDËR STRESIT, E PARAQITET NËSE EDHE MË TEJ I EKSPZOHEMI STRESIT, KUR ZHDUKEN REAKSIONET TRUPORE, KURSE REZISTENCA VAZHDON.

- FAZA E RRASKAPITJES PARAQITET KUR I JEMI EKSPONUAR PËR NJË KOHË TË GJATË VEPRIMIT TË STRESORIT, KUR NA MUNGON FUQIA PËR T'U PËRSHTATUR NË SITUATËN E RE. NDONJËHERË KJO ËSHTË EDHE ARSYE E VDEKJES SË INDIVIDËVE, E NË RASTET MË TË SHPESHTA VIE DERI TE SHTRËNGIMET TRUPORE, SHPIRTËRORE DHE EMOCIONALE.

#### SIMPTOMAT E STRESIT:

- SIMPTOMAT FIZIKE (ITHATI, KOKËDHEMBJA, FTOHJET E SHPESHTA, PROBLEMET SEKSUALE, REDUKIMI I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË etj);
- SIMPTOMAT INTELEKTUALE (HUMBJA E PËRGJITHSHME E QARTËSISË SË MENDIMIT GJATË ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE, CINIZMI I SHPREHUR NDAJ BARTËSVE TË IDEVE TË REJA, POHIMET SE NDONJË DETYRË NUK MUND TË KRYHET etj. PERSONAT E TILLË RRALLËHERË KANË HOBI OSE ÇFARËDO MËNYRE TJETËR TË RELAKSIMIT INTELEKTUAL – LEXIMI, LOJA E SHAHUT, DËGJIMI I MUZIKËS ETJ).
- SIMPTOMAT EMOCIONALE (ÇFARË ËSHTË QASJA BAZIKE NDAJ JETËS OSE PUNËS SË INDIVIDIT QË KA MBETUR PA PUNË, OPTIMISTE OSE PESIMISTE, A ËSHTË I LUMTUR OSE I PIKËLLUAR?)
- SIMPTOMAT SOCIALE (NDJENJA E VETMISË DHE E IZOLIMIT PËR KUNDËR NDJENJES SË PRANIMIT);
- GJENDJA BRENGOSËSE (HUMBJA PROGRESIVE E IDEALIZMIT, ENERGJISË, KUPTIMIT PËR JETË DHE TË INTERESIMIT PËR REZULTATE TË NDONJË PUNE).

#### TEK PERSONAT ME STRES EVIDENTOHEN EDHE KËTO PROBLEME:

- NDRYSHIMI I ORARIT TË AKTIVITETEVE DITORE TË PUNËS
- RASKAPITJA EMOCIONALE;
- PAMJA PUBLIKE NEGATIVE SHOQËRORE;
- MBROJTJA E TEPRUAR E BASHKËSHORTES DHE E FËMIJËVE;
- PËRFORCIMI I EMOCIONEVE
- PROBLEMET SEKSUALE;
- PROBLEMET E IDENTITETIT;
- PROBLEMET ME FËMIJËT.
- REFUZIMI – (PERSONI NUK DËSHIRON TË BESOJË NË ATË QË KA NDODHUR),
- REAKSIONI JOSPECIFIK I DREJTUAR KUNDËR NDONJË PERSONI,

- DEPRESIONI (KJO FAZË ËSHTË MË E GJATA. INTENSITETI I DEPRESIONIT VARET NGA STRUKTURA E PERSONALITETIT, SASIA E TRAUMËS SË SHKAKTUAR ME HUMBJEN E PUNËS, REAKSIONET E SHOQËRISË NDAJ KËSAJ NGJARJEJE, RRJETI SOCIAL I INDIVIDIT DHE FAKTORËT E TJERË),

### MPOSHTJA E PROBLEMIT TË STRESIT

ÇDO INDIVID ZHVILLON STRATEGJINË E VET PËR MPOSHTJEN E RREZIKUT, TË STRESIT OSE TË SITUATAVE KONFLIKTUOZE. KËTO STRATEGJI QUHEN MPOSHTJE.

ÇDO INDIVID REAGON NË MËNYRA TË NDRSHME NË SITUATËN E STRESIT TË KRIJUAR ME HUMBJEN E PUNËS DHE KJO VARET NGA DISA FAKTORË.

1. KËTO JANË VEÇORITË E TIJ PEROSNALE (KOGNJITIVE OSE NJOHËSE, EMOCIONALE DHE TË VULLNETSHME),
2. AFTËSIA E TIJ QË T'I KUPTOJË DREJT TË METAT DHE AFTËSITË E TIJ,
3. AFTËSIA E TË KUPTUARIT TË ARRSYES PËR MPOSHTJEN E DOBËT TË STRESIT,
4. NIVELI I MARRËDHËNIEVE NDËRNJERËZORE,
5. MARRËDHËNIET KOLEGJIALE NË VENDIN E DIKURSHËM TË PUNËS, NË KOLEKTIVIN E DIKURSHËM
6. ORGANIZIMI I PUNËS NË SHOQËRI NË TË CILËN JETON INDIVIDIT ETJ.

### **DISA KËSHILLA PËR MPOSHTJEN E SITUATËS SË STRESIT**

- MEGJITHËSE NË NDONJË SITUATË NDIHENI I PADOBISHËM DHE I PAAFTË, KJO NË RASTET MË TË SHPESHTA NUK ËSHTË ASHTU. SHUMË PREJ JUSH SË SHPEJTI DO TË KONSTATONI SE P.SH. HUMBJA E PUNËS, E MIKUT etj. ËSHTË SFIDË NË TË CILËN DO TË PËRPIQENI TË NDËRTONI RAPORTE TË REJA ME NJERËZ TË RINJ, TË PUNONI NË PËRMIRËSIMIN E POZITËS SUAJ MATERIALE, TË ZBULONI DISA AFTËSI TË REJA QË KANË PUSHUAR TEK JU etj.
- BËHUNI TË VETËDIJSHËM SE NUK JENI GODITUR VETËM JU ME NDONJË SITUATË STRESI. KJO U NDODHË EDHE TË TJERËVE, ÇDOKUND NË BOTË, DHE PËR SHKAK TË TRANZICIONIT TË SHOQËRISË SONË, TË GJITHË DUHET TË JEMI TË GATSHËM PËR KËTË.
- NDRYSHIMET NË JETË GJITHMONË JANË SFIDË, QË MUND T'I SHFRYTËZOJMË NË MNYRË POZITIVE, DUKE ZHVILLUAR DISA AFTËSI TË REJA.
- MEGJITHËSE E GJITHË KJO ËSHTË SHANSË PËR NDRYSHIM NË TË MIRË (SIPAS FJALËS SË URTË POPULLORE “SA MË KEQ - AQ MË MIRË”).

- PËRPIQUNI TË BINDNI VETEN DHE TË TJERËT SE KENI BËRË ÇDO GJË QË T'I MPOSHTNI PROBLEMET, NË MËNYRË QË TË RUANI VETËRESPEKTIN.
- KËRKONI NDIHMË DHE SOLIDARITET NË FAMILJE, VEÇMAS NGA PARTNERI DHE FËMIJËT TUAJ. SQAROJANI SITUATËN E RE EDHE BASHKËSHORTIT EDHE FËMIJËVE,
- NËSE KENI PRINDËR, EDHE ATA I NJIHNI ME PROBLEMIN E KRIJUAR, SEPSE DO TË JETË E MIRËSEARDHUR EDHE PËRKRAHJA E TYRE (MORALE OSE MATERIALE).
- SITUATA E RE SHPESHHERË NËNKUPTON EDHE NEVOJËN PËR MËSIMIN E SHKATHTËSIVE, TË PUNËVE TË REJA, FITIMIN E DIJEVE TË REJA DHE KJO DUHET TË PRANOHET.
- PUSHONI, POR MOS HARONI KONDICIONIN FIZIK. ME FORCIMIN E ORGANIZMIT DO TË BALLAFAQOHENI MË LEHTË ME SITUATËN E RE TË KRIJUAR, KURSE PREJ SAJ DO TË DILNI ME PASOJA MË TË VOGLA TË DËMSHME.

## KAPTINA 14

### PSIKOLOGJIA SOCIALE DHE KRIMINALITETI

Para se të kalojmë në shkoqitje më të hollësishme të temës së dhënë është e nevojshme që të përsërisim dhe të përcaktojmë domethënien e termit **psikologjia sociale dhe kriminaliteti**.

Psikologjia sociale nuk është “specialistike” por disiplinë sintetike midis psikologjisë dhe sociologjisë, që ka për qëllim t’i ndihmojë edhe njëres edhe tjetrës “disiplinë amë” që në mënyrë më të tërësishme t’i vështrojnë problemet që i studiojnë.

**Kriminalitetin** mund ta definojmë si kriminalitet ose prirje për forma të tilla të sjelljes që vijnë në konflikt me ligjet penale dhe normat e tjera shoqërore. Për vlerësimin e veçorisë së tillë (të aktit jokriminal) është kusht i qenësishëm ballafaqimi i përsëritur ose i përhershëm me normat shoqërore, në përmasat që kërkojnë intervenimin shoqëror.

### BURIMET PSIKOSOCIALE TË KRIMINALITETIT

Duke i kërkuar burimet më të përgjithshme të kriminalitetit në shoqërinë njerëzore i vërejmë disa fakte:

1. Çdo bashkësi njerëzore ka **norma** të caktuara të sjelljes për pjesëtarët e vet dhe sanksionet dhe dënimet e caktuara për shkelësit e atyre normave.
2. Normat e sjelljes paraqiten në këto dy forma themelore:
  - a) **Morale** (caktojnë atë që konsiderohet si e mirë ose e keqe).
  - b) **Legale** (ajo që është caktuar me ligje si sjellje e lejueshme ose e palejueshme në formën me shkrim ose si e drejtë zakonore).
3. Në pajtim me normat e sjelljes ekzistojnë edhe dy lloje të sanksioneve: **morale** dhe **legale**. Sanksionet morale konsistojnë në gjykimin moral të ndonjë veprimi devijues dhe janë çështje private e çdo individ. Normat legale janë çështje publike dhe për zbatimin e tyre kujdeset e gjithë bashkësia shoqërore.
4. Ekziston **përputhshmëria** por pa njëjtësi midis normave morale dhe legale të sjelljes. P.sh. **shkelja e kurorës** në shumë shoqëri është akt amoral, por nuk është cekur juridikisht si “e pa lejueshme”. Ose, **kalimi i rrugës** jashtë vendkalimit është i ndaluar me ligj, por shpeshherë nuk është cekur moralisht si ndonjë “e keqe”.
5. **Relativizmi normativ**. Ajo që sot gjykohet edhe moralisht edhe legalisht, nesër mund të jetë normë e sjelljes, dhe anasjelltas. Ose, në një bashkësi të gjerë shoqërore në të njëjtën periudhë pjesëtarët mund të kenë norma të ndryshme të sjelljes (gjakmarrja – akt i ndaluar legalisht, por disa pjesëtarë të asaj bashkësie moralisht e lejojnë).
6. **Normat legale janë të përgjithshme** dhe ato i obligojnë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë që t’i respektojnë. **Normat morale** i obligojnë vetëm ata që i pranojnë.
7. Ekziston **dallimi psikologjik** midis qëndrimit të individit ndaj normave morale dhe legale të sjelljes. **Normat morale internacionalizohen** dhe



kryesisht ekziston pjesa e vetëdijes, kurse shkelja e tyre shkakton “brejtjen e ndërgjegjes” . Nga ana tjetër normat legale s’është e thënë të jenë të internacionalizuara, kurse “frika legale” me rastin e shkeljes së ndonjë norme të sjelljes më lehtë përballohet në aspektin psikologjik sesa ndjenja e fajit personal.

Për shkak të domethënies së jashtëzakonshme psikosociale të raportit dhe të mospërputhshmërisë midis aspektit moral dhe legal të sjelljes do ta pasqyrojmë me një tipologji të thjeshtë. Aspektin moral të ndonjë akti do ta cilësojmë si “i mirë”, “neutral” dhe “i keq”, kurse aspektin legal do ta cilësojmë si “i lejueshëm” dhe “i palejueshëm” dhe do të fitojmë skemën që duket kështu.

		Aspekti	Legal
		i lejueshëm	i palejueshëm
Aspekti moral	i mirë	A	B
	neutral	C	D
	i keq	E	F

1. Vepra **A** – sikur të gjithë të bënin vepra të tilla, në shoqëri nuk do të kishte kurrë kriminalitet. Kjo është shoqëri ideale, por me siguri edhe shumë e mërzitshme.
2. Vepra **B** – në pajtim me normat morale të sjelljes, por legalisht e palejueshme. (vrasja politike).
3. Vepra **C** – formë e sjelljes që nuk i interesojnë autoritetet as morale as legale në shoqëri.
4. Vepra **D** – nuk ka kurrfarë ngjyre morale. Ajo moralisht është relevante, por legalisht është e palejueshme. ( kalimi i rrugës jashtë vendkalimit).
5. Vepra **E** – e keqe morale, legalisht e palejueshme. Për moralistët problemi më i madh (seksi grupor, homoseksualizmi, grindjet e bashkëshortëve).
6. Vepra **F** – pajtim i theksuar i vlerësimeve morale dhe legale për ndonjë vepër (vrasjet, vjedhjet, dhunimet etj).

Me zhvillimi e shoqërisë bëhet disproporcioni i këtyre dy sistemeve të normave të sjelljes. Pra, shoqëria edhe moralisht edhe legalisht do t’i gjykojë vetëm ato vepra të cilat janë me ligj të shënuara si të tilla. Me zhvillimin e shkencave juridike, pranohet rregulla “Nullum crimen sine lege” – (“nuk ka vepër penale pa ligj”).

Siç po e shohim nga tabela e prezantuar, veprat e tipit B dhe D janë problemi më i rëndë psikosocial. Për ndjekjen e tyre është vështirë të përfitohet përkrahja e opinionit.

Duhet theksuar se kriminaliteti dhe çdo gjë që është e lidhur me kriminalitetin shkakton interes të madh tek “njerëzit e rëndomtë” për këto arsye:

### 1. Interesi emocional për kriminalitetin

- a) për shkak të **frikës nga krimi**,
- b) dëshirës për **hakmarrje**,
- c) dëshirave **aventuristike**.

2. **Kriminaliteti** është një nga **rreziqet** më të mëdha për sistemin e stabilizuar të **normave** etike dhe të **vlerave** shoqërore.
3. Kriminaliteti është **barrë e madhe ekonomike për bashkësinë** (zbulimi, kapja, gjykimi, dënimi, riedukimi i kriminelëve).
4. Arsyeja tjetër për kërshërinë e “njeriut të zakonshëm” për kriminalitetin është **njohja e personalitetit dhe e rrugës jetësore** të personit që ka kryer ndonjë veprim kriminal, e që prapë është në funksion të kuptuarit më të mirë të sjelljes së njerëzve dhe të veprimeve të tyre në përgjithësi.

Pa marrë parasysh se nga i cili aspekt dëshirojmë ta njohim kriminalitetin në ndonjë bashkësi shoqërore, së pari parashtrojmë pyetjen sa është e përhapur ajo dukuri. Përgjigjen në këtë pyetje na japin para se gjithash statistikën e ndryshme kriminalistike.

### **KRIMINALITETI SI DUKURI SOCIALE**

Kriminalitetin metodologjikisht mund ta studiojmë në dy mënyra:

- a) me analizën e delinkuentëve individualë dhe,
- b) me analizën e kriminalitetit në tërësi.

Po theksojmë, **jashtë shoqërisë njerëzore nuk ka kriminalitet**. (Robinson Crusoe legjendar në ujdhesën e shkretë nuk ka mundur të bëhet kriminel edhe po të kishte dashur, sepse ai ka qenë plotësisht i vetëm dhe i izoluar, “nga ajo anë e së mirës dhe të keqes”).

Shkaqet e kriminalitetit duhet t’i kërkojmë në **faktorët e përgjithshëm të ecurive shoqërore (ekonomikë, politikë, ideologjikë)**. Mirëpo, nëse dëshirojmë ta kuptojmë kriminalitetin si dukuri individuale, duhet t’i kërkojmë shkaqet në **ato karakteristikat specifike psikologjike dhe sociale të individit të caktuar**.

Ndikimin e faktorëve socialë në dukurinë e kriminalitetit do ta pasqyrojnë shkurtimisht përmes:

- A- ndikimit të fshatit dhe të qytetit në atë dukuri,**
- B- ndikimit të familjes dhe**
- C- ndikimit të vet viktimës së veprës penale.**

Ad-A- studimet ekologjike të kriminalitetit nga shekulli i kaluar kanë treguar se numri i veprave kriminale në qytete është më i madh se në regjionet fshatare. Ajo diferencë nuk është vetëm në numër, por edhe në llojin e veprave penale. Në fshat është numri më i madh i veprave penale të orientuara kundër personave (“jetës dhe trupit” në Kodin penal). Specifikë e veprave penale në fshat janë: zjarret, shkatërrimi i pemishteve, vjedhja e kafshëve etj.

Arsyet për shkallën relativisht më të vogël të kriminalitetit në fshat janë:

1. **Kontrolli joformal social** (secili e njeh secilin),
2. **Fshati është më i varfër** se qyteti, por dallimet në begati janë më të vogla,
3. **Është më i vogël numri i rasteve dhe i sprovave,**
4. **Është më e vogël lëvizshmëria e popullsisë,**
5. **Është më e vogël mundësia e fshehjes** pas kryerjes së veprës etj.

#### Ad—B – Ndikimi i familjes

Familja është pa dyshim sipas mendimit të shumë autorëve agjensi i parë dhe më i rëndësishëm i socializimit të personalitetit. Në rrethin e familjes fillon zhvillimi psikofizik dhe zhvillimi i individit. Hulumentimet e zbatuara deri më sot, e para se gjithash hulumentimet e psikoanalistëve theksojnë se familja është jo vetëm institucion në të cilin realizohet procesi i socializimit, por familja është faktor nga i cili varet se çfarë personaliteti do të bëhet fëmija. Shumica e psikologëve në fillim të këtij shekulli ishin fuqimisht të bindur se përvojat e përjetuara në vitet para “*moshës së arsyeshme*”, d.m.th. deri në vitin e shtatë të jetesës nuk ndikojnë në formësimin e personalitetit moral të njeriut. Është e saktë se në kujtimin tonë mbetin disa gjurmë të rralla nga ajo periudhë e parë jetësore, prandaj psikologët e atëhershëm konsideronin se personalitetin e bëjnë vetëm aktet e vetëdijshme. Askush nuk është kujdesur për vështërsitë e fëmijës së vogël. Në edukimin e fëmijës i është dhënë prioritet shëndetit të tij fizik. Fëmija është edukuar që të jetë “*i mirë*” dhe “*i dëgjueshëm*”.

Shumë hulumtime kanë treguar pikërisht atë se qëndrimi i përzemërt i prindërve ndaj fëmijës, besimi dhe përkrahja e theksuar në rritje dhe zhvillim, shkaktajnë efekte pozitive në zhvillimin e fëmijës dhe se procesi i socializimit zhvillohet në drejtim të cilin e dëshirojnë prindërit. Disa psikologë perëndimorë të orientuar psikoanalitikë konsiderojnë se asnjë faktor social nuk ka qenë aq i qenësishëm për dukurinë e kriminalitetit si familja. Veçmas kanë theksuar ndikimin e të ashtuquajturës “**familjes së shkatërruar**” në zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës.

Me hulumentimet dhe analizat shumëvjeçare kanë ardhur në konkludim se:

1. Ekziston ndërlidhja e caktuar midis “familjes së shkatërruar” dhe dukurisë së delikuencës tek fëmijët, por ajo është mjaft e vogël.
2. Se “familja e shkatërruar” nuk është as përafërsisht faktor aq i rëndësishëm në etiologjinë e kriminalitetit të të miturve shihet nga të dhënat, se nga numri i përgjithshëm i të miturve të burgosur, vetëm 10% të tyre janë nga “familjet e shkatërruara”. Pra, ndër delinkuentët më shumë ka nga ata të familjeve të pashkatërruara.
3. Nëse i shikojmë arsyet që veprojnë në mënyrë kriminogjene në rrethana të caktuara në “familjen e shkatërruar” shohim se ato janë:
  - **rrethanat materiale në familje,**
  - **dobësimi i disiplinës familjare dhe shtëpiake (fëmijët nuk kanë kontroll adekuat për shkak të punësisë së njërës prindër),**
  - **për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm fëmijët vijnë në kontakt me personat kriminogjenë,**
  - **ndryshimet emocionale në atmosferën e përgjithshme sociale të “familjes së shkatërruar”.**

Ad-C –Ndikimi i **viktimës së veprës penale**.

Ndikim i rëndësishëm i mjedisit që vepron në aktivitetin kriminal është ndikimi viktimës së veprës penale. Me këtë problematikë merret disiplina shkencore **viktimologjia**. Ajo i studion viktimat e veprës penale, personat fizik, si dhe personat juridik – entet, organizatat etj. Kjo është interesante dhe shumë e qenësishme sepse është konstatuar se në shumë raste viktimat ka qenë ajo që si “rrufepritës” i ka tërhequr delinkuentët (alkoolistët nuk janë rastësisht viktimat të xhepushve , të mashtruesve dhe të grabitqarëve të imtë).

Kur flasim për këtë, ajo që vlen për njerëzit vlen edhe për personat juridik. Entet dhe organizatat juridike të siguruarat dobët janë gjithëherë tërheqëse për kriminelët.

## **VEÇORITË KRIMINOGENE TË BASHKËSISË SË GJERË SHOQËRORE**

Çdo bashkësi shoqërore ka shumë karakteristika të gjera dhe të përgjithshme që mund të kenë pak a shumë domethënie kriminogjene. Disa prej tyre janë:

1. **Karakter i eksploatues i kapitalizmit** (vjedhin punëdhënësi, tregtari dhe xhepushi).
2. **Karakter i kompetitiv – garues i marrëdhënieve shoqërore**. Këto, para së gjithash, mendojmë në një tjetërsim të njeriut nga njeriu, marrëdhëniet shoqërore ku “homo homini lupus”, ku sundojnë siç thotë Marksi “ligjet e ujkut të kapitalizmit” këto janë kushte ideale për paraqitjen e kriminalitetit.
3. **Lufta për status** - që të arrihet statusi i caktuar, individët u përvishen veprimeve të caktuara asociale dhe kriminogjene.
4. **Roli i parasë** - në shumë shoqëri paraja luan rol të rëndësishëm, veçmas në kapitalizëm. Paraja kryesisht siguron fuqinë, politikën, statusin dhe për këtë arsye shumëkush nuk zgjedhë mjetet që të vijë te paraja në mënyrë që t’i plotësojnë kërkesat e veta megalomane.
5. **Qëndrimi negativ ndaj punës** – shumë individë e kanë të qartë se me punën e vetë praktikisht kurrë nuk mund të fitojnë shumë para. Për këtë arsye u përvishen disa mënyrave për ta më të lehta të fitimit të parasë, që sipas rregullës është kriminogjene.
6. **Humbja e mbështetjes shoqërore** . Është e njohur se zhvillimi i shoqërisë dhe urbanizimi shkaktojnë dobësimin e lidhjeve miqësore, familjare me grupet primare. Kjo është një nga arsyet pse humbet mjeti më i natyrshëm i kontrollit social mbi aktivitetin e individit.
7. **Humbet dallimi midis** ndershmërisë dhe kriminalitetit. Kjo është karakteristike për kapitalizmin, kur humbet dallimi midis disa transaksioneve të ndershme afariste dhe kriminalitetit. Ky është i ashtuquajti kriminaliteti i “njerëzve me jakë të bardhë” siç i ka quajtur një kriminolog amerikan, duke menduar në forma të ndryshme të falsifikimeve, të abuzimeve, të fshehjeve etj.
8. **Tolerimi i disa formave të aktivitetit ilegal**. Fjala është për shpërputhjen midis normave morale dhe legale të sjelljes. Veçanërisht është karakteristike forma e “zarfës së kaltërt” (mjekët, licitimet e ndryshme të kurdisura etj.) ose “VIP – lidhjet dhe miqësitë” kur arrihen përfitime dhe beneficione të arsyeshme dhe të paarsyeshme.

## ANALIZA EKOLOGJIKE E KRIMINALITETIT

Ekologjinë mund ta definojmë si shkencë mbi marrëdhëniet hapësinore midis organizmit dhe mjedisit në të cilin ai organizëm jeton. Në fillim të këtij shekulli fillon të flitet për ekologjinë e njeriut që definohet si shkencë mbi marrëdhëniet hapësinore dhe kohore të qenieve njerëzore në mjedisin e dhënë natyror dhe shoqëror. Si njësi e analizës merret popullata më e vogël ose më e madhe që jeton në një territor të caktuar.

Qasja ekologjike në studimin e kriminalitetit paraqitet viteve të njëzeta të shekullit tonë, kurse themelues konsiderohet kriminologu amerikan **Sho** dhe bashkëpunëtorët e tij. Duke zbatuar shumë hulumtime ata aplikojnë nocionin e regjionit delikuent që përveç tjerash e karakterizojnë:

- **kushtet e këqija të banimit,**
- **varfëria,**
- **mobilizimi i madh i popullsisë,**
- **struktura e ulët arsimore dhe profesionale etj.**

Mirëpo, hulumtimet më të reja në fushën e kriminalitetit tregojnë se kriminaliteti është i lidhur me ato variable që shënojnë standardin e lartë jetësor, e jo varfërinë (hulumtimet në Amerikë). Kjo sqarohet me faktin që mjedisi i zhvilluar ekonomik i ofron delikuentit gjasa më të mira që diçka “të përfitojë” me veprën e vet penale.

## KRIMINALITETI SI DUKURI INDIVIDUALE

Duke debatuar lidhur me atë se pse dikush bëhet kriminel, e dikush jo, vijmë deri te disa karakteristika individuale të individit të prirur për kriminalitet. Mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha: **veçoritë biologjike dhe psikologjike të personalitetit kriminogjen.**

### 1. Veçoritë biologjike

Do të marrim si shembull gjininë e delikuentit. Nga hulumtimet e deritashme përfundojmë se meshkujt paraqesin pjesën më të madhe të popullatës kriminogjene në krahasim me gratë. Shprehur me numra ky raport shkon prej 3:1 deri 8:1 varësisht nga shteti dhe delikuenca që është bërë. Kjo dukuri sqarohet me pozitën sociale të gruas në shoqërinë bashkëkohore, ku ajo megjithatë është më e mbrojtur nga dridhjet ekonomike dhe sociale.

### 2. Veçoritë psikologjike

Ndër karakteristikat e shumta psikologjike të cilave u jepet domethënie kriminogjene do të përmendim **inteligjencinë** dhe **stabilitetin emocional.**

### Inteligjencia

Matjet e para komparative të inteligjencisë së kriminelëve dhe jo kriminelëve tregojnë se ndër kriminelët ekziston një përqindje më e madhe e atyre më pak inteligjentë madje edhe e budallenjve. Mirëpo, me hulumtimet e mëvonshme është konstatuar se ajo diferencë nuk është aq e shprehur sepse supozohet se pikërisht zihen ata që janë më pak inteligjentë. Për këtë arsye inteligjencia jomajft e zhvilluar nuk konsiderohet si faktor

kriminogjen, edhe pse është e sigurt se në disa raste zhvillimi i saj i pamjaftueshëm ka vepruar në mënyrë kriminogjene.

Të gjitha teoritë që përpiqen ta sqarojnë sjelljen devijuese me karakteristika të lindura, me dëmtimet organike ose me inteligjencinë e individit janë konzervative. Kur analizohet materiali i tyre dëshmuar, tregohet se ato i lënë pas dore kushtet shoqërore ose i shëndërojnë në mënyrë jokritike në cilësi “të dhëna” të individit. Për shembull, testet e inteligjencisë u janë përshtatur meshkujve të bardhë nga klasa e mesme; për këtë arsye shumë grupe të paprivileguara, zezakët, emigrantët, gratë dhe të tjerët – shpeshherë kanë koeficiente inferiore të inteligjencisë (Hider, 1978).

### **Stabiliteti emocional**

Të jeshë emocionalisht stabil, do të thotë të reagosh emocionalisht në mënyrë adekuate në të gjitha situatat, qoftë kualitativisht ose kuantitativisht (kualitativisht , p.sh. në varrimin e dikujt të ndjesh pikëllimin, kuantitativisht – në ato momente nuk duhet menduar për vetëvrasje).

Për personat emocionalisht jostabil është karakteristike që e humbin lehtë kontrollin mbi sjelljen e vet dhe veprojnë emocionalisht në mënyrë impulsive dhe joadekuate. Shembull më drastik për këtë është vrasja nga afekti ose siç e quan Ligji penal “vrasje në çast”. Vrasësi kryen krimin në gjendje të njëfarë lloji “marrëzie emocionale” të përkohshme. Mirëpo, për fat, nuk përfundon çdo jostabilitet emocional me vrasje. Në rastet më të shpeshta çdo gjë përfundon me delikte, siç është rrahja, lëndimi, hakmarrja etj.

## **PROBLEMET E MOTIVIMIT KRIMINAL**

Duke studiuar sjelljen psikologjikokriminale nga aspekti individual – psikologjik imponohet një nga çështjet themelore, e kjo është çështja e motivimit kriminal. Pse disa individë në disa situata bëhen delikuentë, e të tjerët jo? E dimë se gjatë të kuptuarit të motivimit të njeriut në rend të parë e vejmë kategorinë **dëshirat**. Dëshira prapë ka dy ndarje dy pjesë:

1. Pjesa e parë përfshin ato procese biologjike, sociale dhe psikologjike që shkaktojnë paraqitjen e dëshirës në vetëdijen tonë (nevoja, ndjenja, dëshira), dhe

2. Pjesa e dytë përfshin ato procese që shkaktojnë ndërmarrjen ose mosndërmarrjen e aksioneve për plotësimin e dëshirave.

Poeti Emerson ka thënë: “Nuk ka krim që nuk e kam dëshiruar!” E ka dëshiruar, por nuk e ka kryer. Dhe kjo është poenta e kësaj thënieje.

Dëshirat vërshojnë, zgjasin dhe ndryshohen. Disa realizohen, disa jo. Problemi psikokriminal është pikërisht realizimi i atyre dëshirave, e në analogji me këtë na imponohen pyetjet, pse pjesa më e madhe e njerëzve nuk bëhen delikuentë? Pse nuk bëjnë vepra penale? Do t'i cekim disa arsye:

1. **Nuk kanë dëshira të gabueshme** (gjë që është karakteristike e njerëzve normalë, nuk do t'u paraqiten dëshira të gabueshme).

2. **Nuk kanë raste** (thuhet se rastet e bëjnë njeriun hajn, p.sh. s'është e thënë që arsimtarët të jenë më të ndershëm se ekonomistët të cilët kryesisht punojnë me para).

3. **Nuk kanë dijeni, shkathtësi dhe shprehi** (thyerja e arkës, prodhimi i heroinës etj).

4. **Nuk kanë energji dhe këmbëngulësi** (përcjellja shumëditëshe e viktimës).

5. **Nuk kanë qëndrueshmëri emocionale** (për shumë vepra penale nevojitet qëndrueshmëria emocionale që t'i mposhtë ndjenjat eventuale të mëshirës, p.sh. tek disa vrasje politike, etj).

6. **Kanë një sistem të ndërtuar të normave morale** (fjala është për sistemin e internacionalizuar mirë të normave morale – **vetëdija jonë** – që “na brenë” edhe atëherë kur këtë nuk e dëshirojmë).

7. **Kanë frikë nga sanksionet dhe dënimet.** ( frika që të mos na zënë dhe të na dënojnë është “kufiri i fundit” që na pengon të mos kryejmë ndonjë veprim kriminal).

Në të cilën mënyrë delinkuenti ia del ta mposhtë frikën nga sanksionet për veprën e kryer:

1. Ndhmësit për mposhtjen e frikës janë **afektet** (vrasja).
2. **Optimizmi kriminal** – shumë kriminel shpresojnë se kurrë nuk do të kapen.
3. **Rreziku i parallogaritur** - pa rrezik nuk ka fitim.
4. **Ekzistimi i sistemit tjetërfare të normave morale** (hakmarrja e gjakut).

Të gjitha veprat penale mund t'i ndajmë në dy grupe:

- a) **Të qëllimshme:** janë të motivuara nga interesi, hakmarrja, ndihma e të tjerëve, detyra, mbrojtja, kënaqja seksuale, kërshtëria.
- b) **Veprat e paqëllimshme:** ato që janë bërë pa vullnetin e subjektit: ndodhin për këto arsye: pakujdesia, rastisja, mosdija, hutia, impulsi afektiv, çrregullimi shoqëror.

## KAPTINA 15.

### PSIKOLOGJIA E KOMUNIKIMIT

Komunikimi tek njeriu është mjaft intensiv, kompleks dhe i llojlojshëm. Ai edhe për nga shpeshtësia tejkalon komunikimin shprehimisht të kafshëve. Ai është përcjellës i përhershëm i aktivitetit të njeriut. Pothuaj në të gjitha format e sjelljes së njeriut është i përfshirë. Kur nuk komunikim me njerëzit e tjerë, njeriu i drejtohet vetvetes, komunikim me veten. Komunikimi tek njeriu është mjaft i zhvilluar, i ngritur dhe kompleks. Ai mbështetet edhe në shenja që janë vetëm sinjale, por para së gjithash mbështetet në simbole. Simbolet që njeriu i shfrytëzon në komunikimin e vet janë mjaft të shumta dhe të ngritura në sisteme komplekse.

Komunikimi, pastaj, është shumë i llojlojshëm dhe realizohet me anë të mjeteve të ndryshme. Për njeriun është karakteristik komunikimi me fjalë. Por nuk realizohet vetëm me fjalë por edhe me figura, skema dhe shenja të ndryshme arbitrare. Lloji i rëndësishëm i komunikimit të njeriut është komunikimi joverbal me anë të llojeve të ndryshme të lëvizjeve si dhe me anë të pozitës në hapësirë. Në sajë të shfrytëzimit të mjeteve teknike komunikimi i njeriut nuk është vetëm komunikim me anë të kontaktit të drejtpërdrejtë, sy më sy, por arrin prej një personi deri te personat e tjerë në largësi që ndonjëherë nuk mund të merren me mend.

Komunikimi ka tek njeriu funksionin ekspresiv dhe apelativ. Me shenja të ndryshme, me lëvizje ekspresive të fytyrës, të trupit dhe të pjesëve të tij, mund të shprehen dhe nga ana e personave të tjerë të regjistrohen gjendjet e shumta të brendshme të njeriut: emocionet, qëndrimet, karakteristikat e personalitetit.

Si funksione të komunikimit tek njeriu mund të dallojmë ato funksione që i kanë shenjat, simbolet dhe sinjalet, që njeriu i shfrytëzon gjatë komunikimit. Zakonisht ceken tri funksione:

- funksioni i reprezentimit, - që konsiston në atë që shenja të qëndrojnë në vend të diçkahit, zëvendëson diçka; atë funksion e kanë edhe simbolet edhe sinjalet;
- funksioni i komunikimit – që mbështetet në faktin që shenjat janë bartës dhe përcjellës të domethënies; këtë funksion e kryejnë simbolet,
- funksioni shprehës – manifeston gjendjet dhe veçoritë e brendshme të njeriut edhe kur nuk ka për qëllim që të komunikojë për këte; ky funksion është e lidhur me sinjale (E.L. Hartley dhe R.E. Hartley 1959, fq. 16)

#### Llojet e komunikimit janë:

- **Intrapsikik:** ajo që ndodhë në kuadër të psikikës, që është e origjinës psikike dhe zhvillohet në kudër të saj me theksim që proceset të mos përhapen më tej:
  - a) transcendent



- b) intrapersonal
    - reversibil (çdo gjë që thuhet mund të tërhiqet),
    - diskret (nuk shkojnë nga jashtë)
  - **interpersonal** (disa ose 5-6 njerëz)
  - **publik**(një person me shumë njerëz)
  - **masovik** (me anë të mediave dhe të kontrollit)
- } ireverzibile

Komunikimi i njeriut është i shumëllojshëm. Është e mundur, para së gjithash, të dallohet komunikimi verbal ose linguistik nga komunikimi joverbal ose jolinguistik. I pari është me anë të fjalëve gojore ose të shkruara. Si sistem të simboleve komunikimin verbal karakteristika për ndonjë komunitet kulturor, e quajmë gjuhë. Komunikimi joverbal mbështet në lëvizje dhe në raporte hapësinore. Komunikimi joverbal është i ashtuquajtur komunikimi paralinguistik që lidhet me shqiptimin e fjalëve, por nuk është në bazë të përmbajtjes së fjalëve.

Është e mundur të dallohen llojet e komunikimit edhe në bazë të kriterëve të tjera. Në bazë të asaj se komunikimi a realizohet me shfrytëzimin e ndonjë mjeti teknik ose pa të dallohet komunikimi i indirekt dhe i drejtpërdrejtë. Edhe pse kuptuar tekstualisht nuk ka komunikim të drejtpërdrejtë, sepse edhe për bisedë sy më sy nevojitet ajri si bartës i zërit, për komunikim të drejtpërdrejtë flasim kur nuk ka shfrytëzim të aparaturës teknike. I tillë është edhe komunikimi me anë të stabilimenteve të veçanta, për shembull me anë të telefonit ose të porositve telegrafike.

Komunikimi indirekt i dedikohet një numri të madh personash, komunikim masiv, sepse gjithmonë realizohet përmes disa mjeteve për t'iu drejtuar masave. Mund të jetë me anë të komunikimeve të ndryshme masovike: të shtypit, filmit, radios, televizionit.

Me komunikimin njëkahor, në kuptim të veçantë mund të shënohet edhe komunikimi i pasuksesshëm ku bashkëbiseduesit nuk reagojnë në përmbajtjen reale të komunikimit por, duke mos u kujdesur për atë që komunikohet, paraqesin dhe diskutojnë vetëm për atë që kanë dashur ta thonë.

Formalisht komunikimi i tillë është dykahor dhe reciprok, por realisht është njëkahor. Që të mund të flasim për komunikimin e suksesshëm, është e nevojshme që ai i cili e merr porosinë të kuptojë çka porosit komunikuesi me anë të saj dhe në reaksionin e vet kthyes të kujdeset për atë përmbajtje.

Komunikim i suksesshëm është procesi që bën një varg komunikimesh dhe reagimesh reciproke, me ç'rast secili prej pjesëmarrësve komunikimin e vet e formon sipas reagimit të pjesëmarrësit tjetër në të. Komunikimi i suksesshëm s'është e thënë të shpie në pajtimin e mendimeve, por duhet të paraqesë shkëmbimin real të mendimeve. Sipas këtij kriteri është e mundur, pra, të dallohet komunikimi i suksesshëm dhe i pasuksesshëm.

Dallim psikologjikisht i rëndësishëm qëndron midis komunikimit interpersonal dhe intrapersonal. Komunikimi sipas definicionit është interpersonal, manifestim i shenjave ndaj të cilave reagon personi tjetër, e nëse shenja është simbol – përcjellja e domethënies prej një personi tek tjetri. Por është e mundur që simbolet t'i dërgohen edhe vetvetes. Duke i shfrytëzuar simbolet verbale njeriu vetvetes ia paraqet arsyet dhe kundërsarset për atë që të pranojë ose të mos pranojë diçka, të bëjë ose të mos bëjë diçka. Në këtë mënyrë e orienton sjelljen e vet dhe bën vetëkontrollin. Kjo, sipas rregullës, nuk

është vetëm vetëkritikë, por edhe kontroll i internacionalizuar shoqëror sepse përmbajtjet e të folurit të brendshëm rregullisht lidhen me botëkuptimet dhe normat shoqërore.

### **Komunikimi verbal**

Mjeti më i rëndësishëm i komunikimit tek njeriu është të folurit. Të folurit dhe komunikimi foljor ose verbal mbështet në aftësinë e njeriut që të prodhojë zëra (fonema) mjaft të llojllojshme, si dhe në aftësinë që zërat t'i lidhë në grupe që bëhen bartëse të domethënies, në fjalë (morfemë) dhe më tej në sisteme fjalësh.

Të folurit me zë dhe gjuha e ndërtuar mbi të është forma më e rëndësishme e komunikimit të njeriut sepse paraqet sistemin social simbolik. Kjo do të thotë se, me anë të gjuhës së caktuar, me gojë dhe me shkrim, mund t'i komunikojnë përjetimet e veta dhe t'i komunikojnë njohuritë e veta një rreth i gjerë individësh, të gjithë ata që i takojnë një komuniteti të caktuar gjuhësor dhe që e kanë përvetësuar domethënien e kombinimeve të zërave të gjuhës së caktuar dhe rregullat e ligjet e përdorimit të tyre.

Të folurit dhe gjuha janë mjet i rëndësishëm i komunikimit, është thënë, sepse shenjat që i shfrytëzon (fjalët), janë bartëse të domethënies, të të ashtuquajturës domethënies denotative.

Domethënia denotative është domethënie që është e njëjtë për të gjithë ata që e shfrytëzojnë gjuhën e caktuar. Fjalët posedojnë, sipas rregullës, edhe një domethënie plotësuese, të ashtuquajturën domethënien konotative. Domethënien konotative e caktojnë (Kreq D. dhe bashkëpunëtorët, 1972) si ndjenja dhe qëndrime që bashkohen me simbolin.

### **Llojet dhe veçoritë e komunikimit verbal**

Llojet e komunikimit verbal duke pasur parasysh qëllimin janë:

- |   |   |            |
|---|---|------------|
| <ul style="list-style-type: none"><li>- <i>kognitiv</i></li><li>- <i>ekspresiv</i></li><li>- <i>persuaziv</i></li><li>- <i>social</i></li></ul> | } | komunikimi |
|---|---|------------|

Veçoritë e komunikimit verbal janë:

- fjalët janë pasqyrim simbolik i mendimit;
- domethënia e fjalëve është me marrëveshje;
- kuptimi zhvillohet nga konteksti verbal në të cilin përdoret fjala;
- komunikimi verbal në pjesën më të madhe është nën kontrollin e vetëdijes.

### **Komunikimi joverbal**

Për njeriun është karakteristik komunikimi verbal. Por as te njeriu komunikimi nuk është vetëm verbal. Njeriu shfrytëzon vazhdimisht edhe shenjat joverbale siç janë theksimi i tingujve përkatës gjatë të folurit, pauzat dhe dallimet në ritmin e të folurit dhe

variacionet e tjera përcjellëse gjatë shqiptimit të fjalëve. Por njeriu shfrytëzon forma të ndryshme joverbale të sjelljes jo vetëm si plotësim i të folurit por edhe si mënyra të pavarura dhe mjaft të shpeshta dhe të rëndësishme të komunikimit: ndryshimi në shprehjen e fytyrës dhe të lëvizjeve, prekja trupore dhe dallimet në distancën nga personi tjetër, orientimi dhe mbajtja e shikimit. Disa prej këtyre shenjave shërbejnë si sinjale, disa si simbole e shumë prej tyre edhe si simbole edhe si sinjale. Mund të jenë bartëse të domethënies mjetet me anën e të cilave dërgohen porositë e përmbajtjes së caktuar. Por shpeshherë janë vetëm shprehje e paqëllimshme e ndonjë gjendjeje të organizmit: të ndjenjës pozitive ose negative, të disponimit, të simpatisë dhe të dashurisë ndaj dikujt ose urrejtje dhe armiqësi ndaj personit të caktuar (Argyle, 1975.)

Komunikimi joverbal thekson, përsërit, zëvendëson, plotëson dhe i kundërvihet komunikimit verbal.

Komunikimi joverbal ka funksion të shumëfishtë. Përveç të tjerash:

- a) ofrimi i informatave lidhur me atë se personi tjetër a po e përcjell me kujdes çka i komunikon bashkëbiseduesit – p.sh. me lëvizjen e kokës;
- b) shënimi i momentit kur gjatë konverzimit duhet të merret fjala dhe të flitet, e kur të ndërpritet të folurit dhe të dëgjohet, sinkronizimi i komunikimit me fjalë të tjera, p.sh. me anë të lëvizjeve të ndryshme me të cilat shënohet miratimi ose mosdurimi ;
- c) Shprehja e qëndrimeve reciproke personale, pozitive dhe negative – p.sh. me afrimin ose largimin reciprok në komunikim;
- d) ilustrimi i përmbajtjes së komunikimit verbal – për shembull me mbështetjen e ndonjë aksioni me anë të lëvizjes;
- e) dhënia e informatës retroaktive lidhur me reagimin në komunikatën e dhënë, duke informuar, përveç tjerash, a është kuptuar çka ka thënë bashkëbiseduesi, a pajtohet me të ose jo, a i besohet ose jo – shumë shpesh me anë të formave të caktuara të ekspresionit facial;
- f) zëvendësimi për komunikatën që përndryshe paraqitet me anë të shenjave verble – siç është shfrytëzimi i shenjave të gjesteve tek shurdhmemecët;
- g) komunikimi për vetveten, njoftimi për personalitetin e vet, me qëllim ose pa qëllim – p.sh. me mënyrën e caktuar të veshjes në mënyrë që të vihet në dukje roli shoqëror vetanak ose (paqëllimshëm) manifestimi me anë të mënyrës së reagimit emocional të veçorive të temperamentit;
- h) funksioni mjaft i shpeshtë dhe mjaft i rëndësishëm – ekspresioni i emocioneve, shprehja e të cilave është pjesë përbërëse e reagimit emocional, e që njeriu i shfrytëzon edhe si shenja sociale që është në gjendje edhe t'i kontrollojë, - i shërbejnë kësaj, përveç begatisë së shprehjes faciale, edhe shenja të tjera të shumta joverbale (Argyle, 1969).

### **Aspektet e komunikimit joverbal**

Dallojmë këto aspekte të komunikimit joverbal:

- *Ekspresioni vokal* - aspekt i fuqishëm i komunikimit verbal janë melodika (lartësia e zërit), dinamika (fuqia e zërit), ritmika (ritmika e sinjalit) , agogika (metrika, shfrytëzimi pauzave, frymëmarrja, këndimi dhe çdo gjë që zëri i njeriut është në gjendje të prodhojë).

- *Ekspresioni facial* – sipas shumë hulumtuesve aspekti më i rëndësishëm i sjelljes joverbale është shprehja e fytyrës. Olport konsideron se kjo është qendra e përjetimit të vetes, kurse Birdvistel i ka veçuar 250 000 shprehje të ndryshme të njeriut. Struktura specifike e shprehjes faciale jep vulën individuale të çdo njeriu.
- *Ekspresioni i gjestikular* – është studimi i lëvizjeve të duarëve në komunikim dhe ka të bëjë me sjelljet që nuk kanë domethënie absolute vetvetiu, por i fitojnë në kontekstet dhe në raportet e caktuara.
- *Ekspresioni postural* – pesë pozitat themelore të trupit janë: qëndrimi në këmbë, qëndrimi ulur, qëndrimi galuc, qëndrimi gjunjazi dhe qëndrimi shtrirë dhe janë njësi themelore nga të cilat kombinohen të gjitha pozitat e tjera.
- *Ekspresioni proksemik* – edhe studimi i kontakteve trupore, në rastet më të shpeshta rënditet në format më primitive të pozitës joverbale të njeriut.
- *Sjellja spaciale* – lëvizja në njëfarë mënyre është ekzistimi në hapësirë. Ajo i bashkon, por edhe i drejton të gjitha format e tjera të shprehjes në hapësirë. Me termin sjellje spaciale nënkuptohet afërsia, orientimi, sjellja territoriale dhe lëvizjet në rrethinën fizike.
- *Ritmi* – ajo që është shumë e qenësishme, jo vetëm në hulumtimin e të hecurit, por edhe në hulumtimin e komunikimit joverbal në përgjithësi janë ritmi dhe shpejtësia e sjelljes shprehëse, për të cilat konsiderohet se në të njëjtën kohë janë ekspresive, por edhe të integruara në faktorin organizues të një personaliteti.
- *Lëvizja në hapësirë* – lëvizja është makro njësi e analizës joverbale. Sipas Olportit ekzistojnë shtatë forma të matshme të hecjes: rregullsia, shpejtësia, forca, gjatësia e hapit, elasticiteti, caktimi i drejtimit dhe ndryshueshmëria. Në bazë të tyre mund të manifestohen karakteristikat e caktuara të karakterit, gjë që mundëson edhe vlerësimin e tyre.
- *Veshja dhe aspektet e tjera të dukjes* – veshja dhe stolitë e ndryshme trupore gjenden nën kontrollin e atij që i mban (për dallim nga flokët dhe ngjyra e lëkurës që vetëm pjesërisht mund t'i kontrollojë).
- *Shkarravitja, vizatimi dhe pikturimi* – studimi i shprehjes simbolike të njeriut tregon se çdo gjë mund të marrë edhe domethënie simbolike: objektet natyrore, bimët, kafshët dhe sjelljet e llojllojshme të njeriut.

### **Dallimet dhe lidhjet midis komunikimit verbal dhe joverbal**

Midis komunikimit verbal dhe joverbal ekzistojnë dallime. Argajl (Argyle, 1969) cek këto katër dallime kryesore:

1. të folurit është veçanërisht i përshtatshëm për komunikim të karakteristikave të objekteve dhe të personave, kurse komunikimi verbal për shprehjen e emocioneve, të qëndrimeve interpersonale dhe të disa aspekteve të tjera të raporteve interpersonale, veçmas kur është jotaktike që emocionet dhe qëndrimet të komunikohen në mënyrë direkte;
2. komunikimin gjuhësor e drejtojmë në mënyrë të vetëdijshme dhe sipas planit, kurse komunikimi verbal shpeshherë është i pavetëdijshëm ose joplotësisht i

vetëdijshëm, më tepër spontan, shpeshherë i paqëllimshëm dhe më i lirshëm se kontrolli i personalitetit;

3. për të folurit është i nevojshëm aktiviteti i pjesëve të caktuara të sistemit qendror nervor, kurse bazë për një pjesë të konsiderueshme të komunikimit joverbal është aktiviteti i qendrave të caktuara subkortikale;
4. të folurit është sistem i kodeve arbitrare në bazë të kombinimit të zërave, (kurse të folurit me shkrim është kombinim i shenjave me shkrim për zërat) për shënimin e objekteve, të raporteve dhe të ideve, dhe shenjat joverbale në një masë të konsiderueshme janë shenja ikonash d.m.th. figurash të objekteve reale ose të pakoduara në bazë të reaksionit të bazuar.

### **Këtyre karakteristikave është e nevojshme t'ju shtohen edhe dy:**

1. fjalët që shfrytëzohen në komunikimin verbal gjithëherë janë bartëse të domethënies, kurse elementet joverbale të komunikimit shpeshherë janë vetëm sinjale me të cilat shprehet gjendja e caktuar e organizmit por nuk bartë dhe nuk komunikon me qëllim ndonjë porosi;
2. me fjalë dhe me kombinimet e tyre kemi mundësi që të komunikojmë njohuritë dhe përjetimet lidhur me shumë veçori të realitetit, raportet e ndërlikuara, idetë e ndryshme që me anë të shenjave joverbale nuk do të ishim në gjendje t'i shprehim, kurse shenjat joverbale, nëse ndonjëherë janë mjet më subtil i shprehjes, para se gjithash janë për shprehjen e disa emocioneve dhe të raporteve interpersonale.

### **Komunikimi interpersonal**

Në procesin mësimor komunikimi interpersonal ka të bëjë me komunikimin direkt të dy ose më shumë personave “sy më sy” dhe nënkupton format e komunikimit verbal, joverbal dhe fizik. Në kuptimin didaktik mund ta përcaktojmë edhe si interaksion në të cilin një person ia prezanton disa përmbajtje personit tjetër në mënyrë që të ndikojë në sjelljen e tij.

Komunikimi interpersonal (personal) shënon të folurit e brendshëm “të folurit” vetvetes ose “të folurit me vetveten” që zhvillohet në brendinë e njeriut (proceset në tru). “Njeriu përpiqet që me anë të komunikimit të brendshëm të vendosë baraspeshën psikike dhe të arrijë stabilitetin kognitiv dhe afektiv”. Pasi që ndodhë brenda subjektit, komunikimi interpersonal përfshin mendimin dhe ndjenjat e tij, proceset e vetëdijshme dhe të nënvetëdijshme.

### **Komunikimi personal dhe apersonal**

Komunikimi interpersonal mund të shënojë interaksionin direkt midis dy ose më shumë personave, e gjithashtu edhe interaksionin tek i cili ekziston ndërmjetësuesi (media). Duke pasur këtë parasysh mund të flasim për komunikimin personal dhe apersonal. Tek ky lloj komunikimi është e dukshme se në ndarje nisemi nga lloji i medias, përkatësisht nga ajo se a është fjala për median e gjallë ose jo të gjallë. Kur dy

ose më shumë persona komunikojnë drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësim të medias, bëhet fjalë për komunikimin personal.

Për dallim nga komunikimi personal, komunikimi apersonal në ndërmjetësimin e vet përfshinë median. Arsimtari tek ky lloj komunikimi shpeshherë paraqitet si medie komplementare. Vlera pedagogjike e komunikimit personal është më e theksuar për shkak të drejtëpërdrejtësisë së saj, prandaj ajo në këtë aspekt është mbi çdo komunikim apersonal.

### **Të dëgjuarit dhe të folurit**

Komunikimi fillon atëherë kur një person i drejtohet tjetrit sepse ka ndonjë nevojë që dëshiron ta plotësojë – diçka që ndodhë tek ai person. Në mënyrë që në procesin mësimor të zhvillohet komunikimi i sukseshëm midis arsimtarit dhe nxënësit, është e nevojshme të verifikohet vazhdimisht çka ka dëgjuar nxënësi dhe si ai e ka kuptuar atë. “Ai, pra, do të reagojë në porosinë e pranuar, e jo në porosinë e dërguar prej nesh”. Për këtë arsye është e domosdoshme të bëhet verifikimi i porosisë së pranuar me anë të kërkesës, të dhënies dhe të marrjes së informatave retroaktive nga bashkëbiseduesi. Biseda zhvillohet me sukses kur jemi të sigurt se bashkëbiseduesi na ka dëgjuar saktë dhe na ka kuptuar drejt. Në suksesin e bisedës ndikojnë disa faktorë, e para se gjithash dërguesi i porosisë, marrësi i porosisë dhe rrethanat në të cilat zhvillohet biseda. Parakusht për bisedën e suksesshme, përveç elementeve tashmë të numëruara, gjithsesi është edhe shkathtësia e tërheqjes së vëmendjes të atij të cilit i dërgohet informata, përkatësisht porosia.

Pasi që situatat në procesin edukativ – arsimor, sipas rregullës, janë situata të takimit të të rriturve me fëmijët, dëgjimi dhe të folurit e drejtuar fëmijëve, na intereson veçanërisht, sepse s’është njësoj se si vepron dëgjimi dhe të folurit tek fëmijët dhe si e pranojnë fëmijët atë. Me fëmijët bisedojmë me sukses kur ata kuptojnë dhe e pranojnë atë që dëshirojmë që ata ta kuptojnë.

### **Shkathtësia e dëgjimit aktiv**

Në jetën e përditshme 50% të komunikimit e përbën të folurit, kurse 50% të dëgjuarit. Ja se si mund të kuptojmë se nuk po dëgjojmë: kur i krahasojmë të tjerët me veten, kur kemi qëndrim negativ ndaj njerëzve (p.sh. kur bashkëbiseduesi është i marrë ose i mërzitshëm...), kur japim këshilla, kur qetësojmë, kur pajtohemi çdoherë, kur mendojmë për atë se si do të përgjigjemi, kur kërkojmë domethënien e fshehur.

#### Llojet e mosdëgjimit:

- *pseudo dëgjimi,*
- *dëgjimi njështrësor,*
- *marrja e fjalës,*
- *dëgjimi në pritë.*

#### Dëgjimi aktiv nënkupton këta hapa:

- të vendoset që të bëhet dëgjimi,
- të shikohet bashkëbiseduesi në sy,

- të pyetet – të parashtrohen pyetje,
- të bëhet parafrazimi,
- të mos flitet shumë – më shumë të dëgjohej,
- të mos ndërpritet personi që flet,
- të shfrytëzohet heshtja - “heshtja është dukat” – atëherë dërgohen shumë më tepër porosi joverbale;
- të shmangen lëvizjet që e pengojnë tjetrin, sepse kjo do të thotë se mungon dëgjimi aktiv.

### **Problemet në komunikimin interpersonal**

1. mekanizmi mbrojtës i atij që dëgjon, diçka që pengon transmetimin e ndonjë porosie, rezistenca që del nga frika nga humbja e autoritetit ose nga e panjohura, kështu që njerëzit dëgjojnë në mënyra të ndryshme;
2. paqartësia e porosisë: diku duhet t’i tregohet diçka në atë mënyrë që atë të mund ta reprodukojë fëmija 6 vjeç;
3. porositë e fshehta – leximi midis rreshtave;
4. statusi – nëse dikush ka rolin e udhëheqësit kjo është më e lehtë;
5. përshtatshmëria e rrethit – nëse është e padenjë mund të jetë problem. Rrethina në të cilën bëhet komunikimi na dërgon porosi të llojit: shefi – vartësi (vetëm do të bisedojmë, nuk ka lidhje me hierarkinë), shefi – vartësi (unë jam shef, ti je vartësi, më dëgjo dhe mos fol). Eprorët, më shumë i shohin në sy vartësit, kurse vartësit shikojnë në dyshe derisa dëgjojnë.
6. armiqësia – emocionet negative – e bëjnë komunikimin më të dobët për shkak të emocionit që ka intensitet të fuqishëm (Pajević, 2005, fq. 19).

### **Çdo stërvitje serioze për zhvillimin e bisedës kërkon që të dëgjohej në pesë plane të ndara në mënyrë të qartë**

1. dëgjimi kontekstual – fjala është për atë që të konstatohet çka është kërkesa reale, nevoja e vërtetë; që të vërehet suaza e bashkëbiseduesit dhe të pyesim për historinë e tij personale;
2. dëgjimi i distancuar – këtu është fjala për atë që duhet të përvetësohet tendenca që vetë t’i indukojmë përgjigjet, t’i seleksionojmë informatat, të kuptojmë përzierjen afektive personale. Mësohet se si gjithnjë e më shumë përhapet dëgjimi personal;
3. dëgjimi analitik – fjala është për identifikimin e motiveve të bashkëbiseduesit, të roleve të tij afektive; për të vërejturit e lojës së tij të agresivitetit, për njohjen dhe lokalizimin e mekanizmave mbrojtës që i hasim tek ai (projeksioni, identifikimi, shmangia, refuzimi, racionalizimi);
4. dëgjimi regulativ – këtu është fjala për kapitalizmin, për zhvillimin e konstruksioneve tona në bazë të asaj që është thënë, për riformulimin, për lehtësimin që bashkëbiseduesi të shprehet. Duhet ditur të dëgjohej pa shqiptimin e gjykimit vetanak, por duhet të bëhet valorizimi dhe të bëhet pranimi pa miratim, dhe të vazhdohej me pyetje të hapura;
5. dëgjimi senzibil – fjala është për atë që të vërehet edhe ajo që është jashtë domenit të verbales, p.sh. gjestet dhe lojërat e shikimit, nga pak si në radar, dhe

kështu të kërkohen indikacionet lidhur me atë që është thënë. Drejtimi i periudhave të heshtjes në bisedë, si porosi joverbale është një nga pikat më të pamiradijshme të stërvitjes për dëgjim. (Pajevic, 2005, fq. 20,210.

### **Rregullat e komunikimit të mirë**

Rregullat e komunikimit të mirë janë:

1. të dihet kush është marrës i porosive, të dihet kush na dëgjon;
2. çka është qëllimi ynë, çka dëshirojmë t'u përcjellim njerëzve me të cilët komunikojmë;
3. të analizohet klima – a janë njerëzit të relaksuar dhe të hapur;
4. të vlerësojmë në kokën tonë çka dëshirojmë t'u porosisim të tjerëve,
5. të komunikohet me fjalorin e atyre të cilëve ua përcjellim porosinë – është karakteristikë e rëndësishme e personalitetit – të dijë t'i përshtatet ndonjë publiku që i drejtohet;
6. nëse dikush nuk e ka kuptuar, atëherë atë duhet t'ua sqarojmë njerëzve të cilëve ua përcjellin;
7. nëse reaksioni edhe më tej është negativ, nuk do të sillemi në mënyrë agresive dhe të përsërisim të njëjtin tregim – për shembull *ndoshta nuk jam shprehur mirë* – do të përpiqem përsëri.



## **PËRMBAJTJA**

### **FAQE**

PARATHËNIE.....	2
1. ÇKA ËSHTË PSIKOLOGJIA?.....	4
2. METODAT DHE TEKNIKAT E HULUMTIMIT NË PSIKOLOGJI..	12
3. PSIKOLOGJIA E SJELLJES DHE E ZHVILLIMIT TË BISEDËS INFORMATIVE ME PERSONA TË DYSHUAR.....	23
4. BAZAT ORGANIKE TË JETËS PSIKIKE TË NJERIUT.....	39
5. PERSONALITETI.....	49
6. MOTIVACIONI.....	60
7. EMOCIONET.....	68
8. INTELEGJENCIA.....	79
9. NDIJIMET DHE PERCEPTIMET.....	85
10. TË MENDUARIT.....	101
11. TË MËSUARIT, KUJTESA, HARRESA.....	107
12. ÇRREGULLIMET PSIKOLOGJIKE.....	120
13. STRESI DHE SHËNDETI TRUPOR.....	122
14. PSIKOLOGJIA SOCIALE DHE KRIMINALITETI.....	127
15. PSIKOLOGJIA E KOMUNIKIMIT.....	136